

**MODERNIZIMI I SKEMËS SË “NDIHMËS
EKONOMIKE” ME ANË TË ADMINISTRIMIT TË
REGJISTRIT ELEKTRONIK KOMBËTAR DHE
SISTEMIT TË PIKËZIMIT NË REPUBLIKËN E
SHQIPËRISË**

Marsida Agron HAXHIU

Dorëzuar

Universitetit Europian të Tiranës

Shkollës Doktorale

Në përmbushje të detyrimeve të programit të Doktoraturës në Shkenca
Juridike, me profil E Drejtë Civile, për marrjen e gradës shkencore
“Doktor”

Udhëheqës shkencor: Prof. Assoc. Dr. Andon KUME

Numri i fjalëve: 50 914

Tiranë, Janar, 2021.

DEKLARATA E AUTORËSISË

Nën përgjegjësinë time deklaroj se ky studim është shkruar prej meje, nuk është prezantuar asnjëherë përpara një institucioni për vlerësim dhe nuk është botuar asnjëherë. Studimi nuk përmban material të shkruar nga persona të tjerë, përveç rasteve të cituara dhe referuara. Pikëpamjet e shprehura në këtë studim janë të autorit dhe nuk pasqyrojnë domosdoshmërisht pikëpamjet e ndonjë prej institucioneve të përfshira në këtë studim.

Emër Mbiemër: Marsida Haxhiu

Firma_____

© Të gjitha të drejtat i rezervohen autorit. Ndalohet botimi i plotë ose i pjesshëm, kopjimi, futja në internet apo transmetimi në forma të tjera elektronike dhe/ose çdo formë tjetër qarkullimi tregtar i këtij botimi, pa lejen përkatëse me shkrim të autorit.

ABSTRAKTI

Modeli dominues i Shërbimeve Shoqërore në Shqipëri është përqëndruar në shpërndarjen e pagesave cash të ndihmës ekonomike, si një mjet për të adresuar kompleksitetin e varfërisë dhe problemet sociale. Ky model *synon zbutjen e varfërisë dhe minimizimin e përjashtimit social për komunitetet, grupet, familjet dhe individët në nevojë nëpërmjet riintegrit social.*

Në këtë punim trajtohet Modernizimi e *Skemës së Ndhmës Ekonomike me anë të administrimit të Regjistrat Elektronik Kombëtar dhe Sistemit të Pikëzimit.*

Ka tre arsye pse vendosa (në statusin e Drejtueses Rajonale të Shërbimit Social Shtetëror të Qarkut Elbasan prej vitit 2013 dhe në vazhdim, kohë e cila përkon me zbatimin e kësaj reforme) të trajtoj këtë temë:

Së pari, në një hulumtim të modaliteteve për realizimin e reformës së NE-së, (*qëllimi kryesor i së cilës është zbutja dhe lehtësimi i varfërisë*), evidentohet fakti se disa aspekte të ndryshme të kësaj reforme *kanë nevojë ende të rregullohen përmes rregullash juridike, të cilat përbëjnë atë që sot quhet “e drejta e ndihmës ekonomike”.*

Së dyti, detyrimet e shtetit shqiptar në integrimin drejt BE-së kanë kushtëzuar marrjen edhe të masave legislative në drejtim të reformës të së drejtës së ndihmës ekonomike si një e drejtë bazike e individit.

Së treti, zbatimi i ligjeve, për të cilat tashmë studiuesit, politikanët dhe qytetarët mendojnë se përgjithësisht janë ligje të mira mbartin me vete një sfidë të vërtetë për t'u zbatuar, gjë që kërkon konsolidimin e praktikave të mira, veçanërisht në komunikimin mes qytetarëve dhe pushtetit.

Evidentimi i problematikave të mësipërme jo vetëm ishte arsyeja pse zgjedha të trajtoj reformimin e skemës së NE-së, por edhe përcaktuan strukturën e këtij punimi, që pretendon të sjellë një trajtim të hollësishëm juridik të gërshëtuar dhe me analizën financiare. Metodologjia e ndjekur është ajo analitike, kërkimore, empirike etj.

Fusha: *politika sociale, mbrojtja dhe mbështetja sociale, ndihma ekonomike, modernizimi i skemës së NE-së, Republika e Shqipërisë, Qarku Elbasan.*

Fjalët kyçe: *ndihma ekonomike; regjistri elektronik kombëtar; sistemi i pikëzimit, modernizimi i skemës së NE-së.*

Abstract

The dominant model of Social Services in Albania has been focused on the distribution of cash payments of economic assistance, as a tool to address the complexity of poverty and social problems. This model aims to alleviate poverty and minimize social exclusion for communities, groups, families and individuals in need through social reintegration.

This research is based on the Modernization Scheme of the Economic Assistance through the administration of the National Electronic Register and the Scoring System.

There are three reasons why i decided to address this topic (in the status of Regional Head of the State Social Service of the Elbasan Region from 2013 onwards, a time which coincides with the implementation of this reform):

First, in a research of the modalities for the implementation of the E.A reform (the main purpose of which is the poverty alleviation), it is evident that some different aspects of this reform still need to be regulated through legal rules, which today is called the "right to economic assistance".

Secondly, the obligations of the Albanian state on the road to the EU have conditioned the adoption of legislative measures in the direction of the reform of the right to economic assistance as a basic right of the human right.

Third, the implementation of laws, which researchers, politicians and citizens already think are generally good laws, carries with it a real challenge to be implemented, which requires the consolidation of good practices, especially in communication between citizens and power.

Highlighting the above issues was not only the reason why i chose to do research on the reform of the E.A scheme, but also defined the structure of this research, which claims

to bring a detailed legal treatment intertwined with financial analysis. The methodology followed is analytical, research, empirical etc.

Area: Social Policy, Social Protection and Support, Economic Assistance, Modernization of the E.A Scheme, Republic of Albania, Elbasan Region

Keywords: Economic Assistance; National Electronic Register; Scoring System, Modernization of the E.A Scheme

Andrës...

FALENDERIME

Mirënjohje dhe falenderime kam për kolegët e mi të *Drejtorisë Rajonale të Shërbimit Social Shtetëror Elbasan*, Matildën, Elvën, Dafinën dhe Gerardin të cilët më përkrahën dhe mbështetën gjatë këtij punimi. Gjithashtu falenderoj të gjithë bashkëpunorët e mi të institucioneve në nivel qendror dhe vendor, publikë dhe jopublikë.

Një falenderim të veçantë kam për familjen time për mbështetjen e vazhdueshme si dhe për vajzën time Andrrën të cilës i kërkoj ndjesë pasi kam munguar në kohën që duhet të kaloja me të.

PËRMBAJTA E LËNDËS

Kapitulli I: Hyrje	1
1.1 Arsyet e punimit	1
1.2. Hipoteza dhe pyetjet kërkimore të studimit	3
1.3. Aspektet strukturore dhe metodologjia e punimit	7
 Kapitulli II: Koncepti i të Drejtës së Ndhmës Ekonomike, parë në këndvështrimin e evoluimit të këtij koncepti dhe aspekteve të tij	15
2.1. Vështrim i përgjithshëm historik i politikave sociale jashtë Republikës së Shqipërisë	15
2.2. Vështrimi historik i shtetit social në Republikën e Shqipërisë	18
2.3. Kushtetuta dhe parimet kushtetuese ku mbështetet sistemi i shërbimeve shoqërore ..	21
2.4. Kuptimi dhe efektet e Ndhmës Ekonomike në përgjithësi jashtë Republikës së Shqipërisë	26
2.5. Zanafilla e Ndhmës Ekonomike në Republikën e Shqipërisë	28
 Kapitulli III: Reformimi i të drejtës së ndihmës ekonomike nga viti 2005 deri sot	31
3.1. Filozofia e sistemit të shërbimeve shoqërore dhe fushat e ndërhyrjes	31
3.2. Karakteristikat social-ekonomike të NE-së pas reformës së parë të vitit 2005-së	41
3.3. Analiza e karakteristikave social-ekonomike të NE-së pas reformës së parë të vitit 2005-së	43
<i>Vështirësitë që ndeshnin familjet e ndihmës ekonomike gjatë procesit të aplikimit</i>	<i>43</i>
<i>Niveli i lartë i gabimit në përjashtim gjatë procesit të përzgjedhjes së përfituesve</i>	<i>43</i>
<i>Ndikimi jo shumë i ndjeshëm i ndihmës ekonomike në zbutjen e varfërisë dhe përmirësimin e cilësisë së jetës së përfituesve</i>	<i>44</i>
<i>Aplikimi jofleksibël i masës së përfitimit dhe mungesa e korrelacionit midis masës së NE-së, nivelit të varfërisë si dhe nevojave reale të familjeve të varfëra</i>	<i>45</i>
<i>Sistemi burokratik i mbledhjes së informacionit dhe dokumentacionit që nevojitej për të matur dhe vlerësuar varfërinë në nivel lokal</i>	<i>45</i>
<i>Pamjaftueshmëria e kapaciteteve institucionale dhe burimeve njerëzore, sidomos në nivel rajonal dhe lokal, për të përballuar sfidat e programit të ndihmës ekonomike</i>	<i>46</i>
<i>Mungesa e kompjuterizimit dhe informatizimit të të dhënave</i>	<i>47</i>
<i>Informaliteti dhe paqartësia në shpërndarjen e ndihmës ekonomike në zonat urbane dhe qytetet e mëdha</i>	<i>47</i>
3.4. Analiza e Masave të reformës së parë dhe të dytë të NE-së	48
<i>Kush përfitoi nga ky sistem pilotimi?</i>	<i>58</i>

3.5. Nevojat e reformës së dytë të ndihmës ekonomike në vitin 2012 dhe në vazhdim.....	59
3.6. Risitë e reformës së dytë të ndihmës ekonomike në vitin 2012 dhe në vazhdim	61
<i>Regjistrin elektronik të të dhënave</i>	<i>63</i>
<i>Formulën e pikëzimit.....</i>	<i>64</i>
<i>Kategoritë e tjera të skemës së ndihmës ekonomike.....</i>	<i>65</i>
<i>Mbështetja me pagesa shtesë</i>	<i>66</i>
<i>Shërbimin e kujdestarisë së përkohshme</i>	<i>67</i>
<i>Grupet e favorizuara për përjashtim nga llogaritja e të ardhurave.....</i>	<i>69</i>
<i>Familjet në proces zgjidhje martese.....</i>	<i>70</i>
<i>Trefishimin dhe më tepër të shumës së përfitimit</i>	<i>70</i>
<i>Familjet e reja përfituese.....</i>	<i>71</i>
<i>Fondin e kushtëzuar</i>	<i>73</i>
<i>Tërheqjen e ndihmës ekonomike nga bashkëshortja</i>	<i>74</i>
<i>Kufizimin në kohë për qëndrimin në skemën e ndihmës ekonomike</i>	<i>75</i>
3.7. Masa dhe llogaritja e përfitimit të NE-së pas reformës së vitit 2012 dhe në vazhdim..	75
3.8. Vështrim i përgjithshëm i paraqitjes së Aplikimit për Ndhmë Ekonomike	78
<i>Hapi i parë: Prezantimi i kërkesës për aplikim.....</i>	<i>78</i>
<i>Hapi i dytë: Rregjistrimi i aplikimit dhe procesi i intervistimit</i>	<i>81</i>
<i>Hapi i tretë: Miratimi i vendimit për familjet/individët në nevojë që do të trajtohen me NE nga Këshillat Bashkiakë</i>	<i>83</i>
<i>Hapi i katërt: Verifikimi i të dhënave në sistem</i>	<i>84</i>
<i>Hapi i pestë: Ekzekutimi i refuzimit të aplikimit dhe dhënies së ndihmës ekonomike</i>	<i>88</i>
<i>Hapi i gjashtë: Transparenca e sistemit të përfitimit të ndihmës ekonomike sipas skemës së re të dixhitalizimit.....</i>	<i>88</i>
<i>Hapi i shtatë: Ruajtja dhe arkivimi i dokumentacionit.....</i>	<i>89</i>
<i>Të tjera.....</i>	<i>89</i>
<i>Kërkesat për marrjen e informacionit mbi statusin e aplikimit.....</i>	<i>90</i>
<i>Komunikimi me sisteme të institucioneve të tjera.....</i>	<i>90</i>
3.9. Proçedurat e kontrollit të skemës së dixhitalizimit të NE-së pas reformës së vitit 2012 dhe në vazhdim.....	91
<i>Proçedurat e kontrollit të skemës së dixhitalizimit të NE-së pas reformës së vitit 2012 ...</i>	<i>91</i>
<i>Proçedurat aktuale të kontrollit të skemës së dixhitalizimit të NE-së</i>	<i>93</i>
3.10. Proçedurat e ankimimit administrativ të NE-së pas reformës së vitit 2012 dhe në vazhdim	103
3.11. Mekanizmat e standartizuar antikorrupsion.....	104

Kapitulli IV: Analiza e ndihmës ekonomike përgjatë vitit 2019-2020.....	108
4.1. Risi të tjera aktuale të legjislacionit të NE-së	108
4.2. Analiza e masave ekonomike.....	114
4.3. Riintegrimi në tregun e punës	119
4.4 Efektiviteti i reformës së Skemës të Ndihmës Ekonomike në Qarkun Elbasan.....	126
<i>Karakteristikat social-ekonomike të Qarkut Elbasan.....</i>	<i>126</i>
<i>Analiza e masave ekonomike.....</i>	<i>129</i>
<i>Ndryshimi i shpeshtë i administratorëve shoqëror.....</i>	<i>132</i>
<i>Riintegrimi në tregun e punës nga Skema e NE-së.....</i>	<i>133</i>
<i>Kategoritë e veçanta përfituese nga Skema e NE-së</i>	<i>136</i>
<i>Niveli i përfitimit të familjeve nga Fondi i kushtëzuar</i>	<i>138</i>
 Kapitulli V: Transparenca e autoriteve përgjegjëse të administratës publike për garantimin e të drejtës së ndihmës ekonomike.....	 140
5.1. Institucionet publike që ofrojnë informacion në procesin e përfitimit të ndihmës ekonomike. Rolet dhe përgjegjësitë e tyre	140
<i>Institucionet në varësi të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale</i>	<i>140</i>
<i>Ministria e Financave.....</i>	<i>142</i>
<i>Institucionet në varësi të Ministrisë së Brendshme</i>	<i>142</i>
<i>Avokati i Popullit.....</i>	<i>144</i>
<i>Institucionet shtetërore të nivelit të dytë.....</i>	<i>145</i>
<i>Strukturat dhe institucionet në nivel njësie vendore.....</i>	<i>146</i>
<i>Këshilli i Qarkut.....</i>	<i>146</i>
<i>Prefekti</i>	<i>146</i>
<i>Bashkia</i>	<i>147</i>
5.2. Etika e administratorit shoqëror	152
<i>Elementet e Etikës</i>	<i>153</i>
<i>Parimet e etikës.....</i>	<i>153</i>
<i>Problematikat konkrete në etikën e administratorit shoqëror dhe qëndrimi i drejtë i tij ..</i>	<i>156</i>
 Kapitulli VI: Analiza e akteve ndërkombëtare që rregullojnë të drejtën e ndihmës ekonomike	 163
6.1. Aktet Ndërkombëtare të Kombeve të Bashkuara.....	164
<i>Karta e Kombeve të Bashkuara.....</i>	<i>164</i>

<i>Deklarata Universale për të Drejtat e Njeriut</i>	<i>165</i>
<i>Konventa për të Drejtat e Fëmijës</i>	<i>166</i>
<i>Pakti Ndërkombëtar për të Drejtat Ekonomike, Shoqërore dhe Kulturore</i>	<i>167</i>
6.2. Aktet ndërkombëtare të nivelit European.....	169
<i>Konventa Europiane për të Drejtat e Njeriut.....</i>	<i>169</i>
<i>Konventa Europiane “Mbi ushtrimin e të drejtave të fëmijëve”</i>	<i>171</i>
<i>Karta Sociale Europiane (e rishikuar)</i>	<i>173</i>
<i>Marrëveshja e Stabilizim Asociimit.....</i>	<i>176</i>
Kapitulli VII: Konkluzione dhe rekomandime	183
7.1. Konkluzione.....	183
7.2. Rekomandime.....	197
SHTOJCAT.....	209
BIBLIOGRAFIA.....	220

Lista e ilustrimeve

<i>Ilustrim1: Roli dhe përgjegjësia e Drejtorisë Rajonale të SHSSH-së në proçesin e vendimarrjes të NE-së.</i>	88
<i>Ilustrim 2: Përbërja e Drejtorisë Rajonale të SHSSH-së të Qarkut Elbasan sipas ndarjes së re administrative.</i>	128

Lista e tabelave dhe grafikëve

GRAFIK 1. Masa mesatare e NE në vitin 2009 dhe 2019 _____	48
GRAFIK 2. Shpërndarja e banorëve sipas Qarkut Durrës, Elbasan dhe Tiranë në vitin 2011 _____	53
GRAFIK 3. Masa mesatare e përfituesve të NE sipas zonave në vitin 2011 _____	54
GRAFIK 4. Lloji i Ndihmës Ekonomike në vitin 2011 _____	54
Tabela 1. Shpërndarja e Ndihmës Ekonomike sipas zonave dhe grupmoshave _____	55
Tabela 2. Shpërndarja e Ndihmës Ekonomike sipas grupmoshave dhe kategorive _____	55
GRAFIK 5. Shpërndarja e fondeve të Ndihmës Ekonomike sipas zonave në vitin 2012 _____	56
GRAFIK 6. Shpërndarja e familjeve përfituese të NE në vitin 2019 _____	116
GRAFIK 7. Shpërndarja e fondit të NE në vitin 2019 _____	116
Tabela 3. Shpërndarja e numrit të familjeve dhe fondit 2 mujor të NE në Shqipëri _____	117
Tabela 4. Fondet dhe përfituesit nga Programi i Ndihmës Ekonomike përgjatë vitit 2019 _____	118
Tabela 5. Të dhënat për targetet e vendosura për punësim për çdo drejtori rajonale për vitin 2019 _____	123
GRAFIK 8. Numri i personave të punësuar sipas Qarqeve në Shqipëri _____	124
GRAFIK 9. Shpërndarja e Ndihmës Ekonomike në Qarkun e Elbasanit viti 2019 _____	129
Tabela 6. Shpërndarja e Ndihmës Ekonomike sipas zonave dhe grup-moshave _____	130
Tabela 7. Shpërndarja e Ndihmës Ekonomike sipas grupmoshave dhe kategorive _____	130
GRAFIK 10. Shpërndarja e fondeve të Ndihmës Ekonomike sipas zonave në vitin 2019 _____	131

LISTA E SHKURTIMEVE DHE E FJALORIT

AK – Aftësi e Kufizuar

AKSHI – Agjensia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit

BE – Bashkimi European

DRSHSSH – Drejtoria Rajonale e Shërbimit Social Shtetëror

DUDNJ – Deklarata Universale për të Drejtat e Njeriut

GDP – Prodhimi i Brendshëm Bruto

IBRD – Banka Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim

INSTAT – Instituti i Statistikave i Republikës së Shqipërisë

KB – Kombet e Bashkuara

KEDNJ – Konventa Europiane e të Drejtave të Njeriut

KiE – Këshilli i Europës

KLSH – Kontrolli i Lartë i Shtetit

KMCAP – Komisioni Mjekësor i Caktimit të Aftësisë për Punë

KRSH – Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë

KDF – Konveta për të Drejtat e Fëmijës

LSMS – Anketa e Matjes së Nivelit të Jetesës

MÇSR – Ministria e Çështjeve Sociale dhe Rinisë

MKR – Mekanizmi Kombëtar i Referimit

MPÇS – Ministria e Punës dhe Çështjeve Sociale

MSA – Marrëveshja Stabilizim Asociim

MSHMS – Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale

MTBP – Program Afatmesëm i buxhetit

NE – Ndihma Ekonomike

NESS – Strategjia Kombëtare për Aftësi

NJA – Njësi Administrative

NJMF – Njësia për Mbrojtjen e Fëmijës

OJF – Organizatë Jo Fitimprurëse

OKB – Organizata e Kombeve të Bashkuara

PAK – Person me Aftësi të Kufizuar

PRS – Program Riintegrimi Social

REPOBA – Rregjistrimi i Popullsisë dhe i Banesave

RSH – Republika e Shqipërisë

SHBA – Shtetet e Bashkuara të Amerikës

SHKP – Shërbimi Kombëtar i Punësimit

SHSSH – Shërbimi Social Shtetëror

SKMS – Strategjia Kombëtare e Mbrojtjes Sociale

SMI – Sistemi i menaxhimit të Integruar

VKM – Vendim i Këshillit të Ministrave

ZKKKT – Zyra e Koordinatorit Kombëtar Kundër Trafikimit

VT – Viktimë Trafikimi

VMT – Viktimë e Mundshme Trafikimi

Kapitulli I: Hyrje

1.1 Arsyet e punimit

Shërbimet Shoqërore janë zhvilluar për të mbrojtur, ndihmuar, fuqizuar dhe parandaluar situatat e abuzimit, dëmtimit, neglizhencës dhe përjashtimit nga sistemi i shërbimeve, varfërisë dhe situatave të krizave, si dhe vulnerabilitetin e individëve dhe familjeve, fëmijëve dhe të rriturve.

Modeli dominues i Shërbimeve Shoqërore në Shqipëri është përqëndruar në shpërndarjen e pagesave cash të ndihmës ekonomike, pagesave të përfitimeve për kategoritë *e ndryshme të aftësisë së kufizuar*, si një mjet për të adresuar kompleksitetin e varfërisë dhe problemet sociale. Ky model *synon zbutjen e varfërisë dhe minimizimin e përjashtimit social për komunitetet, grupet, familjet dhe individët në nevojë*.

Reformimi i sistemit të shërbimeve shoqërore, erdhi si një nevojë dhe kundërpërgjigje ndaj zhvillimeve e ndryshimeve të thella social-ekonomike, juridike dhe strukturore që po kalon shoqëria shqipëtare, si dhe krijimit të kushteve dhe standarteve që garantojnë forcimin e shtetit ligjor, konsolidimin e *ekonomisë së tregut, mbrojtjen e të drejtave të njeriut* dhe ofrimin e shërbimeve sociale.

Në këtë punim do të trajtojmë Modernizimin (reformën) e *Skemës së Ndhmës Ekonomike me anë të administrimit të Regjistrat Elektronik Kombëtar dhe Sistemit të Pikëzimit*. Ka tre arsye pse vendosa (në rolin e Drejtueses Rajonale të Shërbimit Social Shtetëror të Qarkut Elbasan prej vitit 2013 dhe në vazhdim, kohë e cila përkon me zbatimin e kësaj reforme) të trajtoj këtë temë:

Së pari, në një hulumtim të modaliteteve për realizimin e reformës së NE-së (qëllimi kryesor i së cilës është zbutja dhe lehtësimi i varfërisë), evidentohet fakti se disa aspekte të ndryshme të kësaj reforme *kanë nevojë* ende të rregullohen *përmes rregullash juridike, të cilat përbëjnë atë që sot quhet “e drejta e ndihmës ekonomike”*.

Së dyti, detyrimet e shtetit shqiptar në integrimin drejt BE-së kanë kushtëzuar marrjen edhe të masave legislative në drejtim të reformës të së drejtës së ndihmës ekonomike si një e drejtë bazike e individit.

Së treti, zbatimi i ligjeve, për të cilat tashmë studiuesit, politikanët dhe qytetarët mendojnë se përgjithësisht janë ligje të mira mbartin me vete një sfidë të vërtetë për t’u zbatuar, gjë që kërkon konsolidimin e praktikave të mira, veçanërisht në komunikimin mes qytetarëve dhe pushtetit.

Evidentimi i problematikave të mësipërme jo vetëm ishte arsyeja pse zgjodhëm të trajtonim reformimin e NE-së, por edhe përcaktuan strukturën e këtij punimi, që pretendon të sjellë një trajtim të hollësishëm juridik të gërshetuar dhe me analizën financiare. Nëpërmjet strukturës së ndërtuar synohet të jepet analiza konceptuale e të drejtës së ndihmës ekonomike të reformuar mbështetur në legjislacionin shqiptar, e ndërthurur shpesh edhe me problematikat e zbatimit konkret të kuadrit përkatës ligjor të vënë herë pas here përballë rregullimit përmes akteve ndërkombëtare, të cilat normojnë të drejtën e NE-së.

Objekti kryesor i temës është *Modernizimi (reforma) e Skemës së Ndhmës Ekonomike me anë të administrimit të Regjistrit Elektronik Kombëtar dhe Sistemit të Pikëzimit në Republikën e Shqipërisë*, arsye për të cilën pjesa kryesore e punimit i është rezervuar

këtij aspekti, duke mos e shkëputur edhe nga trajtimi i të drejtave të tjera që integrohen me të drejtën për NE-në. Veç kësaj zë një vënd të rëndësishëm edhe trajtimi i akteve ndërkombëtare, kryesisht atyre që janë nënshkruar dhe ratifikuar nga Republika e Shqipërisë, por duke evidentuar edhe legjislacionin e Bashkimit European, përafrimi me të cilin mbetet një detyrim në realizimin e procesit integruar.

1.2. Hipotezat dhe pyetjet kërkimore të studimit

Në përfaqësim të legjislacionit të drejtës së ndihmës ekonomike me aktet ndërkombëtare, ligjvënësit kanë bërë përpjekje maksimale për të garantuar një sistem të NE-së të reformuar sa më efikas, efektiv dhe transparent.

Nëpërmjet këtij punimi, do të shqyrtojmë hipotezat e ngritura, të cilat do të na shërbejnë si pikënisje për evidentimin e problematikave që lidhen me temën objekt studimi.

Për këtë studim ka rëndësi jo vetëm parashtrimi teorik i kuadrit ligjor të NE-së dhe i akteve ndërkombëtare, por dhe pasqyrimi i problematikave, rasteve konkrete të shprehura me Vendime të Këshillave Bashkiak përkatës ose të DRSHSSH-ve përkatëse, dhe gjetja e instrumenteve më të mira për një proces sa më të rregullt ligjor. Të gjitha këto pjesë të strukturës së punimit do t'i shërbejnë hipotezave të tij dhe dhënies së përgjigjeve për pyetjet e ngritura në të.

Hipotezat e këtij punimi kërkimor janë tre, si vijon:

1. Kuadri ligjor i fazës së dytë të zhvillimit të politikës së NE-së ose e quajtur ndryshe faza e zhvillimit përgjatë viteve 2005-2013, (objektivi kryesor i të cilit ishte decentralizimi me qëllim përmirësimin e zbatueshmërisë së procedurave të dhënies së ndihmës, si dhe njëkohësisht realizimin e të drejtave të njeriut), nuk ishte efikas, i paanshëm dhe transparent! Konkretisht bëhet fjalë për *Ligjin nr. 9355, datë 10.03.2005, “Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore” i ndryshuar*.

Pyetjet kërkimore që do të gjejnë përgjigje gjatë parashtrimit të punimit për këtë fazë janë si vijon:

- Ç’farë kuptohet efektivisht dhe praktikisht me termin “e drejtë e ndihmës ekonomike” dhe “skemë apo sistem i NE-së”?
- Kush janë karakteristikat social-ekonomike të NE-së, bazuar në ligjin nr. 9355/2005?
- Përse analiza e karakteristikave social-ekonomike të NE-së konkludon në këtë fazë ekzistencën e një kuadri ligjor jo efikas dhe transparent?
- Përse analiza e masave konkludon se masa e ndihmës ekonomike në këtë fazë nuk ndikon në zbutjen e varfërisë?

- Ç’farë kuptohet me pasivitet të skemës së NE-së në këtë fazë dhe pse ky i fundit nuk ishte efektiv dhe praktik?
2. Kuadri ligjor i fazës së tretë të zhvillimit të politikës së ndihmës ekonomike ose e quajtur ndryshe faza e dixhitalizimit përgjatë viteve 2014-2019, (qëllimi kryesor i të cilit në lidhje me Ndihmën Ekonomike rivjen me një perspektivë të re në drejtim të zbutjes së varfërisë dhe përjashtimit shoqëror duke synuar të ofrojë mundësi të barabarta për përfshirje sociale dhe për zhvillim përmes shërbimeve për një jetesë më të mirë), është efikas i paanshëm dhe transparent! Konkretisht bëhet fjalë për *Ligjin nr. 57 të vitit 2019, “Për asistencën Sociale në Republikën e Shqipërisë”*.

Pyetjet kërkimore që do të gjejnë përgjigje gjatë parashtrimit të punimit për këtë fazë janë si vijon:

- Kush ishin nevojat e NE-së në këtë fazë të tretë të saj që më pas u parashikuan në Ligjin nr. 57/2019?
- Sa efikasë solli Regjistri Elektronik i të dhënave dhe efektiviteti Formula e Pikëzimit, në këtë fazë?
- Kush janë kategoritë e reja që ju shtuan skemës së NE-së dhe që çuan në shënjestrimin më të mirë të përfituesve të kësaj skeme?
- Përse risia e heqjes së llogaritjes të të ardhurave të përfituesve në këtë fazë, çoi në rritjen e *efikasitetit* dhe efektivitetit të ndihmës?
- Ç’farë kuptohet me “mbështetje me pagesa shtesë” në këtë fazë për familjet përfituese të NE-së dhe sa efektive rezultoi kjo risi?

- Risia e nxitjes ndaj shërbimeve shëndetësore (check-up i detyrueshëm), sa efektive rezulton për rimëkëmbjen e familjes?
- Përse analiza e masave konkludon se masa e NE-së në këtë fazë ndikon në zbutjen e varfërisë?
- Kush është risia e Ligjit nr. 57/2019 në lidhje me transformimin e skemës së NE-së nga pasive në aktive?
- Sa efikas dhe efektiv është sot procedura e administrimit, monitorimit dhe vlerësimit të skemës së ndihmës ekonomike?

3. A është legjislacioni i NE-së, në harmoni me aktet ndërkombëtare?

Pyetjet kërkimore që do të gjejnë përgjigje gjatë parashtrimit të punimit për këtë hipotezë janë si vijon:

- Kush janë aktet ndërkombëtare që normojnë të drejtën e NE-së?
- Ekziston përpuethshmëria midis ligjit të brendshëm të ndihmës ekonomike dhe akteve ndërkombëtare?

Me qëllim vërtetimin e këtyre hipotezave, në punim janë studiuar: mënyra se si ka evoluar në Shqipëri kuadri ligjor i të drejtës së ndihmës ekonomike; vështrimi krahasues midis tre fazave të kësaj të drejte; vështrimi i legjislacionit nën dritën e akteve ndërkombëtare në këtë kuadër; problemet e hasura dhe pasqyrimi i tyre; raste të ndryshme të pasqyruara me praktika në këtë fushë...

1. 3. Aspektet strukturore dhe metodologjia e punimit

Metodologjia e përdorur në këtë punim i përgjigjet arritjes së qëllimeve të tij. Në varësi të hipotezës apo të pyetjeve që do të ngrihen në kapitujt e veçantë të punimit, do të zbatohen edhe metodat e hulumtimit shkencor.

*Në shkencat juridike metodat e përdorura kryesisht janë cilësore, për shkak të vetë natyrës së shkencës. Konkretisht në këtë studim do të përdoren **metoda e mbledhjes së të dhënave cilësore, analiza e të dhënave, metodat e përziera cilësore dhe sasore, metoda e analizës dokumentare, studimi i rastit, metoda e analizës dhe krahasimit të legjislacionit, metoda e kërkimit ndërdisiplinor, metoda empirike, metodat sociologjike si ajo statistikore, historike, dhe demografike.***

Punimi, i cili synon të trajtojë pikat e përmendura në paragrafet më lart, do të jetë i ndarë në shtatë kapituj si vijon:

1. Hyrje.
2. Koncepti i të drejtës së ndihmës ekonomike, parë në këndvështrimin e evoluimit të këtij koncepti dhe aspekteve të tij.
3. Reformimi i të drejtës së NE-së nga viti 2005-së deri sot.
4. Analiza e ndihmës ekonomike përgjatë vitit 2019-2020.
5. Transparenca e autoriteve përgjegjëse të administratës publike për garantimin e të drejtës së NE-së.
6. Analiza e akteve ndërkombëtare që rregullojnë të drejtën e NE-së.
7. Konkluzione dhe rekomandime.

Në qendër të kapitullit të parë qëndron qëllimi kryesor strategjik i dixhitalizimit të Skemës së ndihmës ekonomike, që është zbutja dhe lehtësimi i varfërisë (sidomos varfërisë ekstreme).

Vijohet me shqyrtimin e tre hipotezave të ngritura si pikënisje për evidentimin e problematikave që lidhen me temën objekt studimi, pyetjeve kërkimore përkatëse që do të gjejnë përgjigje gjatë shtjellimit të punimit dhe metodave të hulumtimit shkencor të përdorura në varësi të tyre.

Në qendër të kapitullit të dytë shtjellohet evoluimi i konceptit të së drejtës së NE-së, brënda dhe jashtë Republikës së Shqipërisë nëpërmjet metodës historike dhe sociologjike. Konkretisht, në fillimet e konceptit të së drejtës së NE-së, elemente të ndryshëm të mbrojtjes sociale jashtë Shqipërisë, realizoheshin nga vetë familja më pas fisi dhe klani. Vetëm në fund të viteve 1800, mund të flitet për një organizim të sistemit social, sigurime shoqërore të detyrueshme të cilat u dukën në Prusinë e Bismarkut. Ndërsa në RSH ekzistencat e para të elementëve të bamirësisë ofroheshin nga familja, fisi e më pas institucionet fetare (kisha, xhamitë). Forma institucionale e tyre i përket një periudhe relativisht të mëvonshme. Ato janë zhvilluar me krijimin e shtetit pas vitit 1912. Shqipëria nuk trashëgoi nga sistemi i kaluar dhe ai komunist asnjë ligj social megjithëse individët dhe familjet në gjendje risku ishin të shumtë.

Në bazë të trajtimit të këtij kapitulli duke përdorur metodën e analizës së legjislacionit qëndron, *programi i reduktimit të varfërisë, i krijuar dhe zbatuar për herë të parë në maj të vitit 1993* për shkak të rritjes së vazhdueshme të papunësisë, të varfërisë dhe trazirave sociale, i cili funksiononte nën emrin “ndihma ekonomike”. *Kjo është faza e parë e zhvillimit të politikës së NE-së ose e quajtur ndryshe faza përgatitore (1992-*

1996), e cila synonte krijimin e bazës ligjore dhe të instancave përkatëse për zhvillimin e ekonomisë së tregut, ndërsa në planin shoqëror garantimin e mbijetesës. Qëllimi i ligjit ishte që t'u mundësonte ndihmë ekonomike individëve apo familjeve në nevojë, me pagesa cash por edhe me shërbime alternative. NE nuk ishte e mjaftueshme për familjet/individët përfitues e krahasuar me minimumin e standartit të jetesës dhe gjithashtu shkaktonte një ulje të theksuar të motivimit për punë nga personat përfitues.

Në qendër të kapitullit të tretë qëndron faza e dytë e quajtur ndryshe *faza e zhvillimit pas vitit 2000 e ndihmës ekonomike*, objektivi kryesor i së cilës ishte decentralizimi me qëllim përmirësimin e zbatueshmërisë së procedurave të dhënies së ndihmës, si dhe njëkohësisht realizimin e të drejtave të njeriut. Në këtë fazë të dytë deri në vitin 2004 konstatohet se nuk ka patur politika në drejtim të zbutjes së disniveleve ekonomike në shoqëri.

Pas vitit 2005 sistemi i mbrojtjes sociale në Shqipëri, pavarësisht nga progresi i arritur në zbatim të reformave në fushën legislative, organizative dhe strukturore dhe të impaktit të dukshëm për reduktimin e varfërisë, decentralizimin dhe delegimin e kompetencave në qeverisjen vendore, kishte ende nevojë për ndryshime për arritjen e qëllimit të këtyre reformave. Në hartimin e strategjive sektoriale dhe ndërsektoriale, qeveria Shqipëtare në rastin e zhvillimit të Programit të Asistencës Sociale, përcaktonte si detyrë arritjen e objektivave specifike, të cilët synonin modernizimin e kësaj skeme (viti 2014 dhe në vazhdim) me anë të administrimit të Regjistrit Elektronik Kombëtar dhe Sistemit të Pikëzimit që do të çonte në shënjestrimin më efikas të përfituesve të NE-së) dhe si rrjedhojë, uljen e numrit të përfituesve dhe rritjen e masës së NE-së. Zbatimi i kësaj reforme është përshkruar në këtë kapitull shoqëruar me analizën e ndryshimeve të

vazhdueshme sidomos nga ana strukturore, por edhe financiare të së drejtës së NE-së, si dhe tendencat bashkëkohore të zhvillimeve të saj, duke përdorur metodat e përziera sasiore-cilësore, sociologjike, të analizës dokumentare, të analizës dhe krahasimit të legjislacionit, të mbledhjes së të dhënave cilësore, të analizës së të dhënave, të studimit të rastit, empirike, historike, statistikore dhe demografike.

Në këtë kapitull përveç metodës së krahasimit të legjislacionit e përdorur në analizën e fazës së dytë dhe të tretë të NE-së, do të merren në shqyrtim problematikat e hasura në këtë kontest dhe si është mundësuar zgjidhja e tyre duke përdorur metodat e përziera sasiore-cilësore dhe historike. Metoda e analizës dokumentare (dokumenta zyrtare, të shkruara, dhe parësore që në bibliografi janë të ndara në dokumenta të politikave dhe institucionale) do të përdoret për të nxjerr në dritë elementet që vënë në pah ndryshimet në legjislacion. Përveç kësaj, në funksion të kësaj metode të përdorur do të jetë dhe interpretimi i dispozitave ligjore, që hedhin dritë mbi përcaktimet e të drejtës së NE-së të reformuar.

Gjithashtu në këtë kapitull do të gjejnë trajtim të veçantë nevojat dhe risitë e reformës së dixhitalizimit duke përdorur metodat sociologjike, empirike, statistikore dhe demografike; të drejtat specifike të përfituesve të NE-së duke përdorur metodën e studimit të rastit; procedura e ndjekur për zbatimin sa me efikas të skemës së NE-së duke filluar që nga faza e parë që është aplikimi dhe deri tek procedurat e kontrollit të kësaj skeme; mënyra e interpretimit juridik të tyre dhe vendosja e këtyre dispozitave në qendër të analizës të skemës së NE-së. Për këtë qëllim do të përdoret metoda e mbledhjes së të dhënave cilësore, ku do të shfrytëzohen vendime të ndryshme të NE-së të mara nga Këshillat Bashkiak të Bashkive të vendit ose nga 12 *Drejtoritë Rajonale të*

Shërbimit Social Shtetëror. Më pas, do të vazhdohet me analizën e të dhënave të mbledhura, me qëllim që të përshkruajmë, të diskutojmë, të vlerësojmë dhe të shpjegojmë përmbajtjen dhe karakteristikat e këtyre të dhënave.

Në kapitullin e katërt trajtohet risia e vitit të fundit 2019-2020 që është, shfuqizimi tërësisht i ligjit të mëparshëm të vitit 2005 “*Për ndihmën dhe Shërbimet Shoqërore*” i ndryshuar, nga ligji aktualisht në fuqi i vitit 2019 “*Për asistencën Sociale në Republikën e Shqipërisë*”, duke përdorur metodën e analizës dhe krahasimit të legjislacionit. Qëllimi i këtij të fundit në drejtim të Skemës së Ndihmës Ekonomike rivjen me një perspektivë të re në drejtim të zbutjes së varfërisë dhe përjashtimit shoqëror duke synuar të ofrojë mundësi të barabarta për përfshirje sociale dhe për zhvillim përmes shërbimeve për një jetesë më të mirë.

Trajtimi në këtë kre synon gjithashtu analizën e masave ekonomike të NE-së për vitin 2019-2020 duke përdorur metodat e mbledhjes së të dhënave cilësore dhe sasiore, analizës së të dhënave, analizës dokumentare, empirike dhe statistikore. Konkretisht, vërehet një rritje në masën 30% e masës mesatare të NE-së për vitin 2019, krahasuar me masën mesatare të NE-së para reformës të vitit 2012, ndërkohë që rritja e pagës minimale në shkallë vendi është në masën 15.3%, nga viti 2012 deri në vitin 2019. Si rrjedhojë konstatohet që, reforma e skemës së NE-së solli një ndikim në zbutjen e varfërisë dhe *përmirësimin e cilësisë së jetës* të përfituesve.

Duke qenë se pagesa në cash e NE-së, përbën të ardhurën e vetme të familjeve përfituese, mbetet ende e pamjaftueshme për të përmbushur kërkesat minimale të jetesës së tyre. Për këtë arsye kjo reformë parashikon afatin 5 vjeçar për daljen nga skema të

personave në moshë aktive pune, familjet e të cilëve përfitojnë NE, duke i punësuar në tregun e punës, për t'i riintegruar në jetën normale shoqërore. Ka filluar koordinimi midis Shërbimit Kombëtar të Punësimit (SHKP) dhe Shërbimit Social Shtetëror (SHSSH), me anë të Marrëveshjeve midis tyre të nënshkruara për riintegrimin në tregun e punës të përfituesve aktualë. Metoda e kërkimit ndërdisiplinor është përdorur në këtë pjesë të punimit. Gjatë vitit 2019 janë punësuar 1453 punëkërkues të papunë përfitues të NE-së dhe gjatë 6 mujorit të parë të vitit 2020 janë punësuar 558 të tillë, ndërsa 4 janë Ndërmarrjet Sociale që kanë përfituar statusin por ende nuk kanë filluar zbatimin e funksioneve të tyre.

Ky kapitull mbyllet me një analizë të efektivitetit të reformës së Ndihmës Ekonomike në Qarkun Elbasan. Qarku Elbasan zë peshën më të madhe të numrit të familjeve të trajtuara me NE, krahasuar me numrin total të familjeve me ndihmë ekonomike në vend pasi niveli i varfërisë është i lartë. Kjo është dhe arsyeja e analizës në veçanti e këtij qarku në këtë punim, duke përdorur kryesisht metodën empirike.

Duke i kushtuar një vëmendje të veçantë një të drejte tjetër themelore, që është e drejta për informim, në kapitullin e pestë trajtohet transparenca e autoriteve përgjegjëse të administratës publike për garantimin e të drejtës së ndihmës ekonomike. Këto të fundit janë të detyruara të ofrojnë informacion përgjatë gjithë procesit që ndjek ofrimi i NE-së, periodikisht dhe sa herë u kërkohet.

Në këtë kre trajtohen gjithashtu dhe parimet më të larta të etikës, e cila duhet të jetë pjesë aktive e punës reale të administratorit shoqëror, i cili është i pari dhe ndonjëherë i vetmi kontakt që publiku ka me administruesit e sistemit të ndihmës ekonomike. Kjo

etikë e karakterizon figurën e administratorit shoqëror në çdo hap të punës së tij me të varfërit, personat me probleme shëndetësore, verifikimet në familje dhe njëkohësisht përballjen e tij me çdo person “hallexhi” i cili kërkon ndihmë pranë strukturave territoriale apo “zyrave të shtetit”. Duhet që shërbimi i NE-së dhe shërbimeve sociale në tërësi të ofrohet në mënyrë të barabartë, me saktësi, mirësjellje dhe durim. Kjo do të rrisë besimin e qytetarëve tek qeverisja në përgjithësi dhe tek shërbimi i ndihmës ekonomike në veçanti për një shërbim të drejtë dhe të barabartë. Në këtë kapitull përdoret kryesisht metoda sociologjike.

Për një analizë të akteve që tashmë *janë të detyrueshme për t’u zbatuar nga institucionet* dhe qytetarët shqipëtarë për mbrojtjen e të drejtës së ndihmës ekonomike, por edhe për të menduar për situatat që perspektivat e zhvillimit dhe integritit kërkojnë, janë trajtuar në kapitullin e gjashtë disa prej akteve ndërkombëtare të cilat në fakt qëndrojnë në bazë të legjislacionit shqipëtar, përfshirë dhe konventa apo direktiva të cilat janë nënshkruar dhe kanë marrë fuqi juridike brenda sistemit ligjor shqipëtar. Metoda krahasuese dhe analitike është përdorur në funksion të idesë se legjislacioni shqiptar për sa i përket të drejtës së NE-së, është në përputhje me aktet ndërkombëtare.

Analiza e Akteve Ndërkombëtare që normojnë të drejtën e ndihmës ekonomike vjen në rrafshin European dhe në atë të Kombeve të Bashkuara. Për shkak të faktit se *Konventa Europiane e të Drejtave të Njeriut* është tashmë pjesë e sistemit të brendshëm dhe trajtohet si kufiri minimal i mbrojtjes së të drejtave të njeriut që një shtet duhet të *garantojë*, i është kushtuar një vend i veçantë trajtimit të saj shoqëruar me interpretimin e Gjykatës Europiane të Drejtave të Njeriut, të cilat ofrojnë një trajtim doktrinal të së drejtës së ndihmës ekonomike.

Kapitulli i shtatë lidhet me pasqyrimin e problematikave, si dhe me përfundimet dhe rekomandimet. Aty do të përfshihen, në mënyrë të përmbledhur, konstatimet dhe përfundimet e kapitujve paraardhës, kjo në funksion të tre hipotezave të ngritura që në fillim të punimit. Hulumtimet dhe rekomandimet do të kenë për qëllim të përmirësojnë legjislacionin e brendshëm dhe ta harmonizojnë atë me praktikën ndërkombëtare.

Ky studim është mbështetur në një literaturë relativisht të gjerë, që përfshin burime parësore, burime dytësore dhe burime të tjera.

Kapitulli II: Koncepti i të Drejtës së Ndihmës Ekonomike, parë në këndvështrimin e evoluimit të këtij koncepti dhe aspekteve të tij

2.1. Vështrim i përgjithshëm historik i politikave sociale jashtë Republikës së

Shqipërisë

Përkujdesja sociale, si përgjigje ndaj nevojave të grupeve dhe individëve për të mbijetuar ka ekzistuar që herët në çdo komunitet të organizuar njerëzor. Në fillimet e veta elemente të ndryshëm të mbrojtjes sociale realizoheshin nga vetë familja më pas fisi dhe klani. Këto elemente sidomos pas viteve 1700 u organizuan në formën e bamirësisë laike duke hedhur kështu bazën e një sistemi social që ofronte ndihmë për personat në nevojë, madje edhe larg hipotezave fetare. Për realizimin e këtij sistemi sa vjen në kohë e merr përgjegjësi shteti. Bamirësia publike bëhet kështu forma e parë e ndërhyrjes së shtetit që ofronte ndihmë e siguri publike për qytetarët dhe njerëzit në nevojë.

Zhvillimi industrial u shoqërua me përqëndrime të rëndësishme të punëtorëve në zonat urbane. Shpesh herë punëtorët nuk kishin lidhje të ngushta me familjet dhe akoma më keq një pjesë e tyre pleqëronin të vetmuar në këto qendra industriale. Në këto kushte për të plotësuar nevojat në rritje për shërbime ndaj të moshuarve apo ndaj kategorive në nevojë, vetë punëtorët krijuan shoqëritë e ndihmës së ndërsjelltë, dhe më pas zhvilluan institucionet private për këto shërbime. Megjithatë vetëm në fund të viteve 1800, mund të flitet për një organizim të sistemit social, sigurime shoqërore të detyrueshme të cilat u

dukën në Prusinë e Bismarkut.¹ Në këto sigurime shteti u përgjigjej nevojave të qytetarëve duke ju ofruar shpërblime të ndryshme. Këto nevoja i referoheshin qytetarëve që binin në vështirësi, që humbnin vëndin e punës përkohësisht apo përgjithmonë. Ky sistem financohej nga kontributet e vetë punëtorëve. Sistemi i Bismarkut u përhap në tërë Europën. Në Angli në vitin 1911 u shpik sigurimi i papunësisë në disa profesione dhe më pas në vitin 1938 ky sistem u shtri për të gjithë punëtorët.

Kjo reformë e ndërmarrë për ngritjen e një sistemi të ri të sigurimeve, mbështetej në filozofinë e ndërhyrjes së shtetit si rregullator i marrëdhënieve ekonomike në kushtet e acarimit të kontradiktave midis punëmarrësve dhe punëdhënësve. Modeli Bismark u sanksionua në disa ligje të miratuara në Parlamentin e Prusisë së atëhershme në një periudhë 10 vjeçare 1881-1889. Në vitin 1881 u miratua ligji për sigurimin shoqëror të detyrueshëm; në vitin 1883 u miratua ligji për sigurimin për sëmundje; në vitin 1884 u miratua ligji për aksidentet në punë; në vitin 1889 u miratua ligji për pensionin e pleqërisë dhe invaliditetit.

Mbrojtja sociale e ligjëruar nga Parlamenti i Prusisë siguronte të drejtat për të gjithë personat që paguanin sigurimet shoqërore. Masa e mbulimit nuk mbështetej në nevojat e kontributeve por mbi bazën e kontributeve të secilit kontribues. Legjislacioni social i miratuar nga Bismarku, njihej për prirjet e forta autoritariste. Kritikët dhe analistët e kohës theksojnë se politika të tilla synonin shmangien e tensioneve sociale dhe zbutjen e pabarazive sociale të krijuara nga zhvillimi industrial i kohës.

¹ Otto von Bismarck në kohën e tij si kancelar i Gjermanisë nga viti 1871 deri 1890, vendosi ligjin bazë për sistemet e sigurisë sociale, si sigurimin shëndetësor, sigurimin në rastet e aksidenteve dhe sigurimin e pensioneve. (“Bismarcku një mit Gjerman”, publikuar në faqen e Web-it të Deutsche Welle dw.com).

Baza e mendimit modern të zhvillimit të sigurimeve shoqërore ku përcaktoheshin drejtimit e shtetit social “Welfare State” u hodhën në vitin 1942 në Raportin “Mbi varfërinë” që mbajti Lorg Beveridge në Angli. Në këtë raport Beveridge theksonte se çdo qytetari duhet t’i garantohet “një kufi ndihme”, “një minimum jetese” në çdo fazë të jetës nga lindja deri në vdekje. Në këtë mënyrë nga koncepti i sigurimit të rrezikut kalohej në konceptin e mbulimit të nevojës së anëtarëve të shoqërise si: - varfëria; plotësimi i nevojave bazë nëpërmjet mbështetjes në të ardhura; - sëmundja, për të cilat zhvilloheshin sistemet e kujdesit shëndetësor; - analfabetizmi që luftohej duke zhvilluar politika arsimore; - papunësia, nëpërmjet zhvillimit të politikave të nxitjes së punësimit; - aftësia e kufizuar nëpërmjet institucioneve të përkujdesit shoqëror. Nëpërmjet këtyre propozimeve synohej ngritja e një sistemi të unifikuar të mbrojtjes shoqërore. Në këtë mënyrë u fut parimi i përgjithësimin të shërbimeve.

Këto përgjegjësi sanksionoheshin në *Deklaratën mbi të Drejtat e Njeriut të Kombeve të Bashkuara* të vitit 1948; në Konventën mbi Standartet minimale të Mbrojtjes shoqërore të vitit 1952 të ILOS ; Rregulloren e Komitetit Europian mbi mbrojtjen e punëtorëve emigrant si dhe në Kartën sociale europiane të rishikuar.

Në 5 korrik 1948 Anglia vendosi sistemin kombëtar të mbrojtjes shoqërore dhe kujdesit shëndetësor dhe 5 korriku njihet si dita e “lindjes së shtetit social”. Ky sistem u shtri me shpejtësi në vendet e Europës Veriore duke krijuar shtetin e mirëqënies sociale.

Shteti i mirëqënies sociale përfshinte një shtet demografik nga forma. Ndërhyrjet në ekonominë kapitaliste për të arritur një zhvillim ekonomik të vazhdueshëm realizoheshin duke siguruar një punësim të vazhdueshëm dhe të plotë të anëtarëve të saj. Në këtë mënyrë me shtet social do të kuptojmë: “tërësinë e ndërhyrjeve publike që

modernizojnë e sigurojnë mbrojtjen sociale në formën e ndihmës, mbrojtjes dhe sigurisë sociale duke përfshirë të drejtat e veçanta të përcaktuara si dhe detyrimet e posaçme të kontributit financiar”.

2.2. Vështrimi historik i shtetit social në Republikën e Shqipërisë

Në vendin tonë ekzistencat e para të elementëve të bamirësisë ofroheshin nga familja, fisi e më pas institucionet fetare (kisha, xhamitë). Forma institucionale e tyre i përket një periudhe relativisht të mëvonshme. Ato janë zhvilluar me krijimin e shtetit pas vitit 1912. Por vetëm në vitin 1927, Mbreti Zog përcaktoi pensionet e para për nënpunësit shtetëror të cilat funksiononin si një sistem kontributi sigurimesh.

Pas luftës së dytë botërore, shteti Shqipëtar mori në mbrojtje familjet dhe të afërmit e dëshmorëve të luftës antifashiste, invalidët e luftës dhe punonjësit e Ministrisë së Punëve të Brendshme.

Në vitin 1947 u vendos një skemë e përgjithshme e sigurimeve shoqërore, e përmirësuar në vitin 1958-1959 sipas modelit sovjetik. Vetëm në vitin 1966 u krijua një sistem i plotë i sigurimeve shoqërore i cili vazhdon ndikimet e tij edhe në këtë periudhë. Ky sistem mbronte të punësuarit e ndërmarjeve shtetërore në të gjitha degët e ekonomisë si dhe ushtarakët. Në vitin 1972 filloi skema e pensioneve të kooperativistëve.

Reformimi i skemës së sigurimeve shoqërore u realizua me ligjin nr. 7703, datë 11.05.1993, “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”. Sigurimi shoqëror i detyrueshëm mbronte me të ardhura personat e punësuar për:

- paaftësinë e përkohshme në punë për shkaqe sëmundjesh;

- barrë lindje;
- pension pleqërie, invaliditeti dhe familjarë;
- aksident në punë dhe sëmundje profesionale;
- papunësinë.

Sistemi shëndetësor, funksiononte sipas *ligjit nr. 7870, datë 13.10.1994 “Për sigurimet shëndetësore në Republikën e Shqipërisë”*, i cili garantonte një sistem të përgjithshëm që siguronte programe parandaluese për sëmundjet, vizitat diagnostifikuese, kujdes shëndetësor spitalor, shërbimet e urgjencës dhe investime në sektorin e shëndetësisë. Skema e sigurimit të detyrueshëm shëndetësor mbështetej në parimin kontributiv për të gjithë popullsinë, ekonomikisht aktive. Ky sistem mbronte të gjithë shtetasit. Karakteristikë e këtij sistemi ka qenë planifikimi, financimi, dhe kontrolli i centralizuar nga shteti. Ky sistem garantonte *jo vetëm kontributin për familje, por edhe përfitimet për familjet e varfëra* që nuk paguanin kontribute si edhe për pensionistët.

Shqipëria nuk trashëgoi nga sistemi i kaluar dhe ai komunist asnjë ligj social megjithëse individët dhe familjet në gjendje risku ishin të shumtë. Të vetmet shërbime sociale gjatë kësaj periudhe ishin:

1. Shtëpitë për të moshuar (Azile) në 5 qytete: Tiranë, Shkodër, Kavajë, Fier dhe Gjirokastrë;
2. Shtëpitë e fëmijëve me AK mendore në 5 qytete: Tiranë, Shkodër, Korçë, Berat dhe Durrës;
3. Shtëpitë e fëmijëve jetimë: parashkollorë në Shkodër dhe Vlorë dhe për moshën 6-14 vjeç në Tiranë, Shkodër dhe Sarandë.

Në datën 18 maj 1993, u miratua *ligji nr. 7710 “Për ndihmën dhe përkujdesjen shoqërore”*. Ky ligj garantonte mekanizmin e nevojshëm për ofrimin e shërbimeve për individët dhe familjet në nevojë, zbutjen e varfërisë si dhe krijimin e mundësive për integrimin e tyre në jetën shoqërore. Ky ligj hodhi bazat e programit të parë kombëtar shtetëror për reduktimin e varfërisë.

Ligji mbështeste ngritjen e dy programeve sociale bazë, për disa kategori përfituesish:

1. Me ndihmë ekonomike duke siguruar përfitime në para për familjet e varfëra dhe PAK që në lindje, të cilët përfitonin pagesa në të holla dhe shërbime, në përputhje me nivelin e AK që përcaktohej nga KMCAP si: për të verbërit; invalidët para dhe tetraplegjik; PAK mendorë, fizikë dhe invalidët e punës.
2. Me shërbime sociale duke siguruar për grupet në nevojë, për fëmijët, për të moshuarit dhe për PAK mendorë dhe fizikë, strehim në qendra rezidenciale publike dhe jopublike si dhe në qendra komunitare.

Muaji Korrik i vitit 1993 shënoi momentin fillestar të dhënies së ndihmës ekonomike nga shteti shqipëtar bazuar në ligjin nr. 7710, datë 18.05.1993, *“Për ndihmën dhe përkujdesjen shoqërore”*. Ky ligj vijoi më pas me reformimin e sistemit të ndihmës ekonomike, i cili bazohej në këtë ligj dhe plotësimeve të tij si dhe vendimeve përkatëse për ndihmën ekonomike. Reformimi i sistemit të ndihmës ekonomike, erdhi si një nevojë dhe kundërpërgjigje ndaj zhvillimeve e ndryshimeve të thella social-ekonomike, juridike dhe strukturore që po kalonte shoqëria shqipëtare, si dhe krijimit të kushteve dhe standarteve që garantonin forcimin e shtetit ligjor, konsolidimin e ekonomisë së tregut, mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe ofrimin e shërbimeve sociale. Ndërkohë që Parlamanti i Shqipërisë ka ratifikuar konventa të rëndësishme ndërkombëtare që

garantojnë të drejtat politike, ekonomike, e sociale të njeriut, legjislacioni shqiptar është përafruar gjithnjë e më tepër me standartet e Bashkimit European dhe parimet e standartet e Kartës Sociale Europiane të Rishikuar; Kartën Europiane të Autonomisë Lokale; *Konventën Europiane për të Drejtat e Njeriut*²; Konventën për të Drejtat e Fëmijëve. Në kuadrin e plotësimit të detyrimeve që burojnë nga *nënshkrimi i MSA-së*, është reformuar sistemi i mbrojtjes shoqërore dhe është standartizuar legjislacioni dhe politikat sociale. Në këtë kontekst u hartua fillimisht *Ligji nr. 9355, datë 10.03.2005 “Për Ndihmën dhe Shërbimet Shoqërore”*, i ndryshuar sot në Ligjin nr. 57 i vitit 2019 *“Për Asistencën Sociale në Republikën e Shqipërisë”*, si dhe të gjitha Aktet e tjera Ligjore dhe Nënligjore në zbatim të tij. Ky i fundit, ka për qëllim *zbutjen e varfërisë dhe përjashtimit shoqëror* duke synuar të ofrojë mundësi të barabarta për përfshirje sociale dhe për zhvillim përmes shërbimeve për një jetesë më të mirë.

2.3. Kushtetuta dhe parimet kushtetuese ku mbështetet sistemi i shërbimeve shoqërore

Politikat, programet dhe skemat e mbrojtjes sociale mbështeten në *Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë* (KRSH). Neni 49 i saj përcakton se: i) çdo personi duhet t'i krijohet mundësia për punësim të vullnetshëm, si dhe mundësia për arritje profesionale; ii) punëtorët duhet të jenë të mbrottur në punë.

Në nenin 5 të *ligjit nr. 57 të vitit 2019 “Për Asistencën Sociale në Republikën e Shqipërisë”*, janë përcaktuar *parimet bazë*, në bazë të të cilave funksionojnë programet

² Që në vitin 1950, Shtetet anëtare të Këshillit të Europës kanë nëshkruar në Romë, *Konventën Europiane mbi të Drejtat dhe Liritë Themelore të Njeriut*. Kjo Konventë fiton peshë sidomos me zgjerimin e Këshillit të Europës, me pranimin e Shteteve të reja të Europës Lindore në gjirin e tij. Kjo ka sjellë një forcim të rolit të sistemit ndërkombëtar në mbrojtjen e të drejtave të njeriut përkundrejt vendeve me përvoja negative në këtë fushë. (Puto, fq. 85-86: 2008).

e asistencës sociale në Republikën e Shqipërisë. Normalisht që këto parime janë konform parashikimeve kushtetuese mbi to.

Vetë KRSH në Kreun e Parë të Pjesës së Dytë ka përcaktuar *Parimet e Përgjithshme* në të cilat bazohen të *Drejtat dhe liritë Themelore të Njeriut*. Në vijim vijmë në analizë secili prej këtyre parimeve.

Neni 18 i *KRSH*-së i referohet parimit të barazisë përpara ligjit, i cili duke iu përmbajtur edhe parimit të mosdiskriminimit, përcakton se nuk mund dhe nuk duhet të tolerohet asnjë lloj diskriminimi për asnjë lloj arsye ose rrethane nëse ai nuk është i ligjshëm dhe *objektiv*. Vetë ligji nr. 57/2019 në nenin 5 pika e, në harmoni me këtë parim sanksionon barazinë si parimin i cili përcakton se *mbrojtja sociale ofrohet për çdo individ në nevojë, pavarësisht nga gjinia, feja, mosha, aftësitë e kufizuara etj.*

Kreu IV i Pjesës së Dytë të KRSH-së rregullon parimet bazë mbi *Liritë dhe të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore* të personit. Konkretisht neni 52 përcakton të drejtën e cilitdo shtetas për ndihmë në përputhje me ligjin. Kësisoj, ligji nr. 57/2019, i cili është aktualisht në fuqi, është ai i cili në përmbushje të këtij detyrimi kushtetues parashikon ndër të tjera kushtet mbi përfitimin e Ndihmës Ekonomike, duke rregulluar me akte ligjore dhe nënligjore këtë të drejtë kushtetuese të shtetasve shqiptarë.

Me ligjin e ri për Ndihmën Sociale, duke shtuar si kategori përfituese edhe shpërblimin për bebet e sapolindura (bonusi i bebeve), duket se është përmbushur edhe detyrimi i rradhës i ngarkuar nga Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë parashikuar në nenin 54 të saj, i cili përcakton se disa kategori të veçanta si *fëmijët, të rinjtë, gratë shtatzëna dhe nënat e reja* duhet të kenë një vëmendje specifike nga shteti.

Kreu V i pjesës së dytë të *Kushtetutës së Republikë të Shqipërisë* përcakton Objektivat Socialë. Neni 59 në pikën e të tij sanksionon *përkujdesjen dhe ndihmën për të moshuarit, jetimët dhe invalidët*, dhe janë pikërisht këto kategori të cilave u është dhënë rëndësi e veçantë përmes ligjit nr. 57/2019. Është ky ligj ai i cili përcakton *kushtet dhe masën në të cilat mund të kërkohet realizimi i këtyre objektivave*, kërkesë kjo e pikës 2 të *nenit 59 të KRSH-së*. Në rast të mos përmbushjes së këtyre detyrimeve ligjore vetë ligji parashikon *të drejtën për t’iu drejtuar edhe Gjykatës*.

Më tej analizën mund ta zgjerojmë edhe me parime të tjera si: parimi i universalitetit, ai i drejtësisë sociale, mosdiskriminimi, të cilat gjithashtu janë mbështetur në parime kushtetuese.

Konkretisht neni 5 i ligjit nr. 57/2019 ka përcaktuar Parimet e përgjithshme në bazë të të cilave funksionojnë programet e asistencës sociale të cilat janë si vijon:

- a) universaliteti, parimi që përcakton se asistenca sociale është krijuar, funksionon dhe mbikqyret duke i trajtuar në mënyrë të barabartë subjektet që janë në *kushte të njëjta*.
- b) drejtësia sociale, është parimi që përcakton detyrimin që ka çdokush për të siguruar *kushtet bazë të jetesës, si për veten* edhe për personat në ngarkim të tij. Kjo nënkupton detyrimin që duhet të ketë secili në rolin e tij në drejtim të reduktimit të varfërisë për veten dhe të tjerët që janë në pamundësi.
- c) respektimi i të drejtave të njeriut dhe integritetit të përfituesit, është parimi që përcakton ofrimin e shërbimeve të asistencës sociale që *bazohet në respektimin e të drejtave të njeriut, të integritetit të individit, besimit fetar dhe formimit të gjithanshëm të tij*;

ç) mosdiskriminimi është parimi që përcakton të drejtat që burojnë nga ligji nr. 57/2019. Bazuar në këtë parim askush nuk mund dhe nuk duhet të trajtohet në kushte disfavorizuese në raport me të tjerët, për çfarëdolloj arsye. Parimi i mosdiskriminimit qëndron në thelb të funksionimit të Skemës së NE-së, dhe jo vetëm. Ky parim në vazhdimësi i është nënshtruar rishikimeve si nevojë e kërkesës për reformim, duke patur parasysh këtu reformat e ndërmarra në kuadër të Skemës së ndihmës.

d) konfidencialiteti dhe mbrojtja e të dhënave personale është parimi që përcakton se të dhënat personale të individit duhet të jenë të aksesueshme vetëm nga personat e autorizuar me ligj.

dh) barazia është parimi në bazë të të cilit çdo personi duhet t'i krijohet mundësia ligjore dhe reale për trajtim të veçantë në rast nevojë për të përfitur nga shërbimet sociale, pa asnjë lloj diskriminimi.

e) partneriteti është parimi që siguron koordinimin midis instancave vendore dhe të nivelit qendror, midis aktorëve publikë dhe privatë (konkretisht: administrata vendore dhe qendrore, organizatat jo fitimprurëse dhe bizneset). Qëllimi i kësaj fryme bashkëpunimi është koordinimi midis tyre duke synuar zbatueshmërinë e legjislationit të ndihmës, duke filluar nga hapi fillestar i evidentimit të rasteve deri në riintegrimin e kategorive përkatëse.

Në themel të reformës së sistemit të shërbimeve shoqërore qëndrojnë gjithashtu edhe parimet e mëposhtme:

E drejta e jetës, mbijetesës dhe zhvillimit. Një ndër parimet kushtetuese i cili reflektohet edhe në legjislationin për mbrojtjen shoqërore dhe ndihmën ekonomike. Përmes këtij

parimi sanksionohet se individit duhet t'i ofrohen kushte favorizuese në funksion të sigurimit të mbijetesës, në përputhje me principet e dinjitetit njerëzor.

Pavarësi, autonomi dhe respektim i pikëpamjeve. Në themel të këtij parimi qëndron inkurajimi që duhet t'u bëhet individëve në drejtim të marrjes së vendimeve përsa i përket jetesës brenda normave shoqërore. Kjo nënkupton edhe të shpehurit e opinionëve lirisht dhe në pavarësi të plotë, duke iu dhënë kësioj edhe mundësia për ankimime të mundshme. Në bazë të këtij parimi ofruesit e shërbimeve janë të detyruara të respektojnë të drejtat dhe në princip dinjitetin e përfituesëve.

Përfshirja dhe integrimi. Bazuar në parimin e përfshirjes sanksionohet që shërbimet e ofruara të jenë të tilla që të garantojnë aksesin e duhur për individët e shoqërisë me qëllimin që ato të mbrohen nga efekti i përjashtimit social. Integrimi me qëllim përfshirjen duhet të garantohet për të gjitha fushat dhe për të gjitha kategoritë e shoqërisë si në arsim, shëndetësi, dhe domosdo në fushën e mbrotjes sociale.

Cilësi shërbimesh. Ky parim i adresohet ofruesve të shërbimeve të cilët duhet të mbajnë në konsideratë nevojat e përfituesve në raport me mundësitë që ofron ligji për realizimin e këtyre nevojave. Gjatë këtij procesi subjektet ofruese të shërbimeve duhet të kenë informacionin e nevojshëm për të adresuar sa më saktë nevojat e individëve apo grupve vulnerabël. Kapacitetet e ofruesve duhet gjithashtu t'u përmbahen standarteve të përcaktuara ligjërisht.

Standarde për vendimarrjen në nivel lokal. Strukturat qendrore kanë për detyrë të normojnë duke vendosur standartet të cilat duhet të mbahen në konsideratë nga zbatuesit e tyre. Vendimet rast pas rasti merren në nivel lokal, aty ku dhe lindin nevojat konkrete.

Instancat lokale janë ato të cilat duke adresuar problematikat, promovojnë standartet dhe ndihmojnë në aplikimin e tyre.

Respektimi i të drejtave dhe nevojave. Nevojat e individit janë ato të cilat kushtëzojnë marrjen e masave përkatëse nga ligjvënësi. Ndryshimi i këtyre nevojave dikton edhe ndryshimet legislative përkatëse, të cilat duhet të reflektojnë respektimin e të drejtave dhe nevojave konkrete të lindura rishtazi dhe të kategorizuara si thelbësore në ecurinë e skemës së ndihmës konkretisht.

2.4. Kuptimi dhe efektet e Ndhmës Ekonomike në përgjithësi jashtë Republikës së Shqipërisë

Në formën më të thjeshtë koncepti i ndihmës ekonomike përcaktohet si një dhuratë, shërbim, ose veprim që është kryer pa pritur shpërblim. NE mund të përkufizohet si transfertat e njëanshme të burimeve. Sasia e burimeve që ajo vë në dispozicion të marrësit është shtesë e atyre të cilat marrësi do të merrte përmes kanaleve normale të tregtisë ndërkombëtare, ose duke financuar rezervat e veta të huaja. E thënë ndryshe ndihma ekonomike është thjeshtë “ndihmë për të tjerët”. (Abbott, fq. 1213: 1970).

NE është një instrument i rëndësishëm i politikës sociale. Ky instrument ka për qëllim që të ndihmojë *familjet në nevojë, të cilët nuk mund të sigurojnë plotësimin e nevojave bazë jetike* duke i mbështetur ata me ndihma në para. (Kanbur, fq. 6: 2006).

Më poshtë vijojmë me efektet pozitive të ndihmës ekonomike:

Si pasojë e rënies ekonomike globale, qeveritë dhe partnerët e tyre të zhvillimit mendojnë se NE mund të jetë një mjet i fuqishëm për forcimin ndaj tronditjeve prej

krizave ekonomike. Këto tronditje shpesh kanë ndikim më të madh në individët më pak të aftë për ta përballuar krizën, duke krijuar më tej varfërinë, një pasojë që mund të qëndrojë për dekada të tëra. Ndihma sociale mund të ndihmojë grupet e varfëra dhe të prekshme për të përballuar më mirë dhe kjo mund të shërbejë si një investim.

Ndihma sociale mund të rrisë shërbimet publike dhe investimet në kapitalin njerëzor, veçanërisht në arsim dhe shëndetësi, duke rezultuar në produktivitet më të lartë dhe pjesëmarrje më të madhe të të varfërve në tregjet e punës. Ndihma efektive sociale mund të parandalojë një nga pasojat më të rënda të varfërisë që është transmetimi i varfërisë gjatë gjithë jetës për fëmijët. Në fushën e arsimit, shkollimi i jep aftësi fëmijëve dhe rrit shanset e tyre për të gjetur punë. Kjo ndihmon për të thyer ciklin e ndër-gjeneratave të varfërisë.

Programet e ndihmës sociale shpesh ndihmojnë në rritjen e shpenzimeve shtëpiake në ushqim. Mbrojtja sociale mund të gjenerojë përfitime ekonomike për të varfërit dhe për një segment më të gjerë të popullsisë.

Ndihma sociale mund t’ju mundësojë njerëzve të varfër për të mbrojtur veten dhe pasuritë e tyre kundër goditjeve, kështu që ata mund të mbrojnë të ardhurat që gjenerojnë dhe të bëjnë investime produktive.

Por përveç efekteve pozitive të lartpërmendura disa autorë shprehen edhe për efektet e mëposhtme që mund të ndikojnë negativisht në rimëkëmbjen e shoqërisë.

Sipas *Boone*, edhe pse përfitimet e ndihmës ekonomike do të rrisnin konsumin e familjeve të varfra, kjo nuk do të kishte ndikim në investimin financiar. (*Boone*, fq. 677: 1994).

Menaxhimi i ndihmës ndesh në vështirësi të cilat ndikojnë në *ujen e efektivitetit të saj* për arsye se, përgjithësisht subjektet rrezikohen nga ajo që cilësohet si *përrjashtim social*. Vërehet se krijohet një gjendje *pasiviteti i detyruar*, për shkak të të qënurit i varur natyrshëm nga vetë ndihma ekonomike dhe benefitet e ardhura prej saj. Kemi parasysh këtu që familjet përfituese të ndihmës gëzojnë avantazhe të caktuara në drejtim të skemave të tjera social-ekonomike, si arsimi, shëndetësia, strehimi, etj. Sidoqoftë vetë ndihma dhe këto benefite dytësore nuk arrijnë të rrisin ndjeshëm nivelin financiar të këtyre familjeve.

Nga sa analizuam më sipër, si rrjedhojë konstatohet se skema e ndihmës nuk i nxjerr përfundimisht nga gjendja në të cilën këto familje ndodhen.

2.5. Zanafilla e Ndhmës Ekonomike në Republikën e Shqipërisë

Faza e parë e ndihmës ekonomike, e quajtur ndryshe faza përgatitore, (në vitet 1992-1996), lidhet me periudhën e tranzicionit të shoqërisë shqiptare, e cila synonte krijimin e bazës ligjore dhe të instancave përkatëse për zhvillimin e ekonomisë së tregut, ndërsa në planin shoqëror garantimin e mbijetesës.

Në këtë fazë siç u përmend dhe më lart, ligji i parë që fliste për NE-në ishte i datës 18 maj të vitit 1993, nr. 7710 “Për ndihmën dhe përkujdesjen shoqërore”, i ndjekur më pas nga VKM-të përkatëse.³ Ky ligj përcaktonte sistemin e ndihmës dhe përkujdesjes shoqërore. Qëllimi i ligjit ishte që t’u mundësonte ndihmë ekonomike individëve apo familjeve ne nevojë, me pagesa cash por edhe me shërbime alternative.

³ Qeveria mund të ushtrojë pushtetin legjislativ, në kuptimin që të miratojë akte me fuqinë (ose vlerën) e ligjit në fuqi, si rrjedhojë e delegës nga organet kompetente për këtë pushtet duke respektuar në mënyrë rigoroze limitet e kësaj delege. (Cuocolo, fq. 389: 1998).

Ndihmën ekonomike e përfitonin individët apo familjet e shtetasve shqiptarë që kishin të ardhura të ulëta, ose nuk kishin asnjë mundësi për gjenerim të ardhurash nga çfarëdolloj sistemi alternativ për burim financiar.

Në bazë të këtij ligji, ndihma jepej *e plotë ose e pjesshme*, e cila shpërndahej periodikisht çdo muaj. Ndihma *e plotë* jepej në ato raste kur familja nuk kishte asnjë burim financiar tjetër, ndërsa ndihma *e pjesshme* jepej në ato raste kur familja kishte burime financiare të ulëta. Ishin organet e pushtetit lokal, ish-komunat dhe Bashkitë, ato të cilat kishin në kompetencë vendimarrjen për ndihmën në atë kohë.⁴

Organi vendimarrës kur e vlerësonte të arsyeshme mund të miratonte dhënien e ushqimeve, si alternativë të ndihmës, në qoftë se kosntatohej se: 1. dhënia e ndihmës në cash humbte efektshmërinë pasi kishte mungesa furnizimi me ushqime për zonën; 2. *ishte e nevojshme për arsye të vaçanta shëndetësore*. Ndihma jepej një herë në muaj nga administrata lokale në bazë të listave të miratuara nga Këshillat Komunal/Bashkiak, pas rekomandimit nga administratori shoqëror.

Përveç vendimit për individët apo familjet përfituese të NE-së, këshillat e lartpërmednur merrnin vendim gjithashtu dhe për *masën e ndihmës ekonomike*, në varësi të fondeve, në pëputhje me kriteret e VKM-së përkatëse. Masa e NE-së mujore për familjen ishte jo më pak se 70% dhe jo më e madhe se 100% e dy asistencave. Masa e ndihmës së pjesshme që vlerësohej sipas të ardhurave të familjes, nuk ishte më e madhe se masa e plotë e ndihmës.

⁴ Organet e pushtetit të administratës lokale për plotësimin e detyrave të ngarkuara dhe në bazë e për zbatim të ligjeve, dekreteve dhe akteve administrative të organeve më të larta, brënda kompetencave të tyre, nxjerrin sipas rastit urdhëresa e vendime, udhëzime, urdhëra sipas llojit të organit. (Ballanca, fq. 170: 1984).

Faza e dytë (pas fazës së parë përgatitore të lartpërmëndur) ose e quajtur ndryshe *faza e zhvillimit pas vitit 2000 e ndihmës* ka të bëjë me vënien në jetë të *strategjive* për zhvillim në fushën financiare, dhe në fushën sociale në drejtim të rritjes së ndërgjegjes për respektimin e të drejtave të njeriut. Objektivi kryesor në këtë fazë ishte decentralizimi me qëllim përmirësimin e zbatueshmërisë së procedurave të dhënies së ndihmës, si dhe njëkohësisht realizimin e të drejtave të njeriut përmes ndryshimit të kuadrit ligjor. (INSTAT, fq. 17: 2004). Deri në vitin 2004 përqindja dhe problematikat e varfërisë, ishin më të larta në familjet ku kryefamiljari ishte i papunë. Në nivel Kombëtar shkalla e varfërisë ishte pothuajse sa dyfishi për këto familje në krahasim me ato familje ku kryefamiljari kishte një punë. Gjithashtu, varfëria prekte në përqindje të lartë popullsinë e të rinjve si dhe familjet me kryefamiljare femra. Deri në vitin 2004 treguesit mbi arsimin në Shqipëri, ishin optimalë, krahasuar me vendet, të cilat kishin të njëjtin nivel varfërie. Kryerja e studimeve në shkollat fillore ishte një nga anët më pozitive të vendit. Më sfiduese ishte nevoja për të rritur numrin e regjistrimeve në shkollat e mesme dhe profesionale. Rëndësia e arsimit pas atij fillor nuk duhet të ishte afatshkurtër në politikat e qeverisë, pasi mund të kishte rëndësi domethënëse në reduktimin e varfërisë. Analiza e fazës së dytë pas vitit 2005 do të vijojë në kapitullin pasardhës të këtij punimi.

Në këtë punim do të përshkruajmë, ndryshimet e vazhdueshme sidomos nga ana strukturore, por edhe financiare të drejtës së NE-së, si dhe do të japim tendencat bashkëkohore të zhvillimeve të saj.

Kapitulli III: Reformimi i të drejtës së ndihmës ekonomike nga viti 2005 deri sot

3.1. Filozofia e sistemit të shërbimeve shoqërore dhe fushat e ndërhyrjes

Shërbimet shoqërore i ofrojnë individëve në nevojë mundësi për të përballuar jetësën e tyre, duke synuar drejt zhvillimit të mundësive në funksion të rehabilitimit për t'i recuperuar këto nevoja.

Shërbimet Shoqërore janë zhvilluar për të mbrojtur, ndihmuar, fuqizuar dhe parandaluar situatat e abuzimit, dëmtimit, neglizhencës dhe përjashtimit nga sistemi i shërbimeve, varfërisë dhe situatave të krizave, si dhe vulnerabilitetin e individëve dhe familjeve, fëmijëve dhe të rriturve.

Reforma e parë e shërbimeve shoqërore, mbështetej në filozofinë e ndërtimit të një sistemi shërbimesh që plotësonin nevojat apo minimizonin pasojat jo të mira të *dukurive sociale mbi kategoritë që kërkonin të përfitonin nga shërbimet e saj*. Nëpërmjet politikave dhe objektivave reforma synoi plotësimin e nevojave të njerëzve brënda familjes dhe pranë komuniteteve të tyre, në raport me shërbimet e centralizuara dhe rezidenciale.

Politikat e reja, programet dhe shërbimet që do të ngriheshin duhet të garantonin *për individët dhe grupet në nevojë*: i. kushte sociale për të jetuar denjësisht dhe për të zhvilluar aftësitë e veta gjatë jetës, në përputhje me konceptet që po adaptoheshin *nga vendet e Bashkimit Europian*; ii. cilësi, disponibilitet dhe efektivitet të shërbimeve sociale duke mbrojtur dhe përmirësuar të drejtat e përfituesve; iii. standarte të reja shërbimesh që përmirësonin cilësinë e jetës së përfituesve të këtyre shërbimeve; iv. zgjerimin e përgjegjësisë të *qeverisjes vendore për ngritjen e shërbimeve të reja sociale*

dhe përfshirjen e shoqërisë civile si ofrues shërbimesh; v. bashkëveprimin e pushtetit qendror, vendor dhe shoqërisë civile për ngritjen e shërbimeve për përmirësimin e jetës së fëmijëve; vi. sigurimin e qëndrueshmërisë dhe vazhdimësinë e shërbimeve shoqërore; vii. nxitjen e përfshirjes sociale mes grupeve të marxhinalizuara.

Për realizimin në praktikë të objektivave të reformës së parë të shërbimeve shoqërore fillimisht u hartua *ligji nr. 9355 “Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore”*, i cili u miratua në datën 10 mars të vitit 2005 në Parlament. Në zbatim të detyrimeve që rrjedhin nga ligji dhe akteve nënligjore nisi procesi i realizimit të komponentëve të reformës në fushën sociale si vijon:

- Ndarja e përgjegjësisë të reja të strukturave programuese *në nivel qendror* dhe realizuese *në nivel vendor* të shërbimeve shoqërore në kushtet e decentralizimit. (Muçollari, fq. 5-6: 2010).
- Përgatitja e *akteve ligjore dhe nënligjore* për kalimin e përgjegjësisë dhe kompetencave të reja në nivel vendor për ngritjen e shërbimeve shoqërore dhe administrimin e pagesave në *cash* për grupet në nevojë.
- *Ngritja e sistemit të identifikimit të rasteve në nivel vendor, për të përmbushur përgjegjësinë për mbrojtjen shoqërore në përputhje me kërkesat e mekanizmave rajonale dhe kombëtarë.*
- *Ngritja dhe fuqizimi i strukturave të nevojshme për realizimin e përgjegjësisë të reja në nivel qarku, bashkie/ish-komune, në përputhje me kërkesat e procesit të decentralizimit të shërbimeve.*
- *Ndërtimi i një sistemi të ri për shkëmbimin e informacionit dhe të dhënave statistikore ndërmjet strukturave qendrore dhe njësive të qeverisjes vendore.*

- *Rritja e rolit mbështetës dhe bashkëpunues të strukturave ekzekutive në nivel rajonal në mbështetje të iniciativave të njësive të qeverisjes vendore.*
- Sigurimi i mekanizmave të nevojshëm për njohjen e procesit të decentralizimit dhe zbatimin e politikave nëpërmjet medias, publikimeve, fletëpalosjeve etj.
- Zhvillimi i procesit të ndërgjegjësimit për të gjithë aktorët pjesëmarrës në decentralizimin dhe reformat e tjera të shërbimeve shoqërore.

Programi i NE-së financohej tërësisht nga buxheti i shtetit. Programimi dhe shpërndarja e fondeve të NE-së ishte përgjegjësi e dyfishtë e Ish-Ministrit të Punës dhe e Çështjeve Sociale⁵ dhe Pushtetit Vendor.

Njësitë e pushtetit vendor identifikonin familjet në nevojë në bazë të vlerësimit të treguesve të varfërisë. Ndihma ekonomike, në varësi të nivelit të varfërisë së familjes, vazhdonte të jepej e plotë ose e pjesshme. Matja e nivelit të varfërisë dhe përcaktimi i familjeve që duhet të mbështeteshin me NE, bëhej mbi bazën e disa treguesve, të cilët zbatoheshin në nivel kombëtar.

Për identifikimin e familjeve në nevojë që do të përfitonin ndihmë ekonomike të plotë (familjet që vlerësoheshin pa të ardhura, përfitonin NE të plotë), merreshin parasysh të ardhurat e familjes⁶, *numri i anëtarëve të saj në moshë pune, nën moshë pune, mbi moshë pune, pensionistët, personat me aftësi të kufizuara, të ardhurat nga vetëpunësimi, punësimi në sektorin privat ose publik, emigracioni etj.*

⁵ Ish-MPÇS emërtohej kështu në vitin 2005, ndërsa sot quhet Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale.

⁶ Sipas legjislacionit në fuqi Ligji nr. 9355/2005, NE kushtëzohej nga të ardhurat e familjes si punësimi, pronësia e kapitalit, madhësia e familjes dhe struktura, refuzimi i punës së paguar, trajnimet profesionale dhe veprimet spekulative.

Për ndihmën ekonomike të pjesshme (familjet që kishin të ardhura të pakta, përfitonin NE të pjesshme), përveç variablave të mësipërme merreshin në konsideratë edhe disa kritere të tjera si: të ardhurat e familjes nga toka, nga bagëtia, nga pensionet etj. Këto variabla shërbenin për të përcaktuar numrin e familjeve përfituese dhe masën ligjore të ndihmës për çdo familje. Në këtë rast pasi llogariteshin nevojat e këtyre familjeve sipas kritereve kombëtare në fuqi, zbriteshin të ardhurat që ato siguronin nga burime të tjera dhe mbi këtë bazë llogaritej shuma e ndihmës ekonomike së pjesshme. NE të pjesshme kryesisht mernin familjet në zonat rurale të cilat siguronin të ardhura të pakta (të pamjaftueshme) nga toka ose bagëtia.

Për raste të veçanta që karakterizoheshin me varfëri ekstreme, njësitë e qeverisjes vendore, kishin të drejtë t'i mbështesnin këto raste me NE edhe kur ato nuk plotësonin kriteret kombëtare.

Mbi bazën e këtyre llogaritjeve, njësitë e pushtetit vendor, formulonin nevojat për fonde të cilat i adresonin për miratim në Ish-MPÇS-së në atë kohë. Këto kërkesa përsëriteshin çdo dy muaj dhe paraqiteshin për miratim në Ish-MPÇS-së.

Shërbimi Social Shtetëror (SHSSH), si agjensi publike e implementimit të politikave të mbrojtjes sociale bënte vlerësimin e të dhënave dhe kërkesave për fonde që paraqesnin njësitë e pushtetit vendor dhe programonte bllok grandin në bazë të mundësive të buxhetit të shtetit, të cilat i paraqiteshin për miratim në Ish-MPÇS. Nevojat për fonde nëpërmjet Ish-Ministrisë së Punës dhe të Çështjeve Sociale paraqiteshin për miratim në Ministrinë e Financave. Thelbi i kësaj metode konsistonte në vendosjen e një korespondence të drejtë midis vëllimit të nevojave dhe masës së aplikimit të fondeve

për ndihmën ekonomike dhe shërbimeve sociale. *Fondet e NE-së* programoheshin dhe çelehin për *çdo bashki* dhe *ish-komunë*.

Mekanizmi i programimit dhe disbursimit të fondeve bazuar në *ligjin nr. 9355 datë 10.03.2005 “Për Ndihmën dhe Shërbimet Shoqërore”*, do të përmisohej duke i dhënë shumë kompetenca pushtetit vendor për përdorimin e ndihmës ekonomike.

U rritën kompetencat e njësive të pushtetit vendor për vlerësimin e nivelit të varfërisë e cila do të pasurohej me elementë të rinj në mënyrë që:

- ndihma ekonomike të ishte e mirtargetuar dhe e orientuar në segmentet më të varfëra;
- ndihma të mos mbetej pasive, masa të mos mbetej modeste dhe prioritet të kishin shërbimet sociale, kundrejt ndihmës në *cash*;
- ndihma të kushtëzohej me punë e shërbime në komunitet.

Ish-MPÇS, në bazë të *vlerësimit* të kërkesave që paraqitnin njësitë e qeverisjes vendore për fonde dhe sipas mundësive të buxhetit të shtetit, programonte *fondet e NE-së për çdo bashki* dhe *ish-komunë* që në fillim të vitit.

Ish-MPÇS i delegonte fondet e ndihmës ekonomike si grante për çdo njësi të pushtetit vendor, një herë në dy muaj. Të gjitha fondet e kursyera si rezultat i përdorimit me efektivitet të NE-së ishin kompetencë dhe në përdorim të njësisë së pushtetit vendor. Fondet e NE-së që kurseheshin, nuk mund të rishpërndaheshin gjatë vitit nga SHSSH nga një bashki në tjetrën, por i ktheheshin buxhetit të shtetit. Ish-MPÇS çelte në thesar një herë në dy muaj, fondet që do të përdoreheshin nga bashkitë/ish-komunat në bazë të situatës social-ekonomike të familjeve/individëve përfitues.

Qeveria përveç kategorive të tjera, në reformën e vitit 2005-së mbështeti me ndihmë ekonomike dhe kategorinë e Jetimëve mbi *moshën 25 vjeç të cilët nuk ishin sistemuar në punë si dhe nënat që lindnin më shumë se dy fëmijë njëherësh, të cilat u përkisnin familjeve në nevojë.*

Programin e Ne-së e përfitonin vetëm shtetasit shqipëtarë që jetonin brenda vendit siç vijon dhe sot. Përfitimi i saj bëhej mbi bazën e mundësive për të siguruar të ardhura mujore dhe nuk ishte e kufizuar në kohë.

Gjatë ekzekutimit të reformës të vitit 2005, qeveria duke e vlerësuar programin e ndihmës ekonomike, si një komponent të rëndësishëm për zbutjen e varfërisë, vendosi të përmirësojë mekanizmin e shpërndarjes të kësaj ndihme, me synim rritjen e të ardhurave të familjeve në nevojë nëpërmjet punës dhe njëkohësisht, përmirësimin e mjedisit komunitar nga puna e anëtarëve të tij.

Dy metoda ishin që ndiqeshin për përfshirjen në programet e kondicionimit të NE-së me *punë dhe shërbime në komunitet, bazuar në VKM nr. 787, datë 14.12.2005 “Për përcaktimin e kriterëve të procedurave të masës së ndihmës ekonomike” i ndryshuar më pas me VKM nr. 10503, datë 23.04.2008.*

E para me iniciativë të kryetarit të njësisë vendore, ku ishin të ftuar individët/familjet përfituese të NE-së të aftë për punë, që të merrnin pjesë në punë dhe shërbime *në komunitet me kohë të pjesshme (disa ditë në muaj), përkundrejt pagesës së masës përkatëse të ndihmës ekonomike. Këto projekte mund të organizoheshin në bazë ish-komune ose njësie bashkiake, por edhe në njësi më të vogla, në bazë fshati etj.* Shembull: një herë në muaj ishin të ftuar të pastronin një rrugë të përcaktuar nga vetë

kryetari i njësisë vendore, në të kundërt përjashtojë individin nëse ishte i vetëm apo familja ku bënte pjesë individin i ftuar për punë, nga përfitimi i NE-së.

E dyta me iniciativë të kryetarit të njësisë vendore, ku individët/familjet që klasifikoheshin si përfituese të ndihmës ekonomike, ishin të ftuara të mernin pjesë *me kohë të plotë në projektet e punëve dhe shërbimeve në komunitet*, përkundrejt pagës minimale, e cila *nuk duhet të ishte më e vogël se paga minimale në shkallë vendi*. Nëse ato nuk pranonin të aktivizoheshin, përjashtoheshin nga skema e NE-së. Familjet e tjera që kishin të ardhura dhe nuk vlerësoheshin për të përfituar NE, sipas kriterëve të vendosura, nuk përfshiheshin në këto projekte.

Shpenzimet për këto projekte mbulohehin nga:

1. Fondi i NE-së, i cili në atë kohë përllongaritej sipas *sipas strukturës së familjeve*. Kjo shumë nuk duhej të shkonte më shumë se shumta maksimale e NE-së që në atë kohë ishte 7.000 (shtatë mijë) lekë në muaj.
2. Fonde të vetë Bashkive/ish-Komunave, të cilat siguroheshin nga të ardhurat prej taksave vendore. Ky zë duhej të mbulonte pagesat deri në *nivelin e pagës minimale* gjithashtu dhe pagesat për kontributet.

Ishin Bashkitë/ish-komunat ato të cilat *përcaktonin fushat dhe përparësitë, ku do të zbatoheshin projektet për punë komunitare apo për shërbime shoqërore*. Kriteret për limitet e kohës dhe kushteve të punës, përcaktoheshin në nivel kombëtar. Sipas këtyre kriterëve, njësitë paraprakisht duhet të kishin vlerësuar:

- situatën ekonomike të periudhës paraardhëse të njësisë, sipas treguesve sasior dhe cilësor, që përdorejshin në nivel kombëtar për vlerësimin e varfërisë.

- kategorizimin e familjeve përfituese të NE-së sipas strukturës së saj; familje me anëtar person me aftësi të kufizuar⁷; familje me kryefamiljar PAK; familje me mbi 50% të anëtarëve të aftë për punë dhe në moshë pune; persona të aftë për punë nga mosha 18-16 vjeç; familje me një prind; familje me gruan kryefamiljare; të tjera.
- numrin e familjeve dhe anëtarëve të tyre të aftë për punë të cilët ishin në gjëndje të merrnin pjesë në projektet për punë e shërbime në komunitet.
- numrin e familjeve, personat me aftësi të kufizuara dhe ato persona mbi moshë pune të cilët nuk kishin mundësi fizike për t'u angazhuar në projekte për punë e shërbime në komunitet.

Familjeve që vlerësoheshin se kishin anëtarë të aftë për punë, por për arsye sëmundjesh, barrë lindje etj, anëtarët e tyre nuk mund të angazhoheshin me punë në projektet e punësimit apo shërbimet sociale, u akordohej NE në përputhje me kriteret ekzistuese.

Lista e personave që do të ishin pjesëmarrës në punët në komunitet, miratohej nga Këshilli bashkiak/ish-komunal. Ky Këshill përcaktonte dhe objektet ku do të bëheshin punimet, bazuar në një kalendar i cili merrte në konsideratë ngarkesën, duke përcaktuar kështu vëllimin e punës për projektin *me kohë të plotë apo të pjesshme*.

Me mbarimin e projektit individi/familja që ishte e përfshirë në projekt, kishte të drejtë të riaplikonte për t'u përfshirë në skemën e ndihmës ekonomike duke respektuar kriteret e legjislacionit në fuqi për përfitimin e ndihmës. Shërbimi Social Shtetëror dhe Drejtoritë rajonale të SHSSH-së ndiqnin projektet që zbatonin njësitë e qeverisjes

⁷ Person me Aftësi të Kufizuar është ai person të cilit i është kufizuar aftësia, si pasojë e dëmtimit fizik, shqisor, të intelektit, psikiko-mendor, të lindura apo të fituara gjatë jetës nga aksidente, sëmundje të përkohshme ose të përhershme, të cilat nuk vijnë nga shkaqe që lidhen me punësimin.

vendore dhe kontrollojnë zbatimin e tyre, përdorimin e fondeve dhe progresin e objektivave.

Nga intervistimet me strukturat në pushtetin lokal, u konstatua se këto programe nuk kishin gjetur aplikim të gjerë në bashki dhe ish-komuna. Kishte patur disa iniciativa sporadike në disa qytete për aplikimin e tyre, por ishte vlerësuar se mungonin burimet financiare dhe njerëzore për aplikimin e programit të kushtëzimit të ndihmës ekonomike me punë apo shërbime komunitare. Nga këto intervista ishte konstatuar se kishte një nivel të ulët të njohurive nga administratorët social për aplikimin e këtyre programeve, kjo jo vetëm sepse pjesa më e madhe e tyre nuk kishin formimin e duhur profesional por ishin dhe objekt i largimit të shpeshtë nga puna.⁸

Ende dhe sot nuk ka standard në emërimin dhe shkarkimin e tyre. Niveli i njohjes së legjislacionit bazë të ndihmës ekonomike nga administratorët social përcakton, shkallën e efikasitetit të destinacionit të përdorimit të fondeve të NE-së, duke synuar dërgimin e ndihmës ekonomike tek familja realisht e varfër.

“Si një shembull pozitiv mund të përmendim Bashkinë e Tiranës, e cila ka aplikuar për katër vite radhazi këtë program. Në bashkëpunim me Njësitë bashkiake të kryeqytetit janë larguar nga skema e NE-së një numër i konsiderueshëm i personave abuzivë në skemë, të cilët janë konstatuar si aktiv për të ofruar shërbime në komunitete, por e kanë refuzuar këtë program”.

Si një program i decentralizuar, i cili vijon dhe aktualisht, janë fondet shtesë për Bllok Ndhmën të cilat përcaktohen në trajtën e transfertës së kushtëzuar (që do të thotë se,

⁸ Informacion i marrë nga Zyrat dhe Institucionet Qendrore dhe Lokale të Shërbimeve Sociale.

këto fonde përdoren vetëm për NE-në dhe nuk mund të përdoren nga pushteti vendor për nevoja të tjera).⁹ Pushteti lokal përfiton grante të kushtëzuara nga buxheti i shtetit për këtë qëllim nëpërmjet mekanizmit të Bllok grantit të NE-së. Është vetë qeverisja vendore e cila e zbaton këtë program duke parashikuar sipas kërkesave fondet e përvitshme që kalojnë çdo vit në buxhetet e tyre. Gjithashtu qeverisja vendore e zbatonte siç vijon dhe sot, programin e ndihmës ekonomike nëpërmjet administratorëve social në ish-komuna dhe bashki, të cilët vlerësojnë familjet aplikuese sipas dokumentacionit përkatës dhe afateve të përcaktuara me ligj. Ndërkohë monitorimi i përdorimit të fondeve buxhetore të NE-së ishte dhe vazhdon të jetë përgjegjësi e SHSSH dhe strukturave të tij të varësisë. Në 12 qarqet e vendit funksiononin Zyrat e Inspektoriatit të ndihmës ekonomike në atë kohë¹⁰. Inspektimi i zbatimit të programit të NE-së ishte aktiviteti më i rëndësishëm i tyre.¹¹

Sistemi i mbrojtjes sociale në Shqipëri, pavarësisht nga progresi i arritur pas vitit 2005-së në zbatim të reformave në fushën legislative, organizative dhe strukturore dhe të impaktit të dukshëm për reduktimin e varfërisë, decentralizimin dhe delegimin e kompetencave në qeverisjen vendore, kishte ende nevojë për ndryshime për arritjen e qëllimit të këtyre reformave. Në hartimin e strategjive sektoriale dhe ndërsektoriale, Qeveria Shqiptare në rastin e zhvillimit të Programit të Asistencës Sociale, përcaktonte

⁹ Transferte të kushtëzuara do të thotë që, këto fonde përdoren vetëm për NE-në dhe nuk mund të përdoren nga pushteti vendor për nevoja të tjera.

¹⁰ Sot: 12 Drejtoritë Rajonale të Shërbimit Social Shtetëror të cilat shtrihen dhe funksionojnë në 12 Qarqe të vendit.

¹¹ Ato që dikur ishin Zyrat e Inspektoriatit të NE-së, sot Drejtoritë Rajonale të Shërbimit Social Shtetëror, përveç se kontrollojnë përdorimin e fondeve të buxhetit të shtetit për ndihmën ekonomike, kanë të njëjtën kompetencë edhe për kontrollet e fondeve të pagesave të Aftësisë së Kufizuar.

si detyrë arritjen e objektivave specifike, të cilët synonin rritjen e masës së NE-së, uljen e numrit të përfituesve si dhe modernizimin e kësaj skeme.

Si rrjedhojë, gjatë vitit 2011 Kuvendi i Shqipërisë miratoi *Ligjin nr. 10399, datë 17.03.2011 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 9355, datë 10.03.2005 “Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore” (të ndryshuar)*, i cili solli një kategorizim të përfituesve të programit të NE-së, duke vendosur si prioritarë kategori të reja vulnerabël. Do të ndalemi në vijim për këtë reformë të dytë të ndihmës ekonomike që vazhdon dhe aktualisht të zbatohet.

3.2. Karakteristikat social-ekonomike të NE-së pas reformës së parë të vitit 2005-së

Karakteristikat thelbësore social ekonomike të ndihmës ekonomike pas reformës së parë të vitit 2005-së në formë përmbledhëse janë si vijon:

- Zhvillim i ulët ekonomik;
- Kontrastet dhe mospërputhjet midis zhvillimeve ekonomike, sociale dhe kulturore të vendit;
- Nivel i ulët i të ardhurave;
- Rol i rëndësishëm i GDP nga emigrantët shqipëtarë;¹²
- Kontrastet territoriale, gjeografike dhe demografike;
- Niveli i lartë i aktiviteteve informale;
- Niveli i lartë i informalitetit të tregut të punës;
- Niveli i lartë i punës në të zezë;
- Problem në shpërndarjen e burimeve të disponueshme që shpesh herë janë dhe të limituara;

¹² Ekspertët si dhe Banka e Shqipërisë vlerësojnë se të ardhurat nga emigracioni janë 1 billion USD.

- Papërshtashmëria e pensioneve, mbrojtjes sociale dhe sistemit të sigurimeve shoqërore për t’iu përgjigjur nevojave të personave të moshuar;
- Efiçenca jo e mirë e administratës publike;
- Kompetencat e autoriteteve vendore nuk janë ato që kërkohen;
- Influcencë politike/elektorale, traditat, modelet, vlerat dhe stili i jetesës të cilat ndikojnë në përpjekjet për të racionalizuar reformën.

Në këtë kontekst, varfëria, përbën më shumë se një problem social-ekonomik.

Transferta e përfitimeve të paaftësisë (përfitimet për personat me aftësi të kufizuar) dhe sistemi i pagesave të ndihmës ekonomike për herë të parë në vitin 1993, ishin një përgjigje ndaj nevojave për shkak të papunësisë dhe grupeve vulnerabël pa asnjë alternativë për të mbijetuar. Gjithsesi përpjekjet për t’u përballuar me këtë fenomen njëherësh evidentonin që nuk kishte një metodologji të saktë për të përcaktuar si duhej nivelin e NE-së, nivelin e pensioneve si dhe pagesës së papunësisë. Rrjedhimisht indikatorët ekzistues të varfërisë jo gjithnjë na tregonin domosdoshmërisht targetimin e grupeve të popullsisë më të varfër në mënyrë që t’u ofrohej mbështetja e shtetit.

Mbi këtë bazë qeveria Shqipëtare ka modifikuar kushtet për të alokuar përfitimet në cash, në mënyrë që të plotësoheshin kërkesat sociale në krahasim me fondet e buxhetit të shtetit. Për këtë arsye u ndoq reforma e dytë e përgjithshme e sistemit të mbrojtjes sociale në Shqipëri, në mënyrë që t’i përgjigjej më mirë nevojave në rritje për ndihmë ekonomike, asistencë sociale, shërbime sociale dhe përfitime në cash.

3.3. Analiza e karakteristikave social-ekonomike të NE-së pas reformës së parë të vitit 2005-së

Më poshtë vijon analiza e karakteristikave social ekonomike të ndihmës ekonomike pas reformës së parë të vitit 2005 të lartpërmendura:

Vështirësitë që ndeshnin familjet e ndihmës ekonomike gjatë procesit të aplikimit

Gjatë vëzhgimeve të kryera në zyrat lokale të administrimit të programit të NE-së, ishte konstatuar se këto vështirësi kishin të bënin me grumbullimin e dokumentacionit; prezantimin e dokumentacionit pranë zyrave lokale të ndihmës ekonomike si dhe diversifikimin e informacionit të grumbulluar. Konkretisht, aplikantët ndesheshin në vështirësi për sigurimin e dokumentave të nevojshme për aplikim, të cilat ishin të shumta dhe jo lehtësisht të grumbullueshme, duke patur parasysh këtu aftësitë, mundësitë dhe aksesin e familjeve të varfëra për informacion dhe dokumentacion, kushtet e infrastrukturës, kapacitetet e përpunimit të informacionit të grumbulluar, saktësinë dhe vërtetësinë e dokumentacionit që lëshohej nga zyrat, sportelet dhe institucionet e veçanta, mundësinë e lëshimit të dokumenteve false përkundrejt pagesave nën dorë etj. Dokumentacioni ishte i shumëllojshëm, që vinte nga disa burime dhe institucione dhe jo lehtësisht i konvertueshëm dhe i përpunueshëm.

Niveli i lartë i gabimit në përjashtim gjatë procesit të përzgjedhjes së përfituesve

Kriteret e përzgjedhjes së përfituesve ishin të shumta dhe kompleks. Si të tillë këto kritere nuk evidentonin dhe identifikonin qartë përfituesit më nevojtarë legjitimë për t'u

kualifikuar, të cilët bëjnë pjesë në enklavat¹³ e varfërisë ekstreme. Baza e vendim-marrjes vazhdon të ishte shumë e gjerë sepse problematikat e miratimit të listës së përfituesve të ndihmës ekonomike nga këshillat bashkiakë dhe ish-komunalë ndikonin në rritjen e riskut të subjektivizmit dhe manipulimit për motive dhe qëllime korruptive, abuzive, madje edhe politike, klienteliste dhe elektorale. Këtyre motiveve u duhet shtuar edhe mundësia e gabimeve njerëzore gjatë procesit vendim-marrës.

**Ndikimi jo shumë i ndjeshëm i ndihmës ekonomike në zbutjen e varfërisë
dhe përmirësimin e cilësisë së jetës së përfituesve**

Nga studimi i dokumentacionit dhe treguesve të masës së NE-së, konstatohet se, INSTAT llogariste nivelin e varfërisë sipas kriterit të shpenzimeve rreth 4.800 lekë për person në muaj (47.73 dollar) dhe nivelin e varfërisë ekstreme rreth 3.800 lekë për person në muaj (436.87 dollar). Të ardhurat nga ndihma ekonomike për një person ishin mesatarisht rreth 0.5 dollar në ditë ose rreth 50% e nivelit të varfërisë ekstreme ose rreth 25% e nivelit të varfërisë absolute, siç përcaktohet nga LSMS.¹⁴ Mbulimi i nevojave ligjore me fonde nga buxheti qendror ishte ende i ulët në nivelin 40-60% gjatë viteve 2007-2012 ç’ka vështirësonte impaktin pozitiv (pamjaftueshmërinë) të Programit të NE-së në uljen e varfërisë.¹⁵

¹³ Enklavë, rrjedh nga latinishtja: «inclavo», e cila përkthehet si "lockable". Ka kuptimin e një “skute”, “zone të mbërthyer”, të kushtëzuar për të qenë të tillë-të izoluar. (Përshtatur nga autorja).

¹⁴ Të dhënat e varfërisë absolute dhe ekstreme sipas LSMS 2002. LSMS është Anketa e Matjes së Nivelit të Jetesës, realizuar nga Instat.

¹⁵ Gjithashtu ndodhte siç vazhdon dhe sot, një ulje e motivimit për punë nga personat përfitues, pasi NE shihej si një formë e mirë mbijetese dhe pse e pamjaftueshme për të përballuar minimumin e standartit të jetesës. Sipas Zyrës së Punës (viti 2013), kërkesa për punë ishte ulur me 30%. Sipas INSTAT (viti 2012, 2014), papunësia ishte rritur nga 12.8% në vitin 2012, në 14% në vitin 2014, pra ishte rritur me 1.2%.

**Aplikimi jofleksibël i masës së përfitimit dhe mungesa e korrelacionit midis
masës së NE-së, nivelit të varfërisë si dhe nevojave reale të familjeve të
varfëra**

Në mjaft ambjente të politikbërësve, por sidomos në administratorët dhe zbatuesit e programit të NE-së, mbizotëronte mendimi se duhej t'i jepej fund praktikës së akordimit të ndihmës ekonomike në masë të ulët përfitimi. Masa e NE-së të pjesshme në nivelin 5-8-10-20 dollar në muaj ishte e papërfillshme. Po kështu dhe masa e NE-së të plotë, 30-35 dollar në muaj, ishte në fakt sa 1/2 e masës ligjore të nevojave për ndihmën ekonomike të familjeve të varfëra. Po të krahasonim masën faktike të NE-së me nivelin e varfërisë, qoftë edhe të varfërisë ekstreme të përcaktuar nga INSTAT, rezulton se ajo arrinte në 1/3 e këtij niveli.¹⁶

**Sistemi burokratik i mbledhjes së informacionit dhe dokumentacionit që
nevojitej për të matur dhe vlerësuar varfërinë në nivel lokal**

Një nga dobësitë më të dukshme dhe të rëndësishme të sistemit të kaluar të shpërndarjes së ndihmës ekonomike ishte sistemi burokratik i mbledhjes së informacionit dhe dokumentacionit që nevojitej për të matur dhe vlerësuar varfërinë në nivel lokal. Kjo dobësi evidentohet në tre aspekte: i. informacioni dhe dokumentacioni i grumbulluar nga institucionet qeveritare, brenda dhe jashtë sistemit të MPÇS, ishte jo i saktë, nuk sillej në kohë dhe ushqente keqpërdorimin dhe abuzimin me burimet financiare; ii. analiza dhe vlerësimi i informacionit dhe dokumentacionit të grumbulluar nuk ishin të plotë. Analiza dhe vlerësimi nuk bëhej në mënyrë shumëdimensionale si dhe në një perspektivë komplekse; iii. konstatohet një informalitet i qartë dhe i dukshëm në

¹⁶ Burimi: Ish-MPÇS, Drejtorja e Politikave të Shërbimeve Sociale, Tiranë dhjetor 2012.

verifikimin fizik të standarteve të jetesës së aplikantëve sepse dokumentacioni i kërkuar dhe i grumbulluar ishte i pasaktë dhe evaziv si dhe ishte vështirë të identifikoheshin dhe provoheshin në rrugë dhe me dokumente ligjore anëtarët e familjes emigrante, të punësuarit ilegal, kafshët shtëpiake që zotëronte familja etj.

**Pamjaftueshmëria e kapaciteteve institucionale dhe burimeve njerëzore,
sidomos në nivel rajonal dhe lokal, për të përballuar sfidat e programit të
ndihmës ekonomike**

Numri, cilësia dhe kualifikimi i burimeve njerëzore të caktuara për të intervistuar familjet aplikante për NE në shumë bashki dhe ish-komuna, ishin të pamjaftueshëm. Kjo mungesë bënte emergjente nevojën për rritjen e kapaciteteve institucionale të zyrave rajonale dhe lokale, punonjësve socialë dhe administratorëve të NE-së. Pikat më të dobëta në punën e institucioneve dhe individëve të përfshirë në zbatimin e programit të NE-së ishin numri i vogël i administratorëve dhe punonjësve social (dhe në ditët e sotme vijon të mbetet sfida, forcimi dhe rritja e kapaciteteve të burimeve njerëzore për të verifikuar fizikisht banesat dhe kushtet e jetesës të përfituesve një apo dy herë në vit, siç parashikohet në ligj) për banorë/familje/aplikantë që nuk i përgjigjej nevojës për një perzgjedhje korrekte dhe rigoroze të përfituesve të ndihmës ekonomike, sidomos për të realizuar intervista në terren, në familje dhe për të përdorur tregues alternativë të vlerësimit të gjëndjes ekonomike të familjeve aplikuese. (*Avokati i Popullit, fq. 19: 2019*). Gjithashtu konstatohej një mungesë e ndjeshme e njohurive mbi kuadrin ligjor të skemës së NE-së, sidomos për targetimin dhe shpërndarjen. Si rrjedhojë, shtrohej nevoja e standartizimit të raportit midis numrit të administratorëve social në bashki dhe ish-

komuna me numrin e familjeve të NE-së në shkallë vendi. Kjo sepse në terren ka diferenca të ndjeshme nga njëra njësi vendore te tjetra.

Mungesa e kompjuterizimit dhe informatizimit të të dhënave

Kompjuterizimi i informacionit dhe statistikave të grumbulluara ishte në nivel të ulët. Kjo gjëndje e teknologjisë së informacionit në zbatimin e programit të ndihmës ekonomike vështirësonte disponimin dhe qarkullimin e informacionit adekuat dhe nuk mundësonte verifikueshmërinë e informacionit dhe dokumentacionit nga disa burime. Gjithashtu ky nivel i ulët i teknologjisë së informacionit ushqente informalitetin si dhe krijonte terrenin për abuzim dhe praktika korruptive në përzgjedhjen dhe kualifikimin e përfituesve.


Informaliteti dhe paqartësia në shpërndarjen e ndihmës ekonomike në zonat urbane dhe qytetet e mëdha

Paqartësia në mënyrën e funksionimit të skemës së NE-së mund të identifikohet lehtësisht në zonat urbane si dhe në qytetet e mëdha. Nga informacionet e grumbulluara, konstatohet se rreth një pjesë e madhe e aktiviteteve të biznesit në qytete dhe e punonjësve që punonin në aktivitete private të licensuara ishin informale duke ndikuar kështu ndjeshëm në deformimet e zbatimit të programit të ndihmës ekonomike.

Për sa më lartë dalim në konkluzion se, programi i NE-së duhet të integrohet dhe akomodohej më mirë në kontestin e politikave sociale, shërbimeve sociale, politikave të punësimit, pensioneve, luftës kundër papunësisë dhe informalitetit në ekonomi dhe në tregun e punës, luftën kundër varfërisë dhe nxitjes së përfshirjes sociale të familjeve të varfëra.

3.4. Analiza e Masave të reformës së parë dhe të dytë të NE-së

Fondi për Programin e ndihmës ekonomike është rritur nga viti 2007 në vitin 2011 me 21% dhe më pas nuk ka ndryshuar. Vetë masa mesatare e NE-së është rritur. Në vitin 2009 mesatarja e plotë (kjo mesatare i referohet mesatares për NE-në e plotë dhe të pjesshme) e NE-së ka qenë 3.900 lekë/familje dhe në vitin 2012 kjo masë u bë 4.195 lekë/familje, ndërsa masa mesatare e ndihmës ekonomike¹⁷ në vitin 2009 ka qenë 3.150 lekë, dhe në vitin 2012 ka qenë 3.390 lekë/familje.¹⁸ Në grafikun e mëposhtëm nr 1 gjeni dhe ilustrimet përkatëse:



GRAFIK 1. Masa mesatare e NE në vitin 2009 dhe 2019

Kjo rritje e masës së NE-së nuk merrte për bazë dhe indeksimin me pagën minimale në shkallë vendi. Duke qenë se pagesa në cash, përbën të ardhurën e vetme të familjeve përfituese mbetet e pamjaftueshme për të përmbushur kërkesat minimale të jetesës së tyre. Bazuar në VKM nr. 787, datë 14.12.2005 “Për përcaktimin e kritereve, të procedurave dhe të masës së ndihmës ekonomike”, pika 19 pavarësisht nga përbërja e

¹⁷ Masa mesatare nënkupton shpërndarjen e njëtrajtshme të totalit të vlerës, pra numrin total të një njësie (në këtë rast numrin e familjeve) përpjestuar me totalin (pra fondin përkatës).

¹⁸ Burimi: Ish-MPÇSSHB, Drejtoria e Politikave të Shërbimeve Sociale, Tiranë dhjetor 2012.

familjes, masa maksimale mujore e NE-së ishte 7.000 lekë (pagesa maksimale) sipas përllogaritjeve mbi anëtarët e familjes. Kjo masë ndryshoi në 8.000 (tetë mijë) lekë me VKM nr. 96, datë 07.02.2012 “Për një ndryshim në VKM nr. 787 të vitit 2005”. Rreth 59% e këtyre familjeve përfituese ishin në zonat rurale dhe 41% në zonat urbane. Rreth 67% e familjeve përfitonin ndihmën e pjesshme dhe 33% e familjeve përfitonin ndihmën e plotë. Sipas të dhënave rezulton se në vitin 2012, qarqet Shkodër, Dibër, dhe Elbasan kishin numrin më të lartë të përfituesve të ndihmës ekonomike. Sot numrin më të lartë të këtyre përfituesve e kanë qarqet Kukës, Dibër dhe Elbasan.

Numri i familjeve përfituese të ndihmës ekonomike në fund të vitit 2012 rezulton 99.494 me një fond mujor prej 4.3 miliard lekësh. Ky numër ishte rritur me rreth 0.5% krahasuar me vitin 2007, rritje e cila i dedikohej mungesës së mundësive për punësim si dhe përfshirjes së kategorive të reja në këtë skemë.

Nga ana tjetër dhe pse i padukshëm për këtë rritje të numrit të përfituesve të ndihmës ekonomike, qëndronte edhe problemi i presionit që ushtronin Kryetarët e Njësive Vendore ndaj administratorëve shoqërorë, për të trajtuar me NE mjaft familje të cilat nuk i përmbushin kriteret për t’u trajtuar me këtë pagesë. Vlerësohet se masat e propozuara nga inspektoriatet nuk kanë gjetur zbatim nga ana e titullarëve të njësive të qeverisjes vendore.

Ndryshimet në legjislacion pas reformës së parë të konkretizuar me ligjin nr. 9355 të vitit 2005 “Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore”, si në lidhje me kategoritë përfituese dhe në lidhje me alternimin e programit, kontribuonin në *targetimin më të mirë të individëve në nevojë, mbulimin me të ardhura më të larta për familjen, përfitimin e*

komunitetit ku ofroreshin këto punë apo shërbime, reduktimin e nivelit të varfërisë dhe realizimin e kthimit të skemës së ndihmës ekonomike nga një skemë pasive në një skemë aktive. Por ende kjo skemë siç u tha dhe më lart, nuk merrte në konsideratë kompleksitetin e varfërisë dhe si e tillë mbetej një sistem i paaftë për mbrojtjen sociale dhe ekonomike të grupeve të përjashtuara.

Konstatohet se me ndryshimet ligjore të realizuara gjatë periudhës 2007-2012 kishte përpjekje për ripërcaktime të reja në fushën e skemës së asistencës sociale përsa i përket varfërisë dhe përjashtimit social. Targetimi i grupeve të reja dhe prioritizimi i kategorive kishin dhënë një vlerë të shtuar në konceptin e ndihmës tek grupet vulnerabël. Në vitet 2014-2018 u parashikua dhe u realizua një pilotim 4 vjeçar i ligjit të atëhershëm duke përfshirë:

- ngritjen e regjistrit elektronik në nivel kombëtar;¹⁹
- formulën e pikëzimit për përfituesit e ndihmës ekonomike,
- vendimarrjen në nivel kombëtar.

Në kuadër të plotësimit të akteve nënligjore përgjatë viteve 2014-2017 për zonat pilot, dhe nga janari i vitit 2018 dhe në vazhdim në të gjithë vendin, risi solli mënyra e re e aplikimit që familja duhet të plotësojë në prezencë të administratorit shoqëror.

Është parë si një domosdoshmëri dizenjimi i një sistemi të mirë targëtimi. Fillimisht është shumë e rëndësishme të merret në konsideratë një strategji e duhur e mbledhjes së të dhënave. Proçesi i mbledhjes së të dhënave duhet dizenuar me kujdes në mënyrë që të sigurohet transparenca, dinamizmi, efienca e kostos dhe fizibiliteti administrativ.

¹⁹ Thënë ndryshe: Dixhitalizimi i Skemës së Ndhmës Ekonomike.

Suksesi i sistemeve të targetimit të familjeve të varfëra varet shumë nga lloji i aplikimit dhe mbledhjes së të dhënave rreth këtyre familjeve, sepse ato diktojnë llojin e mekanizmit që do të përdoret për pranueshmërinë në skemën e mbrojtjes sociale.

Nëpërmjet përdorimit të formës së aplikimit (para ngritjes së regjistrit elektronik në nivel kombëtar) merrej shumë pak informacion rreth mirëqënies së një familje. Informacioni konsistonte nëse personi ishte i punësuar, nëse kishte tokë apo blegtori. Por kjo mënyrë që vlente për të gjykuar administratori shoqëror mbi situatën social ekonomike, nuk kishte rezultuar efektive. Verifikimi i të dhënave me institucionet bëhej me dërgimin e listave dhe konfirmimin e tyre, proces i cili në më të shumtën e rasteve bëhej fiktiv.

Ndërsa forma e re e aplikimit siguronte tashmë informacion më të gjerë rreth mirëqënies së një familje. Kjo formë aplikimi të jep informacion mbi demografinë e familjes, arsimin përkatës të anëtarëve të saj, punësimin, informacion rreth kushteve të banimit, zotërimit të aseteve, përdorimit të tokës, informacion nëse është përfitues nga skema e ndihmës shoqërore ose nëse përfiton nga remitancat.²⁰

Nga kjo formë aplikimi derivojnë variablat që përdoren në formulën e pikëzimit. Kjo formë aplikimi pasi është bazuar në pyetësin e anketës së matjes të Nivelit të Jetesës²¹ jep shumë informacione mbi konsumimin e një familje dhe çon në identifikimin më të saktë të mirëqënies së familjes. Do të jetë tashmë struktura rajonale²², e cila do të bëjë verifikimin elektronik nëpërmjet softwerit që do të kryqëzoj të dhënat e deklaruara me

²⁰ Remitancat janë pagesa parash në formën e dërgesave pa kundër shpërblim.

²¹ Anketa LSMS e cituar më lartë, e cila ka qenë objekt studimi në mënyrë të vazhduar nga INSTAT.

²² Drejtoritë Rajonale të Shërbimit Social Shtetëror të cilat funksionojnë në 12 Qarqet e vendit.


të gjitha entet shtetërore. Kjo formë aplikimi siguron një proces transparent të mbledhjes së të dhënave dhe mjaft dinamik pasi është një proces regjistrimi i hapur.

Qarqet ku u pilotua fillimisht mënyra e re e aplikimit, verifikimit dhe llogaritjes së ndihmës ekonomike ishin: Tiranë, Durrës dhe Elbasan. Në këto qarqe kemi përfshirjen e katër zonave të ndarjes së nivelit të varfërisë sipas LSMS²³ që janë ato bregdetare, qendrore, malore dhe Tirana që ka një specifikim të veçantë.

Popullsia në këto zona është shumë heterogjene për vetë lëvizjet që kanë ndodhur. Pas vitit 2001 në këto tre qarqe banon rreth 39% e popullsisë së vendit, (referuar Repobës viti 2001)²⁴ ndërsa në vitin 2006 kjo shifër rritet me 6%. *Kemi një dinamikë më të madhe të prurjeve, nga zonat rurale në zonat urbane, nga zonat malore në ato bregdetare dhe ato qendrore.* Në vitin 2011 u regjistruan në Durrës 262.785 banorë, në Elbasan 295.827 dhe në Tiranë 749.365, pra 46% ndaj totalit të të gjithë popullsisë së vendit. Në grafikun e mëposhtëm nr 2 gjeni dhe ilustrimet përkatëse:

²³ Anketa e Matjes së Nivelit të Jetesës, realizuar nga INSTAT.

²⁴ Rregjistrimi i Popullsisë dhe i Banesave, realizuar nga INSTAT.



GRAFIK 2. Shpërndarja e banorëve sipas Qarkut Durrës, Elbasan dhe Tiranë në vitin 2011

Nga të dhënat zyrtare të REPOBA viti 2001, rezultonte se, *dendësia e popullsisë në shkallë vendi ishte zvogëluar nga 107 banorë për km² në vitin 2001, në 97 banorë për km² në vitin 2011*. Qarqet të cilat kishin dendësinë më të madhe të popullsisë ishin: Qarku Tiranë me 454 banorë/km², si dhe Qarku Durrës me 343 banorë/km². Shkak duket të ketë qenë lëvizjet e brendshme të popullsisë nga qarqet e tjera në këto dy qarqe.

Në kah të kundërt me rritjen e popullsisë në këto zona, ka qenë përfshirja në skemën e ndihmës ekonomike. Në këto zona numri i familjeve në këtë skemë zë 26-27% të familjeve gjithsej. Kjo si pasojë e forcimit të kontrollit por edhe i zbatimit të disa kriterëve përjashtuese.²⁵

Qarku i Tiranës përbëhej prej 5 bashkive dhe 22 komunave dhe gjatë vitit 2011 mesatarisht kishin përfituar 12.464 familje ndihmë ekonomike, nga të cilat 8.897 në zonat urbane dhe 3.567 në zonat rurale dhe sipas natyrës së ndihmës ekonomike 5.517

²⁵ Burimi: të dhënat statistikore të SHSSH, dhjetor 2012.

NE të pjesshme dhe 6.947 NE të plotë. Në grafikët e mëposhtëm nr. 3 & 4 gjeni dhe ilustrimet përkatëse.²⁶



GRAFIK 3. Masa mesatare e përfituesve të NE sipas zonave në vitin 2011



GRAFIK 4. Lloji i Ndihmës Ekonomike në vitin 2011

Numri i popullsisë që përfitonte NE në këtë kohë ishte 45.432 persona, nga të cilët 32.986 në zonat urbane dhe 12.446 në zonat rurale. 18.359 persona përfitonin ndihmë ekonomike të pjesshme dhe 27.074 përfitonin NE të plotë. 7.408 familje kishin fëmijë të

²⁶ Burimi: të dhënat statistikore të SHSSH, dhjetor 2012.

moshës 0-18 vjeç, nga të cilët 6.986 fëmijë ndiqnin arsimin e detyrueshëm 9-vjeçar dhe 3.734 ishin femra. Në tabelën e mëposhtme nr. 1 gjeni dhe ilustrimet përkatëse:²⁷

Tabla 1. Shpërndarja e Ndihmës Ekonomike sipas zonave dhe grupmoshave

NE Tiranë	Zona Urbane	Zona Rurale	NE Pjesshme	NE Plotë	0-18 vjeç	9 vjeçare	Femra
Persona	32'986	12'446	18'359	27'074	7'408 (familje)	6'986	3'734

Sipas strukturës së familjes, në qarkun e Tiranës rezultojnë 11.350 kryefamiljarë, 19.893 në moshë pune, 465 mbi moshë pune, 19.736 persona nën moshë pune. Trajtoheshin me NE 97 jetimë, 21 fëmijë trinjakë, 6 fëmijë katërnjakë, 3 pesënjakë. Në tabelën e mëposhtme nr. 2 gjeni dhe ilustrimet përkatëse:²⁸

Tabela 2. Shpërndarja e Ndihmës Ekonomike sipas grupmoshave dhe kategorive

NE Tiranë	Kryefamiljarë	K.në moshë pune	K.mbi moshë pune	K.nën moshë pune	Jetim	Trinjakë	Katërnjakë	Pesënjakë
Persona	11'350	19'893	465	19'736	97	21	6	3


Fondet e deleguara për vitin 2012 në total për qarkun e Tiranës ishin 537 milion lekë e ndarë kjo:

- për zonën urbane 384 milion lekë (në grafikun e mëposhtëm nr. 5 gjeni dhe ilustrimet përkatëse),
- për zonën rurale 152 milion lekë,

²⁷ Burimi: të dhënat statistikore të SHSSH, dhjetor 2012.

²⁸ Burimi: të dhënat statistikore të SHSSH, dhjetor 2012.

- ndërsa fondet e akorduara për 11 njësitë Bashkiake të Tiranës ishin 178 milion lekë.



GRAFIK 5. Shpërndarja e fondeve të Ndihmës Ekonomike sipas zonave në vitin 2012

Sipas përlllogaritjeve të fondeve bazuar në strukturën e familjeve, nevojat për fonde për qarkun e Tiranës për vitin 2012 duhet të ishin në total 675 milion lekë, e ndarë kjo:

- për zonën urbane 475 milion lekë,
- për zonën rurale 199 milion lekë,
- ndërsa për 11 njësitë Bashkiake të Tiranës 220 milion lekë.

Sipas vëzhgimeve në disa njësi administrative të zonës urbane, ishte ruajtur masa 100% sipas strukturës së familjes në shpërndarjen e fondeve dhe konkretisht: Njësia Bashkiake nr. 3 dhe nr. 11 në Tiranë, Bashkia Durrës, Bashkia Elbasan etj, ndërsa për njësitë administrative të tjera në shpërndarjen e fondeve për çdo familje nuk zbatohet masa e përcaktuar sipas *Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 904, datë 12.12.2012*

“Për përcaktimin e kritereve, të procedurave dhe dokumentacionit të përfitimit të ndihmës ekonomike, në zonat pilot”. Kur në shpërndarjen e fondeve për çdo familje nuk zbatohet masa e përcaktuar nga pushteti qendror/ministria përkatëse, duhet të ishte pushteti lokal që t'i plotësonte këto mungesa. Fakti ka treguar që pushteti lokal nuk e përmbushte asnjëherë këtë detyrim.

Implementimi i sistemit të ri u mundësoi tashmë strukturave që ofronin ndihmën ekonomike në tre nivelet (kombëtar, rajonal dhe lokal) siç vazhdon dhe sot:

- të përmirësojnë kapacitetet për planifikimin, menaxhimin, dhe dhënien e Ndihmës Ekonomike;
- të përmirësojnë kapacitetet për monitorimin e NE-së dhe Administratës;
- të bashkërendojnë cilësinë e ndihmës ekonomike përmes menaxhimit të çështjeve;
- të mbështesin shkëmbimin e informacionit në mënyrë të automatizuar midis SHSSH-së (strukturave të tij) dhe Institucioneve të tjera shtetërore;
- të sigurojnë shënjestrimin sa më të drejtë dhe gjithëpërfshirës të familjeve ekstremisht të varfra, të përjashtuara aktualisht nga skema për shkak të kritereve aktuale përjashtuese;
- të sigurojnë përgjigje të shpejtë e profesionale për familjet në nevojë;
- të krijojnë një bazë të dhënash efektive dhe funksionale në lidhje me skemën e pilotimit të ndihmës ekonomike.

Përmirësimet legislative prezantonin për kohën siç vazhdon dhe sot:

- më shumë mundësi sociale për target grupet në nevojë;

- *regjistër elektronik kombëtar me të dhëna të sakta mbi familjet përfituese dhe familjet në nevojë;*
- *sistem i ri pikëzimi për llogaritjen e të ardhurave të familjeve përfituese;*
- *pagesa cash duke mbështetur fëmijët e familjeve në nevojë të cilët ndjekin arsimin;*
- *ligjërimi i familjes kujdestare;*
- *aprovimi për përfitimin e NE-së duke vendosur si kusht angazhimin në punët në komunitet;*
- *hapësirë për mbështetje në formën e pagesës së ndihmës ekonomike përmes fondeve shtesë.²⁹*

Kush përfitoi nga ky sistem pilotimi?

Fillimisht të gjitha familjet dhe individët në nevojë të njërive vendore të qarqeve Tiranë, Durrës dhe Elbasan, dhe pas vitit 2018 dhe në vazhdim familjet dhe individët në nevojë në të gjithë vendin. Konkretisht:

- *familjet në nevojë;*
- *jetimët që nuk janë në institucione;*
- *prindërit e fëmijëve të lindur trinjakë e më shumë njëherësh, që u përkasin familjeve në nevojë;*
- *viktimat e trafikimit, pas daljes nga institucionet e përkujdesit shoqëror, deri në çastin e punësimit të tyre;*

²⁹ Kjo u mundësua me aplikimin e fondit shtesë mbi fondin bazë të aplikuar për NE. Dmth për ato familje të cilat nuk kategorizoheshin dot përfituese nga Bllok Ndihma bazë e NE-së, të mund të përfitonin nga një fond shtesë mbi fondin bazë, i cili do duhej t'u alokohej Bashkive nga Ministria përgjegjëse për NE-në. Fillimisht ky fond shtesë ishte në masën 3% të fondit bazë, dhe më pas u bë 6%.

- *viktimat e dhunës në marrdhëniet familjare, për periudhën e vlefshmërisë së urdhrit të menjëhershëm të mbrojtjes.*

Është *formula e pikëzuar* ajo mbi të cilën përllogaritet masa e NE-së, e cila përfshin parametra që marrin në konsideratë situatën social-ekonomike të aplikantëve, nivelin e tyre të jetesës, asetet e patundshme, të *ardhurat nga remitancat*. Tashmë kjo formulë merr në konsideratë edhe strukturën e familjes, si dhe hapësirën gjeografike / lokalitetin ku kjo familje është vendosur (fshat apo qytet).

Përllogaritja e masës së NE-së, për familjet e përzgjedhura në bazë të formulës së pikëzimit, bëhej fillimisht për qarqet pilot bazuar në *Udhëzimin nr. 8, datë 23.6.2014 “Mbi përllogaritjen e përfitimit të ndihmës ekonomike, në zonat pilot”*, dhe sot për të gjithë vendin bazuar në *VKM-në e miratuar nga Ministria e Shëndetësisë dhe e Mbrojtjes Sociale nr. 597, datë 04.09.2019 “Për përcaktimin e procedurave, të dokumentacionit dhe të masës mujore të përfitimit të NE-së dhe përdorimit të fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike”*.

3.5. Nevojat e reformës së dytë të ndihmës ekonomike në vitin 2012 dhe në

vazhdim

Nga sa u argumentua dhe më lart, u gjykua e nevojshme që të aplikoheshin kritere të reja të diferencuara të llogaritjes së NE-së, sidomos për zonat malore me ose pa tokë, për familjet e mëdha, për zonat me mungesë të infrastrukturës dhe terren malor të thyer, si dhe për zonat me burime alternative jetese të kufizuara.

Pra, sa më shumë familje përfituese të ndihmës ekonomike ishin në pragun e minimumit të përfitimit të NE-së (8-10-15-20 dollar) aq më shumë familje do të ishin pranë daljes nga varfëria (sepse me reformën e dytë nuk do të kishte ndihmë të pjesshme). Një vlerësim i saktë i të ardhurave, sikurse është argumentuar dhe më lart, do të çonte në adresimin më të mirë të NE-së tek familjet realisht të varfëra, por edhe në mënjanimin e mjaft familjeve të cilat përfitonin nga skema pa e merituar.

Megjithatë, kjo duhej parë me shumë kujdes sepse niveli i varfërisë natyrisht që ishte³⁰ relativ dhe ky arsyetim vlente vetëm në kontestin e kuadrit ligjor dhe burimeve financiare të asaj kohe që po i referohemi për zbatimin e programit të ndihmës ekonomike.

Nevojat e familjeve, niveli i varfërisë së tyre si koncept i zhvilluar edhe sipas zonave, apo numri i familjeve përfituese duhej të vlerësohej në korrelacion edhe me përfitimet e tjera që përfitonin tashmë familjet si: kompensimi për rritjen e energjisë elektrike, përfitimet e kujdesit shëndetësor, përfitimet e PAK, pensionet, përfitimet për fëmijët jetimë dhe përfitimet për nënat me shumë fëmijë.

Dokumentacioni që kërkohej për aplikantët, për të përfituar ndihmë ekonomike duhej të thjeshtëzohej, pakësohej dhe lehtësohej nga kërkesat e tepruara. Thellimi i decentralizimit dhe rritja e kompetencave të qeverisjes vendore në shërbimet sociale duhet të shkonte domosdo paralel me fillimin e përdorimit të fondeve të qeverisjes vendore, si një rezervë e rëndësishme për të rritur masën e NE-së.

³⁰ Niveli i varfërisë në këtë kontekst, mbetet relativ gjithashtu edhe sot.

Duhet të vendosej një dysheme e qartë dhe e detyrueshme e masës së ndihmës ekonomike për frymë, dhe mbi këtë bazë, edhe për familje. Kjo duhet të afrohej, të paktën fillimisht, me nivelin ekstrem të varfërisë e më pas të vinte duke u rritur, në raport me rezultatet që do të arriheshin në procesin e implementimit të kriterëve dhe mekanizmave të rinj të zbatimit të programit të NE-së.

Kompjuterizimi dhe informatizimi i informacionit, dokumentacionit dhe statistikave të grumbulluara ishte në nivel të ulët. Në këto kushte ishte e nevojshme të investohej në mënyrë serioze në pajisjen e sistemit me bazën e nevojshme logjistike për përdorimin e teknologjive bashkëkohore të informacionit. Kjo pritej të kishte këto efekte pozitive në zbatimin e programit të ndihmës ekonomike:

- i) rritje të transparencës;
- ii) ulje të abuzivizmit dhe korrupsionit;
- iii) depolitizim në zbatimin e programit të NE-së.

Në formë pilot një sistem i tillë u mendua që mund të implementohej në nivel qarku fillimisht, me qëllim që më vonë të shtrihej në të gjithë vendin, duke lexuar dhe replikuar në mënyrë kritike rezultatet e pilotimit.

3.6. Risitë e reformës së dytë të ndihmës ekonomike në vitin 2012 dhe në vazhdim

Prodhimi i legjislacionit më të plotë (miratimi i akeve të reja ligjore dhe nënligjore) dhe zbatimi me rigorozitet i masave ligjore kundër rasteve abuzive, korruptive, politizuese dhe elektorale në lidhje me programin e ndihmës ekonomike (kriterëve të shpërndarjes të NE-së si pjesë e përsosjes së skemës), do të çonte natyrshëm në fuqizimin e

mekanizmit të kontrollit, rritjen e kompetencave dhe fuqisë goditëse të strukturave të këtij mekanizmi.

Vendosja dhe zbatimi i korrelacionit midis uljes së numrit të familjeve përfituese në skemë dhe rritjes së masës së përfitimit të ndihmës ekonomike, do të çonte në përfshirjen në skemë të familjeve realisht më të varfëra dhe njëkohësisht përjashtimin nga skema të familjeve abuzive. Kjo kishte shkaktuar demotivimin e administratorëve të NE-së dhe trupave vendim-marrëse në bashki dhe ish-komuna për të thelluar më tej punën e tyre në luftën kundër abuzimit dhe targetimin më të mirë të familjeve të varfëra. Përvoja tregonte tashmë se vendim-marja nga këshilli bashkiak ose ish-komunal kishte krijuar më shumë mundësi abuzimi, politizimi, dhe elektoralizimi. Secili prej anëtarëve të këshillit bashkiak ose ish-komunal përfaqësonte dhe sillte në mbledhjen miratuese një listë personash përfitues të NE-së të preferuar, në mjaft raste abuzivë, ose në bazë të lidhjeve personale, familjare, miqësore, politike, elektorale, ose interesave të tjerë. Në këtë mënyrë këshilli bashkiak dhe ish-komunal aplikonte një politikë dhe qëndrim klientelist dhe shmangej nga detyrimet, kriteret dhe standartet ligjore.

Në këtë kontest, zbutja e varfërisë dhe mbrojtja e grupeve në rrezik kanë qenë në qendër të politikave kombëtare të zhvillimit në dekadën e fundit. Në këtë kuadër, në periudhën 2010-2012, janë ndërmarrë iniciativa ligjore, të cilat synonin ridimensionimin e politikave për zgjerimin e grupeve përfituese, përmirësimin e sistemit të vlerësimit, administrimit dhe kontrollit të ndihmës ekonomike si dhe funksionalitetin e shërbimit të kujdestarisë për fëmijët. Orientimi i reformave në sistemin e NE-së edhe në vitet në

vijim do të vazhdojë me përmirësimin e administrimit të skemës së NE-së³¹ duke ndarë qartë kompetencat midis organit qendror dhe atij vendor të qeverisjes, si dhe ngritjen dhe administrimin nga Shërbimi Social Shtetëror (SHSSHS) të Regjistrit elektronik kombëtar të personave që aplikojnë për ndihmë ekonomike.

Ndihma ekonomike duke parë dhe përvojat e vendeve të tjera deri në vitin 2013 (para reformës së dixhitalizimit), do të kushtëzohej me pjesëmarrjen në punë apo shërbime të cilat do të kontribuonin në targetimin më të mirë të individëve në nevojë, mbulimin me të ardhura më të larta për familjen, përfitimin e komunitetit ku ofrohen këto punë apo shërbime, reduktimin e nivelit të varfërisë dhe realizimin e kthimit të skemës së NE-së nga skemë pasive në një skemë aktive. Sot pas reformës ky kushtëzim lidhet me detyrimin për tu punësuar nga zyrat kombëtare të punësimit (lexo për më shumë në paragrafin 3.3 të kapitullit pasardhës).

Ndryshimet e ligjit bazë të NE-së nr. 9355 të vitit 2005 “Për ndihmën ekonomike dhe shërbimet shoqërore” i ndryshuar, reflektojnë një sërë risish të cilat iniciohen me:

Regjistrin elektronik të të dhënave

Ligji nr. 9355 i vitit 2005 me ndryshimet e rradhës, parashikoi ngritjen dhe administrimin e regjistrit elektronik kombëtar në Shërbimin Social Shtetëror, i cili do të përfshinte siç vazhdon dhe sot, aplikantët dhe përfituesit e ndihmës ekonomike. Ngritja e regjistrit dhe përdorimi i tij fillimisht është pilotuar në 3 qarqe në vitet 2014-2018 (në Tiranë, Durrës dhe Elbasan) dhe nga janari i vitit 2018 dhe në vazhdim është shtrirë në të gjithë vendin.

³¹ Sikurse do të vërehet edhe në vijim të shtjellimit të këtij punimi.

Shërbimi i ndihmës ekonomike duhet të jetë tashmë më cilësor dhe i aksesueshëm.

Përsa më sipër ndikojnë një tërësi faktorësh duke nisur nga predispoziteti i stafeve që punojnë në këtë sektor, ndjekur kjo nga hapësira gjeografike që këto mbulojnë dhe kanë në kompetencë, deri tek mbarëvajtja e procedurave të cilat kërkohen të respektohen gjatë procesit. Barra për të eliminuar sado pak pengesa të kësaj natyre i takon nëpunësve të ngarkuar me këtë detyrë.

Formulën e pikëzimit

Në bazë të reformës së re të NE-së qëndron formula e pikëzimit, e cila është përcaktuese në përfitimin dhe masën e NE-së për aplikantët. Në thelb të kësaj formule qëndrojnë parametrat e paracaktuar përmes sistemit të vlerësimit elektronik, të kategorizuar si kritere nga ku secili ka peshën e tij specifike.

Detajet e kësaj formule dhe procedurat janë përcaktuar me VKM nr. 956, datë 07.12.2016 “Për përcaktimin e kritereve dhe të detajeve të formulës së unifikuar të pikëzimit për përfitimin e ndihmës ekonomike”. Formula e unifikuar e pikëzimit përfshin parametra të lidhur në mënyrë empirike me vlerësimin e situatës ekonomike të familjeve, të tilla si: përbërja e familjes, të ardhurat nga programi i mbrojtjes sociale, remitancat, qeraja, asetet, bujqësia, blegtoria, trashëgimia, dhuratat si dhe variabla të tjera të veçanta social-ekonomike që lidhen me statusin e varfërisë. Treguesit e vlerësimit, pjesë e formulës së unifikuar të pikëzimit, që ndihmojnë në përcaktimin e kritereve të pranueshmërisë së familjeve për përfitimin e NE-së, përcaktohen sipas shtojcës nr. 1, bashkëlidhur VKM-së të lartpërmendur. Përditësimi i formulës së unifikuar të pikëzimit propozohet nga ministria përgjegjëse për ndihmën dhe shërbimet

shoqërore, në varësi të ndryshimeve të nivelit të varfërisë në vend, të publikuar nga INSTAT, dhe miratohet me vendim të Këshillit të Ministrave.

Kategoritë e tjera të skemës së ndihmës ekonomike

Përfshirja e disa grupeve si përfitues të NE-së ka lindur si domosdoshmëri. Janë shtuar kategori të reja përfituesish të NE-së si vijon:

- a) Është rikonceptuar kategoria e Jetimëve duke sjell si rrjedhojë rritjen e numrit të përfituesve. Sot me reformën e re përfitojnë *Jetimët të cilët nuk janë në institucionet e përkujdesjes shoqërore*. Shembull: në Bashkinë Gramsh në vitin 2013 rezulton vetëm një person me Status Jetimi përfitues nga Skema e NE-së. Ndërkohë që në vitin 2015 po për këtë Bashki janë 3 raste të tilla, nga të cilët një rast është në moshën mbi 25 vjeç, dhe në janar të vitit 2020 janë 8 përfitues të kësaj kategorie.
- b) Kategoritë e dhunës në familje. Kjo kategori është shtuar me *ligjin nr. 47, datë 24.04.2014 “Për një ndryshim në ligjin nr. 9355 të vitit 2005”*. Shembull: Familja e Znj. G. M (kryefamiljarja) me banim në Njësinë Administrative Elbasan, e përbërë prej 5 anëtarësh, ku bashkëshortja së bashku me 3 fëmijët janë pajisur me Urdhër Mbrotje nga Gjykata e Rrethit Elbasan për një periudhë 1 vjeçare në vitin 2018. Përgjatë kësaj periudhe të 4 anëtarët e familjes me përjashtim të dhunuesit (ish-bashkëshortit) kanë përfituar secili ndihmë ekonomike në vlerën 3.000 lek në muaj. Kjo familje para zbatimit të reformës së dixhitalizimit të NE-së nuk ka përfituar sepse sipas ligjit të mëparshëm nr. 9355

të vitit 2005 “Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore” i ndryshuar, nuk ishte kategori përfituese.

- c) Më kalimin e kohës, përfitues të ndihmës ekonomike janë gjithashtu edhe kategoria e *viktimave të trafikimit*. Viktimat e trafikimit janë shtuar si kategori e re përfituesish në Skemën e NE-së me ligjin nr. 10522, datë 11.03.2010 “Për një ndryshim në ligjin nr. 9355 të vitit 2005”. Vërehet se kjo kategori së bashku me viktimat e dhunës në marrdhëniet familjare, janë shtuar para vitit 2014 (vit kur u implementua në fakt reforma e NE-së në formën e pilotimit), lindur kjo si domosdoshmëri për t’i paraprirë reformës e cila ishte parashikuar për t’u implementuar që në vitin 2012 por që u shty për arsye politike të kohës. Shembull: Znj. A. B me banim në njësinë administrative Elbasan, përfiton si kategori e veçantë në statusin e viktimës së trafikimit në sistemin e ndihmës ekonomike që nga viti 2014 dhe në vazhdim, çdo muaj 3.000 lekë. Kjo zonjë para zbatimit të reformës së dixhitalizimit të NE-së nuk kishte për të përfituar me këtë status, sepse sipas *ligjit të mëparshëm nr. 9355 të vitit 2005 “Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore” i ndryshuar*, nuk ishte kategori përfituese.

Mbështetja me pagesa shtesë

Në ligj është përcaktuar mundësia për të përfituar për familjet e NE-së edhe një pagesë tjetër mbi pagesën bazë, për fëmijët që frekuentojnë rregullisht arsimin e detyrueshëm. Kjo duket është bërë për të motivuar këto familje në drejtim të asimimit të fëmijëve të tyre.

Bazuar në VKM nr. 376, datë 11.06.2014 “Për Disa Ndryshime dhe Shtesa në Vendimin nr. 787, datë 14.12.2005, të Këshillit të Ministrave, “Për Përcaktimin e Kritereve, të Proçedurave dhe të Masës së Ndihmës Ekonomike”, të ndryshuar, shuma e përfituar për ndjekjen e arsimit të detyrueshëm është 300 (treqind) lekë për çdo vërtetim të dorëzuar pranë nëpunësit të NE-së i cili e çekon në sistem në mënyrë që kjo masë t’i shtohet pagesës bazë që përfiton familja përkatëse.

Pagesë tjetër motivuese e parashikuar në këtë VKM është dhe pagesa që jepet për këto familje në rast të vaksinimit të rregullt të fëmijëve. Shuma e marrë në këtë rast është 100 (njëqind) lekë për çdo vaksinë të bërë e cila vërtetohet me kartelën përkatëse të lëshuar nga mjeku.

Ligji ka përcaktuar që anëtarëve të familjes në nevojë, të cilët janë persona me aftësi të kufizuara, të mos u llogaritet masa e ndihmës ekonomike, në strukturën e masës së NE-së për familjen, pasi nuk mund të përfitojnë dy pagesa të cilat kanë të njëjtin burim financimi nga buxheti i shtetit.

Shërbimin e kujdestarisë së përkohshme

Në ligj është përcaktuar mbështetja e shërbimit të kujdestarisë për fëmijët si një shërbim i ri alternativ. Me familje kujdestare kuptojmë një familje alternative sipas përkufizimeve të dhëna nga *Kodi i Familjes në nenin 266 të tij*. Me familje kujdestare kuptojmë atë familje e cila nuk ka domosdoshmërisht lidhje biologjike me fëmijën. Kjo familje e quajtur “kujdestare” ndryshe dhe “alternative”, vendoset përgjatë një proçesi të caktuar gjyqësor, i cili mban parasysh interesin më të lartë të fëmijës në drejtim të të ofruarit të një mjedisi të ngrohtë familjar, sa më të përshtatshëm për zhvillimin e fëmijës. Gjatë shqyrtimit gjyqësor të rastit mbahen parasysh rrethana të tjera po aq të

rëndësishme si afeksioni që duhet të krijojë fëmija me familjen në fjalë, në funksion të mirërritjes së tij në kushte sa më optimale.

Bazuar në legjislacionin në fuqi është Bashkia ajo e cila evidenton listën e familjeve kujdestare. Çdo Bashki ka detyrimin ligjor të ngrejë dhe të bëjë funksional një komision të posaçëm për të vlerësuar rastet e fëmijëve që gjenden në kushtet për t'iu ofruar familje alternative. Ky komision parashikohet të jetë me natyrë multidisiplinare me qëllim që rastet të vlerësohen në kompleksitet pasi të tilla janë për nga vetë natyra dhe nevojat e fëmijëve.

Me Vendim të Këshillit të Ministrave janë përcaktuar edhe procedurat që duhet të ndjekë pushteti vendor, kriteret ku duhet të bazohet për përcaktimin e familjeve dhe jo vetëm por dhe kushtet në të cilat duhet të ndodhet një fëmijë për të përfituar nga ky lloj shërbimi. Është përcaktuar gjithashtu edhe një shumë për të suportuar shpenzimet për këto fëmijë, shumë e cila alokohet nga buxheti i shtetit përmes fondit për mbrojtjen sociale i cili shpërndahet nga Ministria që mbulon çështjet sociale, konkretisht SHSSH-së.

Vendimi i parë që disiplinonte këtë fushë ishte *VKM nr. 89, datë 26.1.2012 “Për përcaktimin e kriterëve, të dokumentacionit dhe të procedurës së shërbimit të kujdestarisë”*. Shuma që përfiton një familje kujdestare në këtë rast është 9000 (nëntë mijë) lekë në muaj për çdo fëmijë. Nëse fëmija është me aftësi ndryshe (njohur si përfitues i pagesës së AK-së), shuma e përlllogaritur është 10.000 (dhjetë mijë) lekë në muaj.

Shembull: Fëmija K. H me banim në njësinë administrative Elbasan, është një fëmijë i vendosur në kujdestarinë e një familje kujdestare, e cila përfiton ndihmë ekonomike prej

vitit 2016 dhe në vazhdim me këtë status. Masa e përfitimit është 9.000 lekë në muaj dhe këtë pagesë e përfiton fëmija deri në moshën 18 vjeç. Për fëmijët e vendosur në kujdestari të cilët vazhdojnë shkollën, përfitojnë gjithashtu një herë në vit pagesën shtesë për shkollën në masën 20.000 lekë. Kjo familje kujdestare para zbatimit të reformës së dixhitalizimit të NE-së nuk kishte për të përfituar me këtë status, sepse sipas ligjit të mëparshëm nr. 9355 të vitit 2005 “Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore” i ndryshuar, nuk ishte kategori përfituese.

Grupet e favorizuara për përjashtim nga llogaritja e të ardhurave

Ndryshimet e mëvonshme ligjore, në fazën kur ndihma ekonomike ishte e plotë dhe e pjesshme, parashikuan disa përmirësime që synonin më tepër garanci në përfshirje dhe mbështetje për disa prej kategorive në nevojë në respektim të parimit të mos diskriminimit. Si rrjedhojë kjo do të sillte më shumë të ardhura duke përfituar tashmë NE të plotë (për këto përfitues të cilësuar ndryshe si *grupe të favorizuara*, në përlllogaritjen e masës së NE-së nuk merreshin parasysh të ardhurat).

Këto grupe ishin: fëmijët, gratë e vetmuara, vajzat nëna, personat me aftësi të kufizuara, prindërve të cilët u ishte hequr e drejta prindërore apo vuanin dënime me heqje lirie etj. (neni 19, pika 4, e ligjit nr. 9355/2015). (Haxhiu, fq. 3: 2020).

Shembull: një grua kryefamiljare që jetonte e vetme me fëmijët në zonat rurale dhe që nuk ishte në gjëndje ta punonte vetë tokën. Kjo zgjati deri në momentin e fillimit të dixhitalizimit të NE-së sepse risia qëndron në faktin që vetë sistemi nuk i llogarit më të ardhurat siç vazhdon dhe sot.

Familjet në proces zgjidhje martese

Ligji ka parashikuar një trajtim të veçantë të familjeve në proces zgjidhje martese.³²

Bazuar në ligj kërkesa fillestare për të aplikuar për NE nëshkruhet nga të gjithë anëtarët madhorë të familjes. Në rastet kur bashkëshortët mund të jenë në *proces zgjidhje martese* por ende nuk është marrë një *vendim gjyqësor i formës së prerë*, aplikimi ndjek të njëjtën procedurë dhe kërkon të njëjtin dokumentacion bazë (duke shtuar edhe vërtetimin e lëshuar nga Gjyakata që tregon që bashkëshortët janë në proces zgjidhje martese). Në këtë rast do të kemi dy aplikime, nga një për secilin bashkëshort (nëse të dy zgjedhin të aplikojnë), ku secili firmos aplikimin e tij dhe në vijim nëse shpallen përfitues, secili tërheq shumën e tij përkatëse dhe ka të drejtën e vetë administrimit mbi to. Pra, shuma e përfituar nga skema e NE-së në këtë rast do të jetë e ndarë për secilin prej bashkëshortëve respektivisht.

Trefishimin dhe më tepër të shumës së përfitimit

Me sistemin e ri elektronik të skemës së NE-së, është rritur automatikisht shuma e pagesës së përfituar mujore, pasi bëhet shënjestrimi më i mirë i përfituesve. Kjo shumë është dyfishuar, trefishuar apo dhe më tepër krahasuar me sistemin e vjetër. Shembuj: 1. Familja e Z. N. H me vendbanim në Njësinë Administrative Belsh, e përbërë prej 5 anëtarësh, në vitin 2014 përfitonte masën e ndihmës ekonomike prej 6.220 lekësh. Kjo familje para zbatimit të reformës së dixhitalizimit të NE-së ka përfituar masën e ndihmës në vlerën prej 2.800 lekësh (rezulton me shumë se dyfishimi i masës së

³² Zgjidhja e martesës bëhet vetëm me vdekjen e njërit prej bashkëshortëve ose me divorcin. Një nga arsyet që kërkohet divorci nga njëri prej bashkëshortëve është nëse bashkëshorti tjetër ka dënime penale të rënda (më të mëdha se 15 vite) ose për kryerjen e disa krimeve të veçanta si dhuna fizike/psikologjike/seksuale ndaj bashkëshortit tjetër ose fëmijës, etj. (Checchini, fq. 249: 2002).

përfitimit). 2. Familja e Z. H. Z me vendbanim në Njësinë Administrative Librazhd, e përbërë prej 5 anëtarësh, që në vitin 2014 përfitonte masën e ndihmës ekonomike prej 6.480 lekësh. Kjo familje para zbatimit të reformës së dixhitalizimit të NE-së ka përfituar masën e ndihmës në vlerën prej 1.800 lekësh (rezulton me shumë se trefishimi i masës së përfitimit). 3. Familja e Z. J. L. me vendbanim në Njësinë Administrative Lunik të Bashkisë Librazhd, e përbërë prej 10 anëtarësh, deri në qershor të vitit 2018 përfitonte masën maksimale të ndihmës ekonomike prej 8.000 lekësh. Kjo familje nga muaji pasardhës dhe në vazhdim përfiton masën maksimale të ndihmës në vlerën prej 12.485 lekësh (rezulton më tepër se një trefishim i masës së përfitimit nga para reformimit të NE-së). 4. Familja e Z. L. M. me vendbanim në Njësinë Administrative Tregan të Bashkisë Elbasan, e përbërë prej 9 anëtarësh, deri në qershor të vitit 2018 përfitonte masën maksimale të ndihmës ekonomike prej 8.000 lekësh. Kjo familje nga muaji pasardhës dhe në vazhdim përfiton masën maksimale të ndihmës në vlerën prej 12.485 lekësh (rezulton më tepër se një trefishim i masës së përfitimit nga para reformimit të NE-së).

Familjet e reja përfituese

Në skemën e dixhitalizuar të ndihmës ekonomike familje të reja përfituese janë gjithashtu:

1. Familjet që masa e ndihmës sipas llogaritjes së ligjit të mëparshëm nr. 9355 të vitit 2005 “Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore” i ndryshuar, ishte nën vlerën 800 lekë. Shembull: Familja e Z. A. H me vendbanim në Njësinë Administrative të Belshit, e përbërë prej 5 antarësh, që në vitin 2014 përfitonte masën e ndihmës ekonomike prej 5.750 lekësh. Kjo familje para zbatimit të reformës së

dixhitalizimit të NE-së nuk ka përfituar sepse masa e ndihmës sipas llogaritjes së ligjit të mëparshëm të lartpërmendur, ishte nën vlerën 800 lekë.

2. Familjet që kishin ndryshuar vendbanimin dhe nuk kishin qenë të trajtuar me ndihmë ekonomike në vendbanimin e mëparshëm. Shembull: Familja e Z. F. K. me vendbanim në Njësine Administrative të Librazhdit, e përbërë prej 5 antarësh, që në vitin 2014 përfitonte masën e ndihmës ekonomike prej 5.760 lekësh. Kjo familje para zbatimit të reformës së dixhitalizimit të NE-së nuk ka përfituar sepse sipas ligjit të mëparshëm të lartpërmendur, ishte familje e ardhur nga Libofsha e Fierit ku dhe nuk kishte qenë e trajtuar me NE.
3. Familjet që përfitonin pension familjar prej 7.000 lekësh.³³ Shembull: Familja e Z. H. K. me vendbanim në Njësine Administrative të Belshit, e përbërë prej 4 antarësh, që në vitin 2014 përfitonte masën e ndihmës ekonomike prej 4.500 lekësh. Kjo familje para zbatimit të reformës së dixhitalizimit të NE-së nuk ka përfituar sepse sipas ligjit të mëparshëm nr. 9355 të vitit 2005 “Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore” i ndryshuar, përfitonte pension familjar prej 7.000 lekësh. Sot me reformën e re të dixhitalizimit të NE-së, mqs ky sistem nuk i llogarit të ardhurat nga familjet aplikuese, familja e Z. H. K. përfiton NE.
4. Familjet emigrante me probleme sociale të kthyer në Shqipëri. Shembull: Familja e Z. S. K. me vendbanim në ish-komunën Shirgjan (sot njësia administrative Shirgjan) të Bashkisë Elbasan, e përbërë prej 6 antarësh, që në vitin 2014 përfitonte masën e ndihmës ekonomike prej 7.020 lekësh. Kjo familje para zbatimit të reformës së dixhitalizimit të NE-së nuk ka përfituar sepse sipas ligjit të mëparshëm nr. 9355 të vitit 2005 “Për ndihmën dhe shërbimet

³³ Vetëm në Qarkun e Elbasanit aktualisht përfitojnë ndihmë ekonomike përafërsisht 550 familje të tilla.

shoqërore” i ndryshuar, ishte familje emigrante me probleme sociale e kthyer nga Greqia, dhe ky ligj nuk shprehej për familjet përfituese që largoheshin me dëshirë për të emigruar të kishin të drejtën e rifutjes. Gjithashtu, faktet tregonin që njësitë administrative ishin paragjyquese përkundrejt këtyre familjeve sepse mendonin që ishin në një nivel më të lartë ekonomik se familjet e tjera jo-emigrante. Sot mqs sistemi nuk i llogarit të ardhurat e familjeve aplikuese, nuk ka më paragjykime nga njësitë vendore përkundrejt këtyre familjeve ish-emigrante.

Familjet që nuk ishin pajisur me certifikatë pronësie.³⁴

5. Shembull: Familja e Z. F. G. me vendbanim në ish-komunën Shushicë (sot njësia administrative Shushicë) të Bashkisë Elbasan, e përbërë prej 8 antarësh, që në vitin 2014 përfitonte masën e ndihmës ekonomike prej 8.000 lekësh. Kjo familje para zbatimit të reformës së dixhitalizimit të NE-së nuk ka përfituar sepse sipas ligjit të mëparshëm të lartëpërmendur, nuk ishte e pajisur me certifikatë pronësie.

Fondin e kushtëzuar

Bazuar në ligj, familjeve të cilat janë të refuzuara nga përfitimi i pagesës nga Skema e NE-së, u jepet një mundësi e dytë për të përfituar përmes asaj që në ligj cilësohet si fondi i kushtëzuar. Ligji ngarkon Këshillin e bashkisë (dhe atë të ish-komunave dikur) që në fillim të çdo viti të miratojnë me Vendim të tyre kriteret që duhet të plotësojnë familjet e refuzuara për arsye pikëzimi, për t'u trajtuar në vijim nga ky fond. Këto kriteret duhet të mbajnë parasysh ndër të tjera faktin që familja të jetë refuzuar për arsye

³⁴ Vetëm në Qarkun e Elbasanit aktualisht përfitojnë ndihmë ekonomike përafërsisht 2200 familje të tilla.

pikëzimi (domethënë që të mos jetë kualifikuar përfituese nga Skema e NE-së për shkak se nuk ka marrë pikët e mjaftueshme nga sistemi). Situata social-ekonomike e familjes duhet të vlerësohet gjithashtu nga administratori shoqëror paraprakisht, në mënyrë që kjo familje të propozohet nga ky i fundit për të përfituar nga ky fond.

Vetë ligji ka përcaktuar edhe masën maksimale që ky fond duhet të ketë dhe sot ai mund të arrijë deri në *në 6% të fondit të kushtëzuar për bllok-ndihmën ekonomike*³⁵. Për çdo muaj po me vendim të Këshillit Bashkiak miratohet edhe lista e familjeve përfituese nga ky fond. Me ndryshimet më të fundit ligjore, masa që përfiton një familje nga fondi i kushtëzuar është e njëjtë me masën që përfiton një familje e kualifikuar si përfituese nga Skema e NE-së, madje së fundmi kjo masë përlogaritet nga vetë sistemi.

Tërheqjen e ndihmës ekonomike nga bashkëshortja

Me ndryshimet që u bënë në VKM-në nr. 904 të vitit 2012 “*Për përcaktimin e kriterëve, të procedurave dhe dokumentacionit të përfitimit të NE-së, në zonat pilot*”, nga VKM nr. 375, datë 11.6.2014, të drejtën për të tërhequr dhe marrë në dorëzim ndihmën ekonomike e përfitoi bashkëshortja. Kjo risi ndodhi për arsye sepse shumica e burrave pasi tërhiqnin ndihmën ekonomike, shkonin dhe e konsumonin atë duke luajtur në lojërat e ndryshme të fatit (kjo kryesisht në zonat urbane), ose duke pirë alkol në lokale (kjo kryesisht në zonat rurale ku mentaliteti patriarkal ishte dhe vazhdon të jetë ende më i theksuar). Për rastet kur në strukturën e familjes bashkëshortja mungon, të drejtën e tërheqjes e ka kryetari i familjes.

³⁵ Fillimisht ky fond ka qenë 3%.

Kufizimin në kohë për qëndrimin në skemën e ndihmës ekonomike

Me shtrirjen e skemës së re të NE-së në të gjithë Shqipërinë, VKM nr. 955 datë 07.12.2016 “Për përcaktimin e kriterëve, të procedurave, dokumentacionit dhe masës së përfitimit të ndihmës ekonomike”, pësoi ndryshimet e rradhës ku ndër më i rëndësishmi ishte dhe vazhdon të jetë edhe, kufizimi i përfitimit nga Skema e ndihmës ekonomike për një periudhë jo më shumë se 5 vjet.

3.7. Masa dhe llogaritja e përfitimit të NE-së pas reformës së vitit 2012 dhe në vazhdim

Ndryshe nga skema e kaluar e përlllogaritjes së masës së ndihmës ekonomike, në sistemin e dixhitalizimit masa e përfitimit përlllogaritet nga vetë sistemi. Kjo në kuptimin që është sistemi i cili përmes formulës së pikëzimit përlllogarit masën e përfitimit.

Sikurse e kemi cilësuar edhe më lartë, bazuar në VKM nr. 904, datë 12.12.2012, fillimisht ligji parashikonte dhe rregullonte ndihmën ekonomike të plotë. Masa për ndihmëm e plotë mund të arrinte deri në 8.000 (tetë mijë) lekë në muaj. Nëse në përbërje të familjes mbetej vetëm një anëtar masa që ky i fundit do të mund përfitonte ishte në shumën që ai do të mund përfinonte nëse do ishte pjesë e strukturës së plotë të familjes, në varësi të pozicionit të tij në të (kryfamiljar apo anëtar tjetër i familjes). Udhëzimi nr. 8 i vitit 2012 “Mbi përlllogaritjen e përfitimit të ndihmës ekonomike, në zonat pilot” përcakonte se shuma që do të mund përfitonte një familje me një anëtar ishte 2600 (dy mijë e gjashtëqind lekë) në muaj. Edhe sot vijon të përfitohet e njëjta shumë.

Ligji nr. 57 të vitit 2019, i cili solli dhe hyrjen në fuqi të VKM nr. 597 datë 04.09.2019 “Për përcaktimin e procedurave, të dokumentacionit dhe të masës mujore të përfitimit të ndihmës ekonomike dhe përdorimit të fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike”, sjell ndryshimin e masës maksimale të NE-së duke hequr tavanin prej 8.000 lekësh dhe llogaritjen e masës së përfitimit sipas strukturës së familjes. Konkretisht, masa e NE-së e llogaritur në këtë mënyrë, shkon deri në 150% të masës së pensionit social dhe e indeksuar.

Pensioni social rregullohet nga legjislacioni i fushës së sigurimeve shoqërore. Bazuar në të, mosha që duhet të arrijë personi për të përfituar pension social është mosha 70 vjeç. Kushte të tjera shtesë janë që personi të ketë patur rregullisht vendbanimin dhe vendqëndrimin në Shqipëri të paktën në 5 vitet e fundit (nga data e aplikimit për këtë pension). Aplikuesi duhet të vërtetojë që nuk përfiton të ardhura nga burime të tjera, madje as nga skema e NE-së dhe për këtë fakt pajiset me një vërtetim të posaçëm nga ana e Drejtorisë Rajonale të ShSSH-së. Burimet e pakta të të ardhurave që aplikuesi mund të ketë, në përlllogaritje nuk duhet të kalojnë shumën që ai do mund të marrë nga ky pension. Natyrisht që aplikuesi duhet të plotësojë dhe kushtin që të mos jetë pensionit apo përfitues nga skemat e tjera të përfitimit të Sigurimeve Shoqërore.

Masa e ndihmës ekonomike indeksohet nga Shërbimi Social Shtetëror sa herë indeksohet pensioni social dhe në bazë të këtij indeksi.

Shuma që një familje e Skemës së NE-së mund të përfitojë përlllogaritet sipas strukturës në vijim:

a) 1.800 lekë, për anëtarin e parë të familjes sipas renditjes në çertifikatën familjare;

b) 1.260 lekë, për anëtarët e tjerë të familjes mbi moshën 18 vjeç;

c) 900 lekë për anëtarët që janë në dhe nën moshën 18 vjeç.

Për kategoritë e veçanta shuma e përfituar është fikse (pasi jepet për individin përkatës). Për familjet që kanë fëmijë të lindur trinjakë shuma është 3000 (treqind) lekë për secilin prej tyre, për fëmijë të lindur katërnjakë shuma është nga 4000 (katër mijë) lekë për secilin prej tyre, ndërsa për fëmijë të lindur pesënjakë shuma është nga 5000 (pesë mijë) lekë për secilin prej tyre. Përkatësisht këto familje përfitojnë shumat: 9000 (nëntë mijë) lekë për fëmijët trinjakë; 16000 (gjashtëmbëdhjetë mijë) lekë për fëmijët katërnjakë dhe 25000 (njëzet e pesë mijë) lekë për fëmijët pesënjakë.

Për kategorinë e viktimave të trafikimit shuma e përfituar është 3000 (tre mijë) lekë në muaj. Kjo shumë përfitohet nga kjo kategori nga momenti që personi del nga qendra ku ka pas qenë i strehuar si VT ose VMT deri në kohën kur punësohet.

Për kategorinë e Viktimave të Dhunës në Marrëdhëniet Familjare shuma e përfituar nga Skema e NE-së është 3000 (tre mijë) lekë në muaj. Kjo shumë përfitohet rregullisht për sa kohë është përcaktuar edhe afati i vlefshmërisë së *Urdhërit të Mbrojtjes ose Urdhërit të Menjëhershëm të Mbrojtjes* në vendimin përkatës të gjyaktës, i cili zakonisht është tre muaj, gjashtë muaj ose një vit.

Në rast se një familje aplikuese dhe si rrjedhim përfituese nga Skema e NE-së ka në përbërje pjesëtarë të familjes të cilët marrin pagesë nga skema e aftësisë së kufizuar, shuma e këtyre të fundit zbritet nga masa totale që përfiton familja në këtë rast. Shuma e zbritur është e njëjtë me atë që këto pjesëtar do mund të përfitonin nga skema (në varësi të strukturës). Shembull: nëse është kryefamiljar zbritet shuma 1800 (një mijë e tetëqind) lekë, ndërsa nëse është anëtar i dytë i familjes zbritet shuma 1200 (një mijë e

dyqind) lekë për bashkëshorten ose për fëmijët zbritet shuma 800 (tetëqind) lekë, sipas rastit.

Ligji ngarkon Bashkitë me përgjegjësinë për marrjen e masave në mënyrë që pagesat të tërhiqen të plota dhe pa komisione bankare apo pagesa shtesë për shërbimet postare. Kjo arrihet përmes marrëveshjeve që bën institucioni i Bashkisë me institucionet bankare ose postare. Kryesisht janë bankat e nivelit të dytë ato ku tërhiqen këto pagesa por edhe zyrrat postare. Këto të fundit janë më të aksesueshme nga përfituesit sidomos në zonat rurale.

3.8. Vështrim i përgjithshëm i paraqitjes së Aplikimit për Ndihmë Ekonomike

Qytetarët shqiptarë fillimisht në 3 rajonet ku u pilotua skema e re e NE-së (Tiranë, Durrës dhe Elbasan) dhe nga viti 2018 dhe në vazhdim në të gjithë vendin, aplikojnë duke plotësuar Formularët e Aplikimit për ndihmë ekonomike pranë zyrave të ndihmës ekonomike në njësitë e pushtetit vendor.

Përshkrimi i hapave që ndiqet për aplikim dhe më pas përfitimin e ndihmës ekonomike sipas formulës së pikëzimit është si vijon:

Hapi i parë: Prezantimi i kërkesës për aplikim

Për të përfituar ndihmë kryefamiljari së bashku me personat madhorë të familjes, paraqiten për të aplikuar pranë zyrës së ndihmës ekonomike në Njësinë Administrative ku kanë vendbanimin. Aplikimet pranohen të bëhen nga data 1 deri në datën 10 të çdo muaji, bazuar kjo në VKM përkatëse. Vetëm në raste të veçanta kur këto data efektive janë të paaksesueshme për aplikim, me Urdhër Ministri shtyhet afati përtej datës 10.

Për dy muajt e parë kur doli fillimisht ky udhëzim aplikimet u shtynë deri në datën 20 të

muajit përkatës, për arsye që t`u jepej mundësia sa më shumë familjeve për të aplikuar.

Në VKM janë përcaktuar edhe dokumentat që duhet të paraqesin familjet në momentin e aplikimit, si më poshtë:

- a) Fotokopje të ID-së të personave madhor të familjes aplikuese.
- b) Dokumente shoqëruese që vërtetojnë nëse familja ka të ardhura të tjera apo jo si:
 - ✓ *Çertifikata e pronësisë*, e lëshuar nga *Agjencia Shtetërore e Kadastrës*. Në mungesë të kësaj të fundit, kjo zyrë mundëson vërtetimin e pasurisë së paluajtshme, *apo aktin e marrjes në pronësi ose në përdorim të tokës*, për zonat që janë ende të paozhornuara;
 - ✓ Për çiftet që janë në proces zgjidhje martese por që nuk ka marrë formë të prerë vendimi i gjyaktës, duhet që secili prej bashkëshortëve aplikant të paraqesë dokumentacionin përkatës, duke shtuar edhe vërtetimin e lëshuar nga Gjyakta.
 - ✓ Nëse në përbërje të familjes përfituese ka persona që përfitojnë pagesë nga fondi i aftësisë së kufizuar, duhet të paraqitet vërtetimi përkatës i lëshuar nga KMCAP që vërteton këtë fakt.
 - ✓ Për familjet aplikuese të cilat kanë fëmijë që ndjekin shkollën deri në klasë të nëntë paraqitet edhe vërtetimi përkatës i lëshuar nga institucioni arsimor. Ky vërtetim duhet të paraqitet dy herë në vit në mënyrë që familja të përfitojë pagesën shtesë nga skema e NE-së, kjo pasi bëhet çekimi i tyre në sistem nga administratori shoqëror.
 - ✓ Nëse familja ka në përbërje fëmijë që vaksinohen atëherë duhet të paraqesë edhe fotokopjen e kartelës së vaksinës për të përfituar pagesën shtesë.
 - ✓ Nëse familja ka anëtarë madhorë të saj të cilët ndjekin arsimin e mesëm ose shkollën e lartë, apo atë pasuniversitar, duhet të dorëzojnë edhe vërtetim për këto pjesëtarë një herë në vit. Kjo justifikon mosfirmosjen nga ana e këtyre

pjesëtarëve dhe mosparaqitjen një herë në tre muaj detyrimisht pranë zyrës së NE-së për deklaratat 3-mujore që janë të detyrueshme për t'u gjeneruar nga sistemi dhe firmosur nga pjesëtarët madhorë të familjeve përfituese. ✓ Për kategorinë e veçantë përfitues nga statusi i Jetimit, të paakomoduar në ndonjë nga qendrat rezidenciale për këtë kategori, duhet të dorëzojë pranë administratorit shoqëror të seksioneve të ndihmës ekonomike fotokopjen e ID-së; fotokopje të noterizuar të librezës së statusit të jetimit. Libreza e statusit të jetimit, lëshohet nga SHSSH në përmbushje të kërkesave ligjore për të përfituar nga ky status. Nëse personi që është i pajisur me status jetimi ndjek dhe shkollën ai duhet të dorëzojë gjithashtu edhe vërtetimin e lëshuar nga institucioni përkatës, në mënyrë që të përfitojë edhe pagesën shtesë për ndjekjen e arsimit të parashikuar në ligj. Ky vërtetim duhet të dorëzohet për çdo semestër. Për kategorinë e jetimëve me status jetimi të cilët vaksinohen, duhet të dorëzojnë edhe fotokopje të kartelës së vaksinës që të mund të përfitojnë gjithashtu pagesën shtesë për vaksinat. ✓ Për familjet të cilat kanë kategori të veçanta si trinjakë, katërnjakë apo pesënjakë, që janë familje në nevojë dhe që aplikojnë për ndihmë duhet të dorëzojnë dokumentacionin e përcaktuar si më lartë, njësoj si për çdo familje tjetër aplikuese. Bazuar në VKM pjesë e dosjes së aplikantëve është edhe formulari i vlerësimit social-ekonomik të familjes. Ky verifikim në familje bëhet nga administratori shoqëror detyrimisht që në muajin e parë kur familja aplikon. Në vijim vizita e verifikimit në familje duhet të bëhet dy herë në vit, konkretisht çdo gjashtë muaj. ✓ Kategoria e Viktimave të Trafikimit, të cilët mund të përfitojnë NE nga momenti i daljes nga qendra e rehabilitimit /

strehimit deri në punësim të tyre, duhet të dorëzojnë vërtetimin e lëshuar nga qendra përkatëse ku ata kanë pas qenë strehuar dhe kanë marrë shërbimet e duhura rehabilituese. Edhe qëllimi i dhënies së një shume të tillë për këtë kategori është vijueshmëria e procesit rehabilitues për to, deri në marrjen e statusit të të punësuarit. Vërtetimi i marrë nga qendra duhet të jetë i lëshuar në 30 ditët e fundit. ✓ *Kategoria e Viktimave të dhunës në marrëdhëniet familjare, për periudhën e vlefshmërisë së urdhrit të mbrojtjes ose të urdhrit të menjëhershëm të mbrojtjes, duhet ndër të tjera të dorëzojë pranë zyrës së NE-së fotokopjen e ID-së si dhe vendimin e gjykatës për lëshim të urdhrit të mbrojtjes ose urdhrit të menjëhershëm të mbrojtjes.*

Hapi i dytë: Rregjistrimi i aplikimit dhe procesi i intervistimit

Pasi është plotësuar formulari i aplikimit për ndihmë, *bazuar në VKM nr. 597, datë 4.9.2019 “Për përcaktimin e procedurave, të dokumentacionit dhe të masës mujore të përfitimit të NE-së dhe përdorimit të fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike”*, administratori shoqëror është i detyruar që brenda 10 ditëve të para çdo muaji të hedhë në sistem të dhënat përkatëse, një pjesë e të cilave gjenerohen automatikisht nga sistemi, i cili është i lidhur me të dhënat e sistemeve të tjera, si p.sh. sistemi i gjendjes civile, nga ku verifikohet përputhshmëria e përbërjes familjare të aplikantëve. Nëse ndonjë aplikim nuk arrihet të hidhet brenda afatit 10 ditor kur sistemi qëndron i hapur për këtë procedurë, atëherë ky aplikim qëndron në draft deri në muajin pasardhës, sepse nuk vijohet dot më tej procedura e verifikimit deri në vendimmarrje për këtë muaj.

1. VKM përcakton se aplikimi si rregull duhet të hidhet në sistem në prani të familjarëve në mënyrë që dhe ata në përfundim të procedurës të mund të firmosin mbi të. Ky formular në mënyrë të koncentruar përmban informacion rreth përbërjes së familjes (e cila duhet të përkojë me atë të gjendjes civile, vërtetuar nga çertifikata familjare), të dhëna për banesën (shtëpi private ose pallat, ose çdo lloj klasifikimi të mundshëm që aplikanti bën sipas gjyqimit të tij), informacion rreth asetëve të patundshme dhe orendive shtëpiake, deklaram i lirë mbi *të ardhurat nga programet e mbrojtjes shoqërore dhe të ardhurat e tjera*. Bashkëlidhur punimit në rubrikën Shtojca (në shtojcën nr 1) është Formulari i Aplikimit për ndihmën ekonomike.
2. Bazuar në po këtë VKM administratori shoqëror duhet të bëjë dy herë në vit vizitën në familje, të cilën e pasqyron në formularin përkatës të verifikimit social-ekonomik. Vizita e parë menjëherë pas aplikimit fillestar duhet të bëhet në të njëjtin muaj që familja ka aplikuar. Bashkëlidhur punimit në rubrikën Shtojca (në shtojcën nr. 2) është Formulari i Aplikimit - Verifikimi i Situatës Social - Ekonomike.
3. Një herë në tre muaj pjesëtarët madhorë të familjes duhet të paraqiten pranë administratës shoqërore, nga data 1 deri në datë 10 të muajit përkatës, për të deklaruar nëse kanë ndryshime të mundshme në të ardhurat apo asetet e tyre. Sa herë kanë ndryshime në përbërjen familjare (lindje, martesë ose vdekje personi) familjarët duhet ta deklarojnë këtë fakt brenda të njëjtit muaj. Bashkëlidhur punimit në rubrikën Shtojca (në shtojcën nr 3) është dhe Deklarata e Paraqitjes çdo 3-muaj të Familjes. Kjo Deklaratë gjenerohet nga sistemi i ndihmës, pasi janë reflektuar ndryshimet e mundshme mbi të, dhe më pas printohet për t'u firmosur nga pjesëtarët madhorë të familjes dhe vetë administratori. Nëse ndonjë nga pjesëtarët madhorë të familjes nuk mund të paraqitet për arsye shëndetësore duhet ta justifikojë këtë fakt

me një raport mjekësor të lëshuar nga mjeku i familjes ose me çdo lloj dokumenti tjetër të mundshëm mjekësor që vërteton faktin e pamundësisë së tij shëndetësore për t'u paraqitur atë muaj për deklarinimin përkatës.

4. Dikur, bazuar në ligjin e mëparshëm nr. 9355/2005 të ndryshuar (pa dalë ende ligji aktual nr. 59/2019) ishte administratori shoqëror ai i cili përcillte *për në këshillin e bashkisë, projekt-vendimin për propozim për familjet/individët në nevojë, që do të trajtoheshin me NE*. Ndërsa me ligjin në fuqi përcjellja e listës së aplikantëve bëhet duke u gjeneruar automatikisht në sistem.

Hapi i tretë: Miratimi i vendimit për familjet/individët në nevojë që do të trajtohen me NE nga Këshillat Bashkiakë

Me ligjin e mëparshëm nr. 9355/2005 të ndryshuar (pa dalë ende ligji aktual nr. 59/2019) projekt-vendimi për ndihmën përcillej nga administratori shoqëror për në Këshillin Bashkiak i cili kishte detyrimin ta merrte në shqyrtim këtë akt dhe në përfundim i takonte po kësaj instance vendimmarrja. Së bashku me projekt-vendimin shqyrtoheshin edhe listat e aplikantëve. Ky Këshill nuk kishte të drejtë të bënte ndryshime në lista, të cilat ishte i detyruar t'i dërgonte *brënda datës 15 të çdo muaji në formë elektronike dhe zyrtare pranë drejtorisë rajonale të shërbimit social shtetëror së bashku me listën shoqëruese*. Ky vendim përcillej së bashku me një relacion shpjegues në ato raste kur anëtarët e këshillit mbanin qëndrime të ndryshme për listën në fjalë.

Ndryshimi më i fundit ligjor, konkretisht ligji nr. 57 i vitit 2019 “*Për asistencën Sociale në Republikën e Shqipërisë*”, i hoqi kompetencën e vendimmarrjes në lidhje me ndihmën Këshillit Bashkiak. Tashmë në kompetencë të këtyre këshillave janë miratimi i kriterëve për dhënien e ndihmës për familjet e refuzuara nga sistemi, përmes fondit

shtesë si dhe marrja e vendimit të përmuajshëm për këto lista, (të cilat së fundmi po gjenerohen nga sistemi i NE-së, duke u filtruar kështu paraprakisht nga ky sistem). Fondi shtesë me ligjin e sotëm është sa 6% e shumës së fondit të kushtëzuar për ndihmën, dhe nëse bashkitë kanë fonde të tyre shtesë mund të mundësojnë më tepër pagesa mbi këtë fond. Dikur ky fond ka qenë 3%.

Dikur, kur vendimarrja për ndihmën ishte në kompetencë të pushtetit vendor, Vendimi i Këshillit Bashkiak duhej detyrimisht të njësohej nga Prefekti duke e dërguar zyrtarisht në këtë institucion dhe më pas dërgohej në Drejtorinë Rajonale të ShSSH-së në mënyrë që të hapej rruga e çeljes së fondeve përkatëse.

Hapi i katërt: Verifikimi i të dhënave në sistem

Verifikimet që realizon DR e SHSSH-Së janë automatike dhe manuale. Verifikimet automatike realizohen përmes sistemit elektronik të NE-së në sajë të kryqëzimit të të dhënave me sistemet e tjera të ndërlidhura. Verifikimet manuale janë ato verifikime të cilat realizohen në rrugë shkresore me institucionet përkatëse, si p.sh. Inspektoriati i Punës, Sektorët e tatimeve dhe taksave pranë Bashkive, Gjykata dhe Drejtoria e Burgjeve.

Verifikimi i të dhënave në sistem nga ana e Drejtorisë Rajonale bëhet me qëllim konfirmimin e informacionit të pasqyruar në të. Verifikimet automatike dhe ato manuale duhet detyrimisht të mbyllen brenda afatave të përcaktuara në mënyrë që t'i lihet koha e duhur procesit të vendimarrjes. Vendimi nga ana e Drejtorisë Rajonale duhet të gjenerohet gjithashtu brenda muajit përkatës të aplikimit.

DRSHSSH mban parasysh respektimin e klauzolave të përcaktuara shprehimisht në VKM nr. 597 datë 4.9.2019 “Për përcaktimin e procedurave, të dokumentacionit dhe të masës mujore të përfitimit të NE-së dhe përdorimit të fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike”:

- a) përsa i përket plotësimit apo jo të kriterëve nga aplikantët;
- b) nëse nuk plotësohen kriteret përkatëse ligjore familja refuzohet për përfitim nga skema përmes sistemit;
- c) në ato raste kur vërtetohet se aplikanti (familje apo individ) ka bërë deklaram të rremë gjithashtu refuzohet nga skema me efekt penalizues, në varësi të arsyes së refuzimit;

Përmes verifikimit automatik është perfeksionuar më tej procesi i dhënies së ndihmës duke mundësuar vendimarrje më objektive, si dhe transparencë në përcjelljen e informacionit midis aplikantëve. Tashmë aplikantët kanë mundësinë të njihen me arsyen e mos kualifikimit të tyre si përfitues. Nga ana tjetër, është mëse e vërtetueshme besueshmëria në deklarin e lirë që bën familja, për vijimësinë e këtij procesi. Një aplikant apo familje e cila është refuzuar dy herë apo më shumë për arsye deklarimi të rremë, e ka besueshmërinë më të vogël të administratorit shoqëror në deklarin e rradhës, dhe kjo gjë natyrshëm reflektohet edhe në ecurinë e aplikimit të rradhës për këtë subjekt.

Sistemet e ndërlidhura me atë të ndihmës ekonomike janë si më poshtë:


1. *Zyra e Gjëndjes Civile*. Sistemi i ndihmës automatikisht verifikon të dhënat për përbërjen familjare, moshën e pjesëtarëve, deri edhe në adresat e tyre duke ndërvepruar me të dhënat nga *Regjistri Kombëtar i Gjëndjes Civile*.
2. *Zyra e Punësimit*, verifikon listën e aplikantëve në *moshë aktive pune* me listat që ka zyra e punës me të papunë të rregjistruar. Madje, shkohet dhe më tej duke verifikuar nëse pjesëtarëve madhorë të familjes u është ofruar oso jo, dhe nëse kanë refuzuar ose jo, nga shërbimet e formimit profesional, apo nga programe të tjera alternative drejt punësimit.
3. *Qendra Kombëtare e Regjistrimit*, verifikon nëse ndonjë prej personave aplikantë ushtrojnë apo jo *veprimtari ekonomike private*.
4. *Zyra e Sigurimeve Shoqërore*, verifikon nëse personat anëtarë të familjeve aplikuese janë përfitues nga skema e sigurimeve shoqërore, dhe nëse ato trajtohen me pension pleqërie ose familjar. Përmes këtij verifikimi shkohet dhe më tej duke konfirmuar nëse ka persona të cilët *paguajnë kontribut sigurimi vullnetar*.
5. *DPSHTR/ Zyrën e Regjistrimit të Automjeteve*, verifikon nëse ndonjë nga pjesëtarët e familjeve aplikuese ka në pronësi mjet motorrik / automjet.
6. *Inspektorati Shtetëror i Punës*, të cilit i dërgohet lista në mënyrë manuale (deri më sot), për të bërë të mundur evidentimin e atyre rasteve të cilët janë punësuar por që nuk janë të rregjistruar si të tillë. Nga kontrollet e rregullta të bëra nga ky institucion duke u ballafaquar lista me të dhënat e nxjerra nga sistemi i ndihmës, raportohen raste konkrete duke reflektuar kështu në procesin e mëtejshëm të vendimarrjes për këto familje (të cilët kanë në përbërje pjesëtarë që rezultojnë të punësuar të paregjistruar ligjërisht në instancat përkatëse).

7. *Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve*, verifikon mbi personat të cilët janë të punësuar legal por që këtë gjë mund të mos e kenë deklaruar dhe reflektuar në sistemin e NE-së. Kështu arrihet të evidentohen edhe rastet abuzive nga skema e ndihmës.
8. *Zyra e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme*, verifikon të dhënat e deklaruar për gjendjen e pasurisë së paluajtshme, për asetet shtëpiake, bizneset duke përfshirë tokën truall dhe atë bujqësore.

Sistemi nuk mundëson verifikimin on-line të të dhënave të aplikuesve, duke komunikuar me sistemet e institucioneve përkatëse në lidhje me seksionet pranë bashkive/ish-komunave për të gjithë personat që rezultojnë se: tregtojnë në tregje të lira; zotërojnë leje ndërtimi apo ndërtojnë pa leje; zotërojnë leje për transport plehërash, transport udhëtarësh dhe leje për tregti ambulante; merren me shpërndarjen e shtypit periodik; apo që merren me tregtimin e lëndëve djegëse. Gjithashtu, sistemi nuk mundëson *verifikimin on-line* të të dhënave të aplikuesve me Drejtoritë e burgjeve, Prokuroritë, Spitalet, Shkollat dhe Gjykatat. Verifikimi për këto institucione mundësohet *manualisht* nga Drejtoria Rajonale e Shërbimit Social Shtetëror.

Gjatë procesit të vendimarrjes DRSHSSH-të kanë të drejtën ligjore për të refuzuar familjet në kushte të mira. Gjithashtu, për të gjithë përfituesit që rezultojnë në marrëdhënie punësimi të deklaruar më shumë se një anëtar apo dhe me paga më të larta se paga minimale, ato kryejnë verifikimet në banesë në mënyrë që të bëjnë skualifikimet nga skema e NE-së gjatë procesit të vendimarrjes. Në ilustrimin e mëposhtëm nr. 1 gjeni dhe skemën përkatëse:

Ilustrim 1: Roli dhe përgjegjësia e Drejtorisë Rajonale të SHSSH-së në procesin e vendimarrjes të NE-së.



Hapi i pestë: Ekzekutimi i refuzimit të aplikimit dhe dhënies së ndihmës ekonomike

Pasi drejtorja rajonale e SHSSH merr vendimin për refuzimin ose për dhënien e NE-së dhe masës së përfitimit, ky vendim i gjeneruar nga sistemi dhe i nënshkruar nga personat përgjegjës, dërgohet zyrtarisht në adresë të *Kryetarit të Njesisë së Qeverisjes Vendore përkatëse*. Më pas është në detyrën e njesisë vendore bërja transparente e këtij vendimi duke njoftuar dhe fituesit të cilëve u kalojnë edhe shumat përkatëse të përcaktuara në këtë vendim.

Hapi i gjashtë: Transparenca e sistemit të përfitimit të ndihmës ekonomike sipas skemës së re të dixhitalizimit

Sikurse kemi analizuar edhe më lartë në kapitujt paraardhës të këtij punimi, parimi i transparencës është një ndër parimet që nënkupton të drejtën e qytetarit për të qenë i informuar dhe për të marrë pjesë në procedurat administrative që i përkasin.

Përsa më sipër, njësia vendore (ende dhe sot) afishon listat e familjeve apo individëve përfitues nga skema e ndihmës, rregullisht në ambiente publike të dukshme për akses të

qytetarëve ndaj këtyre listave (këto ambiente ndodhen në selinë përkatëse të çdo njësie administrative). Lista e afishuar përmban listën e miratuar nga Drejtoria Rajonale e SHSSH-së dhe sipas rastit listën e vendosur nga Këshilli i Bashkisë kur ky i fundit ka miratuar kriteret specifike për të dhënë NE, me fondet e buxhetit vendor, parashikuar sipas legjislacionit në fuqi.

Hapi i shtatë: Ruajtja dhe arkivimi i dokumentacionit

Administratorët shoqërorë bazuar në ligjin në fuqi janë të detyruar që dokumentet e përcaktuara, *t'i ruajnë sipas legjislacionit në fuqi për ruajtjen e dokumentacionit.*

Të tjera

- a) Përfituesit duhet të paraqesin një përditësim të dokumenteve të listuara më sipër pranë zyrave të ndihmës ekonomike një herë në vit, ndërsa çdo tre muaj paraqiten për të plotësuar deklaratën tre mujore në lidhje me ndryshimet e mundëshme të situatës social-ekonomike të familjes/individit.
- b) Përfituesit, të cilët transferohen në rezidenca të ndryshme, ose që kanë një anëtar të familjes që lëviz në një rezidencë të re, duhet ta njoftojnë këtë ndryshim brenda 10 diteve nga ndryshimi pranë zyrës lokale të asistencës sociale të rezidencës së re, nëse transferohet e gjithë familja apo transferohet kryefamiljari ose në zyrën fillestare të asistencës sociale nëse nuk është transferuar kryefamiljari. Mos njoftimi mund të rezultojë në ndërprerjen e përfitimit. Përfituesi duhet të paraqesë dokumentet mbështetëse të listuara në seksionin e mësipërm. Administratori social do të tërheqë aplikimin e përfituesit, printojë aplikimin, intervistojë përfituesin, dhe të përditësojë aplikimin bazuar në këtë intervistë dhe në dokumentet mbështetëse. Përfituesi rishikon

ndryshimet dhe nëse bie dakord që këto ndryshime janë të plota dhe të sakta nënshkruan aplikimin.

Kërkesat për marrjen e informacionit mbi statusin e aplikimit

Aplikuesit mund të kërkojnë të marrin informacion mbi statusin e aplikimeve të tyre duke shkuar në zyrat lokale të ndihmës ekonomike dhe duke pyetur administratorin social për të kontrolluar statusin e aplikimit të tyre. Aplikantët duhet të paraqesin ID-të e tyre për të kontrolluar statusin e aplikimeve të tyre. Administratori social pasi kontrollon statusin e aplikimit në regjistrin elektronik kombëtar e printon për aplikuesin.

Komunikimi me sisteme të institucioneve të tjera

Shërbimi Social Shtetëror komunikon dhe me institucione të tjera për të verifikuar dhe për të marrë informacione të ndryshme në lidhje me pretenduesit për ndihmë ekonomike. Ky komunikim realizohet nëpërmjet sistemeve elektronike që kanë aktualisht këto institucione. Sistemi duhet të ofrojë mundësinë e komunikimit dhe me sistemet e ardhshme që mund të ndërtohen për institucionet të cilat ende nuk janë informatizuar plotësisht. Komunikimi i sistemit të Ndihmës Ekonomike *jo vetëm me institucionet që tashmë kanë sisteme elektronike, por edhe me institucione të tjera që nuk kanë ende*, do të bëhet i mundur vetëm duke e integruar këtë sistem në infrastrukturën e "Government Gateway", e cila aktualisht është operacionale tek AKSHI (Agjensia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit *është krijuar sipas “Vendimit nr. 673, datë 22.11.2017 “Për Riorganizimin e Agjensisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit”*). Government Gateway (GG Core) është arkitektura bazë mbi të cilën po mundësohet integrimi i të gjitha sistemeve elektronike, qofshin këto qeveritare ose jo. Nëpërmjet kësaj arkitekture mund të integrohen duke pasur mundësi

ndërveprimi "interoperabilitet" sisteme të ndryshme qeveritare. Ato mund të ekspozojnë funksionalitetet e tyre përmes portalit kryesor qeveritar e-Albania.

Çdo sistem elektronik qeveritar mund të komunikojë me GG Core nëpërmjet një sistemi integruar. Ky sistem do të lejojë shkëmbimin e mesazheve në mes të GG Core dhe sistemeve të institucioneve. Një nga zgjidhjet më të mira për këtë integrim është "Department Integration Server" (DIS). Kjo do të thotë që çdo institucion, pra edhe Shërbimi Social Shtetëror, duhet të implementojë DIS-in e saj, në mënyrë që të komunikojë me Government Gateway dhe rrjedhimisht me sistemet e tjerë.

3.9. Proçedurat e kontrollit të skemës së dixhitalizimit të NE-së pas reformës së vitit 2012 dhe në vazhdim

Proçedurat e kontrollit të skemës së dixhitalizimit të NE-së pas reformës së vitit 2012

Fillimisht kontrolli i NE-së realizohej nga Inspektorati i Ndihmës Ekonomike, Pagesës për Personat me Aftësi të Kufizuar dhe Shërbimeve Shoqërore, në bazë të proçedurave të përcaktuara në VKM nr. 512, datë 31.05.2006 “Për proçedurat e kryerjes së kontrollit të ndihmës ekonomike, të pagesës së aftësisë së kufizuar dhe shërbimeve shoqërore”. Në fillesat e tyre ato që sot janë Drejtori Rajonale të SHSSH-së, kanë pas qenë në cilësinë e Inspektorateve. Kontrolli bazohej në planin vjetor dhe në programin mujor të punës. Programi i kontrollit përgatitej nga grupi i kontrollit dhe miratohej nga titullari i institucionit. Edhe sot funksionon parimisht në të njëjtën mënyrë, por bazuar në një VKM të posaçme për këtë proçedurë.

Kontrolli mund të ishte i plotë ose tematik. Në çdo rast, përpara kryerjes së kontrollit, drejtuesi i grupit të kontrollit njoftonte me shkrim subjektin për fillimin e kontrollit,

qëllimin, si dhe objektivat që do të realizoheshin. Kontrolli mund të ishte (sikurse edhe sot) i paparalajmëruar, në rastet kur ka sinjalizime për abuzime ose shkelje ligjore nga subjekti përkatës.

Kontrolli i skemës së NE-së gjithmonë është bërë në dy nivele, si vijon:

- I. DRSHSSH kontrollonte, veprimtarinë e aplikimit për NE nga administratori i seksionit ose të zyrës së ndihmës ekonomike duke filluar që nga momenti i rregjistrimit të aplikimit për ndihmë ekonomike deri në procesin përfundimtar të përllogaritjes dhe përfitimit të NE-së. Kontrollonte gjithashtu verifikimet social-ekonomike të realizuara nga administratori shoqëror sipas rastit, si dhe mund të realizonte vetë vizita në familjet përfituese nga skema e ndihmës. Të gjitha bashkitë dhe njësitë administrative kontrolloheshin nga Drejtoritë Rajonale të SHSSH-së një herë në vit.
- II. Drejtoria e Zbatimit të Legjislacionit të Ndihmës Ekonomike, Pagesës për Personat me Aftësi të kufizuara dhe Shërbimeve Shoqërore pranë SHSSH-së. Kjo drejtori kontrollonte të gjithë procesin e aplikimit dhe përfitimit të ndihmës ekonomike konkretisht nga momenti i aplikimit për NE deri në momentin e marrjes së projekt-vendimit për familjet përfituese të NE-së. Kontrollonte gjithashtu momentin e vendimmarrjes nga Drejtoritë Rajonale të Shërbimit Social Shtetëror si dhe hartimin e borderove të pagesës dhe ndarjen e ndihmës ekonomike. Ky kontroll bëhej një herë në vit nga SHSSH.

Grupi i kontrollit në përfundim të inspektimit (procedurës së kontrollit) i reflektonte gjetjet përkatëse në një raport përfundimtar. Si rregull një kopje e këtij raporti dorëzohej në njësinë e kontrolluar, dhe një kopje mbahej nga njësia kontrolluese. Në rast se konstatohej se kishte shkelje të legjislacionit ky fakt vihej në dukje dhe evidentohej qartësisht duke propozuar edhe masat përkatëse bazuar në ligjin në fuqi.

Rezultatet nga gjetjet e kontrollit, reflektonin edhe në masën që duhej të merrte grupi i kontrollit sipas rastit, të cilat në bazë të legjislacionit në fuqi në atë kohë ishin:

- a) gjobë, sipas neneve 5 dhe 6 të ligjit nr.7697, datë 7.4.1993 "Për kundërvajtjet administrative";
- b) vërejtje me shkrim;
- c) propozim për largim nga puna;
- ç) propozim për ndjekje penale, në rastet kur gjendeshin elementët përkatës për marrjen e masave të kësaj natyre.

Akti i evidentimit mbi shkeljet dhe masat e propozuara i përcilleshin zyrtarisht kryetarit të njësisë vendore për ekzekutimin e mëtejshëm të tyre.

Procedurat aktuale të kontrollit të skemës së dixhitalizimit të NE-së

Vendimi i Këshillit të Ministrave bazë i cili vijon të jetë në fuqi për procedurat e kontrollit të pagesave të NE-së është vendimi Nr. 566, datë 29.9.2018 “Për procedurat e kryerjes së kontrollit të veprimtarisë e të zbatimit të legjislacionit për ndihmën ekonomike dhe aftësinë e kufizuar në strukturat e varësisë së shërbimit social shtetëror dhe pranë njësive të vetëqeverisjes vendore”. Në zbatim të tij kanë dalë dy Udhëzime: Udhëzimi nr. 714, datë 11.10.2018 “Për metodologjinë e kontrollit të pagesave të

ndihmës ekonomike”, dhe Udhëzimi nr. 715, datë 11.10.2018 “Për mekanizmat e standardizuar të raportimit, për monitorimin e abuzimeve dhe korrupsionin në skemën e ndihmës ekonomike”. Me hyrjen në fuqi të këtyre akteve nënligjore tashmë, procedurat e kontrollit janë të integruara në sistemin elektronik të NE-së.

Metodologjia e re e kontrollit të ndihmës është një udhëzues, që vendos standarte duke unifikuar procedurat, me qëllim të përmirësimit të veprimtarisë së kontrollit të saj duke synuar profesionalizëm të punonjësve të njësive të kontrollit të ndihmës ekonomike në këtë institucion. Qëllimi i metodologjisë së kontrollit të ndihmës ekonomike është të sigurojë një mjet menaxhimi efikas për procesin e vlerësimit të zbatimit të legjislacionit të ndihmës ekonomike, për të mundësuar parandalimin e abuzimeve dhe minimizimin e dëmeve financiare nëpërmjet vlerësimit të riskut.

Përmes kësaj metodologjie i vihet në ndihmë subjekteve kontrolluese duke u bërë kështu një pikë orientimi për to, me qëllim të qënurit sa më parimor, normativë, teknikien, duke standartizuar kështoj procedurat kontrolluese, për një zbatim sa më objektiv dhe transparent të legjislacionit për ndihmën ekonomike.

Nëpërmjet kësaj metodologjie inkurajohet një nivel më i lartë i kompetencës profesionale të kontrollit të ndihmës ekonomike dhe sigurohet *një bazë reale për matjen e performancës së këtij shërbimi.*

Bazuar në Udhëzimin nr. 714, datë 11.10.2018 “Për metodologjinë e kontrollit të pagesave të ndihmës ekonomike”, tashmë “kontrolli” rikonceptohet si një tërësi procedurash të pavarura objektive, duke ofruar këshillim për përmirësimin e menaxhimit të fondeve të ndihmës ekonomike nga ana e Shërbimit Social Shtetëror përkundrejt njësive të vetëqeverisjes vendore, bazuar në parimin e transparencës dhe në atë të përmirësimit të shërbimeve.

Në këtë Metodologji përcaktohet qartë se kontrolli i NE-së duhet të:

- a) Ndhmojë Shërbimin Social Shtetëror dhe njësitë e vetëqeverisjes vendore për të qenë të përgjegjshëm ndaj qytetarit, duke siguruar zbatimin e legjislacionit të ndihmës ekonomike, dobinë, frytshmërinë dhe menaxhimin eficient të burimeve (financiare, materiale dhe njerëzore);
- b) Japë siguri objektive për drejtorin e përgjithshëm të Shërbimit Social Shtetëror dhe drejtuesit e bashkive, mbi saktësinë e menaxhimit të fondeve të ndihmës ekonomike;
- c) Ndhmojë menaxhimin sa më efektiv drejt arritjes së qëllimit për përmirësim të cilësisë jo vetëm të kontrollit në vetvete por edhe në drejtim të shërbimeve të njësive të kontrolluara;
- d) Minimizojë rastet e abuzivitetit, mashtrimeve si dhe shpërdorimin e detyrës nga administratorët dhe jo vetëm;
- e) T'i vijë në ndihmë stafeve në drejtim të përmirësimit të punës së tyre dhe rritjes së cilësisë për një performancë në rritje.

Një kontrollues i NE-së i pavarur, duhet të jetë sa më profesional dhe i papanshëm. Kontrolluesi duhet të jetë objektiv, i pa ndikuar nga interesa personale. Në punën e kontrolluesit të ndihmës ekonomike në asnjë rrethanë nuk duhet të ketë ndikime të jashtme.

Puna e kontrolluesit të NE-së duhet të bazohet në analizën e riskut. Sa më reale dhe kritike të jetë kjo analizë aq më shumë produktivitet arrihet përmes procesit të kontrollit.

Analiza rast pas rasti, reflektuar përmes gjetjeve me efekt financiar dhe jo vetëm, çon drejt përmirësimit të efektit të kontrollit, duke e klasifikuar atë si produktiv dhe të matshëm.

Në vija të përgjithshme detyrat dhe përgjegjësitë e subjekteve kontrolluese (SHSSH dhe DRSHSSH) vijojnë të jenë të njëjtat. Rëndësi me Metodologjinë e re merr respektimi me preçizitet i afateve dhe pasqyrimi i gjetjeve në mënyrë sa më objektive, duke qenë se tashmë është sistemi ai i cili qëndron si kolonë e gjithë kësaj veprimtarie.

Kontrolli i skemës së ndihmës ekonomike vijon të bëhet në dy nivele nga struktura përgjegjëse në SHSSH-së, në nivel qendror dhe rajonal, sipas procedurave të përcaktuara në VKM nr. 566 të vitit 2018. Kontrolli i strukturave rajonale dhe me përzgjedhje në njësitë e vetëqeverisjes vendore vijon të bëhet nga struktura përgjegjëse e SHSSH-së në nivel qendror, bazuar në planin vjetor të kontrollit dhe në programet mujore në zbatim të tij. Programi i kontrollit vijon të miratohet nga titullari i institucionit, sipas modelit standard, të përcaktuar *me udhëzim të ministrit përgjegjës për çështjet sociale*.³⁶ Kontrolli i njësive të vetëqeverisjes vendore nga strukturat përgjegjëse në SHSSH-së në nivel rajonal vijon të bazohet në planin vjetor të kontrollit dhe në programet mujore në zbatim të tij.

Programi i kontrollit detyrimisht duhet të ketë në përmbajtje të tij njësinë që do kontrollohet, llojin e kontrollit të plotë ose të pjeshëm (tematik), duke përcaktuar saktësisht edhe periudhën gjatë së cilës kryhet kontrolli, si dhe objektivat që pritet të arrihen, të cilat duhet të jenë sa më të matshëm.

³⁶ Udhëzimi nr. 714, datë 11.10.2018 “Për metodologjinë e kontrollit të pagesave të ndihmës ekonomike”.

Në këtë fazë, grupi i kontrollit bazohet në³⁷ Faktorët mbi Planifikimin e Kontrollit të ndihmës ekonomike si: i. madhësia e DRSHSSH-ve/Bashkive/NJA-ve; ii. vendndodhja e Drejtorive Rajonale të Shërbimit Social Shtetëror/Bashkive/Njësi Administrative që do të kontrollohen dhe largësia; iii. aftësitë profesionale individuale të kontrolluesve; iv. aftësia për të punuar në grup e anëtarëve të grupit të kontrollit; v. konflikti i interesave; vi. angazhimi i kontrolluesve edhe me detyra të tjera; vii. krahasimi me programet e mëparshme të kontroleve të ndihmës ekonomike; viii. *Road Map* (hapat që duhet të ndiqen) në planifikimin e kontrollit. Mbledhja e të dhënave në këtë fazë është një proces që realizohet nga grupi i kontrollit dhe shërben për të kuptuar natyrën dhe punën e bërë nga DRSHSSH-të/Bashkitë/Njësitë Administrative.

Kontrolli mund të jetë i plotë ose tematik, sipas analizës së riskut. Në çdo rast, përpara kryerjes së kontrollit subjekti njoftohet me shkrim për *fillimin e kontrollit, qëllimin, si dhe objektivat që do të realizohen*. Struktura përgjegjëse për pagesat e NE-së dhe të AK-së në nivel qendror kryen kontroll të plotë një herë në dy vjet për strukturat rajonale të SHSSH-së dhe, duke zbatuar metodën me përzgjedhje, në bazë të analizës së riskut, kryen kontrole tematike për veprimtarinë e njësive të vetëqeverisjes vendore. Struktura përgjegjëse për pagesat e NE-së dhe të AK-së në nivel rajonal kryen kontroll të plotë një herë në dy vjet në të gjitha njësitë e vetëqeverisjes vendore, si dhe kontrole tematike, sipas analizës së riskut.

³⁷ Vjen si risi me Udhëzimin nr. 714, datë 11.10.2018 “Për metodologjinë e kontrollit të pagesave të ndihmës ekonomike”, pika 3.1.2.

Kontrollet për pagesat e Ndhmës Ekonomike janë realizuar gjithmonë paralel me kontrollet për pagesat e Aftësisë së Kufizuar. Organi më i lartë kontrollues në SHSSH vijon të ketë emërtesën Drejtoria e Kontrollit të pagesave të NE dhe PAK.

Deri para daljes së kësaj VKM-je kontrollet ishin vjetore, domethënë të gjitha Njësitë dhe Bashkitë e një Qarku duhej të kalonin për kontroll nga Drejtoritë Rajonale brenda një viti kalendarik. Për shkak të numrit të lartë të këtyre Njësive duket me kalimin e viteve u kuptua që efikasiteti ishte në rënie, duke qenë se dhe ditët e vëna në dispozicion për të kontrolluar secilën Njësi ishin të pakta. Me kalimin në skemën e re të kontrollit një herë në dy vjet, u shtuan edhe ditët e vëna në dispozicion për Drejtoritë Rajonale të Shërbimit Social Shtetëror për realizimin sa më eficient të këtyre kontrolleve. Vijon që kontrollet mund të jenë të *paparalajmëruar, në rastet kur ka sinjalizime për abuzime ose shkelje ligjore nga subjekti përkatës.*

Objekti i kontrollit të NE-së vijon të mbetet siguri i plotësimit të detyrimeve nga njësitë e vetëqeverisjes vendore dhe DRSHSSH-të, në përputhje me legjislacionin e ndihmës ekonomike në fuqi, nëpërmjet parandalimit dhe zbulimit të mashtrimit, gabimit, korrupsionit, në skemën e ndihmës. Konkretisht grupi i kontrollit në nivel qendror,³⁸ ushtron kontroll për zbatimin e legjislacionit për NE, për:

a) veprimtarinë e strukturave rajonale të SHSSH-së dhe, me përzgjedhje, të njësive të vetëqeverisjes vendore, të cilat janë përgjegjëse për zbatimin e legjislacionit për ndihmën ekonomike;

³⁸ Në nivel qendror është shtuar pozicioni i juristit dhe IT (teknologji informacioni) si pjesë e grupit të kontrollit/auditit.

- b) veprimtarinë e strukturave vendore në bashki dhe njësi administrative, të cilat janë përgjegjëse për zbatimin e legjislacionit të ndihmës ekonomike, duke kryer me përzgjedhje, sipas analizës së riskut, kontrole tematike;
- c) procedurën e kryerjes së verifikimeve automatike në drejtoritë rajonale, nëpërmjet Regjistrat Elektronik Kombëtar të NE-së dhe verifikimeve manuale, nëse ka;
- ç) procedurën e vendimmarrjes për familjet aplikuese dhe përfituese të ndihmës ekonomike;
- d) performancën e strukturave rajonale të SHSSH-së në kryerjen e kontrollit të NE-së në njësitë e vetëqeverisjes vendore.

Grupi i kontrollit të strukturave rajonale,³⁹ ushtron kontroll për zbatimin e legjislacionit për NE për:

- a) veprimtarinë e strukturave vendore në bashki dhe njësi administrative, të cilat janë përgjegjëse për zbatimin e legjislacionit përkatës për NE-në;
- b) dokumentacionin dhe procedurën e kryerjes së aplikimeve në Regjistrin Elektronik Kombëtar të NE-së, si dhe dokumentacionin në dosjen e përfituesit të ndihmës ekonomike;
- c) dokumentacionin e kategorive përfituese të NE-së dhe afatin e vlefshmërisë së përfitimit, sipas legjislacionit në fuqi;

³⁹ Në nivel rajonal është shtuar pozicioni i juristit dhe IT (teknologji informacioni) si pjesë e grupit të kontrollit/auditit.

- ç) kryerjen e verifikimeve social-ekonomike nga administratorët shoqërorë, afatet dhe pasqyrimin e tyre në sistem;
- d) përputhshmërinë e deklarimit të familjes përfituese me vizitën në shtëpi, të pasqyruar nga administratori shoqëror në sistem, nëpërmjet realizimit të verifikimeve social-ekonomike me përzgjedhje;
- dh) familjet që kanë rezultuar me deklarim të rremë dhe afatin e përjashtimit të tyre *nga përfitimi i ndihmës ekonomike për një periudhë 6-mujore*, sipas legjislacionit në fuqi;
- e) deklarimet tremujore të ndryshimit të situatës social-ekonomike të familjeve përfituese të NE-së;
- ë) Aplikimet e familjeve që kanë në përbërjen e tyre një person me aftësi të kufizuara, invalid pune etj;
- f) Proçedurën e ndjekur ndërmjet bashkisë dhe postës/bankës për rakordimin dhe marrjen e informacionit për listën emërore të familjeve që nuk kanë tërhequr ndihmën ekonomike brenda afatit, si dhe ndjekjen e proçesit të largimit të familjes nga përfitimi i NE-së;
- g) saktësinë e planifikimit të fondeve si dhe të shpërndarjes së tyre;
- gj) plotësimin e të dhënave të pasqyruara në evidencat statistike;
- i) proçedurat dhe dokumentacionin e shpërndarjes së pagesave të NE-së për familjet që mbështeten me fondin deri në 6%, në bazë të kriterëve të miratuara nga këshilli bashkiak dhe sipas përcaktimeve të legjislacionit në fuqi;

j) dokumentacionin dhe pagesat e kompensimit të energjisë elektrike për familjet përfituese të skemës së NE-së.

Në përfundim të punës në Njësinë e Kontrolluar, nga specialistët e kontrollit përgatitet projekt - raporti për subjektin e kontrolluar duke i lënë një kopje këtij të fundit, i cili, brenda 10 ditëve pune paraqet vërejtjet apo kundërshtitë, nëse ka, të argumentuara me dokumentacionin përkatës. Në vijim hartohet *raporti përfundimtar* në të cilin pasqyrohen edhe gjetjet shoqëruar me masat përkatëse.

Titullari i institucionit i paraqet raportin përfundimtar: Kryetarit të Bashkisë, Prefektit të qarkut, Drejtorit të përgjithshëm të SHSSH-së dhe Drejtorit rajonal të Shërbimit Social Shtetëror.

Në raportin përfundimtar evidentohen të gjitha shkeljet e konstatuara nga strukturat përgjegjëse për zbatimin e legjislacionit për NE-në dhe pagesat e AK-në, propozimet përkatëse për përmirësimin e gjendjes dhe masat për personat përgjegjës, si më poshtë vijon:

a) Masë disiplinore për shkelje nga strukturat rajonale të Shërbimit Social Shtetëror, lidhur me: i. verifikimin e të dhënave nëpërmjet regjistrit kombëtar elektronik dhe në autoritetet shtetërore përgjegjëse; ii. caktimin e familjes/individëve në nevojë, përfitues të NE-së; iii. refuzimin e përfitimit të ndihmës ekonomike dhe dërgimin e vendimit kryetarit të bashkisë.

b) Masë disiplinore për shkelje nga *struktura përgjegjëse për shërbimet sociale në bashki*, lidhur me: i. hartimin e projekt-vendimit për familjet/individët në nevojë, ii. propozimin e tij në këshillin bashkiak; iii. hartimin e kërkesave për ndihmën ekonomike

për buxhetin dhe projekt-buxhetin për vitin pasardhës; iv. grumbullimin dhe përgatitjen e informacioneve dhe të statistikave; v. regjistrin e përfituesve dhe ndjekjen e shpenzimeve për NE-në dhe pagesat e personave me AK.

c) Masë disiplinore për shkelje, në ato raste kur: a) nuk është bërë saktë identifikimi i familjeve për ndihmë; b) kur konstatohen shkelje gjatë procesit të verifikimeve social - ekonomike në familjet e ndihmës; në hedhjen dhe pasqyrimin e të dhënave të familjeve apo individëve aplikues; në mbajtjen e dokumentacionit dhe dosjeve përkatëse të aplikantëve; nëse gjatë kontrollit të shpërndarjes së shumës së ndihmës ka problematika të evidentuara qartësisht në kundërshtim me aktet përkatëse ligjore.

ç) Gjobë, që varion në vlerën 50.000 (pesëdhjetë mijë) lekë deri në vlerën 100.000 (njëqind mijë) lekë, kur konstatohet se shkeljet e lartëpërmendura janë të përsëritura.

d) Shpërblimin e dëmit nga administratori shoqëror dhe/ose familja dhe/ose punonjësi i strukturës rajonale të Shërbimit Social Shtetëror, nëse konstatohet se është shkaktuar dëm ekonomik;

dh) Kallëzim penal, në rast se dyshohet që janë konsumuar elementet e veprës penale. Struktura përgjegjëse për kontrollin e ndihmës ekonomike, kur konstatohet se ka elementë të tillë, vepron duke ndjekur më pas procedurat përkatëse pranë instancave të drejtësisë.

Bazuar në nenin 71, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, në rast se konstatohen shkelje me fondet e buxhetit të shtetit në sektorin e ndihmës dhe nëse nuk ka element për ndjekje penale, atëherë kundërvajtësi gjobitet.

3.10. Proçedurat e ankimimit administrativ të NE-së pas reformës së vitit 2012 dhe në vazhdim

Proçesi i ankimimit bëhej bazuar në legjislacionin shqipëtar në fuqi, konkretisht në *Ligjin nr. 9355 të vitit 2005 “Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore”* i ndryshuar. Fillimisht ankimuesi i drejtohej me shkrim strukturës e cila kishte bërë njoftimin për moskualifikim për përfitim për ndihmë ekonomike (kryetarit të njësisë vendore). Përgjigjia e ankimimit bëhej me shkrim sipas afateve të përcaktuara në ligj. Afatet ishin: 10 ditë kalendarike (sot është 20 ditë) kishte në dispozicion ankimuesi për të paraqitur ankesë pranë Njësisë Administrative/Bashkisë. Kjo e fundit kishte 7 ditë kalendarike nga marrja e ankesës për kthim përgjigjie (dhe sot vijon të jetë 7 ditë). Afati për t’iu drejtuar Drejtorisë Rajonale të Shërbimit Social Shtetëror ishte 10 ditë kalendarike (sot është 20 ditë) pas marrjes së përgjigjies nga struktura vendore. Struktura rajonale e SHSSH-së, pas shqyrtimit dhe verifikimit të ankesave, kishte 10 ditë kalendarike afat (sot është 14 ditë) për t’i kthyer përgjigjie ankimuesit. Vërehet që afatet e ankimimit sot me ligjin e ri nr. 57 të vitit 2019 “*Për asistencën Sociale në Republikën e Shqipërisë*” janë pothuajse dyfishuar.

Cikli i ankimimit përfundonte me paraqitjen e ankesës në gjykatën e rrethit në të cilin jetonte familja ankimuese (sikurse vazhdon dhe sot). Konkretisht, aplikuesit për përfitimin e ndihmës ekonomike, të cilët pretendojnë se nuk kanë përfituar për shkak jo ligjore, mund t’i drejtohen gjykatës me anë të padisë. Gjykata kompetente në këtë rast është gjykata administrative. Deri sot nuk ka jurisprudencë në lidhje me përfitimin e NE-së.

Në fund të vitit 2019, është iniciuar ngritja e Regjistrisë Elektronike të Ankesave në Sistemin e Ndihmës Ekonomike. Përmes këtij sistemi tashmë jo vetëm që rregjistrohet

çdo ankesë e ardhur nga cilido subjekt, por aksesohet nga secila instancë gjendja e shqyrtimit të ankesës në mënyrë hirearkike: Njësi Administrative, Bashki, DRSHTSH-ë deri tek SHSSH-ë.

3.11. Mekanizmat e standartizuar antikorrupsion

Me Udhëzimin nr. 715, datë 11.10.2018 “Për mekanizmat e standardizuar të raportimit, për monitorimin e abuzimeve dhe korrupsionin në skemën e ndihmës ekonomike”, të Ministrit të Shëndetësisë dhe të Mbrojtjes Sociale, shënohet një progres në drejtim të rritjes së efikasitetit të kontroleve për skemën e ndihmës ekonomike, i cili nuk ka pësuar ndryshime dhe vazhdon aktualisht të aplikohet.

Qëllimi i ngritjes dhe funksionimit të këtij mekanizmi është që të ofrojë një kuadër të përgjithshëm dhe fleksibël, për: mbledhjen në kohë reale dhe të standardizuar, në mënyrë sistematike, të informacionit të saktë, objektiv dhe të besueshëm mbi shkeljet e kryera, si dhe krijimin e bazave të qëndrueshme për marrjen e masave të nevojshme për parandalimin, zbulimin, raportimin dhe menaxhimin e mashtrimit dhe korrupsionit, në zbatim të legjislacionit të ndihmës ekonomike. Ky dokument nuk synon të adresojë të gjitha situatat e mundshme që mund të lindin gjatë zbatimit të legjislacionit të përfitimit të NE-së, por ofron një kuadër mjaftueshëm fleksibël që mund të zbatohet edhe në shumicën e situatave të paparashikuara.

Përmes tij jepet një qartësim i koncepteve “korrupsion” dhe “mashttrim”. Korrupsioni përcaktohet si sjellje që mund të përfshijë mashttrim, vjedhje, keqpërdorim të pozitës apo autoritetit ose akte të tjera që janë të papranueshme që çojnë në keqorientimin e ndihmës ekonomike dhe që mund të shkaktojnë keqpërdorim të fondeve të NE-së, masë të vogël të ndihmës për familjet në nevojë, përjashtimin nga përfitimi i kategorive të

familjeve realisht në nevojë, ulje të perceptimit të komunitetit për punën e Shërbimit Social Shtetëror (SHSSH) dhe politikat sociale shtetërore, si dhe humbje të besimit të komunitetit të SHSSH/MSHMS Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale. Korrupsioni mund të përfshijë elemente, të tilla si: shkelje të besimit dhe konfidencialitetit. Standarti mbi Kontrollin e Mashtrimit dhe Korrupsionit përcakton korrupsionin si veprimtari të pandershme në të cilën një drejtor, ekzekutiv, menaxher, specialist ose administrator shoqëror i një njësie vepron në kundërshtim me interesat e ligjit të NE-së dhe abuzon me pozitën e tij të besimit për të arritur ndonjë përfitim ose avantazh personal për vete ose për një person ose subjekt tjetër.

Mashtrimi mund të shihet si një derivat i korrupsionit dhe është një vepër e pandershme, e qëllimshme dhe e paramenduar që në veprim ose mosveprim, ka për qëllim për të përfituar nga pozita e besimit ose autoritetit. Mashtrimi përfshin akte të tilla si dhënien e deklaratave ose përfaqësimeve të rreme, manipulimin e informacionit, mashtrimin kriminal etj. Standardi mbi kontrollin e mashtrimit dhe korrupsionit përcakton mashtrimin si veprimtari të pandershme që shkakton faktikisht ose potencialisht shpërdorime ose humbje të mundshme financiare nga punonjësit ose familje përfituese të ndihmës ekonomike në të gjitha fazat e përfitimit të NE-së. Kjo përfshin, gjithashtu, falsifikimin e qëllimshëm, fshehjen, shkatërrimin ose përdorimin e dokumentacionit të falsifikuar, ose të destinuar për përdorim, për qëllime të përfitimit të padrejtë të NE-së ose përdorimin jo të duhur të informacionit ose pozitës nga administratori (gjatë intervistimit të familjes aplikuese në zyrë ose gjatë vizitave në shtëpi).

Në thelb kërkohet që të shmanget keqadministrimi i skemës së ndihmës ekonomike,⁴⁰ duke e përcaktuar si një veprim administrativ të paligjshëm, arbitrar, të padrejtë, diskriminues ose të ndërmarrë për qëllime të padrejta dhe që ndikon dukshëm dhe negativisht në interesat e familjeve në nevojë si dhe në fondet buxhetore të NE-së. Shembuj: keqadministrimi i fondit 6% duke u dhënë ndihmë ekonomike familjeve të cilat nuk kanë aplikuar për NE; shtesa e pagesës për fëmijët që ndjekin arsimin e detyrueshëm pa dokument për vazhdimin e shkollës; mosfirmosja e formularit të aplikimit nga vetë qytetari por nga administratori/persona të tretë; deklarime të rreme të vendbanimit të qytetarit aplikues/përfitues i ndihmës ekonomike, etj.

Rëndësi merr trajtimi i çështjes së krijimit të një monitorimi sa më efektiv dhe kjo gjë mund të realizohet përmes kombinimit të *funksioneve parandaluese me ato ndërkohëse*. Legjislacioni shqiptar është përpjekur që masat e parashikuara nga ligji nr. 9355 i vitit 2005 “Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore” (i ndryshuar), t’i përfshijë të dyja, edhe pse funksioni parandalues zë pjesën më të vogël ndër këto masa. Në fakt detyrat e parashikuara në ligj, janë më së shumti me në lidhje *mbikëqyrjen dhe kontrollin*.

Një mekanizëm efektiv i monitorimit të efektivitetit të skemës së ndihmës ekonomike, i realizuar nëpërmjet sondazheve vjetore, do duhet të përmbajë vlerësimin e politikave sociale, veçanërisht atë të mbështetjes në para. Mekanizmi duhet të zbatohet përmes organizatave jashtë strukturave të SHSSH-së, nga ana e shoqërisë dhe e rrjeteve civile.

Ky mekanizëm do duhet të shërbejë si një mjet në rritjen e aksesit të publikut në

⁴⁰ Sjellja korruptive përfshin kryerjen e një veprimi të pandershëm (jo të paanshëm), shkelje të besimit ose keqpërdorimin e informacionit për shkak të detyrës. Më tej, nëse vërtetohet, mund të jetë një vepër penale ose trajtohet si një shkelje disiplinore, duke ofruar shkaqe të arsyeshme për ndërprerjen e shërbimeve.

informacion. Këto të dhëna në lidhje me përdorimin e fondeve publike për reduktimin e varfërisë, (por edhe transfertat e tjera) duhet të bëhen publike si një informacion, duke lejuar aksesin e tyre për vlerësimin dhe ndryshimin e politikave.

Sistemi elektronik i ndihmës ekonomike mundëson që çdo kontrollues të ketë llogari përdoruese dhe fjalëkalim në rolin e përdoruesit “Kontrollues”. Një gjë e tillë lehtëson procesin e grumbullimit të informacionit dhe të dhënave gjatë fazës së planifikimit si dhe procesin e përpunimit të tyre. Jep informacion për vlerësimin e riskut dhe mbi performancën e subjektit në zbatim të legjislacionit të NE-së që do të kontrollohet. Gjithashtu ul kostot e kontrollit pasi lejon që procesi të realizohet në vendin e punës së kontrolluesit dhe jo në terren.

Kapitulli IV: Analiza e ndihmës ekonomike përgjatë vitit 2019-2020

4.1. Risi të tjera aktuale të legjislacionit të NE-së

Sikurse konstatuam në trajtimin e deritanishëm të këtij punimi, *Ligji nr. 9355 i vitit 2005 “Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore”*, pësoi një seri ndryshimesh, ku më të rëndësishme duket të ishin ndryshimet që i paraprinë reformës së dixhitalizimit të vitit 2012. Risia e vitit të fundit 2019-2020 është shfuqizimi tërësisht i *ligjit 9355 të vitit 2005 nga ligji nr. 57 i vitit 2019 “Për asistencën Sociale në Republikën e Shqipërisë”*. Qëllimi i këtij të fundit në drejtim të Skemës së Ndhmës Ekonomike rivjen me një perspektivë të re në drejtim të zbutjes së varfërisë dhe përjashtimit shoqëror duke synuar të ofrojë mundësi të barabarta për përfshirje sociale dhe për zhvillim përmes shërbimeve për një jetesë më të mirë.

Pagesa e NE-së vjen tashmë në formën e asistencës sociale. Kategoritë përfituese vijnë të jenë po ato të përcaktuara në ligjin e mëparshëm.

Me ndryshimet më të fundit ligjore përfituesit e ndihmës kanë të drejtën e një kohë të kufizuar të qëndrimit në këtë skemë e cila maksimalisht është 5 vjet. *VKM nr. 597, datë 4.9.2019 “Për përcaktimin e procedurave, të dokumentacionit dhe të masës mujore të përfitimit të ndihmës ekonomike dhe përdorimit të fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike”, pika 3, përcakton se NE kufizohet në kohë për një periudhë jo më shumë se 5 vjet.*

Raste përjashtimore janë dy të parashikuara në po këtë VKM:

1. Kur anëtarët e familjes përfituese të skemës janë mbi moshë pune;
2. Kur familja përfituese është me kryefamiljare grua e cila ka në ngarkim minimumi një fëmijë që vazhdon shkollën deri në nëntëvjeçare.

Këto dy përjashtime vërehet se nuk kanë qenë në ligjin e mëparshëm. Gjithsesi do të jetë Vendimi i Këshillit të Ministrave që pritet të miratohet sa më shpejt, i cili do të specifikojë procedurat dhe mënyrën se si do implementohet ky parashikim ligjor.

Administratori shoqëror i cili ka përgjegjësinë për të identifikuar familjet dhe individët në nevojë, duke i informuar ata mbi procedurat e aplikimit dhe të përfitimit të ndihmës ekonomike dhe më pas duke i njoftuar ata për aplikim, duhet gjithashtu të verifikojë situatën social ekonomike të familjeve në nevojë nëpërmjet vizitave në familje, brenda muajit të aplikimit për familjet që aplikojnë për herë të parë si dhe dy herë në vit për të gjitha familjet që trajtohen me NE. Detyrimi për kryerjen e vizitës në familje brenda muajit të aplikimit vjen si risi në VKM e lartëpërmendur, ndryshe nga legjislacioni i mëparshëm. Kjo gjë mundëson shmangien e abuzivitetit nga familjet aplikuese. Më parë ky afat ishte tre muaj pasi familja shpallej përfituese. Nëse familja vlerësohej si jo e përshtatshme për aplikim pas kryerjes së vizitës në familje, pasi kishte bërë deklarime jo të sakta, dhe ndërkohë ajo kishte përfituar një deri në tre muaj pagesë padrejtësisht, kthimi mbrapsht i kësaj shume nuk ishte më i mundur. Tashmë kjo gjë shmanget, madje përgjegjësinë në rast se nuk është realizuar vizita në familje e ka administratori shoqëror. Kujtojmë që formulari tip për vizitën në familje gjendet në shtojcën nr. 2 në fund të këtij punimi. Ky formular përmban të dhëna rreth përbërjes së familjes, nivelit arsimor të anëtarëve të saj, të dhëna për banesën (shtëpi private ose pallat), të dhëna për

orenditë shtëpiake, si dhe deklarimin e lirë rreth të ardhurave financiare që mund të ketë familja nga burime të ndryshme.

Risia tjetër me ligjin e ri lidhet me deklaratën tre mujore. Kjo deklarata vijon të bëhet me të njëjtin periodicitet por nëse rezulton që të jetë e rreme (kur nuk janë deklaruar saktë ndryshimet e mundshme), efekti në këtë rast është përjashtimi për riaplikim për një periudhë 6 mujore. Pra kur familjarët nuk deklarojnë ndryshime të natyrës që janë të aksesueshme për verifikim nga sistemi elektronik, automatikisht skualifikohen për muajin pasardhës dhe si rrjedhojë, ngarkohen me penaltet për riaplikim për një periudhë 6 mujore. Gjithashtu në rast se familja/individ kryen më shumë se një deklaram të rremë përjashtohet nga përfitimi i ndihmës ekonomike për një periudhë një vjeçare.

Me përmirësimet që u bënë në skemën e re të NE-së, u përmirësua procedura në rastet e ndryshimit të vendbanimit të familjeve përfituese. Tashmë çdo ndryshim vendbanimi shoqërohet me transferim të dosjes përkatëse pranë Njesisë Administrative të re ku është vendosur familja. Informacioni për ndryshimin e vendbanimit vjen automatikisht përmes sistemit të Gjendjes Civile. Ndërkohë që për të kaluar familjen aplikuese/përfituese të Skemës së NE-së në Njësine e vendbanimit të ri, ndryshimin duhet ta bëjë Administratori shoqëror i kësaj njësie. Për njësine administrative ku ka pas qenë përfituse kjo familje deri në atë moment të kohës, dosja e saj kategorizohet si dosje e mbyllur.

Një risi tjetër që sjell legjislacioni aktual në fuqi është, parashikimi që bën për detyrimin e Strukturave të *Fondit të Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor*, të cilat përmes mjekut të familjes, kanë në kompetencë kryerjen e kontrollit mjekësor bazë,

njohur ndryshe si chek-up. Kjo instancë duke bashkëpunuar me administratorin shoqëror shkëmben informacionin për realizmin e chek-up për përfituesit e ndihmës të moshës nga 35 deri në 70 vjeç. Është detyrë e administratorit shoqëror që të njoftojë 3 muaj para se personi (përfitues nga skema e ndihmës) të ketë ditëlindjen e radhës, në mënyrë që ky i fundit të paraqitet pranë mjekut përkatës për të kryer kontrollin mjekësor. Ky kontroll duhet të bëhet brenda muajit që ka ditëlindjen personi. Pasi kryhen këtë kontroll personi pajiset me një vërtetim nga mjeku, të cilin e paraqet pranë njësisë administrative ku trajtohet me ndihmë ekonomike. Nga ana tjetër, është struktura mjekësore e Fondit e cila deri në shtatë ditë nga mbarimi i kontrollit mjekësor duhet të dërgoj të dhënat përkatëse pranë njësisë.

Të mirëpërcaktuara në legjislacionin aktual janë gjithashtu rastet e përjashtimit nga skema e NE-së, duke i ndarë ato sipas afateve gjashtë mujore dhe një vjeçare.

Në bazë të ligjit të ri *nr. 57/2019* dhe VKM-së nxjerrë në zbatim të tij, parashikohet se kufizimi në kohë për të mosaplikuar për 6 muaj për ndihmë, është për famijet për të cilat një nga anëtarët e saj mund të gjëndet në një nga situatat si më poshtë vijon:

1. Nëse një pjesëtar i familjes veçohet nga trangu familjar (nga çertifikata familjare kalon me gjendje civile më vete), jo për shkak lidhje martese të re, me përjashtim nëse personi është *vajzë-nënë*.
2. Në qoftë se familja nuk tërheq ndihmën në kohë, vetëm në rast se kjo gjë ndodh për arsye të justifikuara si shkak shëndetësor ose fatkeqësi të caktuara familjare.
3. Nëse familja nuk pranon që të bëhet vizita social - ekonomike nga administratori shoqëror ose nga instancat e tjera kontrolluese.

4. Nëse ndonjë nga pjesëtarët e familjes nuk është i sinqertë në deklaram duke fshehur të dhëna për të cilat është i detyruar të deklarojë.
5. Nëse anëtarët madhorë të familjes nuk paraqiten rregullisht çdo tre muaj pranë administratorit shoqëror për të bërë deklaramin përkatës. Në këtë rast ka përjashtim të justifikuar për mosparaqitje nëse pesoni është AK, invalid pune ose i moshuar, të cilët janë në pamundësi për t`u paraqitur fizikisht pranë njësisë.
6. Nëse pjesëtarët në moshë aktive pune refuzojnë të jenë pjesë e kurseve profesionale të ofruara sipas legjislacionit përkatës.
7. Nëse anëtarët madhorë të aftë për punë të cilët cilësohen si *moshë aktive pune* nuk paraqiten për këtë fakt pranë zyrove përkatëse të punësimit për t`u rregjistruar si të tillë. Përjashtim në këtë rast bëjnë anëtarët e familjeve që kanë tokë bujqësore ose ato që jetojnë në zonat rurale.
8. Nëse familja ka anëtarë aktivë për punë që nuk janë paraqitur rregullisht për t`u rregjistruar si të tillë në zyrat përkatëse. Në këtë rast përjashtimi është për ata anëtarë të familjes të cilët janë të moshës deri në 25 vjeç dhe vazhdojnë shkollën.

Legjislacioni në fuqi ka mirëpërcaktuar edhe rastet e pezullimit për të bërë riaplikim për një periudhë një vjeçare sipas situatave në vijim:

1. Nëse një nga pjesëtarët e familjes aplikuese ose përfituese është në moshë aktive pune dhe pasi i janë ofruar një ose disa vende pune nga zyra e punës, i ka refuzuar ato. Deri në sa vënde pune lejohet të rezufojë një person për të dalë nga *skema e punësimit*, kjo gjë rregullohet nga legjislacioni përkatës për punësimin.

2. Nëse një pjesëtar i familjes së ndihmës ka qenë i punësuar por largohet nga *puna* pa shkaqe të arsyeshme. Nëse largimi bëhet nga vetë punëdhënësi, atëherë nuk ndodhet në kushtet e pezullimit një vjeçar për riaplikim.
3. Nëse minimumi një nga pjesëtarët e familjes nuk referon të dhëna të sakta në deklarin e tij.
4. Nëse nga verifikimi social ekonomik në familje nga ana e administratorit ose të instancave të tjera kontrolluese, familja del se ka kushte jetese të mira (të pa deklaruar dhe të pa pasqyruara në sistem).

Është reflektuar në Regjistrin Elektronik të NE-së në përputhje me legjislacionin, ndryshimi i masës maksimale të ndihmës ekonomike duke hequr tavanin prej 8.000 lekësh dhe duke e llogaritur atë sipas përbërjes familjare. Sot e llogaritur në këtë mënyrë, masa maksimale që përfiton një familje është 12.485 lekë.

Fondi shtesë deri në vlerën 6% të fondit bazë vijon të jetë i njëjtë, dhe mundësia mbetet e hapur që vetë bashkitë të shtojnë mbi këtë fond, për t'u dhënë më shumë shanse familjeve të refuzuara për të përfituar dhe ato ndihmë.

Ligji mirëpërcakton faktin se, familjet në nevojë, duhet të plotësojnë kushtin që të kenë aplikuar në tre muajt e fundit në skemë, para se të propozohen për në fondin shtesë, si dhe të mos kenë mundur të kualifikohen si fituese nga skema për arsye të mos marrjes së pikëve të mjaftueshme.

Risi tashmë është që aplikimet dhe listëpagesat për Fondin 6% janë të aksesueshme përmes sistemit elektronik. Masa e NE-së për familjet përfituese nga ky fond llogaritet

në të njëjtën mënyrë sipas përlllogaritjes së masës së strukturës së familjes për familjet përfituese të ndihmës ekonomike.

Me ndryshimet dhe përmirësimet e bëra në sistemin elektronik të ndihmës ekonomike në fillim të vitit 2020 është bërë e aksesueshme përmes Sistemit Elektronik të NE-së, që administratori shoqëror të hedhi në një rubrikë të posaçme të sistemit, familjet pretenduese për përfitim nga Fondi 6%, duke i çekuar ato. Sistemi i bën vetë llogaritë për masën e pagesës që duhet të përfitojë secila familje, sikurse procedon edhe për familjet e Skemës së NE-së. Lista kalon automatikisht tek profili i përgjegjës të sektorit përkatës të Bashkisë, i cili e paraqet për miratim në Këshillin Bashkiak. Më pas, lista e miratuar pasqyrohet në sistem duke u shënuar me numrin e protokollit që ka marrë Vendimi i Këshillit Bashkiak.

4.2. Analiza e masave ekonomike

Sikurse kemi analizuar në kapitullin paraardhës të këtij punimi, procedura e financimit të ndihmës ekonomike fillon me Planin e Buxhetit/Programimin e Fondeve nga administratorët shoqëror të njësive administrative të Bashkive respektive. Pasi hartohet programimi i fondeve dërgohet pranë DRSHSSH-ve të 12 Qarqeve përkatëse, dhe pasi kontrollohen dhe verifikohen nga këto të fundit, fondet e kërkuara nga Bashkitë dërgohen për miratim pranë Drejtorisë së Përgjithshme të SHSSH-së në Tiranë, e cila më pas e dërgon këtë kërkesë për fonde për miratim në Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrotjtjes Sociale. Kjo e fundit e dërgon kërkesën për fonde pranë Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, e cila çel fondet nëpërmjet Degëve të Thesarit në Rrethe. Këto të fundit i dërgojnë fondet e çelura me shkresë në institucionet e lartëpërmendura.

Programimi i fondeve bëhet 2 herë në vit, pra çdo 6 mujor. Më pas çdo 2 muaj Bashkitë raportojnë me anë të Evidencave Statistikore për fondet e përdorura, dhe në bazë të tyre akordohet fondi përkatës për çdo 2 mujor.

Duke marrë për bazë të dhënat e fundit statistikore⁴¹ të vitit 2019, pothuajse çdo 2 mujor fondi akorduar për familjet në NE varion nga 726.700.000 Lekë deri më 775.400.000 Lekë, ndërsa familjet në skemën e ndihmës ekonomike pa përfshirë këtu kategoritë e veçanta si viktimat dhune, viktimat trafikimi, jetim etj dhe kompensimin e energjisë, variojnë nga 59.500 deri më 61.400 familje. Pra në total për vitin 2019 është shpenzuar 4.184.238.843 Lekë për rreth 361.618 familje në të gjithë Republikën e Shqipërisë.


Vlen të përmendet se Qarqet me numrin më të lartë të përfituesve janë Elbasani, Dibra dhe Kukësi, me afërsisht 16.392, 10.241 dhe 8.353 familje në çdo 2 mujor, respektivisht. Ndërsa Qarqet me numrin më të ulët të përfituesve janë Durrësi, Gjirokastra dhe Vlora, me afërsisht 635, 822 dhe 1.645 familje në çdo 2 mujor, respektivisht.

Qarku i Elbasanit me fond 2 mujor përafërsisht 195.250.000 Lekë zë rreth 26.8% të fondit të përgjithshëm. Qarku i Dibrës me fond 132.410.000 Lekë zë rreth 18.2% dhe i Qarku i Kukësit me fond 101.294.000 Lekë zë rreth 13.9%, pra një pjesë të konsiderueshme në krahasim me rrethet e tjera.


Ndërsa më pak përmendim Qarkun e Durrësit me fond 2 mujor përafërsisht 8.100.000 Lekë i cili zë rreth 1.1% të fondit të përgjithshëm, Qarkun e Gjirokastrës me fond

⁴¹ Shërbimi Social Shtetëror Tiranë - Analiza e punës viti 2019.

9.700.000 Lekë e cila zë rreth 1.3% dhe Qarkun e Vlorës me fond 15.000.000 Lekë e cila zë rreth 2.1%. Në grafikët e mëposhtëm nr 6 & 7 gjeni dhe ilustrimet përkatëse:



GRAFIK 6. Shpërndarja e familjeve përfituese të NE në vitin 2019



GRAFIK 7. Shpërndarja e fondit të NE në vitin 2019

Qarqet e tjera të mbetura janë: Berat 1.625 , Fier 2.190, Korçë 7.801, Lezhë 2.680, Shkodër 4.450 dhe Tiranë 3.280 familje në çdo 2 mujor.

Fondi i akorduar çdo 2 mujor për 6 qarqet e mbetura është: Berat 18.700.000 lekë, Fier 25.200.000 lekë, Korçë 87.900.000 lekë, Lezhë 32.800.000 lekë, Shkodër 51.780.000 lekë dhe Tiranë 41.980.000 lekë.

Në tabelën e mëposhtëme nr 3. gjeni dhe ilustrimet përkatëse:

Tabela 3. Shpërndarja e numrit të familjeve dhe fondit 2 mujor të NE në Shqipëri

Qarqet e Shqipërisë	Numri i familjeve në skemë	Fondi 2 mujor/lekë
Berat	1'625	18'700'000
Dibër	10'241	132'410'000
Durrës	635	8'100'000
Elbasan	16'392	195'250'000
Fier	2'190	25'200'000
Gjirokastrë	822	9'700'000
Korçë	7'801	87'900'000
Kukës	8'353	101'294'000
Lezhë	2'680	32'800'000
Shkodër	4'450	51'780'000
Tiranë	3'280	41'980'000
Vlorë	1'645	15'000'000

Numri i familjeve përfituese të NE-së çdo muaj në fund të vitit 2019 rezulton 60.500 familje me një fond mujor prej 4.2 miliard lekësh. Ndërkohë që çdo muaj në fund të vitit 2012 rezultonin 99.494 familje përfituese me një fond mujor prej 4.3 miliard lekësh. Pra vërehet shënjestrimi më i mirë i familjeve përfituese që ka sjell reformimi i skemës së ndihmës ekonomike, sepse përafërsisht për të njëjtin fond përfitojnë 39% familje më pak por me një shumë më tepër se të trefishuar të NE-së.

Numri i familjeve përfituese si dhe fondi për Programin e ndihmës ekonomike është rritur nga viti 2018 në vitin 2019 me 11.8%, rezultat ky që tregon saktësinë në të dhënat e plotësuar në formularët e aplikimit si dhe përmirësimin e verifikimeve automatike e vendimarrja në Drejtoritë Rajonale.⁴²

Masa mesatare e NE-së është rritur në vlerën 11.571 lekë për familje, ndërsa masa maksimale e NE-së është rritur në vlerën prej 12.485 lekë për familje. Në tabelën e mëposhtme nr. 4 gjeni dhe ilustrimet përkatëse:

Tabela 4. Fondet dhe përfituesit nga Programi i Ndihmës Ekonomike përgjatë vitit 2019

Viti	Fondet e programuara Miliardë/lekë	Numri i familjeve në NE/...	% e mbulimit me fonde	NE Mesatare Lekë/familje
2019	4'184'238'843	361'618	100%	11'571

Pra vërehet një rritje në masën 30% e masës mesatare të NE-së për vitin 2019, krahasuar me masën mesatare të NE-së para reformës të vitit 2012 që ishte 3 390 lekë. Ndërkohë që rritja e pagës minimale në shkallë vendi është në masën 15.3%, nga viti 2012 (që ishte në vlerën 22.000 lekë), deri në vitin 2019 (që është në vlerën 26.000 lekë, përafërsisht sa gjysma e rritjes së masës maksimale të NE-së).

Si rrjedhojë, **reforma e skemës së NE-së solli një ndikim në zbutjen e varfërisë dhe përmirësimin e cilësisë së jetës të përfituesve.** Duke qenë se pagesa në cash e ndihmës ekonomike, përbën të ardhurën e vetme të familjeve përfituese, mbetet ende e pamjaftueshme për të përmbushur kërkesat minimale të jetesës së tyre. Për këtë arsye

⁴² Gjatë vitit 2018, në 9 qarqet e mbetura jo pilot ku u shtri për herë të parë reforma e NE-së, është e kuptueshme që ka munguar saktësia (jo e qëllimshme) nga institucionet përkatëse, panvarësisht trajnimeve të vazhdueshme.

kjo reformë parashikon afatin 5 vjeçar për daljen nga skema të personave në moshë aktive pune, familjet e të cilëve përfitojnë NE, duke i punësuar në tregun e punës, për ti ri-integruar në jetën normale shoqërore.

4.3. Riintegrimi në tregun e punës

Politika për zbutjen e varfërisë, krijimi i kushteve që individët, familjet dhe fëmijët në situata të vështira të përballojnë efektet që shkakton varfëria, vulnerabiliteti dhe përjashtimi është prioritet kyç i Strategjisë Kombëtare të Mbrojtjes Sociale 2020–2023. MSHMS është institucioni përgjegjës për zhvillimin e politikave të Mbrojtjes Sociale në Republikën e Shqipërisë. Kjo Strategji adreson objektiva të qartë dhe të matshëm për mbrojtjen sociale në Shqipëri. Strategjia gërsheton politika dhe programe specifike për të reduktuar varfërinë, duke zvogëluar ekspozimin e familjeve dhe popullatës/njerëzve ndaj rreziqeve dhe duke rritur kapacitetin e tyre për të mbrojtur veten nga rreziqet dhe mungesën e të ardhurave. Propozon ndërhyrje prioritare nëpërmjet zbatimit të programeve të ndihmës ekonomike, sistemit të vlerësimit të aftësisë së kufizuar dhe të shërbimeve shoqërore e shëndetësore, duke përfshirë mbrojtjen e familjeve, fëmijëve dhe popullatës bazuar në skema makro (në nivel kombëtar) dhe në nivel mikro (në nivel bashkie, qyteti, fshati, komuniteti, familje), si dhe procesin e rikthimit drejt tregut të punës me qëllim përmirësimin e kushteve të jetesës për çdo individ dhe familje.

Synimi numër 1 dhe 8 i kësaj Strategjie të cilat i adresohen Skemës së ndihmës ekonomike janë: (1) Zhdukja e varfërisë kudo dhe në të gjitha format; (8) Promovim i rritjes së qëndrueshme dhe gjithëpërfshirëse ekonomike, punësim dhe punë për të gjithë.

Aktualisht gjendet se ka një korrelacion midis skemës së ndihmës dhe masave të ndërmarra në skemën e punësimit. Gjithsesi, në kushtet në të cilat ndodhet tregu shqiptar i punësimit ndikimi i kësaj të fundit në skemën e ndihmës mbetet i ulët.

SHSSH-ë, si agjencia implementuese e politikave të ministrisë për programet e mbrojtjes sociale, ka nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi me Shërbimin Kombëtar të Punësimit (SHKP) për punësimin e personave në moshë aktive pune, familjet e të cilëve përfitojnë NE.

Strategjia synon që përmes punësimit të nxisë familjet e ndihmës për një jetë më të mirë. Kjo vlerësohet të arrihet përmes: nxitjes së punësimit, orientimit në tregun e punës nëpërmjet kurseve të formimit profesional dhe programeve të ngjashme që kanë çuar në përfshirjen në tregun e punës të anëtarëve në moshë aktive pune. Për vitin 2018, nga 15.000 persona që janë trajtuar nga zyrat e punësimit, 4.266 janë punësuar dhe 681 persona janë regjistruar në programet e formimit profesional.⁴³ Për të gjithë aplikantët e ndihmës ekonomike u parashikua me anë të Kësaj Strategjie, se duhet të regjistrohen çdo muaj si punëkërkues të papunë. Kjo praktikë duket se ka sjellë rezultate në punësimin e anëtarëve në moshë punë të familjeve të skemës së NE-së.⁴⁴

Bazuar në programin e Qeverisë Shqiptare, me mbështetjen e Bankës Botërore, Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale hartoi “Programin e daljes”, si një program i cili ka si qëllim ndërlidhjen e programeve të mbrojtjes sociale me skema të tjera nxitëse punësimi, *duke u krijuar mundësinë e integrimit në tregun e punës të anëtarëve në moshë pune në skemën e NE-së*. Këtë qëllim programi i daljes synon ta

⁴³ Burimi: Buletini i Tregut të Punës 2018, Shërbimi Kombëtar i Punësimit.

⁴⁴ Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 866, datë 24.12.2019 “Për miratimin e strategjisë kombëtare të mbrojtjes sociale 2020-2023, dhe të planit të veprimit në zbatim të saj”.

realizojë nëpërmjet ndërthurjes/gërshetimit/integrimit të paketës së plotë ligjore për ngritjen (*formimin profesional*) dhe funksionimin e ndërmarrjeve sociale me programet e aftësimit për punësim, punësimit efektiv në tregun e punës, gjithashtu edhe në mundësi më të mëdha për përfituesit skemës së ndihmës në programet e zhvillimit lokal dhe jo vetëm si në industrinë, infrastrukturën, bujqësinë, etj.

Ligji nr. 65 i vitit 2016 “Për Ndërmarrjet Sociale në Republikën e Shqipërisë”, synon drejt një përfshirjeje të kategorive në nevojë. Kjo vlerësohet të arrihet përmes:

1. mundësive për punësim efektiv;
2. më tepër mundësi në tregun e punës për kategoritë e veçuara të cilat nuk mund të kenë kapacitete të plota për akses për shkak të moshës, gjendjes shëndetësore apo gjendjes familjare;
3. larmishmëri produktesh dhe shërbimesh me qëllim sigurimin e shanseve për kategoritë në nevojë, për të çuar kështu drejt një hapi më tej për barazi gjinore, duke vlerësuar se këto shërbime do të lehtësojnë aksesin e grave drejt punësimit;
4. më tepër mundësi për përfshirje të kategorive në nevojë, me qëllim nxitjen e bashkëpunimit dhe frymës sociale në shoqëri;

Bazuar në frymën e legjislacionit për ndërmarrjet sociale, vlerësohet se zhvillimi i tyre do mund të arrihet përmes masave me natyrë financiare duke u mbështetur natyrisht nga shteti dhe jo vetëm. Pushteti vendor ka përgjegjësinë e tij ligjore për të nxitur zhvillimin e tyre. Në këtë nivel kërkohet përfshirja e ndërmarrjeve sociale edhe në fushat e prokurimit publik, duke respektuar legjislacionin përkatës.

Për të mbajtur statusin e ndërmarrjes sociale duhet të plotësohen kriteret ekonomike dhe kriteret sociale të listuara në ligj. Përmendim disa prej tyre si vijon: 1. në veprimtarinë e saj ndërmarrja sociale, përveç kontributit të vullnetarëve, duhet të përfshijë domosdoshmërisht edhe, të paktën, 3 punonjës me pagesë; 2. të paktën, 30% e punonjësve të punësuar në ndërmarrjen sociale duhet t’i përkasin kategorisë së grupeve të pafavorizuara nga pikëpamja sociale dhe ekonomike. Natyrshëm që këto janë dhe kategoritë me problematika sociale, të ndodhur në kushte të tilla për shkaqe të ndryshme si mosintegrimi në tregun e punës, diskrimimi shoqëror ose dhe vetë paragjykimi që mund të kenë për pozitën në të cilën kanë rënë.

Ndërmarrjet Sociale e ushtrojnë veprimtarinë në shumë fusha të tilla si: sektori shoqëror, integrimi në tregun e punës, përfshirja për të rinjtë në trajnime të aftësimit profesional drejt punësimit, shëndetësia, arsimimi, zhvillimi lokal dhe rural, etj.

Bazuar në aktet e fundit administrative si *Udhëzimi nr. 602, datë 1.8.2018 “Për Proçedurat dhe Dokumentacionin e Nevojshëm për Marrjen e Statusit të Ndërmarrjes Sociale”, Urdhëri i Ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale nr. 636, datë 03.09.2018 “Për Miratimin e Rregullores Tip të Funksionimit të Ndërmarrjeve Sociale” si dhe Udhëzimin nr. 22, datë 04.01.2019 “Për Regjistrimin e Ndërmarrjeve Sociale dhe Rregullat për Mbajtjen e Tij”, në Drejtorinë e Përgjithshme të Politikave dhe Zhvillimit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale (në MSHMS), që është e ngarkuar për ndjekjen e funksionimit të Ndërmarrjeve Sociale në RSH, aktualisht janë 4 subjekte që kanë përfituar statusin por ende nuk kanë filluar zbatimin e funksioneve të tyre.⁴⁵*

⁴⁵ Burimi i informacionit është marrë nga kjo drejtori në gusht të vitit 2020.


Është pikërisht Urdhëri⁴⁶ i përbashkët i Ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe Ministrit të Financave dhe Ekonomisë nr. 624 datë 29.08.2019 në lidhje me miratimin e Planit Operacional për punësimin e anëtarëve në moshë aktive pune, që përcaktoi treguesit për çdo drejtori rajonale të Shërbimit Social Shtetëror, që do të arriheshin nga një ndërveprim më i mirë me Zyrat e Punës në Qarqe. Targeti i përcaktuar për 12 DRSHSSH-të për vitin 2019 ka në përbërje moshën aktive për punë. Konkretisht, grupmosha 16-25 vjeç orientohen drejt formimit profesional dhe për punësim grupmoshat 25-50 vjeç. Gjatë vitit 2019 janë punësuar 1.453 punëkërkues të papunë përfitues të ndihmës ekonomike dhe gjatë 6 muorit të parë të vitit 2020 janë punësuar 558 të tillë. Në tabelën nr. 5 dhe grafikun nr. 8 të mëposhtëm gjeni dhe ilustrimet përkatëse:

Tabela 5. Të dhënat për targetet e vendosura për punësim për çdo drejtori rajonale për vitin 2019

Qarqet	Përfitues familje në nevojë gjithsej	Anëtar në moshë aktive pune gjithsej	Anëtar në moshë aktive pune që duhet të paraqiten në zyrat e punës	Numri i anëtarëve në moshë aktive pune referuar në zyrat e punës nga DRSHSSH (mosha 18-50)	Target vjetor SHSSH +SHKP (punësim, formim profesional)
Elbasan	16'517	40'226	8'276	5'000	240
Durrës	629	1'402	430	300	100
Tiranë	3'166	7'485	2'951	1'200	210
Berat	1'641	3'646	688	340	72
Fier	2.16	5'032	825	500	69
Vlorë	1'703	3'408	1'454	800	197
Gjirokastrë	820	2'204	544	400	25

46 Akti Administrativ është emërtimi në mënyrë të përgjithshme i të gjitha llojeve të akteve që nxjerrin organet e administratës gjatë veprimtarisë së tyre ekzekutive dhe urdhërdhënëse. Ky akt administrativ merr emërtime të ndryshme si Urdhër, Vendim, Rregullore, Udhëzim etj. (Sadushi, fq. 8: 2005).

Korçë	7'832	18.44	2'326	1'500	60
Shkodër	4.5	11'374	2'175	1'500	179
Kukës	8'374	24'069	3'223	2'900	60
Lezhë	2'609	6'539	2'848	2'100	116
Dibër	10.31	29'206	4'610	3'000	125
Total	60'261	153'031	30'350	19'540	1'453



GRAFIK8. Numri i personave të punësuar sipas Qarqeve në Shqipëri

Urdhri i lartëpërmendur pasohet nga Urdhri nr. 808, dt. 31.12.2019 “Për miratimin e planit të masave, në zbatim të programit të daljes nga skema e ndihmës ekonomike”.

Një nga masat e parashikuara në këtë Urdhër është monitorimi dhe implementimi i programit të daljes nga skema e ndihmës ekonomike. Aktivitetet e parashikuara në përmbushje të kësaj mase janë:

- Grumbullimi i të dhënave lidhur me implementimin dhe dinamikat e Programit të Daljes nga skema NE-së në lidhje me rastet, trajnimet dhe punësimin e individëve në dalje nga skema e ndihmës ekonomike.

- Analiza e të dhënave të përfituesve të ndihmës ekonomike që janë në moshë aktive bazuar në profilin e tyre social dhe nevojat sociale.
- Përgatitja e raporteve me bazë tre-mujore për të treguar progresin dhe çështjet e hasura gjatë implementimit dhe dinamikat e Programit të Daljes nga skema NE-së në lidhje me rastet, trajnimet dhe punësimin e individëve në dalje nga skema e ndihmës ekonomike.
- Përcaktimi i strukturave të monitorimit, vlerësimit dhe raportimit në lidhje me implementimin e programit të daljes nga skema e NE-së; punësim i stafit nëse është e nevojshme.
- Trajnimi i vazhdueshëm i ekspertëve të strukturave të Monitorimit dhe Vlerësimit në lidhje me implementimin e Programit të Daljes nga Skema e Ndhmës Ekonomike.
- Draftimi i mekanizmit të ankimimit të përfituesve të cilët dalin nga skema e ndihmës ekonomike dhe rishikimi i kriterëve përjashtimore nga rregulli i përfundimit të afatit si dhe kushtet dhe kriteret për ri-aplikimin në programin e NE-së.

Në vitin 2021-2022 është parashikuar të bëhet një Vlerësim i impaktit të masave për daljen nga skema e ndihmës ekonomike dhe punësimin e qëndrueshëm të përfituesve të mëparshëm të NE-së, mqs afati 5 vjeçar i daljes nga kjo skemë përfundon në fund të vitit 2022.

4.4. Efektiviteti i reformës së Skemës të Ndihmës Ekonomike në Qarkun Elbasan

Karakteristikat social-ekonomike të Qarkut Elbasan

Qarku Elbasan është ndër qarqet i cili ndodhet në hapësirën gjeografike favorizuese në qendër të Shqipërisë. *Ky qark ka një sipërfaqe të përgjithshme prej 3.292 km² dhe një popullsi prej 437.394 banorë.*

Qarku i Elbasanit si një ndër qarqet më të mëdha të Shqipërisë paraqet problematika të shumta sociale. Në përbërje të tij sipas ndarjes së re administrative janë 7 Bashki dhe 51 Njësi Administrative në total.

Konkretisht këto bashki janë si vijon: Bashkia Elbasan që është e përbërë nga 13 njësi administrative, Bashkia Gramsh që është e përbërë nga 10 njësi administrative, Bashkia Cërrik që është e përbërë nga 5 njësi administrative, Bashkia Peqin që është e përbërë nga 6 njësi administrative, Bashkia Librazhd që është e përbërë nga 7 njësi administrative, Bashkia Belsh që është e përbërë nga 5 njësi administrative dhe Bashkia Prrenjas që është e përbërë nga 5 njësi administrative.

Prezenca e grupeve sociale të rrezikuara si: fëmijët, të rinjtë, gratë, personat me aftësi të kufizuar, të moshuarit si dhe komunitetet Rome dhe Egjiptiane, i bëjnë më të theksuara këto problematika dhe kërkojnë në çdo kohë përgjigje sa më të shpejta dhe efikase.

Relievi është i thyer në pjesën më të madhe të Qarkut. Më relievin lidhet domosdo edhe infrastruktura e cila nga ana tjetër ndikon në zhvillimin ekonomik të zonave të caktuara. P.sh. karakteristikë për Bashkinë Elbasan, Gramsh dhe Librazhd është dominimi i

zonave malore të cilat duke patur relief të thyer aksesin në infastruktura e kanë më të vështirë, gjë që kërkon kosto më të lartë në investim dhe mirëmbajtje të tyre.

Një pjesë e tokave në Bashkitë Belsh, Librazhd, Gramsh, karakterizohen nga prodhueshmëria e ulët. Shkak për këtë është dhe vështirësia në ujitje, arsye e cila këto toka dita ditës po gjenden të braktisura nga banorët e zonës.

Bashkia Elbasan ka një nivel të lartë të varfërisë. Në publikimin Statistikor të rradhës të vitit 2019 të INSTAT, vërehet se, Bashkia Elbasan zë peshën më të madhe të numrit të familjeve të trajtuara me NE, në masën 10.6% ndaj numrit total të familjeve me ndihmë ekonomike në vend. Arsytet e nivelit të lartë të varfërisë janë fshatrat përreth saj që karakterizohen nga një relief i thyer malor. Arsye e varfërisë është gjithashtu dhe vetë qyteti i Elbasanit që gjatë kohës së komunizmit mbledhi disa qindra mijëra punëtorë përreth zonës industriale të Kombinatit Metalurgjik (Ndërmarja e Prodhim Çelikut), por pas viteve 1990 industria e rëndë kryesisht e këtij kombinati u mbyll. Si rrjedhojë nga *industria e mbijetuar tashmë në Kombinatit Metalurgjik janë punësuar vetëm pak banorë duke lënë pjesën tjetër të popullsisë të papunë. (Këshilli i Qarkut Elbasan, fq. 4: 2016).*


Problemi më i madh në Bashkinë e Peqinit është punësimi. Edhe pse një pjesë e mirë e banorëve merren me bujqësi, mundësitë ekonomike për ta janë të pakta.

Bashkia Prrenjas ka një pozicion të favorshëm gjeografik, pasi gjendet fare pranë dy pikave doganore me Maqedoninë. Por ky avantazh nuk është shfrytëzuar deri më sot për nxitjen e sipërmarrjes dhe shtimin e vendeve të punës. Përgjatë tranzicionit, në këtë zonë kanë munguar strategjitë e zhvillimit. E megjithatë, emigracioni në zonën e

Prrenjasit nuk ka qenë i lartë. Kjo pasi shumë banorë të zonës kanë zgjedhur punësimin sezonal në Maqedoninë fqinje, me të ardhurat e të cilëve mbijeton një pjesë e mirë e popullatës. Papunësia mbetet plaga kryesore për banorët e Prrenjasit.


Qarku i Elbasanit, falë kapaciteteve në burime njerëzore që disponon, ka pasur gjithmonë mundësinë t’i paraprijë modeleve novatore duke bërë të mundur pilotimin e tyre dhe duke e bashkëndarë me aktorë të tjerë në rajon e më gjerë. Pilotimi i skemës së NE-së dhe jo vetëm, por së fundmi edhe ai për reformën e Skemës së Aftësisë së Kufizuar që po zbatohet aktualisht, janë tregues për sa më sipër. Në këtë kuadër janë sjellë disa rekomandime për ndërhyrje socio-ekonomike mbi shërbimet më të kërkuara nga popullsia e Qarkut të Elbasanit, me qëllim që të përmirësojnë situatën e shumë familjeve në nevojë që jetojnë në kushte të vështira e vulnerabël. Në ilustrimin e mëposhtëm nr 2 gjeni dhe skemën përkatëse. (Këshilli i Qarkut Elbasan, fq. 46: 2016).

Ilustrim 2: Përbërja e Drejtorisë Rajonale të SHSSH-së të Qarkut Elbasan sipas ndarjes së re administrative



Analiza e masave ekonomike

Në Qarkun e Elbasanit gjatë vitit 2019 kanë përfituar mesatarisht 16.392 familje ndihmë ekonomike nga të cilat 19.5% në zonat urbane dhe 80.5% në zonat rurale, me një fond total prej 195.250.000 lekësh. Në grafikun e mëposhtëm nr 9 gjeni dhe ilustrimet përkatëse.



GRAFIK 9. Shpërndarja e Ndihmës Ekonomike në Qarkun e Elbasanit viti 2019

Nga këto 16.392 familje përfituese, 96.204 familje kishin fëmijë të moshës 0-18 vjeç, nga të cilët 64.386 fëmijë ndiqnin arsimin e detyrueshëm 9-vjeçar dhe 7.902 ishin femra. Në tabelën e mëposhtme nr 6 gjeni dhe ilustrimet përkatëse.

Tabela 6. Shpërndarja e Ndihmës Ekonomike sipas zonave dhe grup-moshave

NE Elbasan	Zona Urbane	Zona Rurale	NE Plotë (2 mujor)	0-18 vjeç	9 vjeçare	Femra
Persona	19.5%	80.5%	16'392	96'204 (familje)	64'386	7'902


Sipas strukturës së familjes, në qarkun e Elbasanit rezultojnë 32.792 kryefamiljarë, prej të cilëve 42.164 në moshë pune dhe 63.378 mbi moshë pune. Trajtoheshin me ndihmë ekonomike 62 jetim dhe 12 fëmijë trinjak. Në tabelën e mëposhtme nr 7 gjeni dhe ilustrimet përkatëse.

Tabela 7. Shpërndarja e Ndihmës Ekonomike sipas grupmoshave dhe kategorive

NE Elbasan	Kryefamiljarë	K.mbi moshë pune	K.në moshë pune	Jetim	Trinjakë
Persona	32'792	63'378	42'164	62	12

Fondet e akorduara për vitin 2019 në total për qarkun e Elbasanit ishin 991 milion lekë e ndarë kjo: (në grafikun e mëposhtëm nr 10 gjeni dhe ilustrimet përkatëse)

- për zonën urbane 173 milion lekë,
- për zonën rurale 818 milion lekë.



GRAFIK 10. Shpërndarja e fondeve të Ndihmës Ekonomike sipas zonave në vitin 2019

Me modernizimin e *Skemës së Ndihmës Ekonomike me anë të administrimit të Regjistrimit Elektronik Kombëtar dhe Sistemit të Pikëzimit*, vërehet një rritje e numrit të përfituesve të NE-së në zonat rurale dhe një ulje e numrit të tyre në zonat urbane në nivel Kombëtar. Konkretisht edhe në Qarkun e Elbasanit, përfituesit e NE-së në zonat rurale në vitin 2019 janë shtuar me 9.3% krahasuar kjo me numrin e këtyre përfituesve në vitin 2013 (para zbatimit të reformës). Paralelisht ka ndodhur dhe ulja e numrit të këtyre përfituesve në zonat urbane në masën 9.3%. Kjo ndodh si rrjedhojë e zbatimit të rrisë së reformës që është eliminimi i ndihmës ekonomike të pjesshme. Kjo e fundit kryesisht përfitohej në zonat rurale pasi familjet/individët përfitues të NE-së kishin plus dhe të ardhurat nga toka. Duke qenë se varfëria është më shumë e prekshme në zonat urbane (sepse familjet/individët në nevojë nuk kanë të ardhura nga toka) se rurale, mendoj se është e nevojshme të rishikohen treguesit e vlerësimit të formulës së unifikuar të pikëzimit, që ndihmojnë në përcaktimin e kritereve të pranueshmërisë të familjeve për përfitimin e ndihmës ekonomike.

Ndryshimi i shpeshtë i administratorëve shoqëror

Në nivel Qarku Elbasan janë gjithsej 83 administratorë shoqërorë të cilët operojnë në skemën e NE-së. Nga të dhënat rezulton se nga fillimet e zbatimi të reformës së NE-së (qeshori i vitit 2014) deri më sot nga këto 83 administratorë vetëm 9 prej tyre janë ende në të njëjtin pozicion pune. Njësitë administrative që kanë numër të lartë dhe të ulët përfituesish dhe kanë vetëm një administrator shoqëror: - Qendër Librazhd 800 familje; Qukës 964 familje; Rrajcë 975 familje; Kukur 454 familje; Labinot Mal 619 familje; Shushicë 418 familje; Hotolisht 596 familje; Përrenjas 400 familje; Orenjë 509 familje; Polis 409 familje; / Fierzë 78 familje; Rrasë 89 familje; Gostimë 121 familje; Klos 78 familje; Shalës 56 familje; Steblevë 54 familje; Kushovë 121 familje; Lenie 111 familje; Sult 101 familje.

Këto ndryshime të shpeshta të administratorëve (mesatarisht 1 herë në vit për ç’do njësi administrative) reflektojnë në mënyrën e menaxhimit të Skemës së Ndihmës Ekonomike në nivel vendor. Sikurse e kemi theksuar roli i administratorit shoqëror mbetet kyç në efikasitetin e zbatimit të reformës por dhe të ecurisë së Skemës në vijim. Nga ana tjetër, ndryshimet e shpeshta të administratorëve shoqëror ndikojnë në menaxhimin e burimeve njerëzore dhe jo vetëm, por dhe në atë materiale dhe kohore, si për Bashkitë ashtu edhe për SHSSH-në dhe Drejtoritë Rajonale të saj.

Nga praktika e punës në DR të SHSSH Elbasan vërehet se, ndryshimi i një administratori shoqëror i merr kohë efektive por dhe kosto reale stafit të kësaj Drejtorie dhe jo vetëm. Kjo situatë vërehet se ka ndikuar edhe në ecurinë e skemës për atë njësi

për një periudhë të caktuar. Nga ana e sistemit, hapja e një *User-i*⁴⁷ të ri kërkon dy deri në tre ditë pune për drejtorinë rajonale për shkak të procedurave zyrtare që duhen ndjekur në këtë rast, nga marrja e shkresës së emërimit në këtë pozicion pune deri në përcjelljen e saj pranë Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale. Nëse një gjë e tillë përkon me fillimin e muajit (nga data 1 deri në 10) kur janë dhe datat e lejuara nga ligji për aplikim, kjo ndikon drejtpërdrejtë në hedhjen e aplikimeve të reja apo dhe në deklaratimet 3-mujore. Tërthorazi një situatë e tillë ndikon në cilësinë e punës së kryer, pasi normalisht do i duhej më shumë se një muaj (mesatarisht 3 muaj) një administratori të ri njohja me procedurat përkatëse dhe trajnimi rreth tyre.

Riintegrimi në tregun e punës nga Skema e NE-së

Varfëria është mungesa e mjeteve të mjaftueshme financiare për të plotësuar nevojat bazë të individit referuar standardit të jetesës. (Kontrolli i Lartë i Shtetit, fq. 7: 2018).

Sipas një studimi të bërë nga Institucioni i Kontrollit të Lartë të Shtetit, të publikuar në raportin e vitit 2018 të këtij institucioni përcaktohet se, llogaritja e minimumit jetik shërben si një tregues për të përcaktuar kufirin real të varfërisë. Minimum jetik mund të konsiderohen të ardhurat minimale të një individi për të plotësuar nevojat bazë. Përmes këtij raporti pranohet se, *në Shqipëri nuk ka një vlerë të miratuar nga qeveria të minimumit jetik dhe kufirit të varfërisë, mbi të cilën të bazohen politikat dhe studimet e përkujdesit social*. (Kontrolli i Lartë i Shtetit, fq. 30: 2018).

Në vitin 2016, institucioni i Avokatit të Popullit ka publikuar raportin “*Llogaritja e Minimumit Jetik në Shqipëri – Nga minimumi jetik si mbijetesë drejt një standardi jetese*”

⁴⁷ Është llogaria personale që ka një administrator shoqëror në sistemin elektronik të NE-së.

të arsyeshëm”, në përpjekje për të llogaritur një vlerë të minimumit jetik që rezultoi rreth 16.000 lekë në muaj për frymë. Megjithatë, shifrat e nxjerra nga këto raporte nuk janë miratuar nga Këshilli i Ministrave si vlera zyrtare të minimumit jetik në Shqipëri. Në këtë mënyrë, *Shqipëria është aktualisht i vetmi vend në Europë që nuk ka një tregues zyrtar të minimumit jetik të deklaruar.* (Kontrolli i Lartë i Shtetit, fq. 32: 2018).

Varfëria është një problem dinamik, e cila provokon një zinxhir hallkash që duhet të funksionojnë efektivisht për zgjidhjen e saj. MSHMS, si *institucioni përgjegjës për zbatimin e politikave dhe legjislacionit të ndihmës ekonomike*, ka ngritur skemën e Ndihmës Ekonomike si instrument për reduktimin e varfërisë. (Kontrolli i Lartë i Shtetit, fq. 21: 2018).

Qëllimi final i Strategjive për Mbrojtjen Sociale është zbutja dhe lehtësimi i varfërisë, përfshirë mbulimin më të mirë të familjeve të varfëra me skemën e NE-së, si dhe shmangien e abuzimeve me këtë skemë. Lufta kundër varfërisë është gjithashtu Objektiv nr. 1 i Agjendës së Kombeve të Bashkuara për Zhvillimin e Qëndrueshëm.

Varfëria është një fenomen kompleks, i ndikuar nga një shumëllojshmëri faktorësh, ku një ndër më të rëndësishmit është tregu i punës. Ndaj dhe në vijim do ndalemi të paraqesim disa të dhëna faktike mbi situatën e punësimit në Qarkun Elbasan,⁴⁸ në mënyrë që panorama e trendit të Skemës së NE-së të jetë më e qartë.

Numri i punësimeve në total në vitin 2018 për Qarkun Elbasan ishte 1.654 persona prej të cilëve 256 nga skema e NE-së. Ndërsa numri i punësimeve në total në vitin 2019 në këtë Qark ishte 2.044 persona prej të cilëve 240 nga skema e ndihmës ekonomike.

⁴⁸ Burimi: Të dhënat janë marrë nga Zyra e Punës Elbasan.

Numri total i punësimeve përmbledh ndërmjetësimet, gjetje pune vetë (vetëpunësim) dhe pjesëmarrje në programet e nxitjes së punësimeve.

Legjislacioni për NE-në ka parashikuar se individët përfitues të ndihmës ekonomike, të cilët janë në moshë pune duhet të përfshihen në programe të riintegritit social të miratuara nga Këshilli i Ministrave (*neni 22 i Ligjit nr. 57/2019 “Për asistencën Sociale në Republikën e Shqipërisë”*). Shteti shqiptar ka ngritur mekanizma në funksion të politikave aktive në tregun e punës. Rasti më tipik i tyre janë programet e nxitjes së punësimit, të cilat synojnë të promovojnë punësimin e kategorisë së punëkërkuesve të papunë dhe integrimin e tyre në tregun e punës. Programet e riintegritit social për përfituesit e ndihmës ekonomike janë *programet e nxitjes së punësimit* dhe *programet e formimit profesional* sipas VKM-ve të ndryshme përkatëse.

Kujtojmë që, në mënyrë që të përfitojnë nga skema e NE-së, individët në moshë pune duhet të regjistrohen pranë Shërbimit Kombëtar të Punësimit si punëkërkues të papunë. Kategoria e veçantë e individëve, të cilët përfitojnë nga skemat e mbështetjes me të ardhura ndahen në dy kategori: 1) Punëkërkues të papunë të familjeve me Ndihmë Ekonomike dhe 2) Punëkërkues të papunë të programit pasiv të pagesës së papunësisë.

SHKP thekson se punësimi apo ripunësimi i këtyre individëve mbetet një problem serioz, për shkak edhe të faktorëve të tillë si mosha e përfituese, niveli i ulët i arsimimit etj.

Një ndër programet e formimit profesional që u aplikua gjatë vitit 2019 në Qarkun e Elbasanit ishte dhe *Start Smart* (program 2 javor, formimi dhe orientimi në tregun e punës). Numri i punëkërkuesve nga skema e NE-së që kanë përfituar formim

profesional në vitin 2018 ishte 150 persona në total. Ndërsa në vitin 2019 kanë përfituar formim profesional 72 punëkërkues nga ndihma ekonomike. Numri i punëkërkuesve që kanë përfituar *Start Smart* në vitin 2019 ishte 1.353 prej të cilëve 108 nga skema e NE-së.

Në programet e nxitjes së punësimit në vitin 2018 janë përfshirë 16 punëkërkues nga skema e ndihmës ekonomike. Ndërsa në programet e nxitjes në vitin 2019 janë përfshirë 3 punëkërkues nga skema e NE-së.

Në Qarkun e Elbasanit numri i Ndërmjetësimeve në total në vitin 2018 ishte 980 punëkërkues prej të cilëve 83 nga skema e NE-së. Ndërsa numri i Ndërmjetësimeve në total për vitin 2019 ishte 1.313 punëkërkues prej të cilëve 93 nga skema e NE-së.

Kategoritë e veçanta përfituese nga Skema e NE-së

- Shërbimi i kujdestarisë së përkohshme. Fëmijët e vendosur në familje kujdestare.

Me reformën e dytë të Skemës së NE-së sikurse e kemi theksuar gjatë këtij punimi në ligj u përcaktua mbështetja e *shërbimit të kujdestarisë për fëmijët si një shërbim i ri alternativ*. Vendimi i parë që disiplinon këtë fushë është VKM nr. 89, datë 26.1.2012 “Për përcaktimin e kriterëve, të dokumentacionit dhe të procedurës së shërbimit të kujdestarisë”. Bazuar në këtë VKM masat e marra dhe nga ana e Njësive vendore duket që janë efektive, pasi kjo gjë shprehet në numrin gjithnjë e në rritje të përfituesve nga kjo kategori.

Sipas të dhënave nga Skema e NE-së, rezulton se në nivel Qarku Elbasan në vitin 2015 kanë qenë 10 familje përfituese nga kjo kategori, me një fond prej 91.000 lekësh.

Përkatësisht nga dy familje në Bashkitë Cërrik dhe Peqin, dhe gjashtë familje në Bashkinë Elbasan. Ndërsa në vitin 2019 rezultojnë 44 familje përfituese nga kjo kategori në nivel qarku, me një fond prej 397.000 lekësh (aktualisht përfitojnë ndihmë ekonomike 38 familje të tilla). Shpërndarja në Bashkitë përkatëse ishte: 3 në Belsh, 4 në Librazhd, 5 në Gramsh, 10 në Elbasan, 10 në Peqin dhe 12 në Cërrik. Sikurse vërehet nga të dhënat ka një trend në rritje të këtij numri. Kjo rritje ka ardhur si efekt i zbatueshmërisë së legjislacionit për familjen kujdestare dhe natyrisht edhe i ndërgjegjësimit të masës së popullsisë përmes punës bindëse që kanë bërë dhe vazhdojnë të bëjnë strukturat lokale të Bashkive dhe Drejtoria Rajonale e ShSSH-së Elbasan, duke i orientuar drejt programeve të tilla përfituese kategoritë në nevojë.

- Familje me më shumë se tre fëmijë.

Në total nga viti 2015 deri në dhjetor të vitit 2019 kanë përfituar 11 familje nga kjo kategori, me një fond total prej 2.961.000 lekësh.⁴⁹ Në janar të vitit 2020 rezultojnë 3 raste të tilla në nivel qarku, përkatësisht nga një në bashkitë Elbasan, Gramsh dhe Librazhd.

- Jetimët që nuk janë në Institucione.

Në total nga viti 2015 deri në dhjetor 2019 kanë përfituar 68 jetimë që nuk janë të vendosur në institucione, me një fond total prej 4.383.300 lekësh. Në janar 2020 rezultojnë 35 raste të tilla në nivel qarku, përkatësisht: 13 në Bashkinë Elbasan, 8 në Bashkinë Gramsh, 5 në Bashkinë Belsh, 4 në Bashkinë Peqin, 3 në Bashkinë Librazhd dhe 1 në Bashkinë Cërrik.

⁴⁹ Të dhëna këto të gjeneruara nga Raportet e Sistemit Elektronik për Qarkun Elbasan.

- Viktimat e trafikimit.

Gjatë gjithë periudhës që kur është ngritur sistemi i NE-së deri në dhjetor të vitit 2019 rezultojnë 3 raste të viktimave të trafikimit të cilat kanë përfituar nga kjo Skemë me një fond total prej 333.000 lekësh.

- Viktimat e dhunës në familje.

Në total nga viti 2015 deri në dhjetor të vitit 2019 kanë përfituar 264 familje nga kjo kategori, me një fond total prej 5.679.000 lekësh. Këtu kemi parasysh se janë jo vetëm gratë e dhunuara por dhe fëmijët e tyre të pajisur me Urdhër Mbrojtje. Nga këto viktime të dhunës në familje tre raste janë kryefamiljarë meshkuj që banojnë në zonë rurale. Në janar të vitit 2020 rezultojnë 67 raste të tilla, përkatësisht: 40 në Bashkinë Elbasan, 14 në Bashkinë Gramsh, 2 në Bashkinë Belsh, 6 në Bashkinë Librazhd dhe 5 në Bashkinë Prrenjas.

Niveli i përfitimit të familjeve nga Fondi i kushtëzuar

Kujtojmë që risi e legjislacionit të ri reformues të Skemës së NE-së ishte edhe Fondi i kushtëzuar (fillimisht në masën 3% e më pas u rrit në masën 6% sikurse është edhe sot).

Meqenëse Qarku Elbasan ishte ndër tre qarqet ku u implementua fillimisht skema pilot e ndihmës ekonomike, natyrshëm që edhe efektshmëria e aplikimit të këtij fondi ishte e ndjeshme. Ulja e përqindjes ndër vite të familjeve përfituese nga fondi 6% tregon efikasitet të vetë Skemës së NE-së, duke qenë se kriteri parësor ligjor për përfitim nga ky fond është “familje të dala nga Skema e NE-së për arsye pikëzimi/mosmarrja e pikëve të mjaftueshme për kualifikim”. Domethënë, sa më pak familje të dalin nga Skema për arsye pikëzimi, aq më pak familje përfitojnë në fondin 6%. Konkluzioni: efikasitet e

Skemës së NE-së duke rritur mundësitë për përfitim për familjet aplikuese dhe ulja e skualifikimeve nga vetë sistemi (për arsye pikëzimi).

Në qershor të vitit 2020 në nivel Qarku janë 278 familje gjithsej përfituese nga ky fond. Shuma e këtij fondi për këtë muaj është 796.880 lekë. E shprehur në përqindje janë 1.6% e familjeve përfituese të skemës, dhe afërsisht 1% në raport me fondin total për Qarkun e Elbasanit të familjeve përfituese nga Skema e NE-së. Pra, dukshëm më e vogël se maksimalja e lejuar prej 6%.

Kapitulli V: Transparenca e autoriteve përgjegjëse të administratës publike për garantimin e të drejtës së ndihmës ekonomike

5.1. Institucionet publike që ofrojnë informacion në procesin e përfitimit të ndihmës ekonomike. Rolet dhe përgjegjësitë e tyre

Ligji nr. 57 i vitit 2019 “Për asistencën Sociale në Republikën e Shqipërisë”, detyron të ofrojnë informacion përgjatë gjithë procesit që ndjek ofrimi i NE-së, institucionet publike përkatëse. Periodikisht dhe sa herë u kërkohet ato do të vazhdojnë të ofrojnë të dhëna për individët që përftojnë shërbime pranë tyre. Roli i këtyre institucioneve publike dhe në procesin e reformimit nëpërmjet sistemit elektronik të ndihmës ekonomike nuk ka ndryshuar. Për të patur një këndvështrim më të plotë, këto institucione po i grupojmë si më poshtë:

Institucionet në varësi të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale

Institucionet në varësi të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale janë përmendur dhe në kapitujt paraardhës. Në vijim do të ndalemi në një analizë më të detajuar të tyre.

Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale (MSHMS) mban peshën kryesore në përmbushje të detyrave primare në nivel të politikave në fushën sociale por dhe në ekezekutueshmërinë e tyre. Drejtimet që mbulon kjo ministri në fushën sociale janë politikat e zbutjes së varfërisë drejt përmirësimit të jetesës së familjeve apo individëve në nevojë si dhe përkushtimi social për këto kategori drejt një përfshirjeje më të madhe në jetën shoqërore, pa barriera midis tyre. Drejtoria më me peshë në sektorin social në këtë ministri është *Drejtoria e Përgjithshme e Politikave të Shërbimeve Sociale*. Kjo

drejtori koordinon punën në drejtim të hartimit dhe zbatimit të politikave me karakter social, me qëllim azhornimin e legjislacionit përkatës, përshtatjen e tij me standartet në zhvillim dhe harmonizimin e masave në raport me fushat e tjera të ndërlidhura.

Kujtojmë këtu që Shërbimi Social Shtetëror (SHSSH), është institucioni direkt pas kësaj ministrie i cili kryen ekzekutimin e politikave sociale, duke monitoruar në vazhdimësi përmes drejtorive rajonale të SHSSH në 12 qarqet e vendit.

Bazuar në parimin e decentralizimit, detyrë kryesore e SHSSH-së mbetet *inspektimi dhe monitorimi* për alokimin e fondeve buxhetore në drejtim të skemës së ndihmës dhe jo vetëm. Është SHSSH ajo e cila bën përlllogaritjen e fondeve bazuar në të dhënat e dërgura nga njësitë vendore, nën monitorimin e drejtorive rajonale, duke ndjekur më pas edhe ekzekutimin e tyre, deri në momentin që përfituesit të kenë marrë atë çfarë u takon me ligj. SHSSH ka gjithashtu në varësi të tij direkte institucione kombëtare të përkujdesjes shoqërore të njohura si IPSH. Për strukturat e këtyre institucioneve SHSSH ka përgjegjësi organizimin e trajnimeve për ngritjen dhe përmirësimin e kapaciteteve të stafeve të tyre, ashtu sikurse edhe për IPSH jo publike (të cilat operojnë në formën e OJF-ve me vetëfinancim ose me donacione nga jashtë).

Gjithashtu, Shërbimi Social Shtetëror, organizon trajnime për ngritjen dhe përmirësimin e kapaciteteve profesionale edhe të stafeve të cilat merren direkt me ofrimin e shërbimeve në fushën e NE/PAK. Çdo reforme të ndërmarrë në nivel qendror i përgjigjet një tërësi trajnimesh për stafet përkatëse. Si shembull mund të sjellim ciklin e vazhduar ndër vite të Trajnimeve të ndërmarra nga SHSSH-ë në kuadër të reformës së Skemës së re të NE-së, apo së fundmi trajnimet e ofruara për Bashkitë dhe Njësitë

Administrative në kuadër të reformës së ngritjes dhe shtrirjes të Rregjistrit Elektronik Kombëtar për Shërbimet Shoqërore.

Në Shërbimin Social Shtetëror është ngritur dhe funksionon Drejtoria e Kontrollit të Pagesës së NE dhe PAK e cila bazuar në *Udhëzim nr. 714, datë 11.10.2018 “Për metodologjinë e kontrollit të pagesave të ndihmës ekonomike”*, përmes Drejtorive Rajonale, kontrollon zbatimin e programeve vjetore të kontrollit të hartuara e të propozuara nga drejtuesi i drejtorive dhe të miratuara nga drejtori i përgjithshëm i SHSSH-së.

Ministria e Financave

Është përmendur dhe në kapitujt paraardhës që, *financimi i programeve të ndihmës ekonomike përballohet nga Buxheti i Shtetit*. Ministria e Financës bën programimin e fondeve buxhetore për shërbimet e përkujdesit, sipas parashikimeve që i paraqet Drejtoria e Përgjithshme e SHSSH-së.

Institucionet në varësi të Ministrisë së Brendshme

Institucionet në varësi të Ministrisë së Brëndshme, që ofrojnë informacion në procesin e përfitimit të NE-së janë Drejtoria e Përgjithshme, konkretisht *Departamenti Kundër Krimit të organizuar dhe Krimeve të Rënda si dhe Drejtoria kundër Narkotikëve dhe Trafikeve*.

Është pikërisht *Spektori Kundër Trafikimit të paligjshëm* i cili për shkak të funksionit që ka lidhet me veprimatrinë që bën policia vendore, ku kjo e fundit në bashkëpunim me Drejtoritë Rajonale të SHSSH-së, realizojnë fazën e vlerësimit për Viktimat e Trafikimit (VT-të) dhe Viktimat e mundshme të Trafikimit (VMT-të).

Një Zyrë e cilësuar si *Koordinatori Kombëtar Kundër Trafikimit (ZKKKT)*, është në organikë të kësaj Ministrie, dhe kryesohet nga *Zëvendësministri i Brendshëm*. Ky i fundit është gjithashtu dhe kryetar i *Autoritetit Përgjegjës në kuadër të Mekanizmit Kombëtar të Referimit (MKR)*.

Puna e ZKKKT realizohet përmes *Njesisë Antitrafik*, e cila funksionon në bazë të *Urdhrit të Kryeministrit, nr. 203, datë 19.12.2005 “Për mënyrën e funksionimit të Njesisë Antitrafik”*. Kjo Njësi ka në organikë Drejtorin e saj si dhe 4 Koordinatorë. Njësia Antitrafik është nën drejtimin e *Zëvendësministrit të Brendshëm në statusin e Koordinatorit Kombëtar për Luftën kundër Trafikimit të Personave* i cili ndër të tjera ka në kompetencë monitorimin dhe koordinimin e aktiviteteve në kuadër të fushatave antitrafik në nivel republike.

Në drejtim të trajtimit të kategorisë së VT-së / VMT-së janë strehëzat antitrafik ato të cilat shërbejnë si pikë mbështetëse dhe orinetuese në integrimin e kësaj kategorie në shoqëri. Këto strehëza në monitorim të vazhduar nga qeveria shqipëtare, mbështeten nga kjo e fundit si dhe nga bashkitë ku ato ushtrojnë aktivitetin e tyre.

Konstatohet se strehëzat funksionale në vend vijnë në një numër të vogël. Një ndër to është *Qendra Kombëtare e Pritjes për Viktimat e Trafikimit*⁵⁰ e menaxhuar nga *Shërbimi Social Shtetëror* dhe gjithashtu tre qendra të menaxhuara nga OJF (strehëza “Të ndryshëm të barabartë” në Tiranë, strehëza “Tjetër Vizion” në Elbasan si dhe

⁵⁰ Shoqatat dhe Fondacionet klasifikohen në kategorinë e Organizatave Jo Qeveritare (OJF). Ato krijohen në mënyrë vullnetare dhe veprojnë të pavarura nga shteti. Shoqata është bashkim vullnetar personash fizikë dhe juridikë, vendas ose të huaj, që vepron me kontributet e anëtarëve ose me burime të tjera të parashikuara me ligj, për arritjen e synimeve në të mirë të publikut ose të anëtarëve të saj. Fondacioni është një person juridik, pa anëtarësi, që ka në dispozicion të ardhura dhe pasuri me qëllim që të sigurojë mbështetje financiare, materiale apo të formave të tjera, personave të tretë, për arritjen e një ose më shumë qëllimeve në të mirë të publikut. (Latifi, fq. 115: 2005).

strehëza ‘Vatra’ në Vlorë) të financuara pjesërisht nga donatorë të huaj dhe pjesërisht nga fondet e MSHMS nëpërmjet Këshillit të Qarkut.

Pranë çdo Drejtorie të Policisë Vendore ka dhe një sektor të posaçëm i cili trajton viktimat e dhunës në familje (këto të fundit janë një nga kategoritë përfituese nga ndihma sikurse e kemi cilësuar edhe më lartë në kapitujt paraardhës). Ky sektor është pjesë e Departamentit që përshin edhe Mbrojtjen e të Miturve.

Avokati i Popullit

Avokati i Popullit është institucion i pavarur, i cili ka për qëllim ndërhyrjen ligjore në drejtim të mbrojtjes së të drejtave të qytetarëve. Rekomandimet e tij janë propozuese. Avokati i Popullit gëzon të drejtën dhe detyrimin që në bashkëpunim me zyrtarët publikë në nivel qendror apo vendor të përpiqet për krijimin e një kulture demokratike dhe standardeve më të larta të respektimit të lirive dhe të të drejtave të njeriut në vend.

Në këtë kuadër, kjo instancë vazhdon të luajë një rol të rëndësishëm gjatë gjithë procesit të draftimit të projektligjit përkatës, duke dhënë vërejtje dhe sugjerime të cilat janë pasqyruar në një masë të mirë të tyre në përmbajtjen e dispozitave të ligjit nr. 57 të vitit 2019 “Për asistencën Sociale në Republikën e Shqipërisë”. Ky rol proaktiv ka vijuar dhe po vijon edhe në procesin e diskutimit dhe miratimit të akteve nënligjore që janë nxjerrë dhe që pritet të nxirren nga ana e organeve përkatëse të ngarkuara me këtë detyrim në zbatim të dispozitave të ligjit të sipërcituar. Referuar ankesave të regjistruara nga Institucioni i Avokatit të Popullit për vitin 2019, rezultojnë të jenë trajtuar 40 ankesa nga qytetarët të cilat evidentojnë ekzistencën e problematikave kryesore të tilla si: - ndërprerja e përfitimit të ndihmës ekonomike dhe paqartësia e qytetarëve për arsyet e mospërfitimit apo mospërfshirjes së tyre në skemën e përfitimit të NE-së; - masa e ulët e

ndihmës. Trajtimi i ankesave të qytetarëve nga kjo instancë ka mundësuar informimin e rregullt të tyre lidhur me bazën ligjore të trajtimit të problematikave nga ana e njësive të pushtetit vendor si dhe kushtet ligjore dhe faktike që ata që duhet të plotësojnë për të qenë përfitues të skemës së ndihmës ekonomike. (Avokati i Popullit, fq. 80: 2019).

Hartimi i “Raportit të monitorimit për shpërndarjen e NE-së *përbën një nga risitë e punës së Avokatit të Popullit*. Në kontekstin e monitorimit, se si ofrohen shërbimet sociale për grupet në nevojë në nivel vendor për bashkitë Kukës, Elbasan, Librazhd, Fier, Berat dhe Pogradec, raporti përmban gjetje konkrete, evidenton problematikat me të cilat ballafaqohen qytetarët në ofrimin dhe *shpërndarjen e ndihmës ekonomike* nga organet e pushtetit vendor dhe përfshin në përmbajtjen e tij, rekomandime konkrete, përkatësisht për *organet e qeverisjes qendrore dhe vendore* për adresimin e duhur dhe tejkalimin e problematikave të konstatuara.

Institucionet shtetërore të nivelit të dytë

Në funksion të menaxhimit të punës në fushën e NE-së kemi të listuar një tërësi organesh në nivel rajonal, përfaqësuese të instancave më të larta, si dhe institucionet e nivelit lokal. Në këtë pjesë të punimit sjellim në analizë organet e nivelit rajonal si më poshtë vijon:

DRShSSH-të; Zyra Rajonale e Punës; Drejtoria e Policisë së Qarkut; Drejtoria Rajonale Arsimore; Zyra Rajonale e Inspektoratit të Punës; Qendra Kombëtare e Regjistrimit; Zyra Rajonale e Sigurimeve Shoqërore; Zyra Rajonale e Regjistrimit të Automjeteve; Drejtoria-Rajonale e Tatimeve; Agjensia Shtetërore e Kadastrës; Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve; Spitalet Rajonale, Gjykata e Shkallës së Parë etj. Përgjegjësi e këtyre instancave është ndjekja e procedurave në zbatimin e ligjit për përfituesit e

ndihmës dhe jo vetëm, duke mbajtur parasysh parimin e trajtimit të barabartë, jo diskriminues sidomos për etnitë, grupet dhe familjet në nevojë apo varfëri ekstreme. Proçedurat kanë të bëjnë me lëshimin e dokumentacionit të kërkuar për statusin e përfitimit të ndihmës ekonomike nga skemat e tyre të shërbimit, identifikimin e përfituesve të ndihmës dhe bërjen efektive të këtyre përfitimeve.

Strukturat dhe institucionet në nivel njësie vendore

Në nivel vendor janë vendosur institucionet si Shkollat, Zyrat e gjëndjes civile si dhe Seksionet pranë bashkive të cilët konfirmojnë për të gjithë personat aplikues për përfitimin e ndihmës ekonomike (emër, atësi, mbiemër) nëse rezultojnë që: - të tregtojnë në tregje të lira; - të zotërojnë leje ndërtimi apo ndërtojnë pa leje; - të zotërojnë leje për transport mallërash, transport udhëtarësh dhe leje për tregti ambulante; - të merren me shpërndarjen e shtypit periodik apo të merren me tregtimin e lëndëve djegëse.

Këshilli i Qarkut

Janë 12 Këshillat e Qarqeve të shtrirë në të gjithë Republikën e Shqipërisë, të cilët kanë luajtur një rol të rëndësishëm mbështetës dhe bashkëpunues gjatë viteve të zbatimit të reformës së ndihmës ekonomike, midis strukturave ekzekutive në nivel rajonal dhe vendor.

Prefekti

Bazuar në *ligjin nr. 57 të vitit 2019 “Për asistencën sociale në Republikën e Shqipërisë”*, Këshilli Bashkiak miraton vendimin mbi kriteret për fondin shtesë 6%. Ky fond të cilin e kemi sqaruar edhe në kapitujt paraardhës, është parashikur si një mundësi

e dytë për familjet e refuzuara nga skema për arsye se nuk kanë marrë pikët e mjaftueshme. Lista miratohet nga Këshilli Bashkiak për këto familje çdo muaj.⁵¹ Janë pikërisht këto vendime të cilat kalojnë për konfirmim në prefekturë e më pas përcillen pranë drejtorisë rajonale të SHSSH-së.

Bashkia

Bashkia është një ndër hallkat më të rëndësishme në sistemin e menaxhimit administrativ të ndihmës. Si instanca më e lartë vendore, Bashkia ka përgjegjësi ligjore direkte jo vetëm në sektorin e ndihmës por duke shkuar më tej dhe në fushën sociale që ajo mbulon.

Dy janë nivelet e kompetencave të bashkive në fushën sociale:

1. Në drejtim të administrimit të skemës së NE-së në nivel vendor përmes njësive të saj administrative.
2. Në drejtim të vlerësimit të nevojave në fushën e mbështetjes sociale përtej ndihmës për këto familje apo individë.

Konkretisht sipas legjislacionit në fuqi, njësitë administrative kanë në përgjegjësinë e tyre direkte identifikimin e këtyre nevojave dhe ndjekjen e tyre deri në përfitim real të pagesave si dhe të shërbimeve të tjera mbështetëse për kategoritë subjekt i përfitimit nga ligji.

⁵¹Me ligjin e mëparshëm nr. 9355/2005 Këshilli Bashkiak kishte të drejtë dhe detyrë marrjen e vendimit që familja/individët në nevojë të trajtoheshin me ndihmë ekonomike dhe parashikonte *masën përkatëse të përfitimit*.

Pranë çdo njësie administrative të qeverisjes vendore janë ngritur strukturat e ndihmës dhe përkujdesit social. Këto struktura janë si vijon:

- Administratori Shoqëror

I cili pret, shqyrton dhe me pas proçedon për përfitimin e NE-së për familjet dhe individët të cilët kanë bërë kërkesë. Konkretisht, qëllimi i punës të administratorëve shoqërorë është:

- Administrimi, zbatimi dhe kontrolli i NE-së për individët/grupet në nevojë.
- Identifikimi, vlerësimi dhe referimi i individëve dhe familjeve në nevojë tek shërbimet shoqërore.
- Koordinimi i punës dhe ofrimi i mbështetjes së nevojshme për parandalimin e varfërisë dhe përjashtimit shoqëror për individët/familjet në nevojë, duke mundësuar ndërhyrje efektive në kohë reale sipas rastit, me qëllim rritjen e cilësisë së jetesës së tyre.
- Përgatitja, përcjellja dhe bashkëpunimi në kryerjen e detyrave funksionale që lidhen me proçedurat e rregullta të mirëpërcaktuara në ligj si dhe nga urdhëresat e marra nga instancat eprorë.

Numri i administratorëve shoqëror në këtë sektor në nivel Republike aktualisht është 504 persona. Kujtojmë që nuk ka patur dhe vijon të mos ketë standarde në emërimin dhe shkarkimin e punonjësve të sektorit të përkujdesit social. Për këtë arsye, ndër vite është vënë re dhe vazhdon, një ndryshim i shpeshtë i administratorëve, si rrjedhojë e shkarkimit të tyre pa shkak të vlefshëm nga eprori, duke përbërë një problem të

rëndësishëm në lidhje me kohën që duhet vënë në dispozicion për aftësimin e personelit të sapo emëruar, me instrumentet e reja të skemës së NE-së.

- Administratori i Njesisë Administrative

Titullari i Njesisë Administrative i cili dikur njihej si kryetari i Komunës me ndryshimet e bëra në legjislacionin për qeverisjen vendore, sot emërtohet si Administratori i Njesisë Administrative. Në rolin e titullarit të Institucionit ai firmos shkresat zyrtare që lidhen me procedurat e NE-së, si dhe njoftimet me shkrim të ankesave që bëjnë individët.

Administratori i Njesisë Administrative, lëshon vërtetime për ndihmën ekonomike të kërkuara nga qytetarët, *duke përcaktuar masën e përfitimit dhe periudhën e trajtimit.*

- *Struktura përgjegjëse për shërbimet sociale në bashki*

Bashkia është institucioni i cili merr masa për shpërndarjen një herë në muaj të pagesave të NE-së nëpërmjet shërbimit bankar dhe/ose shërbimit postar, bazuar në vendimin e Drejtorisë Rajonale të Shërbimit Social Shtetëror. Nga ana e strukturave bashkiake ndiqen hapat e nevojshëm procedural dhe administrativ deri sa pagesa të mbërrijë tek përfituesi. Kompetente për këto procedura që lidhen me ekzekutimin final të pagesave është zyra ose drejtoria apo sektori i financës.

Struktura përgjegjëse për shërbimet sociale në bashki merr emërtime të ndryshme. Në bazë të organikës së Bashkive diku cilësohen si Drejtori dhe diku tjetër si Sektorë, dhe përkatësisht pozicionet kyçe janë: Drejtor i Drejtorisë ose Përgjegjës Sektori.

Ligji përcakton se në përgjegjësinë e kësaj strukture është dërgimi, në formë shkresore dhe elektronike, përmes sistemit të ndihmës, i të dhënave të sakta për subjektet përfitues

që normalisht janë në territorin e saj, pranë Drejtorisë Rajonale përkatëse të ShSSH-së e cila është kompetente në nivel Qarku. Kjo procedurë duhet të mbyllet brenda datës 15 të çdo muaji, sipas formateve përkatëse. Duke qenë se procedura finale bëhet përmes sistemit, personi i cili ka llogari në sistemin elektronik të NE-së është përgjegjësi/drejtori i sektorit për shërbimet sociale pranë bashkisë. Ai përmes sistemit gjeneron listën e aplikantëve, e cila kalon përmes sistemit pranë Drejtorisë Rajonale të ShSSH-së.

Një ndër detyrat e rëndësishme është edhe hartimi në kohë i kërkesës për fonde për NE-në për vitin në vijim, e cila duhet të bëhet pikërisht nga kjo strukturë. Bazuar në informacionet dhe statistikën e ardhura nga Njësitë Administrative, përgjegjësi i sektorit të strukturës përkatëse në Bashki, përpunon statistikën, i dokumenton ato përmes formateve standarte, dhe më pas i përcjell në instancat përkatëse rajonale të Shërbimit Social.

Rol kyç i kësaj strukture është monitorimi i vazhduar i punës së administratorëve shoqërorë, me qëllim zbatimin korrekt të ligjit duke bashkëpunuar edhe me Drejtorinë Rajonale të SHSSH-së.

Në lidhje me fondin e kushtëzuar, kjo instancë në bashki harton projek-vendimin për familjet në nevojë, në bazë të propozimeve dhe të vlerësimeve social-ekonomike të ardhura nga administratori shoqëror, për trajtim me ndihmë nga fondi shtesë 6%. Është kjo strukturë e cila përllogarit këtë fond për të gjitha njësitë vendore të bashkisë duke e dërguar më pas për miratim në këshillin bashkiak.

Dikur kuadri ligjor, nuk mbulonte përgjegjësinë e sektorëve të ndihmës për trajtimin e rasteve në rrezik dhune. Kjo vinte për shkak të kapaciteve të kufizuara në burime njerëzore, ndaj dhe vëmendja dhe fokusi vihej më shumë në fushën e ndihmës.

Me përmirësimet e legjislationit, sot këta punonjës që menaxhojnë çështje të dhunës, abuzimit apo keqtrajtimit, nuk janë më administratorët shoqërorë por punonjësit socialë, në rolin e specialistëve të Njesisë për Mbrotjtjen e Fëmijëve (NjMF-ve), të moshës së tretë, të personave me aftësi të kufizuara, të barazisë gjinore dhe të dhunës në familje. Koncretisht, ligji nr. 10329, datë 30.9.2010 “Për Masa Ndaj Dhunës në Marrëdhëniet Familjare”, vuri si synim që të rriste kapacitetet. Gjithashtu ndërmori një sërë masash të reja duke i kushtuar më shumë vëmendje këtyre kategorive të rriskuar nga dhuna, sidomos për vajzat, nënat dhe fëmijët, si dhe për çdo subjekt të këtij ligji, që paraqet nevoja të veçanta mbrojtjeje. (Haxhiu, fq. 4: 2020).

Është VKM nr. 334 e vitit 2011 ajo e cila parashikon ngritjen e Mekanizmit të Bashkërendimit të punës për referimin e rasteve të dhunës në familje i cili përbëhet nga Komitetet drejtuese për bashkërendimin e veprimtarisë së institucioneve të autoriteteve përgjegjëse, në nivel vendor, dhe referimin e rasteve të dhunës në familje, të cilët funksionojnë pranë çdo bashkie. Këto janë komitete koordinues ad-hoc⁵², që çdo tre muaj, i raportojnë Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale me raport propozime. Ky mekanizëm përbëhet gjithashtu dhe nga Ekipet teknike ndërdisiplinore si dhe Koordinatorët vendorë për referimin e rasteve të dhunës në marrëdhëniet familjare.

⁵² Grupe/komitete koordinuese të ngritura për një qëllim të caktuar atëherë kur janë të nevojshme (të përkohshme).

- Struktura e financës pranë Bashkisë

Kjo strukturë merret me procedurat financiare të menaxhimit të fondeve të transferuara nga Ministria përgjegjëse për Çështjet Sociale.

- Kryetari i Bashkisë

Kujtojmë që, siç e kemi përmendur dhe në kapitullin tre, në VKM-në nr. 597, datë 4.9.2019 “Për përcaktimin e procedurave, të dokumentacionit dhe të masës mujore të përfitimit të NE-së dhe përdorimit të fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike”, në pikën 8 të saj përcaktohet se Drejtoria Rajonale e SHSSH-së i dërgon kryetarit të bashkisë vendimin final të marrë nga ana e saj për Ndhmën Ekonomike. Është kompetencë dhe përgjegjësi e tij më pas që të marrë masa përmes strukturave vartëse, për të njoftuar kërkuesit për përfitimin e NE-së si dhe për të kryer veprimet financiare për pagesën për përfituesit e ndihmës.

5.2. Etika e administratorit shoqëror

Në përfitim të të gjitha ndryshimeve të mësipërme ky punim, do të reflektojë edhe parimet më të larta të etikës, e cila duhet të jetë pjesë aktive e punës reale të administratorit shoqëror. Kjo etikë e karakterizon figurën e administratorit shoqëror në çdo hap të punës së tij me të varfërit, personat me probleme shëndetësore, verifikimet në familje dhe njëkohësisht përballjen e tij me çdo person “hallexhi” i cili kërkon ndihmë pranë strukturave territoriale apo “zyrave të shtetit”.

Në kuptimin e përgjithshëm, etika është tërësia e detyrimeve dhe përgjegjësisë morale që janë të pranuar nga një shoqëri ose një grup shoqëror i caktuar. Me etikë kuptohet

gjithashtu, studimi i sjelljes humane jo vetëm për të gjetur të vërtetën e gjërave ashtu siç është, por edhe për të zbuluar vlerën e mirësisë të veprimeve njerëzore.

Etika përfshin rregulla ose standarte të sjelljes ose të praktikës të së drejtës, veçanërisht standartet e profesionit. Rregullat dhe kufizimet etike paraqiten në kode etike të cilat pranohen dhe zbatohen nga anëtarët e grupeve të caktuara të shoqërisë.

Elementet e Etikës

Në etikën personale apo publike e cila pasqyrohet edhe në jetën tonë shoqërore ka elemente të cilat formojnë parimet bazë mbi të cilat kryhet një sjellje apo mënyrë veprimi me etikë. Konkretisht këto elemente janë si vijon:

- a. Besueshmëria;*
- b. Respekti;*
- c. Përgjegjësia;*
- d. Përkujdesi;*
- e. Ndershmëria/Paanshmëria;*
- f. Virtyti qytetar.*

Parimet etike janë një pjesë e rëndësishme e praktikës profesionale të administratorit shoqëror. Aftësia e tyre dhe përmbushja e akteve etike, janë një aspekt thelbësor i cilësisë së ofrimit të ndihmës ekonomike. Disa aspekte etike dhe probleme të punës janë specifike në disa njësi administrative dhe të njëjta në disa të tjera.

Parimet e etikës

Në vijim vijnë në analizë parimet e etikës:

Të drejtat humane dhe dinjiteti human

Puna sociale është e bazuar në respektin për vlerat e lindura dhe dinjitetin e njerëzve, si dhe mbi të drejtat që rrjedhin prej tyre. Administratori shoqëror mbështet dhe mbron integritetin, mirëqënien fizike, psikologjike, emocionale dhe shpirtërore të çdo njeriu. Kjo do të thotë:

1. Respektimi i të drejtave të vetvendosjes. Administratori shoqëror respekton dhe promovon të drejtat e njeriut duke i lejuar të bëjnë vetë zgjedhjet e tyre dhe të marrin vetë vendimet e tyre, pavarësisht nga vlerat dhe zgjedhjet e jetës, duke siguruar kështu moskërcënimin e të drejtave dhe interesave ligjore të të tjerëve.
2. Promovimi i të drejtës për të marrë pjesë. Administratori shoqëror promovon përfshirjen e plotë dhe pjesëmarrjen e njerëzve duke i bërë ata më aktiv në të tëra aspektet e vendimarrjes në jetën e tyre.
3. Trajtimi i çdo individ si një të tërë. Administratori shoqëror përqendrohet tek individ si një qenie e tërë me familjen, komunitetin, mjedisin social dhe fizik duke u munduar të organizojë të tëra aspektet e jetës së personit.
4. Identifikimi dhe zhvillimi i potencialit njerëzor. Administratori shoqëror përqendrohet tek potenciali njerëzor tek individ, grupet dhe komuniteti.

Drejtësia sociale

Drejtësia sociale nënkupton, trajtimin e barabartë të tërë përfituesve të ndihmës ekonomike dhe shërbimeve sociale që ofron administratori shoqëror. Administratori shoqëror ka përgjegjësinë për promovimin e drejtësisë shoqërore në mardhëniet në përgjithësi si dhe në mardhëniet me ata me të cilët punon.

Sfidimi i diskriminimit negativ

Administratori shoqëror ka përgjegjësinë për të sfiduar diskriminimin negativ të karakteristikave bazë si aftësitë, mosha, kultura, gjinia, statusi shoqëror, statusi social ekonomik, opinioni politik, ngjyra e lëkurës, karakteristika të tjera racore ose fizike, orientimi seksual apo besimi shpirtëror. Konkretisht, administratori shoqëror duhet të pranojë dhe respektojë diversitetin etnik dhe kulturor të shoqërisë në të cilën bën pjesë duke marrë parasysh dhe diferencat individuale, sociale dhe ato të komunitetit. Gjithashtu administratori shoqëror duhet të sigurojë që burimet të cilat ai disponon të ndahen në mënyrë të drejtë dhe të paanshme sipas nevojave, si dhe të sfidojë dëshmitë dhe praktikën e padrejta, duke u siguruar që punëtorët, politikbërësit, dhe situatat e përgjithshme publike ku burimet janë të papërshtatshme ose shpërndarja e burimeve, politikave dhe praktikave janë të padrejta, shtypëse dhe të dëmshme të jenë nën kontrollin e tij. Së fundi, administratori shoqëror duhet të jetë solidar sepse ka detyrimin të sfidojë kushtet sociale që ndikojnë në përjashtimin social, stigmatizimin dhe të punojë në drejtim të një shoqërie gjithë përfshirëse.

Sjellja profesionale

Administratori shoqëror duhet të veprojë në përputhje me kodin etik dhe me ligjet e vendit në të cilin ai punon. Kjo në përgjithësi përfshin më shumë detaje të praktikës etike në kontestin rajonal.⁵³ Konkretisht disa prej këtyre sjelljeve praktike janë fakti që, administratori shoqëror nuk duhet të lejojë që aftësitë e tij të përdoren për qëllime antinjerëzore si tortura apo terrorizmi, si dhe të mos abuzojë për përfitime personale në mardhëniet me njerëzit nevojtarë që përfitojnë nga shërbimi i tij, duke njohur kështu

⁵³ Kodi i Sjelljes, Bashkia Elbasan, miratuar në nëntor 2019.

ndryshimin midis jetës së tij personale dhe profesionale. Gjithashtu, administratori shoqëror duhet të ruajë në mënyrë kofidenciale informacionet që ka për personat që përdorin shërbimet e tij. Përrjashtohen rastet kur thyerja e kofidencialitetit bëhet për çështje të rëndësishme si vetëvrasja, fshehja e një krimi etj. Një prej këtyre sjelljeve praktike është dhe fakti që, administratori shoqëror duhet të dijë se është përgjegjës për veprimet e veta përpara personave që përdorin shërbimin e tij, përpara kolegëve, eprorit dhe para ligjit, si dhe kjo përgjegjësi mund ta vendosë atë përpara konflikteve.

Problematikat konkrete në etikën e administratorit shoqëror dhe qëndrimi i drejtë i tij

Pengesat për aksesin e publikut në shërbime:

Pengesat për aksesin e publikut në shërbime, janë rrjedhojë e vështirësive në artikulum dhe mungesës së njohurive që kanë aplikantët e ndihmës. Për më tepër, *pengesat psikologjike mund të krijohen nga fakti se procedurat e panjohura, të paarritshme, ndonjëherë padrejtësisht të komplikuar e bejnë një individ me nivel të kufizuar ekonomik, arsimor apo kulturor të tërhiqet.*

Aftësia e shtetasve për marrjen e informacionit pa shkuar në ndërtesën e administratorëve shoqëror është duke u përmirësuar, por ende është larg nga idealja. Ofrimi i mundësisë për komunikim në distancë të publikut ose sjellja e shërbimeve të ndihmës ekonomike tek publiku është shumë embrionale, sepse qëndrimi pozitiv që duhet të shoqërojë shkëmbimin e informacionit është ende i cekët.

Faktorët që ndikojnë në aksesin e publikut në shërbime:

Ajo se si administratori shoqëror i përgjigjet pyetjeve nga publiku mund të ketë ndikim të konsiderueshëm në administrimin e qeverisjes në përgjithësi dhe administrimit të skemës së NE-së në veçanti, duke ndikuar në përshtypjen që qytetarët krijojnë nga eksperiencia e tyre në përballjen me këto shërbime. Personeli që gjëndet në pozicione të kontaktit të drejtëpërdrejtë me klientët është i pari dhe ndonjëherë i vetmi kontakt që publiku ka me administruesit e sistemit të NE-së.

Ata duhet të formojnë një përshtypje afatgjatë dhe perceptimin rreth sistemit, nga kontakti i parë me punonjësin e administrimit të ndihmës ekonomike. Mënyra se si përgjigjet personeli, ndikon drejtëpërdrejt në aksesin e publikut në shërbime, sepse shumë njerëz nuk janë të familjarizuar me procedurat e aplikimit që kërkojnë një nivel të caktuar ndihme. Nëse dikush nuk di se si të përdorë këtë sistem dhe personeli nuk jep informacionin që ai ka nevojë, atëherë efektivisht aksesin mohohet.

Administratori shoqëror (personeli) gjatë ofrimit të shërbimit duhet që:

- Ta lehtësojë sa më shumë punën dhe të identifikojë nëse dikush është duke kërkuar vetëm informacion apo ndihmë ligjore:

Së pari, është e domosdoshme që administratori shoqëror të kuptojë se çfarë kërkojnë apo çfarë kanë nevojë njerëzit. Kjo nuk është aq e lehtë sa duket. Shumë njerëz nuk janë të familjarizuar me terminologjinë ligjore dhe kanë vështirësi në komunikimin efektiv për çështjet ligjore. Shumë shpesh ata mund ti japin administratorit shoqëror, shumë ose pak informacion ose përdorin terma ligjore ose joligjore, por jo të saktë për të përshkruar problemin e tyre. Në këto kushte, administratori shoqëror, duhet të vihet në

dispozicion dhe të bëjë pyetje për të qartësuar se cilat janë nevojat e personit (ndihmë administrative apo ndihmë ligjore). Dëgjimi i vëmëndshëm është gjithashtu i rëndësishëm sepse disa njerëz mund të përpiqen për të marrë informacionin që do t'i ndihmonte ata për të realizuar me sukses të drejtën e pretenduar.

Administratori shoqëror duhet të jetë i duruar sepse shumë njerëz nuk janë të familjarizuar me sistemin dhe, për këtë arsye, paraqitja për të përfituar shërbimin mund të jetë shumë stresuese, e paqartë, dhe mund t'i bëjë ata të ndjehen të ndrojtur. Është shumë e rëndësishme për administratorët shoqëror të kujtojnë që, edhe pse ata e kanë shpjeguar të njëjtën procedurë pesë herë gjatë orës së fundit, për personin që po ndihmojnë në një çast të dhënë nuk është e njëjta gjë. Nëse ata janë të paqartë dhe dikush u kushtoi kohë për t'u shpjeguar me kujdes se çfarë ndodh ata do ta vlerësonin shumë.

Ndodh shumë herë që publikut i thuhet se administratorët nuk mund të japin ndihmë ligjore dhe nuk shpjegohet arsyeja pse. Nëse personeli nuk mund të ofrojë informacionin e kërkuar, ata duhet të shpjegojnë arsyet se pse ata nuk mund të ofrojnë ndihmë ligjore. Të japësh arsyet, ndihmon ngritjen e mirëkuptimit të publikut për sistemin e qeverisjes në përgjithësi dhe për sistemin e ndihmës ekonomike në veçanti.

Shumë herë “ndihma ligjore” përdoret si një shfajësim për të mos dhënë shërbim. Kjo mund të ndodhë në një sërë situatash, si p.sh: kur administratori shoqëror keqtrajtohet (nga publiku); kur është i mbingarkuar; kur administratori shoqëror ka mbajtur një qëndrim negativ që ndikon në kryerjen e detyrës së tij ose nëse ai nuk e kupton se është përgjegjësia e tij për të ofruar informacion dhe akses.

Administratori shoqëror mund të përdorë “ndihmën ligjore” si një shfajësim për të mos ofruar shërbim kur ata kuptojnë se dikush kërkon ndihmë ligjore. Për shembull, shpesh fjala duhet eshte një tregues që dikush po kërkon ndihmë ligjore: “unë sapo mora një biçikletë. ç’farë duhet të bëj unë?”. Por, fjala duhet nuk do të thotë automatikisht se ata po kërkojnë ndihmë ligjore. Ata vetëm mund të duan të dinë se cilat janë opsionet e tyre, por ata nuk e kanë shprehur atë me korrektesë.

Së fundi, edhe nëse një person, shumë qartë, kërkon ndihmë ligjore, administratori shoqëror nuk duhet ta përdorë atë si një shfajësim për të mos dhënë shërbim. Zakonisht, ka një sasi informacioni që mund të ofrohet për t’i ndihmuar ata, si p.sh: shpjegimi i arsyeve se pse ata nuk mund të japin ndihmë ligjore; shpjegimi i mundësive të tyre proceduriale, ose referimi i tyre në organe të cilat mund ti ndihmojnë ata.

Është gjithnjë shumë e rëndësishme të kujtojmë se toni i zërit dhe gjuha e xhesteve, flasin me zë më të lartë se sa fjalët, dhe se ato kanë ndikim të madh në mënyrën se si njerëzit i përgjigjen përpjekjeve për të ofruar ndihmë.

Megjithatë shumë probleme nuk varen thjesht nga dëshira e mirë apo nga aktiviteti i administratorëve shoqëror por edhe nga kushtet në të cilat punojnë si edhe stimujt materialë dhe moralë që ata kanë gjatë punës së tyre.

- Qytetarët ti trajtojë si të barabartë në zbatimin e rregullave.

Fatkeqësisht, në praktikë ndodh që rregullat nuk zbatohen drejt dhe në mënyrë të barabartë për të gjithë. Trajtimi i drejtë dhe i barabartë rrit besimin dhe krijon tek qytetarët përshtypjen e drejtësisë. Kjo është mjaft e rëndësishme edhe gjatë punës së administratorëve shoqëror që është hapi i parë që bëjnë qytetarët për të kërkuar ndihmë

ekonomike apo shërbime të tjera. Ky shërbim nuk duhet të shihet si vend ku disa favorizohen dhe disa të tjerë jo. Qytetarët duhet të vijnë dhe të marrin shërbimin e kërkuar duke gjykuar se rasti i tij u trajtua si cdo rast tjetër i ngjashëm me të. Kuptohet, në rastin e personave të paaftë mund të bëhen edhe favorizime të njëfarë lloji, por që nuk çënon parimin e barazisë dhe të drejtësisë në trajtimin ligjor.

- Të punojë në një mjedis pune të përshtatshëm.

Kjo do të thotë që çdo administrator shoqëror duhet të ndihet përgjegjës për mbikqyrjen e mjedisit të tij të punës si dhe për ndërmarrjen e hapave për ta mbajtur këtë mjedis sa më efikas.

- Ta kryej aplikimin brënda një kohe të arsyeshme.

Aplikimi duhet të behet sa më shpejtë të jetë e mundur, pa shkelur parimet e një shërbimi efektiv dhe të saktë.

- Maksimumi i mundshëm duhet të bëhet nga ana e administratorit shoqëror për zgjidhjen e problemeve të qytetarëve.
- Informacioni duhet të jetë i saktë dhe i plotë.

Është e rëndësishme që, informacioni që u ofrohet qytetarëve për kërkesat e tyre nga administratori shoqëror të jetë i saktë dhe i plotë në të njëjtën kohë, ndryshe qytetarët do të kthehen aty disa herë gjë që do ti irritonte ata, por në të njëjtën kohë do të rriste edhe punën e personelit. Është më mirë që qytetari të lihet të presë për pak kohë dhe në fund ti jepet një informacion apo përgjigje e saktë dhe e plotë sesa t'i jepet një përgjigje e shpejtë por e pastudiuar.

Është e rëndësishme që puna të kryhet shpejt, por asnjëherë në dëm të saktësisë apo qartësisë së informacionit të dhënë. Për këtë arsye është më mirë që qytetari të vijë një ditë tjetër për të marrë informacion të saktë dhe të plotë sesa të largohet nga aty me një përgjigje të gabuar ose të paqartë.

- Të jetë i kuptueshëm.

Personat që kanë të bëjnë me sistemet e ndihmës ekonomike dhe e njohin terminologjinë e tyre e kuptojnë pa problem gjuhën që flitet në këto shërbime. Sidoqoftë, për publikun e gjerë, shpeshherë gjuha që përdoret në këto zyra është e pakuptueshme dhe e koklavitur. Shumë shpesh një term nuk kuptohet qartë, ose nuk dëgjohet me vëmendje dhe ai më pas keq interpretohet. Administratori shoqëror, kuptohet brënda mundësive që i jep problemi konkret që po trajtohet, duhet të flasë dhe të shkruajë në atë mënyrë që një person i zakonshëm ti kuptojë.⁵⁴

- Të respektojë çdo qytetar.

Qytetarët që paraqiten në zyrat e ndihmës ekonomike, në të shumtën e rasteve janë me probleme të shumta ekonomike. Kjo i bën ata më të ndjeshëm dhe më emocionalë ndaj faktorëve të jashtëm. Njëkohësisht ata mund të mos kenë njohuri ligjore. Prandaj, është mirë që kur ata paraqiten për të kërkuar shërbim, të trajtohen me mirësjellje dhe durim. Mirësjellja shfaqet si nga mënyra se si i drejtohem, si i flasim, si veprojmë dhe si reagojmë ndaj kërkesave apo pyetjeve të tyre. Administratorët shoqëror duhet që ti dëgjojnë me vëmendje dhe durim kërkesat e tyre. Të përpiqen sa më shumë ti përgjigjen

⁵⁴ “Kodi Etik, Bashkia Belsh,” miratuar në vitin 2015 (i rishikuar).

nevojave të tyre me sinqeriet dhe dashamirësi. Të përqëndrohen me ta derisa të zgjidhin problemet e tyre (në rast se munden). Në rast se qytetari do t'i shikojë përpjekjet e sinqerta të administratorit shoqëror, ai do ta mirëkuptojë edhe në rast se ai nuk e zgjidhi dot problemin e tij.

Mosnjohja e ligjeve dhe e mënyrës së funksionimit të procedurave të përfitimit të ndihmës ekonomike, i bën njerëzit të mos jenë shumë të qartë në atë që kërkojnë. Në shumicën e rasteve, shpesh do t'ju duhet punonjësve të këtyre zyrave që ti sugjerojnë qytetarëve se ku duhet të shkojnë dhe se çfarë duhet të bëjnë. Duhet patur parasysh, që qytetarët duhet të këshillohen me mirësjellje dhe në mënyrë të dobishme, që të mos humbasin kohë.

Nga të gjitha këto që u thanë më lart, duhet që shërbimi i NE-së dhe shërbimeve sociale të ofrohet në mënyrë të barabartë, me saktësi, mirësjellje dhe durim. Jemi të gjithë të ndërgjegjshëm që askush nuk do ti zvarrisë punët e tij. Ajo që duhet të bëhet është që administratorët social të ndërgjegjësojnë vetveten dhe më pas në mënyrë graduale edhe qytetarët se parimet e përshkruara më lart duhen respektuar dhe po respektohen. Kjo do të rrisë besimin e qytetarëve tek qeverisja në përgjithësi dhe tek shërbimi i ndihmës ekonomike në veçanti për një shërbim të drejtë dhe të barabartë.

Kapitulli VI: Analiza e akteve ndërkombëtare që rregullojnë të drejtën e ndihmës ekonomike

Në mbrojtjen e të drejtave të njeriut në plan të parë vjen legjislacioni i brendshëm i çdo shteti, dhe më pas janë normat me natyrë ndërkombëtare ato të cilat ndikojnë në normat juridike shtetërore. Normat e të drejtës ndërkombëtare janë ato tërësi rregullash të natyrës ndërkombëtare të cilat janë të sistemuara në akte në formën e pakteve, traktateve, konventave, të nënshkruara rregullisht mes shteteve të njohura ndërkombëtarisht. Shtetet mund të bëhen pjesë e një akti ndërkombëtar përmes ratifikimit ose aderimit. Mjeti juridik që i mundëson një shteti aderimin/pjesëmarrjen në një Akt Ndërkombëtar quhet instrument i ratifikimit ose aderimit. Pjesë e analizës në vijim janë ato akte ndërkombëtare⁵⁵ të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, duke u bërë kështu pjesë e legjislacionit tonë të brendshëm, të cilat në fushën e tyre të zbatimit lidhen direkt apo dhe tërthorazi me tematikën e asistencës sociale dhe më konkretisht me Ndihmën Ekonomike.

Neni 116 i Kushtetutës tonë përcakton se *marrëveshjet ndërkombëtare të ratifikuara kanë fuqi në të gjithë territorin e vendit*, në rend të dytë pas Kushtetutës. Është pikërisht Kushtetuta jonë, akti më i lartë juridik, e cila saksionon se *një marrëveshje ndërkombëtare e ratifikuar me ligj ka epërsi mbi ligjet e vendit që nuk pajtohen me të*, (neni 122).

Kushtetuta jonë në nenin 122 të saj përcakton se një marrëveshjeje ndërkombëtare i jepet fuqi në sistemin tonë të brendshëm ligjor pas ratifikimit me botimin në Fletoren

⁵⁵Termi AKT përdoret për marrëveshje shumë-palëshe, të lidhura në kongrese apo konferenca ndërkombëtare përmes subjekteve të së drejtës ndërkombëtare. (Gruda, f. 4: 2003).

Zyrtare të Republikës së Shqipërisë. Zbatimi mund të jetë: i drejtpërdrejtë (nëse është e vetëzbatueshme), ose përmes një ligji.

6.1. Aktet Ndërkombëtare të Kombeve të Bashkuara

Shqipëria është pranuar në OKB në 14 dhjetor të vitit 1955. Shqipëria gjatë ecures së saj në këtë organizatë ka shfaqur dhe përcjellë interes në tematika të stabilitetit ndër-rajonal. Në drejtim të promovimit të të drejtave të njeriut, ky interes është shtrirë në fushat social-ekonomike, në ato të arsim-kulturës, në shëndetësi dhe më gjerë.

Aktet Ndërkombëtare të Kombeve të Bashkuara të cilat në mënyrë direkte ose tërthorazi lidhen me të drejtën e ndihmës ekonomike janë si vijon:

Karta e Kombeve të Bashkuara

Është akt juridik i *Organizatës së Kombeve të Bashkuara (OKB)*, i cili e ka filluar veprimtarinë e tij që në vitin 1945, me qëllim forcimin e bashkëpunimit në fushën ekonomike, të sigurisë dhe ruajtjes së paqes midis kombeve. OKB vjen tashmë si një zgjerim i asaj që dikur njihej si Lidhja e Kombeve.

Kjo Kartë është miratuar dhe ka marrë fuqi juridike në po të njëjtin vit 1945. 26 qershori i këtij viti është shpallur edhe si Dita Ndërkombëtare e OKB-së. Duke qenë se Republika e Shqipërisë është pjesë e OKB, rrjedhimisht kjo Kartë është pjesë e legjislacionit tonë të zbatueshëm.

Në nenin 5 të Kartës së OKB-së vihet theksi në zhvillimin e një fryme bashkëpunuese midis shteteve në fushat social-ekonomike kryesisht, duke theksuar se për të arritur progres në këto drejtime duhet të respektohet miqësia ndërshtetërore në funksion të ruajtjes së harmonisë midis kombeve, bazuar në parimin e të qënurit të barabartë.

Bazuar në këtë nen shtetet anëtare duhet që: - të mbështesin përpjekjet për një jetesë më të mirë dhe zhvillim social-ekonomik; - të inkurajojnë frymën e bashkëpunimit duke shmangur konfliktet midis tyre; - të nxisin komunikimin për shkëmbim kulturash dhe në drejtim të edukimit të brezave, duke i kushtuar rëndësinë e duhur procesit arsimor; - të respektojnë të drejtat e gjithësecilit pa asnjë diskriminim të çfarëdolloj natyre.

Sikurse do të analizohet në vijim të këtij punimi, vendi ynë ka synuar reformimin dhe zhvillimin në fushën e Ndihmës Ekonomike, në përmbushje edhe të detyrimeve që rrjedhin nga zbatimi i kësaj Karte.

Deklarata Universale për të Drejtat e Njeriut

Sikurse u përmend dhe më lart, meqenëse vendi ynë ka aderuar si vend anëtar i OKB-së, si rrjedhojë njëj dhe zbaton edhe *DUDNJ-në* të vitit 1948.

Në nenin 22 të kësaj Deklarate sanksionohet ndër të tjera siguria në fushat social-ekonomike, deri në zhvillimin në fushën e kulturës, duke vlerësuar se këto janë në funksion të respektimit të të drejtave bazë të njeriut. Në themel të këtyre të drejtave qëndron ruajtja e dinjitetit njerëzor, dhe si rrjedhojë çdo shtet anëtar ka detyrimin që brenda mundësive të tij të ndër marrë masat e duhura në respektimin e tyre.

Nga sa më sipër shteti Shqiptar, falë dhe bashkëpunimit ndërkombëtar por dhe duke mbajtur parasysh burimet e tij, hap pas hapi ka ndër marrë reforma në drejtim të sigurisë sociale, me synim respektimin e të drejtave të fushës ekonomike të shtetasve, një ndër të cilat është dhe e drejta për përfitim nga Skema e Ndihmës Ekonomike.

Konventa për të Drejtat e Fëmijës

Është akt juridik i OKB-së të cilin Shqipëria e ka ratifikuar me anë të *ligjit nr. 7531, datë 11.12.1991 “Për Ratifikimin e Konventës për të Drejtat e Fëmijës”*.

Qëllimi i këtij akti parashikon parimet bazë të mbrojtjes së të drejtave bazike të njeriut si dhe të dinjitetit njerëzor për jetesë më të mirë.

Përmes kësaj Konvente shprehet bindja në respektimin e familjes dhe përmes saj të shoqërisë. Rëndësi i kushtohet në veçanti dhe fëmijëve, duke i ofruar këtyre të fundit mbrojtjen e nevojshme me qëllim dhënien e rolit të duhur në shoqëri.

Në analizën në vijim është pasqyrimi në legjislacionin tonë të brendshëm i rregullimit ligjor për familjen kujdestare. Sikurse e kemi sjellë në analizë në kapitullin e tretë të këtij punimi, fëmijët e vendosur në familje kujdestare janë një nga kategoritë përfituese nga Skema e NE-së. Kjo Konventë sanksionon në nenin 3 të saj se shtetet duhet të mbajnë gjithmonë në konsideratë *interesin më të lartë të fëmijës* në të gjithë veprimtarinë juridike dhe administrative nga ana e instancave publike apo private që operojnë për këto interesa.

Neni 20 pika 2 e kësaj Konvente vijon më tej duke përcaktuar se një fëmije duhet t'i ofrohet mbrojtje e posaçme nga shteti, deri në përkujdesje alternative, nëse i është mohuar mjedisi familjar, ose nëse interesi më i lartë i tij kushtëzon të qëndruarit në familjen përkatëse.

Duke mbajtur parasysh këtë detyrim ligjor për shtetet palë, shteti Shqiptar ka marrë përsipër të sigurojë për fëmijën të cilit i është mohuar përkohësisht mjedisi familjar (ose

që gjendet në pamundësi të përkohshme për të përfituar nga mjedisi i tij familjar), përkujdesje alternative duke e vendosur në familje kujdestare.

Është pikërisht ligji nr. 57/2019 për ndihmën ekonomike, i cili ka normuar të drejtën për të përfituar nga skema e NE-së si kategori e veçantë edhe për fëmijët e vendosur në familje kujdestare (njohur ndryshe si familje alternative).

Legjislacioni ynë i brendshëm pasqyron gjithashtu edhe parashikimet e *nenit 26 të Konventës për të Drejtat e Fëmijëve*, në të cilin përcaktohet se fëmijët kanë të drejtën të përfitojnë nga programet e përkrahjes sociale. Për këtë shtetet duhet të marrin masat e duhura që të përshtasin në legjislacionin e tyre të brendshëm respektimin e klauzolës për sigurim social.

Analiza jonë vijon më tej duke konkluduar për sa më sipër se, dhe në drejtim të së drejtës së njohur nga ligji për të përfituar NE, legjislacioni ynë vlerëson se në konsideratë duhet të mbahen të ardhurat financiare, kushtet në të cilat ndodhet fëmija por dhe personat që e kanë atë nën përgjegjësi (familja), duke i njohur çdo fëmije të familjeve në nevojë, mundësinë për të përfituar nga mbrojtja sociale më tepër siguri financiare, dhe jo vetëm, përmes skemës së NE-së.

Pakti Ndërkombëtar për të Drejtat Ekonomike, Shoqërore dhe Kulturore

Ky Pakt është gjithashtu akt juridik i OKB-së miratuar në dhjetor 1966. Shqipëria e ka nënshkruar në datë 4 tetor të vitit 1991.

Përmes këtij pakti shtetet palë janë angazhuar në disa fusha ndër të cilat edhe në fushën e ndihmës ekonomike dhe atë sociale, duke synuar standard më të lartë dhe më të sigurt jetese për shtetasit.

Shtetet zotohen që të veprojnë duke shfrytëzuar maksimalisht burimet e tyre, *me qëllim sigurimin* e të drejtave të njohura në këtë Pakt, veçanërisht në drejtim të marrjes së masave legislative.

Shtetet angazhohen të garantojnë të drejtat e sanksionuara në këtë Pakt, me qëllim që këto të drejta të mund të jenë të zbatueshme në respektim edhe të parimit të mosdiskriminimit të çfarëdolloj natyre. Shtetet mund të vendosin kufizime për gëzimin e këtyre të drejtave. Këto kufizime duhet të jenë shprehimisht të rregulluara me ligj. Qëllimi mbetet siguri i mirëqënies së shoqërisë, në një hapësisë demokratike të funksionimit të saj.

Ndër të drejtat ekonomike të rregulluara nga ky Pakt janë e drejta për punësim (duke përfshirë jo thjesht mundësitë për punësim, por duke shkuar më tej në kushte të favorshme pune, të drejtat sindikale, të drejtën për grevë), e drejta për mbrojtje shëndetësore, etj.

Përmes këtij Pakti vihet theksi në respektimin e të drejtave bazike të individit si pjesë e shoqërisë. Për këto drejta të cilat njihen tashmë botërisht çdo shtet ka ngritur sistemin e tij të mbrojtjes sa më efektiv për to. Përkundrejt këtyre të drejtave nuk mund dhe nuk duhet të tolerohet asnjë shkelje.

Neni 9 i këtij akti i referohet çështjeve të sigurisë sociale, duke përcaktuar se secili shtet nënshkrues ka detyrimin ligjor ndërkombëtar të respektojë të drejtat për *siguri shoqërore* të gjithësecilit shtetas.

Neni 11 vijon më tej duke përcaktuar të drejtën për standard të përshtatshëm jetese, duke nënkuptuar të drejtën për ushqim, për t'u veshur, për strehim dhe në përgjithësi për

kushte më të mira jetese, të cilat duhet të jenë në përmirësim të vazhduar. Bazuar në sa më sipër shtetet detyrohen të marrin masat e duhura dhe sa më të përshtatshme me qëllim realizimin e këtyre të drejtave.

Në përmbajtje për sa më sipër, shteti Shqiptar njeh të drejtën e secilit nënshtetas Shqiptar për përmirësim të vazhueshëm të kushteve të jetesës, duke i dhënë mundësinë familjeve me të ardhura të pamjaftueshme të bëhen pjesë e Skemës së NE-së dhe duke vijuar më tej në programin e daljes graduale nga kjo Skemë përmes riintegrit në tregun e punë, sikurse e kemi analizuar edhe në kapitullin e katërt të këtij punimi. Riintegrimi drejt tregut të punës para së gjithash nënkupton më tepër siguri social-ekonomike për përfituesit e NE-së në perspektivën afatgjatë, duke shkëputur varësinë nga skemat pasive të mbrojtjes sociale, ndaj dhe NE mund të konsiderohet si një etapë kalimtare drejt një standardi më të mirë jetese.

6.2. Aktet ndërkombëtare të nivelit Europian

Në këtë pjesë të punimit trajtohen Aktet Ndërkombëtare të nivelit Europian të cilat janë të zbatueshme në sistemin tonë ligjor, si vijon:

Konventa Europiane për të Drejtat e Njeriut

Konventa Europiane për të Drejtat e Njeriut është akt juridik i Këshillit të Europës. Kjo Konventë është nënshkruar në Romë më 04.11.1950. Duke qenë akt juridik i KiE zbatimi i KEDNJ monitorohet nga ky Këshill i cili vepron përmes organeve të tij eksperte, duke matur progresin e bërë nga secili shtet anëtar në zbatim të saj.

KEDNJ është ratifikuar nga Shqipëria me ligjin nr. 8137 datë 31.7.1996. “Për Ratifikimin e Konventës Europiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore”.

Shqipëria është anëtarësuar në (KiE) në 13 korrik 1995. Pasi është pranuar në këtë Këshill, në Shqipëri është krijuar një prani e KiE-së me përfaqësues të zgjedhur nga Sekretari i Përgjithshëm i këtij Këshilli. Më tej është krijuar edhe Zyra e Informacionit e Këshillit të Evropës (IOCE).

Kushtetuta jonë në nenin 17 të saj përcakton se thelbi i lirive dhe të drejtave të njeriut nuk mund të tejkalohet kufizimet e parashikuara në KEDNJ.

Si rrjedhojë KEDNJ zë një vend të veçantë në Kushtetutën tonë, në raport jo vetëm me aktet e tjera ndërkombëtare, por në raport edhe me vetë Kushtetutën. Edhe pse Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë është hartuar kronologjikisht pas marrjes fuqi të kësaj Konvente në Shqipëri, vetë Kushtetuta e ka bërë të zbatueshme automatikisht duke i dhënë një rëndësi të veçantë zbatimit të saj.

Këtu duket sikur Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë çiftëzohet me Konventën Europiane, me këtë akt ndërkombëtar të drejtave të Njeriut, e cila merr fuqi kushtetuese në Republikën e Shqipërisë vetëm përsa i përket çështjes së kufizimit të drejtave dhe lirive themelore. (Omari, Anastasi, fq. 115: 2010).

KEDNJ përcakton parimin e mosdiskriminimit. Në nenin 14 të saj por dhe në nenin 1 të Protokollit nr. 12, sanksionon parimin e mosdiskriminimit bazuar në seks, racë, ngjyrë, gjuhë, fe, bindje politike, origjinë kombëtare apo shoqërore, përkatësi kombëtare, pasuri ose çdo situatë tjetër.

Për sa më sipër, në vijim të analizës sonë, në lidhje me tematikën e Ndhmës Ekonomike, mund të konkludojmë se: në legjislacionin në fuqi por dhe në atë të mëparshëm, parimi i mosdiskriminimit qëndron në thelb të funksionimit të Skemës së NE-së, dhe jo vetëm. Ky parim herë pas here i është nënshtruar rishikimeve si nevojë e kërkesës për reformim, duke patur parasysh këtu reformat e ndërmarra në kuadër të Skemës së NE-së, analizuar në Kapitullin tre dhe katër të këtij punimi.

Qëllimi i ligjit nr. 57/2019 për NE-në është ndër të tjera dhe: - dhënia e ndihmës për të plotësuar nevojat jetike (për një periudhë kalimtare); - më tepër mundësi për zhvillim personal dhe integrim social drejt një perspektive riintegruese në tregun e punës.

Ndër parimet e tjera të sanksionuara në këtë ligj përveç mosdiskriminimit janë ato të respektimit të drejtave të njeriut dhe integritetit të përfituesit, të cilat janë sjellë në një analizë më të hollësishme në kapitullin e dytë të këtij punimi.

Konventa Europiane “Mbi ushtrimin e të drejtave të fëmijëve”

Ky akt është i nivelit europian, pasi është nxjerrë për zbatim nga KiE, në vitin 1996. Nga ana e vendit tonë kjo Konventë është ratifikuar me ligjin nr. 10 425, datë 2.6.2011 “Për ratifikimin e Konventës Europiane “Mbi ushtrimin e të drejtave të fëmijëve”.

Hartuesit e kësaj Konvente i janë referuar qëllimit të KiE-së për një frymë bashkëpunuese midis shteteve duke mbajtur në konsideratë Konventën e Kombeve të Bashkuara mbi të Drejtat e Fëmijëve. Konkretisht, neni 4 i kësaj Konvente i drejtohet vendeve nënshkruese për të patur në konsideratë parësore në legjislacionin e tyre marrjen e masave mbi zbatueshmërinë e të drejtave të sanksionuara në këtë akt. Pra, duket që nënshkrimi i kësaj Konvente nga vendet e Kontinentit Europian vjen si obligim

nga pjesëmarrja në Kombet e Bashkuara, dhe pikërisht nga nënshkrimi prej kësaj të fundit të *Konventës për të Drejtat e Fëmijëve*.

Duke qenë se më lartë është analizuar *Konventa e OKB për të Drejtat e Fëmijëve*, në këtë pikë të punimit mund t'i referohemi pikërisht nenit 2 të *Konventës Europiane për të Drejtat e Fëmijëve*.

Në këtë nen trajtohet koncepti “*mbajtësit e përgjegjësive prindërore*” duke nënkuptuar *prindërit dhe persona të tjerë ose organe, të cilët kanë të drejtë të ushtrojnë disa ose të gjitha përgjegjësitë prindërore*. Pra, mbahet në konsideratë parësore *interesi më i lartë i fëmijës*, duke sanksionuar “organet” si mbajtës të përgjegjësive prindërore. Në këtë kontekst, mund të themi se sistemi ynë ligjor *për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve*, duke iu përmbajtur kësaj klauzole, njih detyrimin e organeve të caktuara për ushtrim të përgjegjësive prindërore në raste të caktuara. Këtu kemi parasysh *ligjin nr. 121 të vitit 2016 “Për Shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë”*.

Ndër të tjera ky ligj rregullon “Shërbimet rezidenciale”, duke njohur kështu dhe rastet se kur një “organ” apo “institucion” është mbajtës i përgjegjësisë prindërore. Duke qenë i tillë një institucion apo një organ i caktuar ka të drejtën dhe detyrimin ligjor që të menaxhojë të ardhurat e fëmijës, dhe një nga burimet e këtyre të ardhurave është dhe përfitimi nga Skema e NE-së. Kemi parasysh këtu rastin e jetimëve të cilët përfitojnë pagesën përkatëse të NE-së si kategori e veçantë, *apo dhe* pagesat e Kempeve që mund të marrin fëmijët me aftësi të kufizuara po nga i njëjti fond.

Karta Sociale Europiane (e rishikuar)

Kjo Kartë është akt juridik i Këshillit të Europës. Ajo është nënshkruar në Strasburg, më datë 3 Maj të vitit 1996. Shqipëria e ka ratifikuar atë me anë të ligjit nr. 8960, datë 24.10.2002 “Për Ratifikimin e Kartës Sociale Europiane, e ndryshuar”.

Shtetet anëtare të KiE janë dhe shtetet nënshkruese të kësaj Karte. Këto shtete duke patur parasysh synimin e KiE në drejtim të arritjes së unitetit sa më të madh midis anëtarëve të saj, me qëllim ruajtjen e parimeve të trashëgimisë së përbashkët europiane, për t’i realizuar në vijim këto ideale, hartuan dhe shtruan për miratim këtë Kartë.

Gjatë hartimit të Kartës Sociale Europiane është mbajtur parasysh KEDNJ e vitit 1950, e cila sanksionon *liritë dhe të drejtat* themelore ndër të cilat *të drejtat ekonomike dhe sociale*.

Pjesa e parë e Kartës Sociale Europiane (e rishikuar) sanksionon të drejtën për asistencë sociale dhe mjekësore në pikën 13 të saj. Pika 14 thekson se kushdo ka të drejtën të përfitojë nga këto shërbime të mirëqënies sociale. Gjithashtu i jepet rëndësi edhe familjes duke theksuar rëndësinë e saj primare për shoqërinë, ndaj dhe asaj i duhet kushtuar rëndësia e duhur për zhvillim social-ekonomik.⁵⁶ Në pikën 17 i kushtohet rëndësi fëmijëve dhe të rinjve duke u njohur atyre të drejtën *për mbrojtje të përshtatshme ekonomike, juridike dhe sociale*.

Përsa është parashikuar më sipër edhe legjislacioni ynë për ndihmën ekonomike ka sanksionuar të drejtën e cילו pa burime të papërshtatshme duke përdorur termin “të

⁵⁶ Pika 16 e pjesës së parë të Kartës Sociale Europiane (e rishikuar), nënshkruar në Strasburg, më 3 Maj 1996 nga vendet anëtare të Këshillit të Europës.

ardhura të pamjaftueshme”.⁵⁷ Me anë të ligjit tonë për asistencën sociale është shkuar më tej duke iu dhënë mundësia cilido personi apo familje të aplikojë dhe të përfitojë nga këto shërbime, konform kjo pikës 14 të Kartës Sociale Europiane (të rishikuar).

Legjislacioni ynë për Ndihmën Ekonomike dhe për asistencën sociale në përgjithësi u jep mundësinë personave apo individëve për të përfituar asistencë të përshtatshme dhe në rast sëmundje deri në perkujdesje me kujdestari, konform parashikimeve të bëra në pjesën e dytë të Kartës Sociale Europiane, konkretisht **neni 13 i cili sanksionon të drejtën për asistencë mjekësore dhe sociale.**

Për të siguruar realizimin e këtyre të drejtave shtetet nënshkruese të kësaj Karte marrin përsipër të sigurojnë për çdo person, i cili është i pamundur të vetësigurojë kushte për asistencë të përshtatshme mjekësore përmes skemave të sigurimeve shoqërore kryesisht.

Neni 14 i Kartës parashikon të drejtën për të përfituar nga shërbimet e mirëqënies sociale.

Bazuar në këtë nen shtetet nënshkruese marrin përsipër që të krijojnë kushtet më të vaforshme për shërbime të aksesueshme, duke përfshirë edhe punën në komunitet, e cila kontribuon në integrimin e personave dhe shoqërisë si një e tërë.

Në këtë kuadër shteti ynë ka marrë masa duke parashikuar në legjislacionin e kohës metoda të punës sociale sikurse ishte “puna në komunitet” e analizuar në kapitullin e tretë të këtij punimi. Me qëllim përshtatjen e individëve në mjedisin social dhe inkurajimin e tyre për t’u riintegruar në komunitet janë marrë gjithashtu masa dhe në

⁵⁷ Neni 7 pika a, Ligj nr. 57/2019 “Për asistencën sociale në Republikën e Shqipërisë”.

vijim për aktivizimin e tyre në programe të aftësimit profesional deri dhe në riintegrim në tregun e punës (analizuar në kapitullin e katërt të këtij punimi).

Neni 16 i Kartës saksionon të drejtën e familjes për mbrojtje ekonomike, ligjore dhe sociale. Synimi është sigurimi i kushteve për zhvillim të familjes duke nxitur mbrojtjen në fushën ekonomike, atë ligjore dhe sociale, përmes mjeteve fiskale, materiale, etj. Në vëmendje kërkohen të jenë çiftet e reja por dhe ato familje të krijuara tashmë por që gjenden në vështirësi për t'u përballuar me kushtet e vështira të jetesës.

Në përmbushje të këtyre detyrimeve ligjore duke patur parasysh mbrojtjen ekonomike dhe zhvillimin e familjes, për t'i dhënë asaj më shumë mundësi për përfitime sociale, shteti ynë është angazhuar duke rregulluar me ligj asistencën sociale në përgjithësi dhe ndihmën ekonomike në veçanti. Nevojat e individit dhe të familjes evoluojnë me kalimin e kohës ashtu sikurse ka evoluar dhe është përmirësuar edhe legjislacioni përkatës në fushën e NE-së. Konkretisht siç e vumë re në kapitujt tre dhe katër të këtij punimi, me qëllim të përshtatjes së nevojave të shoqërisë u ndërmorrën reformat e njëpasnjëshme në funksion të përmirësimit të Skemës së Ndihmës Ekonomike.

E drejta e mbrojtjes nga varfëria dhe përjashtimi shoqëror vjen si një ndër të drejtat primare të parashikuara në Kartën Sociale Europiane pikërisht në nenin 30 të saj.

Synimi i këtij parashikimi ligjor është sigurimi efektiv i të drejtës për t'u mbrojtur nga varfëria dhe si rrjedhim nga përjashtimi shoqëror. Masat e ndërmarra nga shtetet duhet të jenë të tilla që të nxisin aksesin efektiv të këtyre personave që mund të ndodhen në risk ndaj këtij përjashtimi shoqëror. Fushat në të cilat kërkohet ndërhyrje shtetërore

përmes masave ligjore janë: punësimi, strehimi, arsimimi, asistencë mjekësore, si dhe kultura.

Përkthyer kjo në legjislacionin tonë të brendshëm do të thotë më shumë mundësi reale, efektive për grupet vulnerabël. Kjo lidhet me parimin e drejtësisë sociale parshikuar në *nenin 5 të ligjit nr. 57 të vitit 2019 “Për Asistencën Sociale në Republikën e Shqipërisë”*. Drejtësia sociale është parimi që përcakton detyrimin që ka çdokush për të siguruar kushtet bazë të jetesës, si për veten edhe për personat në ngarkim të tij. Kjo nënkupton detyrimin që duhet të ketë secili në rolin e tij në drejtim të reduktimit të varfërisë për veten dhe të tjerët që janë në pamundësi.

Mundësi të kësaj natyre për t’iu gjendur pranë familjeve në nevojë deri në riintegrim të tyre ofron padyshim legjislacioni për ndihmën ekonomike, duke patur këtu parasysh në tërësi legjislacionin për ndihmën, ashtu sikurse edhe *Strategjitë* e miratuara nga qeveria shqiptare dhe *Planet e Veprimit* në zbatim të tyre.

Marrëveshja e Stabilizim Asociimit

MSA është akt juridik me natyrë *ndërkombëtare* e nënshkruar nga vendi ynë dhe BE, e cila synon krijimin e bashkëpunimit drejt hapave për anëtarësimin e Shqipërisë në BE. Përmes MSA-së vendoset një bashkëpunim midis Shqipërisë dhe Bashkimit Europian. Ky bashkëpunim synon që Shqipëria të ketë mbështetjen e duhur në drejtim të integritetit në të gjitha sferat e veprimtarisë që përfshin kjo Marrëveshje.

Republika e Shqipërisë e nënshkroi këtë marrëveshje në muajin qershor 2006. Në mars të këtij viti përfundoi procesi i ratifikimit nga të gjitha vendet anëtare të BE-së. Kjo Marrëveshje hyri në fuqi më 1 prill 2009.

Neni bazë i parashikuar në Marrëveshjen e Stabilizim Asociimit i cili i atribuohet fushës sociale është neni 99 i cili sanksionon bashkëpunimin social. Bazuar në këtë nen palët marrin përsipër të bashkëpunojnë me qëllim realizimin e reformave të shtetit shqiptar në fushën e punësimit, duke përfshirë këtu përshtatjen e legjislacionit *mbi kushtet e punës dhe mundësive të barabarta për mbrotje të shëndetit dhe sigurisë në punë*, për punëtorët në përgjithësi dhe për gratë në veçanti.

Në thelb ky nen ka të bëjë me përshtatjen e legjislacionit shqiptar të sigurimeve shoqërore, por përmes tij shkohet më tej duke gjetur pikat e kontaktit me fushën sociale të ndihmës ekonomike dhe jo vetëm, sikurse do vërejmë më poshtë.

Në analizën në vijim vijmë Planet Kombëtare për Integrimin European dhe Strategjitë e hartuara nga shteti Shqiptar me synim të kuptuarit sa më qartë të klauzolës së lartpërmendur.

Si nevojë e zbatimit të MSA janë hartuar disa Plane Kombëtare për Integrimin European përmes Vendimeve të Këshillit të Ministrave. Planet bazë janë disa vjeçare. Në përmbajtje të këtyre planeve janë hartuar dhe miratuar disa plane vjetore.

Plani Kombëtar për Integrimin European 2016-2020 është hartuar si rezultat i zbatimit nga ana jonë e MSA-së. Kapitulli 19 i këtij Plani i kushtohet Politikave sociale dhe punësimit. Politikat e punësimit të parashikuara në Planin Kombëtar për Integrimin European pasqyrojnë përmbushjen e detyrimeve që burojnë nga zbatimi i MSA-së dhe legjislacionit të BE-së. Detyrime në fushën sociale burojnë nga neni 99 i Marrëveshjes së Stabilizim Asociimit.

Nenet 46, 47, 48, 77, 99 të MSA-së përcaktojnë se bashkëpunimi midis vendit tonë dhe BE-së, ka për synim përafrimin e legjislacionit tonë me atë komunitar në drejtim të tregut të punës dhe formimit profesional me qëllim arritjen e standarteve europiane.

Sikurse e kemi cilësuar edhe më lartë gjatë trajtimit të këtij punimi, reformat e iniciuara nga qeveritë shqiptare në fushën sociale konkretizohen në atë që ne e cilësojmë tashmë si *modernizimi i Asistencës Sociale në Shqipëri* (duke nënkuptuar reformat e ndërmarra në fushën e ndihmës ekonomike dhe atë të aftësisë së kufizuar). Paralel me të shkon edhe reforma e *Shërbimeve Sociale* (cilësuar ndryshe si Shërbimet Shoqërore), e cila synon në deinstitutionalizimin e shërbimeve të kujdesit shoqëror.

Plani më i fundit Kombëtar për Integrimin në Bashkimin European është Plani 2020-2022.

Sikurse Planet e mëparshme edhe ky Plan vë në fokus *respektimin e parimeve demokratike të të drejtave të njeriut* të shpallura edhe në DUDNJ, si dhe në KEDNJ.

Strategjia në fjalë vë theksin në përmbushjen e detyrimeve në fushën sociale dhe në politikat e punësimit, të cilat burojnë nga neni 99 i MSA, duke vlerësuar se qeveria shqiptare ka treguar vendosmëri në zhvillimin e këtyre politikave, përmes investimeve në kapital njerëzor dhe kohezion social (tregues këto të vizionit strategjik të Bashkimit European).

Prioritetet në fushën e mbrojtjes sociale vijnë të jenë ndër të tjera: shtyrja e afatit për zbatim të Strategjisë Kombëtare të Mbrojtjes Sociale në vitet 2019-2022 dhe Planit të saj të Veprimit; *ndryshimin e ndihmës* në një skemë aktive që mundëson riintegrimin shoqëror.

Në analizën e bërë për këtë Plan vlerësohet se janë bërë përpjekje reale në rritjen profesionale të stafëve në nivel ministrie por edhe të SHSSH-së në nivel qendror dhe rajonal, të strukturave shëndetësore që referojnë rastet dhe kapacitetet e stafëve të institucioneve që ofrojnë shërbime në qarkun e Tiranës dhe më tej. Gjithashtu, është krijuar baza ligjore e duhur për aplikimin e reformës së vlerësimit të afëtësisë së kufizuar përmes sistemit bio-psiko-social në të gjithë Shqipërinë e cila gërsheton përfitimin në cash me shërbime integruese. Së fundmi vlerësimi bio-psiko-social si një formë e re, sipas modelit evropian për aftësinë e kufizuar pritet të zbatohet në tre Qarqe të vendit: Tiranë, Elbasan dhe Durrës.

Strategjitë Kombëtare të Mbrojtjes Sociale. Në kuadër të mbrojtjes sociale, dhe në përmbushje të kërkesave që rrjedhin nga MSA, nga shteti Shqiptar janë hartuar disa Strategji Kombëtare për Mbrojtjen Sociale.

Ndër Strategjitë e para është ajo e vitit 2015. **Zbatimi i Strategjisë Kombëtare të Mbrojtjes Sociale 2015-2020 (SKMS)** ka sjellë shndërrimin e skemës së ndihmës ekonomike (NE) në një skemë aktive që mundëson ndër të tjera riintegrimin shoqëror;

Falë zbatimit të kësaj Strategjie, për sa i përket *mbrojtjes sociale*, ligji nr. 57/2019 arriti të lehtësojë procedurat pasi vendimi për ndihmën tashmë meret nga Drejtoritë Rajonale të SHSSH-së dhe jo nga Bashkitë.⁵⁸

Me ligjin e ri por dhe VKM-të e reja u rrit efektshmëria e kontrolleve duke u përshtatur tashmë me sistemin përkatës SMI⁵⁹. Bazuar në këtë sistem merret në konsideratë

⁵⁸ Sikurse kemi analizuar edhe në kapitujt e mëparshëm të këtij punimi, me ligjin e vjetër ishin Këshillat Bashkiak/ Komunal ato të cilat kishin të drejtën ekskluzive për vendimarrjen për ndihmë.

⁵⁹ Sistemi i Menaxhimit të Integruar.

tashmë niveli i rriskut, mirëmenaxhimi i tij, duke rritur efikasitetin në drejtim të parandalimit të abuzimeve me fondet. Janë shumë sisteme të insitucioneve të tjera të cilat bashkëveprojnë midis tyre në transparencë të plotë.

Sikurse analizuam edhe në kapitullin e katërt të këtij punimi, programi i daljes nga skema e ndihmës për familjet që kanë mbushur 5 vjet përfitimi nga NE, si dhe plani në funksion të këtij programi, po realizohen duke synuar riintegrimin në jetën shoqërore të familjeve të ndihmës përmes aftësimit profesional dhe punëzënies efektive duke mundësuar kështu që të arrihet në atë që tashmë e cilësojmë si shndërrimi nga një *skemë pasive* në *aktive*.

Strategjia Kombëtare e mbrojtjes Sociale 2020-2023, në përmbushje të detyrimeve ligjore që rrjedhin nga *nenet 70 dhe 99*, të MSA-së , si dhe të detyrimeve që burojnë nga Plan Kombëtar për Integrimin Europian. Politika për zbutjen e varfërisë, krijimi i kushteve që individët, familjet dhe fëmijët në situata të vështira të përballojnë efektet që shkakton varfëria, vulnerabiliteti dhe përjashtimi është prioritet kyç i kësaj Strategjie.

Kjo Strategji synon reduktimin e varfërisë, sidomos varfërisë ekstreme, duke garantuar një jetesë dinjitoze për familjet/individin dhe fëmijët. Varfëria do të ulet, duke nxitur zhvillimin e kapaciteteve dhe aftësive të tyre nëpërmjet adresimit të nevojave në kontekstin e rehabilitimit, integritit në tregun e punës dhe të shërbimeve shoqërore.

Referencat e kësaj Strategjie janë koherente me dokumentet strategjike të BE-së.

Politikat aktive të punësimit përmes aplikimit të Strategjive të bazuara në MSA-në dhe jo vetëm. Sikurse kemi analizuar në kapitullin e katërt të kësaj teme, vërehet se ekziston një varësi e ndërsjelltë midis skemës së ndihmës dhe *politikave aktive të*

punësimi. Për këtë arsye dhe reforma e ndihmës synon të arrijë riintegrimin social-ekonomik përmes projekteve të tilla si: nxitja e punësimi, orientimi në tregun e punës nëpërmjet kurseve të formimit profesional dhe programeve të ngjashme që kanë çuar në përfshirjen në tregun e punës të anëtarëve në moshë aktive pune. Këto kërkesa në thelb burojnë nga nevoja për integrim në BE, pasi është pikërisht MSA e cila obligon qeverinë Shqiptare në nxitjen e këtyre politikave aktive të punësimi. Në këtë kuadër qeveria Shqiptare ka miratuar disa *strategji për punësimin*.

Për secilën Strategji është hartuar edhe plani përkatës për realizim të tyre. Pas periudhave të caktuara bëhet dhe rishikimi i tyre në formën e raporteve të vlerësimit (afatmesëm kryesisht).

Ajo që ka vlerë të theksohet është se tashmë ka filluar koordinimi midis Shërbimit Kombëtar të Punësimi (SHKP) dhe Shërbimit Social Shtetëror (SHSSH). Marrëveshja mes SHKP-së dhe Shërbimit Social Shtetëror e nënshkruar për riintegrimin në tregun e punës të përfituesve aktualë dhe ish të ndihmës duket se ka sjellë rezultatet e saj të para që në vitin 2018.

Të dhënat tregojnë se ka një tendencë në rritje të të punësuarve nga skema e ndihmës përmes riintegrimit në tregun e punës, duke mos lënë mënjanë këtu edhe aftësimin për punësim për individët e familjeve në nevojë të cilëve u ofrohen kurse profesionale në varësi të kapaciteve të tyre.

Sa më sipër mund të konkludojmë se, programi i qeverisë Shqiptare 2017-2021 ka në vëmendje parësore politikat e punësimi në përputhje me detyrimet e integritetit drejt BE-së. Masa këto të cilat reflektohen në strategjitë përkatëse për punësim, duke i

kushtuar vëmendje edhe realizimit të qëllimit për rintegrimin e familjeve të skemës së ndihmës.

Nxitja e riintegrit në tregun e punës është një nga pikat kryesore të Strategjisë më të fundit për punësim e cila konsiston në hartimin e skemës riintegruese në tregun e punës të përfituesve të skemës së NE-së. Strategjia në fjalë parashikon që, shërbimet e punësimit të jenë të harmonizuara me Shërbimin Social Shtetëror, i cili adreson nevojat e individëve, që përballen me dizavantazhe të shumta, për të maksimizuar ndërveprimin midis politikave pasive dhe aktive, për të identifikuar e minimizuar faktorët shkurajues për *hyrjen në tregun e punës si dhe për të realizuar daljen nga skema të përfituesve të ndihmës ekonomike.*

Kapitulli VII: Konkluzione dhe rekomandime

7.1. Konkluzione

Ndihma ekonomike ka ndjekur rrugën e përgjithshme të zhvillimit politiko-shoqëror, me ndryshimet dhe veçoritë përkatëse të çdo periudhe. Në punim pasqyrohet evolucioni historik që ka bërë skema NE-së, parimet bazë të saj dhe mënyrën si është trajtuar figura e përfituesve të saj në periudha të ndryshme kohore nga legjislacioni përkatës. Shqipëria nuk trashëgoi nga sistemi i kaluar dhe ai komunist asnjë ligj social megjithëse individët dhe familjet në gjendje risku ishin të shumtë. Programi i reduktimit të varfërisë, i krijuar dhe zbatuar për herë të parë (faza e parë e skemës së NE-së) *në maj të vitit 1993 (ligji nr. 7710 “Për ndihmën dhe përkujdesjen shoqërore”)* i cili funksiononte nën emrin “ndihma ekonomike”, u krijua për shkak të rritjes së vazhdueshme të papunësisë, të varfërisë dhe trazirave sociale dhe kishte për objekt kryesor krijimin e bazës ligjore dhe të instancave përkatëse për zhvillimin e *ekonomisë së tregut*, ndërsa *në planin shoqëror* garantimin e *mbijetesës*.

Me miratimin e Kushtetutës në vitin 1998 u saksionuan ndër të tjera edhe parimet bazë mbi të cilat mbështeten politikat, programet dhe skemat e mbrojtjes sociale në Republikën e Shqipërisë. Neni 116 i KRSH-së përcakton se *marrëveshjet ndërkombëtare të ratifikuara* kanë fuqi në të gjithë territorin e RSH-së, në rend të dytë pas Kushtetutës.

Është pikërisht Kushtetuta jonë, akti më i lartë juridik, e cila ka sanksionuar rëndësinë që kanë marrëveshjet ndërkombëtare, të cilat kanë efekt ligjor më të lartë në sistemin tonë juridik në raport me çdo akt tjetër që bie në kundërshtim me to.

Kjo Kushtetutë në nenin 17 të saj përcakton se thelbi i lirive dhe të drejtave të njeriut nuk mund të tejkalohet kufizimet e parashikuara në KEDNJ. Si rrjedhojë KEDNJ zë një vend të veçantë në Kushtetutën tonë, në raport jo vetëm me aktet e tjera ndërkombëtare, por në raport edhe me vetë Kushtetutën. Edhe pse Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë është miratuar pas marrjes fuqi të kësaj Konvente në Shqipëri, vetë Kushtetuta e ka bërë të zbatueshme automatikisht duke i dhënë një rëndësi të veçantë zbatimit të saj. Kjo bën që KEDNJ, si pjesë e së drejtës ndërkombëtare që vepron në RSH, jo vetëm që qëndron mbi ligjin e brendshëm, por orienton legjislacionin tonë drejt Bashkimit Europian.

Analiza e punimit provon plotësisht hipotezën e tretë të ngritur se legjislacioni shqiptar, për sa i përket skemës së NE-së, është në përputhje me aktet ndërkombëtare.

Në fazën e dytë të NE-së (e quajtur ndryshe faza e zhvillimit përgjatë viteve 2005-2013) që përkon dhe me hipotezën e dytë të këtij punimi, sistemi i mbrojtjes sociale në Shqipëri, pavarësisht nga progresi i arritur në zbatim të reformave në fushën legjislative, organizative dhe strukturore dhe të impaktit të dukshëm në reduktimin e varfërisë, decentralizimin dhe delegimin e kompetencave në qeverisjen vendore, kishte ende nevojë për ndryshime për arritjen e qëllimit të këtyre reformave. Koncretisht *ligji nr. 9355, datë 10.03.2005, “Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore” i ndryshuar, karakterizohej nga mungesa e efikasitetit, efijencës dhe e transparencës të skemës së Ndihmës Ekonomike!* Në këtë ligj mungonin: - shënjestrimi dhe mbulimi i familjeve të varfra; - ekzistenca e *një sistemi të paanshëm dhe transparent që ulte subjektivitetin*

në vendimmarrje dhe si rrjedhojë rriste efikasitetin në administrimin e skemës. Shtjellimi i disa prej këtyre arsyeve është si vijon:

1. Ekzistenca e burokracisë për mbledhjen e dokumentacionit të nevojshëm për të aplikuar për NE.

Gjatë vëzhgimeve të kryera në zyrat lokale të administrimit të programit të NE-së, ishte konstatuar se këto vështirësi kishin të bënin me grumbullimin e dokumentacionit; prezantimin e dokumentacionit pranë zyrave lokale të ndihmës ekonomike si dhe diversifikimin e informacionit të grumbulluar. Konkretisht, aplikantët ndesheshin në vështirësi për sigurimin e dokumentave të nevojshme për aplikim, të cilat ishin të shumta dhe jo lehtësisht të grumbullueshme, duke patur parasysh këtu aftësitë, mundësitë dhe aksesin e familjeve të varfëra për informacion dhe dokumentacion, kushtet e infrastrukturës, kapacitetet e përpunimit të informacionit të grumbulluar, saktësinë dhe vërtetësinë e dokumentacionit që lëshohej nga zyrat, sportelet dhe institucionet e veçanta, mundësinë e lëshimit të dokumenteve false përkundrejt pagesave në dorë etj. Dokumentacioni ishte i shumëllojshëm, që vinte nga disa burime dhe institucione dhe jo lehtësisht i konvertueshëm dhe i përpunueshëm.

Një dobësi tjetër e dukshme dhe e rëndësishme e sistemit të kaluar të shpërndarjes së NE-së ishte sistemi burokratik i mbledhjes së informacionit dhe dokumentacionit që nevojitej për të matur dhe vlerësuar varfërinë në nivel lokal. Kjo dobësi evidentohej në tre aspekte: i. informacioni dhe dokumentacioni i grumbulluar nga institucionet qeveritare, brenda dhe jashtë sistemit të MPÇS, ishte jo i saktë, nuk sillej në kohë dhe ushqente keqpërdorimin dhe abuzimin me burimet financiare; ii. analiza dhe vlerësimi i

informacionit dhe dokumentacionit të grumbulluar nuk ishin të plotë. Analiza dhe vlerësimi nuk bëhej në mënyrë shumëdimensionale si dhe në një perspektivë komplekse; iii. konstatohej një informalitet i qartë dhe i dukshëm në verifikimin fizik të standarteve të jetesës së aplikantëve sepse dokumentacioni i kërkuar dhe i grumbulluar ishte i pasaktë dhe evaziv si dhe ishte vështirë të identifikoheshin dhe provoheshin në rrugë dhe me dokumente ligjore anëtarët e familjes emigrante, të punësuarit ilegal, kafshët shtëpiake që zotëronte familja etj.

Gjithashtu dhe paqartësia në mënyrën e funksionimit të skemës së NE-së mund të identifikohet lehtësisht në zonat urbane si dhe në qytetet e mëdha. Nga informacionet e grumbulluara, konstatohej se rreth një pjesë e madhe e aktiviteteve të biznesit në qytete dhe e punonjësve që punonin në aktivitete private të licensuara ishin informale duke ndikuar kështu ndjeshëm në deformimet e zbatimit të programit të ndihmës ekonomike.

2. Ekzistenca e shumë kategorive në nevojë që duhet të përfitonin por ishin të penalizuara sepse ligji në fjalë (nr. 9355/2005, neni 5) nuk parashikonte të drejtën e aplikimit të tyre.

Ky fakt sillte si rrjedhojë shënjestrimin jo të sakte të kategorive në nevojë që duhet të përfitonin NE. Mungesa e shënjestrimit të familjeve përfituese çonte në rritjen e numrit të përfituesve në nivel kombëtar (numri i familjeve përfituese të NE-së në fund të vitit 2012 rezultonte çdo muaj 99.494 me një fond mujor prej 4.3 miliard lekësh). Këto kategori do ti analizojmë në vijim në hipotezën e tretë.

3. Proçedimi i marjes së vendimit përfundimtar të përfituesve të ndihmës ekonomike nga Këshilli i Bashkisë/Ish-Komunës duke mundësuar kështu subjektivizmin (ligji nr. 9355/2005, neni 29).

Kompjuterizimi i informacionit dhe statistikave të grumbulluara ishte në nivel të ulët. Kjo gjëndje e teknologjisë së informacionit në zbatimin e programit të NE-së vështirësonte disponimin dhe qarkullimin e informacionit adekuat dhe nuk mundësonte verifikueshmërinë e informacionit dhe dokumentacionit nga disa burime. Gjithashtu ky nivel i ulët i teknologjisë së informacionit ushqente informalitetin si dhe krijonte terrenin për abuzim dhe praktika korruptive në përzgjedhjen dhe kualifikimin e përfituesve.

Mungesa e kompjuterizimit dhe informatizimit të të dhënave favorizonte dhe nivelin e lartë të gabimeve në përjashtim gjatë proçesit të përzgjedhjes së përfituesve. Konkretisht, kriteret ligjore të përzgjedhjes së përfituesve ishin të shumtë dhe kompleks. Si të tillë këto kriteret nuk evidentonin dhe identifikonin qartë përfituesit më nevojtarë legjitimë për t'u kualifikuar, të cilët bënin pjesë në enklavat e varfërisë ekstreme. Baza e vendim-marrjes vazhdonte të ishte shumë e gjerë sepse problematikat e miratimit të listës së përfituesve të NE-së nga këshillat bashkiakë dhe ish-komunalë ndikonin në rritjen e riskut të subjektivizmit dhe manipulimit për motive dhe qëllime korruptive, abuzive, dhe madje edhe politike, klienteliste dhe elektorale. Këtyre motiveve u duhet shtuar edhe mundësia e gabimeve njerëzore gjatë proçesit vendim-marrës.

4. Pamjaftueshmëria e kapaciteteve institucionale dhe burimeve njerëzore, sidomos në nivel rajonal dhe lokal, për të përballuar sfidat e programit të ndihmës ekonomike

Numri, cilësia dhe kualifikimi i burimeve njerëzore të caktuara për të intervistuar familjet aplikante për NE në shumë bashki dhe ish-komuna, ishin të pamjaftueshëm. Kjo mungesë bënte emergjente nevojën për rritjen e kapaciteteve institucionale të zyrave rajonale dhe lokale, punonjësve socialë dhe administratorëve të NE-së. Pikat më të dobëta në punën e institucioneve dhe individëve të përfshirë në zbatimin e programit të NE-së ishin numri i vogël i administratorëve dhe punonjësve social (dhe në ditët e sotme vijon të mbetet sfida, forcimi dhe rritja e kapaciteteve të burimeve njerëzore për të verifikuar fizikisht banesat dhe kushtet e jetesës të përfituesve një apo dy herë në vit, siç parashikohet në ligj) për banorë/familje/aplikantë që nuk i përgjigjej nevojës për një perzgjedhje korrekte dhe rigoroze të përfituesve të ndihmës ekonomike, sidomos për të realizuar intervista në terren, në familje dhe për të përdorur tregues alternativë të vlerësimit të gjëndjes ekonomike të familjeve aplikuese. Gjithashtu konstatohej një mungesë e ndjeshme e njohurive mbi kuadrin ligjor të skemës së NE-së, sidomos për targetimin dhe shpërndarjen. Si rrjedhojë, shtrohej nevoja e standartizimit të raportit midis numrit të administratorëve social në bashki dhe ish-komuna me numrin e familjeve të NE-së në shkallë vendi. Kjo sepse në terren ka diferenca të ndjeshme nga njëra njësi vendore te tjetra.

5. Ekzistenca e një skeme pasive të NE-së

Ky fakt sepse mungonin programet e përfshirjes në tregun e punës, me qëllim rimëkëmbjen e ekonomisë familjare dhe të vetë individit.

Nga analiza më lartë konkludojmë se ende kjo skemë nuk merrte në konsideratë kompleksitetin e varfërisë dhe si e tillë mbetej një sistem i paaftë për mbrojtjen sociale dhe ekonomike të grupeve të përjashtuara. Si rrjedhojë kishte një **ndikim jo shumë të ndjeshëm të ndihmës ekonomike në zbutjen e varfërisë dhe përmirësimin e cilësisë së jetës së përfituesve, bazuar në ligjin nr. 9355, datë 10.03.2005, “Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore” i ndryshuar.**

Konkretisht, përgjatë viteve 2007-2012 nga studimi i dokumentacionit dhe treguesve të masës së NE-së, konstatohet se, INSTAT llogariste nivelin e varfërisë sipas kriterit të shpenzimeve rreth 4.800 lekë për person në muaj (47.73 dollar) dhe nivelin e varfërisë ekstreme rreth 3.800 lekë për person në muaj (436.87 dollar). Të ardhurat nga NE për një person ishin mesatarisht rreth 0.5 dollar në ditë ose rreth 50% e nivelit të varfërisë ekstreme ose rreth 25% e nivelit të varfërisë absolute, siç përcaktohej nga LSMS. Mbulimi i nevojave ligjore me fonde nga buxheti qendror ishte ende i ulët në nivelin 40-60% në këto vite çka vështirësonte impaktin pozitiv (pamjaftueshmërinë) të Programit të NE-së në uljen e varfërisë. Gjithashtu ndodhte, një ulje e motivimit për punë nga personat përfitues, pasi NE shihej si një formë e mirë mbijetese dhe pse e pamjaftueshme për të përballuar minimumin e standartit të jetesës. Sipas Zyrës së Punës (viti 2013), kërkesa për punë ishte ulur me 30%. Sipas INSTAT (viti 2012, 2014),

papunësia ishte rritur nga 12.8% në vitin 2012, në 14% në vitin 2014, pra ishte rritur me 1.2%.

Masa e NE-së nuk merrte për bazë dhe indeksimin me pagën minimale në shkallë vendi. Duke qenë se pagesa në cash, përbënte të ardhurën e vetme të familjeve përfituese mbetej e pamjaftueshme për të përmbushur kërkesat minimale të jetesës së tyre. Në vitin 2005 masa maksimale mujore e NE-së ishte 7.000 lekë sipas përlllogaritjeve mbi anëtarët e familjes. Kjo masë ndryshoi në 8.000 (tetë mijë) lekë në vitin 2012.

Për sa më lartë dalim në konkluzion se, programi i NE-së (ligji 9355/2005) duhej të integrohej dhe akomodohej më mirë në kontestin e politikave sociale, shërbimeve sociale, politikave të punësimit, pensioneve, luftës kundër papunësisë dhe informalitetit në ekonomi dhe në tregun e punës, luftën kundër varfërisë dhe nxitjes së përfshirjes sociale të familjeve të varfëra.

Në hartimin e strategjive sektoriale dhe ndërsektoriale, qeveria Shqipëtare në rastin e zhvillimit të Programit të Asistencës Sociale, përcaktonte si detyrë arritjen e objektivave specifike, të cilët synonin rritjen e masës së NE-së, uljen e numrit të përfituesve si dhe modernizimin e kësaj skeme.

Si rrjedhojë, kuadri ligjor i fazës së tretë të zhvillimit të politikës së ndihmës ekonomike ose e quajtur ndryshe faza e dixhitalizimit përgjatë viteve 2014-2019 (qëllimi i këtij ligji në drejtim të Skemës së Ndihmës Ekonomike rivjen me një perspektivë të re në drejtim të zbutjes së varfërisë dhe përjashtimit shoqëror duke synuar të ofrojë mundësi të barabarta për përfshirje sociale dhe për zhvillim përmes shërbimeve për një jetesë më të mirë. Konkretisht kjo skemë synon të sigurojë *asistencë afat-shkurtër për personat në*

nevojë, ndërkohë inkurajon dhe mbështet ata për daljen nga skema duke u punësuar etj, por edhe duke pranuar se një përqindje e aplikantëve kërkojnë një mbështetje më afatgjatë), **është efikas i paanshëm dhe transparent!** Konkretisht bëhet fjalë për Ligjin nr. 57 të vitit 2019, “Për Asistencën Sociale në Republikën e Shqipërisë” që shfuqizoi tërësisht ligjin e mëparshëm nr. 9355 të vitit 2005 “Për ndihmën dhe Shërbimet Shoqërore” i ndryshuar. Ky ligj garanton **rritjen e efikasitetit, efijencës dhe transparencës të skemës së NE-së**. Kjo është realizuar dhe vijon të zbatohet me ekzistencën e një sistemi të paanshëm dhe transparent që ul subjektivitetin në vendimmarrje dhe si rrjedhojë rrit efijencën në administrimin e skemës. Shtjellimi i disa prej këtyre risive është si vijon:

1. Heqja e burokracisë për mbledhjen e dokumentacionit të nevojshëm për të aplikuar për NE.

U realizua nëpërmjet ngritjes së regjistrit elektronik kombëtar i cili garanton një shërbim të ndihmës ekonomike më cilësor dhe dhe të aksesueshëm. Sankionohet tashmë me ligj se familjet e vetme përfituese nga Skema e NE-së do jenë ato të cilat i kalojnë filtrit të verifikimeve të përcaktuara edhe këto qartë në ligj (ligji nr. 57/2019, neni 20).

2. Shtimi në ligj i kategorive përfituese të penalizuara para reformës së NE-së;

Vlerësimi i saktë i të ardhurave, sikurse është argumentuar dhe në punim, çoi në adresimin më të mirë të NE-së tek familjet realisht të varfëra, por edhe në mënjanimin e mjaft familjeve të cilat përfitonin nga skema pa e merituar. Konkretisht shtimi i kategorive përfituese të penalizuara para reformës së NE-së janë: - familjet që përfitonin pension familjar prej 7.000 lekësh (shembull: vetëm në Qarkun e Elbasanit aktualisht

përfitojnë NE për afërsisht 550 familje të tilla); - familjet emigrante me probleme sociale të kthyer në Shqipëri. (ligji nr. 57/2019, neni 7).

Viktimat e trafikimit, pas daljes nga institucionet e përkujdesit shoqëror, deri në çastin e punësimit të tyre janë shtuar si kategori e re përfituesish në skemën e NE-së së bashku me kategorinë e viktimave të dhunës në marrdhëniet familjare, para vitit 2014 (vit kur u implementua në fakt reforma e NE-së në formën e pilotimit), lindur kjo si domosdoshmëri për t'i paraprirë reformës e cila ishte parashikuar për t'u implementuar që në vitin 2012 por që u shty për arsye politike të kohës.

Në ligjin nr. 57/2019 neni 12, është përcaktuar si risi pagesa shtesë për familjet e ndihmës të cilët kanë fëmijë që ndjekin arsimin e detyrueshëm 9-vjeçar, deri në moshën 16 vjeç, me qëllim inkurajimin e familjeve përfituese të NE-së për të dërguar fëmijët në shkollë. Kjo vlen dhe për fëmijët e këtyre familjeve të cilët vaksinohen. Ligji parashikon gjithashtu dhe mbështetje shëndetësore, duke bërë të detyrueshme për personat nga mosha 35 deri në 70 vjeç përfitues të ndihmës, kryerjen e kontrollit mjekësor bazë (check-up i detyrueshëm, VKM nr. 597/2019).

Me ligj është përcaktuar gjithashtu, mbështetja për fëmijët të cilët vendosen në familje kujdestare ose alternative. Cilësohet si e tillë një familje e cila ofrohet për të marrë në kujdestari fëmijë që gjenden pa kujdes prindëror, duke iu përmbajtur kriterëve ligjore dhe në respektim të procedurave përkatëse. Shembull: vetëm në Qarkun e Elbasanit aktualisht përfitojnë ndihmë ekonomike 38 familje të tilla. (VKM nr. 597/2019).

Kategori të tjera të shtuara me këtë ligj janë edhe: - familjet që kanë ndryshuar vendbanimin dhe nuk kishin qenë të trajtuar me NE në vendbanimin e mëparshëm; - familjet që nuk ishin pajisur me certifikatë pronësie (vetëm në Qarkun e Elbasanit

aktualisht përfitojnë ndihmë ekonomike përafërsisht 2200 familje të tilla); - familjet që masa e ndihmës sipas llogaritjes së ligjit të vitit 2005, ishte nën vlerën 800 lekë. (VKM nr. 597/2019)

3. Proçedimi i marjes së vendimit përfundimtar të përfituesve të NE-së nga Drejtoritë Rajonale të SHSSH-së dhe jo më nga Këshilli i Bashkisë/Ish Komunës nëpërmjet *regjistrit elektronik kombëtar dhe sistemit të pikëzimit*, duke hequr kështu subjektivizmin.

Përvoja tregonte tashmë se vendim-marja nga këshilli bashkiak ose ish-komunal kishte krijuar më shumë mundësi abuzimi, politizimi, dhe elektoralizimi. Risia e proçedimit të marjes së vendimit përfundimtar të përfituesve të NE-së, nga DRSHTH-të heq subjektivizmin (ligji nr. 57/2019 neni 20). I gjithë proçesi tashmë nga aplikimi, përzgjedhja, vendimmarrja dhe deri tek pagesat kryhet elektronikisht. *Regjistri elektronik* i NE-së mundëson aksesin on-line me sistemet e institucioneve të tjera sipas rastit si dhe *krijimin e profilit të riskut të përfituesve*, për të zbuluar kështu rastet e abuzimit. *Regjistri gjithashtu mundëson monitorimin në kohë reale të skemës dhe vlerëson performancën e saj*. Vendimmarrja merret nëpërmjet formulës unike të pikëzimit në të gjithë vendin. Kjo formulë *përfshin parametra të lidhur në mënyrë empirike me vlerësimin e situatës ekonomike të familjeve, të tilla si: përbërja e familjes, të ardhurat nga programi i mbrojtjes sociale, remitancat, qeraja, asetet, bujqësia, blegtoaria, trashëgimia, dhuratat si dhe variabla të tjera të veçanta social-ekonomike që lidhen me statusin e varfërisë* (VKM nr. 956/2016).

Për një zbatim sa më efikas të ligjit 57/2019, është realizuar **krijimi dhe forcimi i strukturave si dhe i mekanizmave monitorues, vlerësues dhe raportues në të gjitha nivelet qendrore, rajonale dhe vendore.**

Institucionet përgjegjëse të skemës së NE-së janë të afta për administrimin, monitorimin dhe vlerësimin e kësaj skeme. Aspekt kryesor është aftësimi tashmë i personelit për instrumentet e reja të skemës nëpërmjet trajnimeve të vazhdueshme ndër vite (dhe pse vijon të mos ketë standard: - në emërimin dhe shkarkimin e administratorëve shoqëror nga eprorët e tyre; - të raportit midis numrit të administratorëve social në bashki dhe ish-komuna me numrin e familjeve të NE-së në shkallë vendi, sepse në terren ka diferenca të ndjeshme nga njëra njësi vendore te tjetra). Gjithashtu regjistri elektronik gjeneron raporte çdo tre muaj mbi bazën e të cilave vlerësohet efektshmëria e skemës si dhe merren masa të mëtejshme në përmirësimin e saj.

Është **përmirësuar cilësia e shërbimeve të kontrollit/auditit për të reduktuar numrin e abuzimeve** (Udhëzim nr. 714/2018 i MSHMS), *nëpërmjet forcimit të kapaciteteve dhe rritjes së ndërgjegjësimit të nëpunësve civil përgjegjës*. Për këtë qëllim janë shtuar si pjesë e grupit të kontrollit në nivel qendror dhe rajonal pozicioni i juristit dhe IT-së (teknologji informacioni). Forcimi i kapaciteteve është përqëndruar në drejtim të evidentimit të abuzivitetit me skemën, në formën e *gabimeve* apo mashtrimeve nga ana e stafeve apo përfituesve, duke dhënë *penalitetet* përkatëse sipas rasteve.

Zbatimi i ligjit nr. 57/2019 solli gjithashtu si risi kthimin nga një skemë pasive në një skemë aktive e NE-së që po realizohet nëpërmjet programeve të riintegritit dhe alternimit të tyre me skemat e punësimit.

Duke qenë se pagesa në cash e NE-së, në të shumtën e rasteve përbën të ardhurën e vetme të familjeve përfituese, mbetet ende e pamjaftueshme për të përmbushur kërkesat minimale të jetesës së tyre. Për këtë arsye kjo reformë parashikon afatin 5 vjeçar për daljen nga skema (janar 2023) të personave në moshë aktive pune, familjet e të cilëve përfitojnë NE, duke i punësuar në tregun e punës, për t'i riintegruar në jetën normale shoqërore (VKM nr. 597/2019).

Bazuar në programin e Qeverisë Shqiptare, me mbështetjen e Bankës Botërore, Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale hartoi “Programin e daljes”, si një program i cili ka si qëllim ndërlidhjen e programeve të mbrojtjes sociale me skema të tjera nxitëse punësimi, *duke krijuar mundësinë e integritit në tregun e punës* të anëtarëve në moshë pune të skemës së NE-së. Këtë qëllim programi i daljes synon ta realizojë nëpërmjet ndërthurjes/gërshetimit/integritit të paketës së plotë ligjore për ngritjen (*formimin profesional*) dhe funksionimin e ndërmarrjeve sociale me programet e aftësimin për punësim, punësimit efektiv në tregun e punës, gjithashtu edhe në mundësi më të mëdha për përfituesit skemës së ndihmës në programet e zhvillimit lokal dhe jo vetëm si në industrinë, infrastrukturë, bujqësi, etj.

Si rrjedhojë, ka filluar koordinimi midis Shërbimit Kombëtar të Punësimit (SHKP) dhe Shërbimit Social Shtetëror (SHSSH), me anë të Marrëveshjeve midis tyre të nënshkruara për riintegrimin në tregun e punës të përfituesve aktualë. Konkretisht, gjatë vitit 2019 janë punësuar 1453 (2,8%) punëkërkues të papunë përfitues të ndihmës ekonomike dhe gjatë 6 muajve të parë të vitit 2020 janë punësuar 558 (1.3%) të tillë.

Rezultati i risive të lartëpërmendura solli një **ndikim të ndjeshëm të NE-së në zbutjen e varfërisë dhe përmirësimin e cilësisë së jetës së përfituesve, në fazën e tretë të saj bazuar në ligjin nr. 57 të vitit 2019, “Për Asistencën Sociale në Republikën e Shqipërisë”.**

Me sistemin e ri elektronik të skemës së NE-së, është rritur automatikisht shuma e pagesës së përfituar mujore, pasi bëhet shënjestrimi më i mirë i përfituesve. Konkretisht, numri i familjeve përfituese të NE-së çdo muaj në fund të vitit 2019 rezulton 60.500 familje me një fond mujor prej 4.2 miliard lekësh. Ndërkohë që çdo muaj në fund të vitit 2012 rezultonin 99.494 familje përfituese me një fond mujor prej 4.3 miliard lekësh. Pra vërehet shënjestrimi më i mirë i familjeve përfituese që ka sjell reformimi i skemës së NE-së, sepse përafërsisht për të njëjtin fond përfitojnë 39% familje më pak por me një shumë më tepër se të trefishuar të NE-së.

Rritja e shënjestrimit të familjeve përfituese çon në një rritje në masën 30% të masës mesatare të NE-së për vitin 2019, krahasuar me masën mesatare të NE-së para reformës së vitit 2012. Ndërkohë që rritja e pagës minimale në shkallë vendi është në masën 15.3%, nga viti 2012 deri në vitin 2019. Ligji nr. 57/2019 ndryshoi masën maksimale të NE-së duke hequr tavanin prej 8.000 lekësh sipas përlllogaritjes mbi anëtarët e familjes. Si rrjedhojë, masa e NE-së e llogaritur në këtë mënyrë, shkon deri në 150% të masës së pensionit social dhe e indeksuar. Masa e ndihmës ekonomike indeksohet nga SHSSH sa herë indeksohet pensioni social dhe në bazë të këtij indeksi. Sot e llogaritur në këtë mënyrë, masa maksimale që përfiton një familje është 12.485 lekë. *Nga analiza më lart vihet re se aktet në zbatim të ligjit 57/2019 nuk janë plotësisht të mjaftueshme në disa pika që do ti analizojmë në seksionin pasardhës.*

7.2. Rekomandime

Bazuar në analizën më lart, rekomandimet do të konkludonin si vijon:

1. Përditësimi i formulës së pikëzimit.

Siç përmendëm në konkluzionet më lart, vendimarrja për përfituesit e ndihmës merret *nëpërmjet formulës unike të pikëzimit në të gjithë vendin sipas VKM nr. 956, datë 07.12.2016 “Për përcaktimin e kriterëve dhe të detajeve të formulës së unifikuar të pikëzimit për përfitimin e ndihmës ekonomike”*. Kjo formulë përfshin parametra të lidhur në mënyrë empirike me vlerësimin e situatës ekonomike të familjeve, të tilla si: përbërja e familjes (madhësia e familjes sipas numrit të anëtarëve dhe moshë e fëmijëve), të ardhurat nga programi i mbrojtjes sociale, remitancat, qeraja, asetet, bujqësia, blegtoaria, trashëgimia, dhuratat si dhe variabla të tjera të veçanta social-ekonomike që lidhen me statusin e varfërisë. Treguesit e vlerësimit të formulës së unifikuar të pikëzimit të lartëpërmendur, ndihmojnë në përcaktimin e kriterëve të pranueshmërisë të familjeve për përfitimin e NE-së.

Fakti ka treguar se përgjatë këtyre viteve, formula e unifikuar e pikëzimit aktuale, trajton familjet/individët me probleme ekonomike dhe sociale të ndryshme në mënyrë të barabartë. *Megjithëse masa mujore e NE-së përcaktohet ligjërisht nga kushtet reale sociale dhe ekonomike të çdo familje që aplikon për ndihmë ekonomike*, diferencimi i familjeve/individëve përfitues të NE-së bazohet kryesisht në numrin dhe moshën e anëtarëve të familjes dhe jo në nevojat reale të tyre. Këto nevojat reale të tyre konsistojnë në: - kushtet e banesës; - asetet shtëpiake dhe vlerësimin e të ardhurave.

Konkretisht, bazuar në statistikat e mbledhura nga vizita në familje e përfituesve të ndihmës ekonomike, po sjellim në analizë shembujt e rasteve si vijon:

Rasti 1 & 2 për kushtet e banesës:

1. Familja e Z. M. R, banuese në njësinë administrative Kodovjat të bashkisë Gramsh, përbëhet gjithsej nga 4 anëtarë nga të cilët 2 janë fëmijë nën moshën 18 vjeç. Banesa ku jeton familja është në pronësi të kryefamiljarit dhe kushtet e kësaj banese janë shumë të mira. Me këto kushte banese që janë deklaruar nga familja në momentin e aplikimit, sistemi i ri i dixhitalizimit e nxjerr përfituese të NE-së.
2. Familja e Znj. S. Koçiu banuese në njësinë administrative Grekan të bashkisë Belsh, përbëhet gjithsej nga 2 anëtarë, nga të cilët një kryefamiljare femër sepse i ka vdekur bashkëshorti dhe një fëmijë në moshën 3 vjeç. Banesa ku jeton familja nuk është në pronësi të kryefamiljares (qëndron pa pagesë) dhe kushtet e kësaj banese nuk janë aspak të mira. Me këto kushte banese që janë deklaruar nga familja në momentin e aplikimit, sistemi i ri i dixhitalizimit nuk e nxjerr përfituese të NE-së.

Kjo nevojë reale e aplikuesve të NE-së që konsiston në *kushtet e banesës* kërkon rishikim. Ky rishikim duhet bërë duke i dhënë më shumë pikë familjeve që nuk e kanë në pronësi banesën ku jetojnë, dhe si rrjedhojë më pak pikë familjeve që e kanë në pronësi banesën ku jetojnë, duke marr në konsideratë në të dyja rastet dhe kushtet e kësaj banese.

Rasti 3 & 4 për asetet shtëpiake:

1. Familja e Z. M. R, banuese në njësinë administrative Kodovjat të bashkisë Gramsh, përbëhet gjithsej nga 4 anëtarë nga të cilët 2 janë fëmijë nën moshën 18 vjeç. Banesa ku jeton familja është në pronësi të kryefamiljarit dhe kushtet e kësaj banese janë shumë të mira. Familja zotëron në këtë banesë të gjitha asetet shtëpiake (tv, mobilje, frigorifer, lavatriçe etj) dhe përveç këtyre kryefamiljari është pronar dhe i një automjeti. Me këto të dhëna që janë deklaruar nga familja në momentin e aplikimit, sistemi i ri i dixhitalizimit e nxjerr përfituese të NE-së.
2. Familja e Znj. XH. S, banuese në njësinë administrative Gramsh, përbëhet gjithsej nga 2 anëtarë, nga të cilët një kryefamiljare femër (e divorcuar) dhe një fëmijë nën moshën 18 vjeç. Banesa ku jeton familja është në pronësi të kryefamiljares por kushtet e kësaj banese nuk janë aspak të mira (kasolle e vogël) dhe nuk zotëron asnjë aset shtëpiak. Me këto të dhëna që janë deklaruar nga familja në momentin e aplikimit, sistemi i ri i dixhitalizimit nuk e nxjerr përfituese të NE-së.

Kjo nevojë reale e aplikuesve të NE-së që konsiston në *asetet shtëpiake* kërkon rishikim. Ky rishikim duhet bërë duke i dhënë më shumë pikë familjeve që nuk zotërojnë asete shtëpiake ose kanë pak prej tyre dhe si rrjedhojë më pak pikë familjeve që i zotërojnë të gjitha ose shumë prej këtyre aseteve.

Rasti 5 & 6 për vlerësimin e të ardhurave:

1. Familja e Z. F. H, banuese në njësinë administrative Mollas të bashkisë Cërrik, përbëhet gjithsej nga 5 anëtarë nga të cilët 3 janë fëmijë nën moshën 18 vjeç. Banesa ku jeton familja është në pronësi të kryefamiljarit dhe kushtet e kësaj banese janë shumë të mira. Përveç kësaj banese familja ka të ardhura të tjera në

masën 240.000 lekë në vit. Me këto të dhëna që janë deklaruar nga familja në momentin e aplikimit, sistemi i ri i dixhitalizimit e nxjerr përfituese të NE-së.

2. Familja e Znj. M. B, banuese në njësinë administrative Elbasan, përbëhet gjithsej nga 3 anëtarë, nga të cilët një kryefamiljare (e divorcuar) dhe dy fëmijë nën moshën 18 vjeç. Banesa ku jeton familja nuk është në pronësi të kryefamiljares por me qera. Nuk zotëron gjithashtu dhe asnjë të ardhur tjetër. Me këto të dhëna që janë deklaruar nga familja në momentin e aplikimit, sistemi i ri i dixhitalizimit nuk e nxjerr përfituese të NE-së.

Kjo nevojë reale e aplikuesve të NE-së që konsiston në *vlerësimin e të ardhurave* kërkon rishikim. Kjo e fundit konsiston në faktin se vetë sistemi nuk i llogarit të ardhurat e përfituesve të ndihmës duke mundësuar përfshirjen në skemën e NE-së të kategorive që kanë dhe të ardhura të tjera përveç NE-së. Por rezultati siç u përmend dhe në rastet 5-6 është që kjo ndodh duke penalizuar familjet/individët realisht të varfër pa asnjë të ardhur përveç NE-së. Ky rishikim duhet bërë duke i dhënë më shumë pikë familjeve që nuk kanë asnjë të ardhur përveç NE-së dhe si rrjedhojë më pak pikë familjeve që kanë dhe të ardhura të tjera përveç NE-së.

Përditësimi i formulës së unifikuar të pikëzimit propozohet nga ministria përgjegjëse për ndihmën dhe shërbimet shoqërore (MSHMS në lidhje me koeficientët e përdorur në formulën e vlerësimit të konsumit), në varësi dhe të ndryshimeve të nivelit të varfërisë në vend, të publikuar nga INSTAT (për zona të ndryshme të vendit), dhe miratohet me vendim të Këshillit të Ministrave.

Për sa më sipër konkludoj që, bazuar në parimin e “*Respektimit të të drejtave dhe nevojave*”, për një adresimin sa më të mirë të ndihmës ekonomike tek familjet realisht

të varfëra, rekomandoj që të përditësohen treguesit e vlerësimit të formulës së unifikuar të pikëzimit sipas nevojave reale të lartëpërmendura (duke i dhënë më shumë pikë këtyre nevojave reale në krahasim me koeficientët e tjerë të formulës së pikëzimit), që ndihmojnë në përcaktimin e kriterëve të pranueshmërisë të familjeve për përfitimin e NE-së, bazuar kjo e fundit në ligjin nr. 57/2019.

2. Zbatimi i Ndërmarrjeve Sociale për riintegrimin në punë të familjeve/individëve përfitues të NE-së.

Në konkluzionet më lart u përmend se, pagesa në cash e NE-së, që në të shumtën e rasteve përbën të ardhurën e vetme të familjeve përfituese, mbetet ende e pamjaftueshme për të përmbushur kërkesat minimale të jetesës së tyre. Për këtë arsye VKM nr. 597/2019 në zbatim të ligjit nr. 57/2019 parashikon afatin 5 vjeçar për daljen nga skema (janar 2023) të personave në moshë aktive pune, familjet e të cilëve përfitojnë NE, duke i punësuar në tregun e punës, për t'i riintegruar në jetën normale shoqërore. Bazuar në programin e Qeverisë Shqiptare, me mbështetjen e Bankës Botërore, MSHMS ka hartuar “Programin e daljes”, si një program i cili ka si qëllim ndërlidhjen e programeve të mbrojtjes sociale me skema të tjera nxitëse punësimi, duke krijuar mundësinë e integritit në tregun e punës të anëtarëve në moshë pune në skemën e NE-së. Këtë qëllim programi i daljes synon ta realizojë nëpërmjet ndërthurjes /gërshetimit/integritit të paketës së plotë ligjore për ngritjen (*formimin profesional*) dhe funksionimin e ndërmarrjeve sociale me programet e aftësimin për punësim dhe punësimin efektiv në tregun e punës.

Konkretisht, *ligji nr. 65 i vitit 2016 “Për Ndërmarrjet Sociale në Republikën e Shqipërisë”*, synon drejt një përfshirjeje të kategorive në nevojë. Kjo vlerësohet të arrihet përmes: 1. mundësive për punësim efektiv; 2. më tepër mundësi në tregun e punës për kategoritë e veçuara të cilat nuk mund të kenë kapacitete të plota për akses për shkak të moshës, gjendjes shëndetësore apo gjendjes familjare; 3. larmishmëri produkesh dhe shërbimesh me qëllim sigurimin e shanseve për kategoritë në nevojë, duke çuar kështu drejt një hapi më tej për barazi gjinore, si dhe duke vlerësuar se këto shërbime do të *lehtësojnë aksesin e grave drejt punësimit*; 4. më tepër mundësi për përfshirje të kategorive në nevojë, me qëllim nxitjen e bashkëpunimit dhe frymës sociale në shoqëri;

Për të mbajtur statusin e ndërmarrjes sociale duhet të plotësohen kriteret ekonomike dhe kriteret sociale të listuara në ligj. Përmendim disa prej tyre si vijon: 1. në veprimtarinë e saj ndërmarrja sociale, përveç kontributit të vullnetarëve, duhet të përfshijë domosdoshmërisht edhe, të paktën, 3 punonjës me pagesë; 2. të paktën, 30% e punonjësve të punësuar në ndërmarrjen sociale duhet t’i përkasin kategorisë së grupeve të pafavorizuara nga pikëpamja sociale dhe ekonomike. Natyrshëm që këto janë dhe kategoritë me problematika sociale, të ndodhur në kushte të tilla për shkaqe të ndryshme si mosintegrimi në tregun e punës, diskriminimi shoqëror ose dhe vetë paragjykimin që mund të kenë për gjendjen në të cilën kanë rënë.

Ndërmarrjet Sociale e ushtrojnë veprimtarinë në shumë fusha të tilla si: sektori shoqëror, integrimi në tregun e punës, përfshirja për të rinjtë në trajnime të aftësimit profesional drejt punësimit, shëndetësia, arsimimi, zhvillimi lokal dhe rural, etj. Këto fusha janë në fokus të zbatimit të ligjit nr. 57/2019.

Bazuar në frymën e legjislacionit për ndërmarrjet sociale, vlerësohet se zhvillimi i tyre do mund të arrihet përmes masave me natyrë financiare duke u mbështetur natyrisht nga shteti dhe jo vetëm. Pushteti vendor ka përgjegjësinë e tij ligjore gjithashtu për të nxitur zhvillimin e tyre. Në këtë nivel kërkohet përfshirja e ndërmarrjeve sociale edhe në fushat e prokurimit publik, duke respektuar legjislacionin përkatës.

Në lidhje me ngritjen dhe funksionimin e ndërmarrjeve sociale, *Drejtoria e Përgjithshme e Politikave dhe Zhvillimit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale* (në MSHMS), shprehet se aktualisht 4 subjekte kanë përfituar statusin por ende nuk kanë filluar zbatimin e funksioneve të tyre.

Për sa më sipër konkludoj që, ashtu siç vijon *krijimi i lidhjes së qëndrueshme midis skemës së ndihmës ekonomike dhe skemave të punësimit, arsimit profesional dhe programeve të përgatitjes për punësim*, rekomandoj që meqenëse të paktën 30% e punonjësve të punësuar në ndërmarrjet sociale duhet t'i përkasin kategorisë së përfituesve të NE-së, të vijojë edhe nxitja për fillimin sa më të shpejtë dhe afatgjatë e zbatimit të funksionimit të ndërmarrjeve sociale, me synim *fuqizimin dhe aktivizimin e familjes dhe individit, nga ana e pushtetit qendror dhe atij vendor*.

**3. Përmirësimi i shërbimeve të kontrollit për të reduktuar numrin e abuzimeve në
DRSHSSH-së.**

Siç përmendëm në seksionin e konkluzioneve, është përmirësuar cilësia e shërbimeve të kontrollit/auditit për të reduktuar numrin e abuzimeve, nëpërmjet forcimit të kapaciteteve dhe rritjes së ndërgjegjësimit të nëpunësve civil përgjegjës. Për këtë qëllim janë shtuar si pjesë e grupit të kontrollit në nivel qendror dhe rajonal pozicioni i juristit

dhe IT-së (teknologji informacioni), sipas Udhëzimit nr. 714/2018 të MSHMS në zbatim të ligjit nr. 57/2019. Por kjo shtesë është e pjesshme dhe jo e plotë siç do argumentohet në vijim:

Grupi i kontrollit të strukturave rajonale, kontrollon zbatimin e legjislacionit për ndihmën ekonomike në njësitë administrative të pushtetit vendor. Paralelisht grupi i kontrollit të Drejtorive Rajonale të SHSSH-së, verifikon mospërputhjet e të dhënave të familjeve/individëve aplikues për NE pas kryerjes nga ana e sistemit elektronik të verifikimit automatik (sistemi elektronik automatikisht kontrollon on-line të dhënat e hedhura në kohë reale, duke ndërvepruar me sistemet e institucioneve të tjera), dhe mospërputhjet e të dhënave manuale të familjeve/individëve aplikues për NE pas përgjigjes zyrtare të institucioneve që ende nuk kanë një sistem on-line (VKM nr. 597/2019).

Në Rregulloren e SHSSH-së e cila përcakton edhe ndarjen e detyrave funksionale të specialistëve të DRSHSSH-ve përcaktohet shprehimisht se, dy specialistët financiar dhe jurist të cilët kryejnë kontrole në njësitë administrative të pushtetit vendor për pagesat e NE-së gjithashtu kanë në përgjegjësi edhe procesin e verifikimeve automatike dhe manuale të lartëpërmendura sipas legjislacionit në fuqi. Pra grupi i kontrollit të NE-së të Drejtorive Rajonale, verifikon në sistem familjet/individët përfitues të NE-së dhe njëkohësisht i kontrollon këto përfitues në pushtetin vendor. Duket qartë të ketë një konflikt interesi ndaj pozicionit të punës së tyre.

Për sa më sipër konkludoj që, për një zbatim sa më efikas, eficient dhe efektiv të ligjit nr. 57/2019 si rrjedhojë e këtij konflikti interesi rekomandoj, të ketë një rritje të numrit të

punonjësve prej dy personash (jurist dhe ekonomist) në DRSHSSH-të nga ana e pushtetit qendror, me qëllim ndarjen në dy grupe në cilësinë e verifikuesve njëri grup dhe në cilësinë e kontrolluesve në njësitë administrative grupi tjetër, për të eliminuar abuzimet e mundëshme.

4. Përcaktimi i një numri të kufizuar familje/individ përfitues të NE-së në përgjegjësinë e Administratorit Shoqëror.

Siç është përmendur dhe në analizën e punimit, roli i administratorit shoqëror mbetet kyç në efikasitetin e zbatimit të reformës së dixhitalizimit por dhe të ecurisë të skemës së NE-së në vijim. Pikat më të dobëta në punën e institucioneve dhe individëve të përfshirë në zbatimin e programit të NE-së ishin dhe vazhdojnë ende të jenë numri i vogël i administratorëve shoqëror për banorë/familje/aplikantë që nuk i përgjigjet nevojës për të realizuar intervista në terren, në familje si dhe për të verifikuar fizikisht banesat dhe kushtet e jetesës së përfituesve një apo dy herë në vit, siç parashikohet në ligj. Kjo mungesë bëri emergjente nevojën për rritjen e kapaciteteve institucionale të zyrave rajonale dhe lokale, dhe të administratorëve shoqëror të NE-së. Kjo mungesë u realizua pjesërisht në nivel rajonal siç u përmend në rekomandimin nr 3, ndërsa në nivel vendor ekziston ende. *Ligji nr. 139/2015 “Për vetëqëverisjen vendore”, përcakton se kryetari i Bashkisë ka kompetencë të miratojë strukturën e administratës të kësaj të fundit. Ai gjithashtu emëron dhe shkarkon punonjësit e tjerë të strukturave dhe njërive në varësi të bashkisë.* Mungesa e një baze ligjore e cila do të duhej të përcaktonte një raport të drejtë dhe objektiv midis numrit të aplikantëve dhe përfituesve të ndihmës për çdo administrator shoqëror ka ekzistuar dhe vijon ende të ndikojë në mënyrën e organizimit të brendshëm të tyre.

Si rrjedhojë, shtrohet nevoja e standartizimit të raportit midis numrit të administratorëve social në çdo njësi administrative me numrin e familjeve të NE-së në shkallë vendi. Kjo sepse në terren ka diferenca të ndjeshme nga njëra njësi administrative tek tjetra. Konkreisht për Qarkun e Elbasanit përmendim njësitet administrative që kanë numër të lartë dhe të ulët përfituesish dhe kanë vetëm një administrator shoqëror: Qendër-Librazhd 800 familje; Qukës 964 familje; Rrajcë 975 familje; Kukur 454 familje; Labinot-Mal 619 familje; Shushicë 418 familje; Hotolisht 596 familje; Përrenjas 400 familje; Orenjë 509 familje; Polis 409 familje; Fierzë; 78 familje; Rrasë 89 familje; Gostimë 121 familje; Klos 78 familje; Shalës 56 familje; Steblevë 54 familje; Kushovë 121 familje; Lenie 111 familje; Sult 101 familje.

Për sa më sipër konkludoj që, për një zbatim sa më efikas, eficient dhe efektiv të ligjit nr. 57/2019, rekomandoj të përcaktohet një numër familjesh/individësh i kufizuar për secilin Administrator Shoqëror, nga ana e pushtetit vendor. Ky numër të variojë nga 250 deri në 350 familje/individ përfitues të ndihmës ekonomike për secilin administrator në varësi të terrenit (fushor, malor, urban apo rural) dhe kushteve të infrastrukturës.

5. Përmirësimi i shërbimeve të kontrollit në Bashki për të reduktuar numrin e abuzimeve

Cilësia dhe kualifikimi i administratorëve shoqëror ishin që në fillesat e NE-së të pamjaftueshëm. Kjo situatë vazhdon të jetë ende dhe sot, për arsye të ndryshimit të shpeshtë të tyre pa shkak të vlefshëm nga eprori. Kujtojmë që, emërimi dhe largimi nga detyra i administratorëve shoqëror është një e drejtë ligjore e organit të pushtetit vendor Bashkisë (ligji nr. 139/2015 “Për vetëqëverisjen vendore”, neni 64).

Në funksion të ushtrimit të detyrave në fushën e NE-së (dhe jo vetëm), administratorit shoqëror i delegohen detyra nga organe të pushtetit qendror, duke u monitoruar direkt prej tyre (MSHMS/SHSSH). Njëkohësisht zbatimi i detyrave funksionale të administratorit shoqëror monitorohen në mënyrë të vazhduar për të shmangur veprime të kryera në kundërshtim me ligjin, duke bashkëpunuar me Drejtorinë Rajonale të SHSSH-së edhe nga ana e Strukturave Përgjegjëse për Shërbimet Sociale të Bashkive (drejtori ose sektor). Pothuajse në të gjitha Bashkitë e vendit mungojnë pjesërisht ose plotësisht këto struktura. Duket të ketë një sistem dualist të kontrollit ndaj pozicionit të punës së administratorit shoqëror (vendor/qendror), por që në nivel vendor ka mangësi.

